



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

RAPORTI I VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE 2020-2024

DHJETOR 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

RAPORTI I VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE 2020- 2024

DHJETOR 2024

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	12
2. Qëllimi dhe metodologjia e vlerësimit.....	14
2.1. Kufizimet e vlerësimit.....	20
3. Gjetjet kryesore.....	21
3.1. Rëndësia dhe koherenca e objektivave të PKBGJ-së.....	21
3.1.1. Inputet gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së.....	26
3.2. Efektiviteti i PKBGJ-së.....	43
3.3. Vlerësimi i efijencës.....	86
3.4. Ndikimi i PKBGJ-së.....	87
3.5. Vlerësimi i qëndrueshmërisë.....	89
3.5.1. Qëndrueshmëria institucionale.....	89
3.5.2. Qëndrueshmëria financiare.....	94
3.5.3. Sfidat lidhur me qëndrueshmërinë.....	97
4. Rekomandime për Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.....	99

Lista e figurave

Figura 1: Statusi i arritjes së caqeve të indikatorëve të PKBGJ-së, sipas shtyllave.....	44
Figura 2: Të dhënat përmbledhëse lidhur me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të PKBGJ-së, numri I aktiviteteve.....	44

Lista e tabelave

Tabela 1: Evidenca e raportimit të komunave për periudhën 2020-prill 2024.....	18
Tabela 2: Statusi i arritjes së caqeve të synuara në Objektivin strategjik 1.....	57
Tabela 3: Lëndët me perspektivë gjinore në Universitetin e Prishtinës.....	64
Tabela 5: Statusi i arritjes së caqeve të synuara në Objektivin strategjik 2.....	73
Tabela 6: Statusi i arritjes së caqeve të synuara në Objektivin strategjik 3.....	86

Lista e shkurtesave

ABGJ	-	Agjencia për Barazi Gjinore
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BPGJ	-	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
DSPF	-	Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjeve
EIGE	-	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
FSK	-	Forca e Sigurisë së Kosovës
GREVIO	-	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
ILO	-	Organizata Ndërkombëtare e Punës
LBGJ	-	Ligji për Barazi Gjinore
MAPL	-	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MATP	-	Masat Aktive të Tregut të Punës
MASHTI	-	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	-	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MZHR	-	Ministria e Zhvillimit Rajonal
MCC	-	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
MFPT	-	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
PKBGJ	-	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
RROGRAEK	-	Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës
QAP	-	Qendrat e Aftësisë Profesionale/Agjencia e Punësimit
QKMF	-	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKRMT	-	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QPS	-	Qendrat për Punë Sociale
QRK	-	Qeveria e Republikës së Kosovës
RRGK	-	Rrjeti i Grave të Kosovës
SSHP	-	Siguria dhe Shëndeti në Punë
UA	-	Udhëzim Administrativ
VNGJ	-	Vlerësimi i Ndikimit Gjinor
ZBGJ	-	Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore

Ky vlerësim u realizua nga Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, e mbështetur nga UN Women në Kosovë, si pjesë e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Instrumenti për Barazi Gjinore” si dhe projekti “Financimi transformues për barazinë gjinore në Ballkanin Lindor” financuar nga SIDA.

Përmbledhje ekzekutive

Një nga politikat kyçe që synon të mbyll boshllëkun në zhvillim mes burrave dhe grave është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ), i cili është hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ) dhe si e tillë është e vetmja politik publike obliguese me ligj të hartohet dhe aprovohet nga QRK. Deri më tani, Agjencia ka hartuar dhe zbatuar dy PKBGJ, e para e cila ka mbuluar periudhën nga 2008 deri më 2013 ndërsa e dyta që është objekt i këtij vlerësimi përfshin periudhën 2020-2024.

Deklarata e misionit të PKBGJ-së ishte *“Kosova të sigurojë që barazia gjinore të jetë në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve”*. Ky objektiv synon të arrihet duke punuar në tri drejtime/tri objektivave strategjike në tri shtyllat kryesore të PKBGJ-së: *Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale; Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore; dhe avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore.*

Objektivi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është që të përcaktojë shkallën e përparimit të shënuar ndërmjet viteve 2020- fundi i prillit 2024 drejt përmbushjes së vizionit të PKBGJ-së të shprehur më lartë. Fushëveprimi i këtij vlerësimi mbulon të gjitha fushat e identifikuara të Programit, si dhe arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme të tyre siç përcaktohet në dokumentin e PKBGJ 2020-2024. Pyetjet kryesore të vlerësimit janë:

- a) nëse ishin relevante objektivat e PKBGJ-së, logjika dhe koherenca, si dhe ndikimi i tyre i synuar dhe i arritur për secilin objektiv;
- b) vlerësimi i shkallës në të cilët objektivat dhe aktivitetet në kuadër të PKBGJ-së janë arritur dhe zbatuar;
- c) vlerësimi se sa burimet e financimit, personelit, ato rregullative, administrative, kohore dhe të tjera i kanë kontribuar ose kanë penguar arritjen e rezultateve;
- d) në çfarë shkalle dhe mënyre ka përmirësuar zbatimin e PKBGJ-së gjendjen e grave dhe burrave në Kosovë, veçanërisht të grave;
- e) vlerësimi nëse rezultatet e strategjisë përfshirëse gjinore janë të qëndrueshme në kohë, pra nëse kanë arrite ti përballojnë sfidat.

Metodologjia e aplikuar për këtë vlerësim bazohet në kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) (QRK) Nr. 07/2018 dhe Manualin për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Vlerësimi është realizuar në përputhje me parimet, standardet dhe praktikën të cilat i respektojnë standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare ashtu siç janë formuluar në kuadër të Vlerësimit të Parimeve të OBZHE. Është përdorur një gamë e gjerë e metodave për të siguruar informata për këtë vlerësim.

Për këtë vlerësim janë përdorur të dhënat nga dy raportet e para të monitorimit dhe vlerësimit të PKBGJ-së për periudhën 2020-2022. Për vitin 2023, dhe periudhën janar-prill 2024, të dhënat janë siguruar nga raportet e dërguara nga institucionet në nivelin qendror dhe lokal, nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Për matjen e arritjes së indikatorëve të dhënat u siguruan nga ABGJ, ministritë, komunat, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia Kadastrale, Banka Qendrore, Policia e Kosovës, e të tjera. Për këtë vlerësim dhe për të mësuar lidhur me ndikimin e granteve të fituara nga ABGJ gjatë pandemisë COVID-19 informata u mbledhën edhe përmes intervistave me aktorët aktiv në fushën e barazisë gjinore.

Rezultatet e prezantuara në këtë raport të vlerësimit janë të nënvlerësuara për shkak të këtyre arsyeve kryesore:

- a) ndërsa indikatorët e synuar në PKBGJ i referohen fundit të vitit 2024, shumica e të dhënave të siguruar për treguesit i referohen fundit të vitit 2023;
- b) përkundër përpjekjeve nga ABGJ nuk u arrit të sigurohen të dhënat nga të gjitha ministritë, komunat, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtar që janë aktiv në fushën e barazisë gjinore; raportimet e pranuar nga institucionet dhe organizatat nuk kanë qenë tërësisht plotë, dhe kanë munguar të dhënat për buxhetin e shpenzuar për të gjitha aktivitetet e zbatuara.
- c) Kufizimet në vlerësim janë edhe në mungesë të të dhënave për disa nga indikatorët e PKBGJ-së dhe mungesës së vlerës bazë për një nga indikatorët e përcaktuar në PKBGJ.
- d) Gjatë leximit të këtij raporti të vlerësimit duhet pasur parasysh se gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ ndikim negativ kishte pandemia COVID-19 që pengoi punën e të gjitha institucioneve, dhe zhvendosi fokusin drejt mbështetjes emergjente si të institucioneve publike po ashtu edhe të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare.

Nga gjithsej 36 indikatorëve të synuar në kuadër të PKBGJ-së :

- a) vetëm 8 janë arritur (22% të caqeve),
- b) 14 nuk janë arritur,
- c) për 12 indikatorë nuk janë siguruar të dhënat,
- d) për 2 indikatorë në Objektivin e 3-të nuk ka qenë e mundur të raportohet: njëri cak nuk ishte mirë i definuar dhe për tjetrin në mungesë të vlerës bazë nuk ishte caktuar as caku.

Në përqindje në :

- 1. Objektivin e parë nga 10 caqet e synuara për vitin 2024, 30% u arritën, në
- 2. Objektivin e dytë nga 12 caqe u arritën 25% e caqeve të caktuara ndërsa në
- 3. Objektivin e tretë nga 14 caqe u arritën caqet për vetëm 14% të indikatorëve.

Elaborim i detajuar do të prezantohet sipas Objektivave veç e veç në këtë seksion.

Sa i përket realizimit të aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit të PKBGJ-së në mesin e 178 aktiviteteve të planifikuara u punua në 147 sosh do të thotë në 83% e aktiviteteve u punua (Figura 2). Shkalla e zbatimit të aktiviteteve sipas shtyllave është si në vijim:

- 1. në Shtyllën 1 u puna në 97% të aktiviteteve të planifikuara;
- 2. në Shtyllën 2 u punua në 81% të aktiviteteve të planifikuarave; dhe
- 3. në Shtyllën 3 u punua në vetëm 61% të aktiviteteve të planifikuara.

Në Shtyllën Fuqizimi Ekonomik dhe Mirëqenia Sociale u arritën këto rezultate:

- a) norma e punësimit tek gratë u rrit nga 13.9% (2019) në 19.8% (2023);
- b) pjesëmarrja e grave pronare e bizneseve u rrit nga 11% (2018) në 18% (2023);
- c) dhe përqindja e grave si pronare e shtëpive/banesave u rrit nga 12% (2018) në 19.8% (2023).

Në këtë shtyllë me rëndësi për tu përmendur është edhe rëndësia e miratimit të koncept dokumentit për BPGJ dhe vazhdimin e punës të cilën po e bën ABGJ dhe MFPT për sigurimin e zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; vendosja e sistemit të vlerësimit të ndikimit gjinor (VNGJ) me rreth 700 zyrtarë të trajnuar të ministrive dhe manualin për VNGJ të publikuar në vitin 2019.

Mbështetje për rritjen e punësimit u ofrua në vazhdimësi nga: masat aktive të tregut të punës nga Agjencia e Punësimit; përmes skemës Superpunës; subvencioneve dhe granteve në bujqësi nga MBPZHR dhe komunat; masave mbështetëse në kuadër të masave në kohën e pandemisë COVID-19; dhe mbështetjes së ndërmarrjeve.

Në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike buxheti prej 2 milion Euro iu nda ABGJ-së e cila me një milion Euro mbështeti 115 kopshteve private dhe në partneritet publiko-privat të udhëhequra nga 108 gra, siguruan punësimin e 1,145 grave. Me një milionin tjetër ABGJ mbështeti: 273 bizneseve të vogla në pronësi të grave, dhe 24 OJQ nëpërmes të cilave shërbime përfituan 1,296 gra dhe vajza.

Masa të targetuara për zbutjen e varfërisë në energji dhe energjisë eficiente u zbatuan nga Ministria e Ekonomisë duke mbështetur 6,353 gra në vlerë prej 1.8 milionë Euro; 24 biznese të vogla dhe të mesme në pronësi të grave me vlerë prej 6,373 Euro; dhe u mbështetën aktivitetet e disa OJQ-ve në fushën e TIK-ut dhe efijencës së energjisë me vlerë prej 44,715 Euro. Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë mbështeti 157 familje përfituese gra në vlerë prej 591,354 Euro.

Në Shtyllën e dytë Zhvillimi njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore u shënuan këto rezultate:

- a) Përqindja e fëmijëve të moshës 0-4 vjeçare, në institucione parashkollore-shkalla bruto e regjistrimit: Arritje 7.2% ndërsa caku për vitin 2024 ishte 6%;
- b) Janë 17 lëndë në Universitetin e Prishtinës me perspektivë gjinore ndërsa caku ishte 15 lëndë;
- c) Në periudhën 2020-2023 u mbështetën me bursa 4,630 vajza në fushat STEM me buxhet prej 4.6 milionë Euro;
- d) Në vitin 2024 -vaksina kundër virusit HPV u bë pjesë e kalendarit të vaksinave për vajzat e moshës 15 vjeçare;
- e) Është rritur numri i vizitave për nënat shtatzëna dhe për foshnje (68,151 vizita në shtëpi për fëmijë 0-3 vjeç të realizuara në vitin 2022-2023);
- f) Është rritë mbështetja financiare nga MKRS për vajzat dhe gratë në sport, art dhe trashëgimi kulturore.

Qasja në drejtësi u avancua përmes një sërë veprimesh dhe mbështetje:

- a) Konventa e Stambollit u përfshi në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- b) Është aprovuar Ligji i ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në baza Gjimore;
- c) Është aprovuar Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe dhuna në baza Gjimore (2022-2026);
- d) Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
- e) Është amandamentuar Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas;
- f) Është hartuar Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, dhe Protokolli Shtetëror për Trajtimin e rasteve të Dhunës seksuale;
- g) Është hartuar udhëzuesi për Buxhetimin Operacional të Strehimoreve në Kosovë dhe Udhëzuesi i Projektimit.

Në shtyllën e tretë Gratë, Paqja dhe Siguria arritjet kryesore janë:

- a) Është rritur në 45.6% të përfaqësimit të grave në institucione publike (në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror); arritja e 32.1% të pozitave drejtuese nga gratë (36.4% në nivel të drejtues të ulët (udhëheqëse të divizioneve/sektorëve); 20.4% në mesin e drejtues të mesëm (drejtor të departamenteve); dhe 23.1% në mesin e drejtuesve të lartë (Sekretar të Përgjithshëm/Drejtor Ekzekutiv);
- b) 40.8% e pozitave drejtuese dhe të larta drejtuese në nivelin komunal (drejtor të drejtorive) mbulohet nga gratë;
- c) Rritja e pjesëmarrjes së grave në bordet e ndërmarrjeve publike nga 10% sa ishte në vitin 2017 në 43% në vitin 2024;
- d) Gjatë kohës së zbatimit të PKBGJ-së u zhvilluan module të reja në data-bazën nacionale për evidentimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovës;
- e) Janë hartuar masa e punësimit për gratë viktime të dhunës;
- f) Është vazhduar afati i punës së Komisionit Qeveritar për identifikimin dhe verifikimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës dhe nga 2,074 aplikacione të pranuar u trajtuan 2,033 (98%)-nga këto 1,688 u aprovuan;

g) Gjatë periudhës 2020-prill 2024, 11.3 milionë Euro janë ndarë nga QRK për pensionet e të mbijetuarve/ave nga dhuna seksuale gjatë luftës, është mbështetur Komisioni për Verifikimin e Statusit dhe 4-OJQ-të mbështetëse në këtë proces. Kosova është duke ofruar model unik të mbështetjes së mbijetuarve/ave të dunës seksuale gjatë luftës.

Faktorët mbështetës në arritjen e këtyre rezultateve janë:

- A) Vullnet politik; ndërgjegjësimi për rëndësinë e zbatimit;
- B) Ofrimi i asistencës teknike në momentin e duhur-sipas kërkesave të bazuara në nevojë të përfituesit;
- C) Fuqizimi i rolit të Agjencisë për Barazi Gjinore përmes eksperiencës dhe ekspertizës së fituar dhe lidërshit;
- D) Angazhimi OJQ-ve dhe partnerëve ndërkombëtar, në fusha të ndryshme për të avancuar barazinë gjinore;
- E) Bashkëpunimi në vazhdimësi i ABGJ me organizatat e grave përmes takimeve të rregullta dhe organizimeve të përbashkëta;
- F) Ngritja e kapaciteteve të ZBGJ-ve në nivelin qendror dhe lokal; bashkërendimi i ABGJ-së me institucionet e linjës;
- G) Angazhimi shtuar i komunave në prioritetimin e aktiviteteve të PKBGJ-së.

Progresi është sfiduar nga faktorët në vijim:

1. Mungesa e emërimit të ZBGJ-ve në disa ministri dhe komuna;
2. Mungesa e ekspertizës-integritit gjinorë në fushën e barazisë gjinore në institucione edhe tek partnerët ndërkombëtarë;
3. Moszbatimi i instrumenteve të qendërimit gjinor në hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre (si VNGJ, analiza gjinore, buxhetim gjinor, mbledhja e të dhënave me bazë gjinore, etj.); dhe
4. Mungesa në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave administrative; qasja e limituar në të dhëna; dhe mos-raportimi nga institucionet në përputhje me metodologjinë dhe afatet e përcaktuara kohore periodike.

Lidhur me arritjen e objektivave sfidat kryesore mbesin në:

1. Rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës;
2. Qasjen e barabartë në fonde publike; rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme;
3. Zvogëlimin e hendekut në ndarjet gjinore në profesione;
4. Rritja e përfaqësimit të grave në pozita drejtuese në shkolla; në Kuvendin e Kosovës, Kuvendet Komunale; përfaqësimin në pozitat e lartë vendimmarrëse;
5. Rritjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës;
6. Zvogëlimin e dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore;
7. Të sigurohet përfaqësimi i grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit.

PKBGJ-ja e ardhshme duhet të përforcoj analizën jo vetëm të gjendjes aktuale por edhe të shkaktarëve që ndikojnë në pabarazinë gjinore. Duhet të zgjerohet lista e aktiviteteve për avancim në fushën e sportit: mjedisit; transportit; kulturës; dhe fushave të tjera të kohës.

Në PKBGJ-në e ardhshme duhet siguruar që për secilën fushë të këtë indikatorë për matjen e progresit dhe indikatorët të plotësojnë kushtet që të jenë të matshëm, të arritshëm dhe specifik.

Është e domosdoshme që në PKBGJ-në e ardhshme të vazhdojnë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e ndikimit gjinor.

Gjatë procesit të hartimit të PKBGJ së re duhet të përfshihet Kuvendi i Republikës së Kosovës si në analizën e situatës, indikatorët dhe aktivitete duhet të përfshihen dhe përcaktohen për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

1. HYRJE

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore është hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ), me përfshirje të gjerë të partnerëve kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe është e vetmja politik publike e cila është obligative sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe që kërkohet të raportohet në Kuvendin e Kosovës dhe që raportet të bëhen publike. Që nga themelimi Agjencia ka zbatuar dhe raportuar për dy Programe, njërin për periudhën 2008-2013, ka prezantuar dy raporte periodike për vitet 2020-2021- 2022, dhe raporti final që është subjekt i këtij vlerësimi që përfshin periudhën 2020-2024. Programi për periudhën 2020-2024 mbulon 9 objektiva specifike që bien në tri fushat e mëposhtme programatike:

1. Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me synim “Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në/nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale”;
2. Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore me synim “Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore”;
3. Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguri që synon “Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore”.

Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës kërkon monitorim, vlerësim dhe raportim periodik mbi zbatimin e politikave publike të Kosovës nga perspektiva e barazisë gjinore. ABGJ-ja është akteri kryesor për koordinimin e realizimit të këtyre veprimeve, dhe përhapjen e gjetjeve tek të gjitha institucionet shtetërore, partnerët dhe shoqërinë në përgjithësi, duke synuar avancimin e barazisë gjinore në Kosovë dhe adresimin e sfidave të ndërlidhura me barazinë gjinore. Prandaj, vlerësimi i PKBGJ kërkon të përcaktoj progresin e arritur gjatë periudhës janar 2020 deri në fund të prillit 2024 në fushën e barazisë gjinore dhe të gjeneroj njohuri mbi pengesat të cilat kanë ndaluar progresin e barazisë gjinore në Kosovë.

Gjithashtu, ky vlerësim është një aktivitet i rëndësishëm për mësim nga palët e përfshira, të cilat do e informonin zhvillimin e dokumentit të ri të PKBGJ.

Vlerësimi është realizuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ (UA) (QRK) Nr. 07/2018 dhe Manualin për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, parimet, standardet dhe praktikën të cilat i respektojnë standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare ashtu siç janë formuluar në kuadër të Parimeve të Vlerësimit të OBZHE. Periudha e raportimit përfshin periudhën janar 2020 deri në maj 2024, do të thotë nuk mbulon 8

muajt e fundit të ciklit jetësor të PKBGJ-së. Duke pasur parasysh se ABGJ ishte në fazën e inicimit të punës për hartimin e PKBGJ-së së re u vendos që raportimi të bëhej deri në Prill të viti 2024, në mënyrë që të përdoreshin të dhënat e raportimit për dokumentin e ri strategjik. Për arsye të vonesave në raportim nga ana e disa institucioneve dhe partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, faza e finalizimit të raportit është shtyrë, dhe jemi koshient se ka aktivitete të cilat nuk janë përfshirë sepse ishin në zhvillim e sipër. Sido që të jetë rekomandim i kësaj ndërmarrjeje duhet të jetë një sistem më eficientë monitorimi dhe koordinim më i mirë mes palëve. E rëndësishme është se ABGJ prodhoi tre raporte vlerësimi për këtë dokument strategjik-PKBGJ 2020-2024.

Ky raporti është strukturuar si më poshtë: Kapitulli 2 e vë në pah metodologjinë e aplikuar të ndjekur nga prezantimi i kufizimeve të vlerësimit, të paraqitur në Seksionin 2.1.

Gjetjet kryesore janë paraqitur në Kapitullin 3, dhe përbëhen nga vlerësimi i relevancës, efikasitetit, eficiencës, ndikimit, dhe qëndrueshmërisë së ndikimit.

Raporti përfundon me një përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe nxjerr mësimet për të informuar zhvillimin e një Programi të ardhshëm të Kosovës për Barazinë Gjinore.

2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020- 2024¹ është hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ). Hartimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) është obligim i përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore 05/L -020. Neni 11, i cili obligon Agjencinë për Barazi Gjinore të bashkërendoj përgatitjen e Programit, të monitoroj zbatimin e tij, si dhe të raportoj çdo vit tek Qeveria për zbatimin e tij. Ky Nen, po ashtu përcakton që Qeveria shqyrton dhe miraton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe raportin çdo vit në Kuvend për zbatimin e tij, dhe këto raporte bëhen publike.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 synon *të sigurojë që barazia gjinore të jetë në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve*. Ky objektivi synon të arrihet duke punuar në tre drejtime/tre objektivate strategjike në tre shtyllat kryesore të PKBGJ-së:

1. Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në/nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;
2. Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore; dhe
3. Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore.

Fushëveprimi dhe përqendrimi

Objektivi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është që të përcaktojë shkallën e përparimit të shënuar ndërmjet viteve 2020- fundi i prillit 2024 drejt përmbushjes së vizionit të PKBGJ-së të shprehur më lartë. Fushëveprimi i këtij vlerësimi mbulon të gjitha fushat e identifikuara të Programit, si dhe arritjen e objektivate dhe rezultateve të pritshme të tyre siç përcaktohet në dokumentin e PKBGJ 2020-2024. Ky raport i vlerësimit është mbështetur nga UN Women në Kosovë, si pjesë e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Instrumenti për Barazi Gjinore”, si dhe projekti “Financimi transformues për barazinë gjinore në Ballkanin Lindor” financuar nga SIDA.

Vlerësimi po ashtu ka për qëllim të informoj ABGJ-në në hartimin e PKBGJ-së së re për periudhën 2025-2035.

¹<https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024%20-%20SHQIP%20-%20FINAL.pdf>

Në kuadër të 3 shtyllave të PKBGJ-së 2020-2024 objektivat e përcaktuara janë si në vijim:

SHTYLLA 1: FUQIZIMI EKONOMIK DHE MIRËQENIA SOCIALE

1. Rritja e punësimit të grave dhe vajzave; dhe
2. Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime.

SHTYLLA 2: ZHVILLIMI NJERËZOR DHE ROLET DHE MARRËDHËNIET GJINORE

1. Barazia gjinore trajtohet si kusht për arsim cilësor, gjithëpërfshirës;
2. Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore; dhe
3. Gjithë përfshirja në kujdesin cilësor shëndetësor dhe edukimi shëndetësor i popullatës mbi barazinë gjinore, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues.

SHTYLLA 3: TË DREJTAT E GRAVE, QASJA NË DREJTËSI DHE SIGURI

1. Fuqizimi i mekanizmave institucional dhe ngritja e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi;
2. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore;
3. Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë; dhe
4. Ngritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit, përfaqësive diplomatike dhe misioneve jashtë vendit.

Ky vlerësim ndjek parimet, standardet dhe praktikën, duke respektuar standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të formuluar në Parimet e Vlerësimit të Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBZHE-së).

Pyetjet kryesore të vlerësimit janë:

Vlerësimi i relevancës: Nëse ishin relevante objektivat e PKBGJ-së, logjika dhe koherenca, si dhe ndikimi i tyre i synuar dhe i arritur për secilin objektiv,

Vlerësimi i efikasitetit: Vlerësimi i shkallës në të cilët objektivat dhe aktivitetet në kuadër të PKBGJ-së janë arritur dhe zbatuar;

Vlerësimi i efijencës: Vlerësimi se sa burimet e financimit, personelit, ato rregullative, administrative, kohore dhe të tjera i kanë kontribuar ose kanë penguar arritjen e rezultateve;

Vlerësimi i ndikimit: Në çfarë shkalle dhe mënyre ka përmirësuar zbatimin e PKBGJ-së gjendjen e grave dhe burrave në Kosovë, veçanërisht të grave;

Vlerësimi i qëndrueshmërisë: Shqyrtimi i qëndrueshmërisë së çështjeve gjinore si çështje ndër-sektoriale në politikat publike të Qeverisë së Kosovës, pra vlerësimi nëse rezultatet e strategjisë përfshirëse gjinore i 'përballojnë' kohës. Vlerësimi do të fokusohet edhe në identifikimin e inputeve gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së respektivisht në identifikimin e legjislacionit të ri, strategjive kombëtare, mekanizmave shtesë.

Në përputhje me metodologjinë e aplikuar në vlerësimin e PKBGJ-së së parë kriteret shtesë që janë vlerësuar janë si në vijim:

Metodologjia e vlerësimit

Metodologjia e aplikuar për këtë vlerësim bazohet në kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) (QRK) Nr. 07/2018 dhe Manualin për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Vlerësim në tërësi është në përputhje me Udhëzimin Administrativ. Natyra e nismave të politikave kombëtare, ndër-sektoriale dhe horizontale të tilla si Programi i Kosovës për Barazi Gjinore kërkon përdorimin e një sërë metodash dhe mjetesish për vlerësimin e zbatimit të tij strategjik dhe operativ në nivel të qeverisë qendrore dhe lokale, si dhe ndikimin e tij në jetën e grave dhe burrave në Kosovë.

Burimet dytësore të të dhënave

Për këtë vlerësim janë përdorur të dhënat nga dy raportet e para të monitorimit dhe vlerësimit të PKBGJ-së për periudhën 2020-2022. Për vitin 2023 dhe periudhën janar-prill 2024 të dhënat janë siguruar nga raportet e dërguara nga institucionet në nivelin qendror dhe lokal, nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e masave afirmative, janë analizuar dokumentet strategjike dhe planet e veprimit të zhvilluara në periudhën janar 2020-prill 2024. Për matjen e arritjes së indikatorëve të

dhënat u siguruan nga ABGJ, ministritë, komunat, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia Kadastrale, Banka Qendrore, Policia e Kosovës, e të tjera. Informatat mbi aktivitetet e ndërmarra nga ABGJ dhe ZBGJ-të e ministrive dhe komunave u morën edhe nga Buletini i ABGJ-së dhe nga raportet e rregullta periodike të ofruara për këtë vlerësim nga ZBGJ-të. Ky vlerësimi është bazuar në të dhënat e siguruara nga institucionet vendore si në vijim:

1. Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit;
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës;
3. Banka Qendrore e Kosovës;
4. Ministria e Financa, Punës dhe Transfereve duke përfshi edhe Agjencinë e Punësimit;
5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
6. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
7. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
8. Ministria e Ekonomisë;
9. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
10. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
11. Ministria e Mbrojtjes;
12. Ministria e Punëve të Brendshme;
13. Ministria e Zhvillimit Rajonal;
14. Ministria e Drejtësisë;
15. Ministria për Minoritete dhe Kthim;
16. Policia e Kosovës; dhe
17. Fondi për Garantimin e Kredive.

Në vitin 2020 dhe 2021 nuk raportoi Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ndërsa për vitin 2023 dhe periudhën janar-prill 2024 nuk raportuan në formularin e kërkuar këto ministri: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Mos emërimi i ZBGJ-ve në disa nga Ministritë dhe komunat ka afektuar dukshëm në zbatimin e aktiviteteve, mbledhjen dhe raportimin e informacionit. Vlen të përmendet se përgjatë tërë ciklit të PKBGJ, ministritë si MKRS- nuk arriti të rekrutoj ZBGJ; MPJ nuk arriti të emëroj pozitë të përhershme të ZBGJ-se; ndërsa me fuzionimin e Ministrive dhe daljen në pension të ZBGJ-së MFPT, transferoj ZBGJ-në nga detyra, përkundër kërkesave të LBGJ që të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal të caktojnë zyrtaret/zyrtarët përkatës për barazi gjinore kjo çështje vazhdon të mbetet sfiduese.

Sa i përket nivelit komunal evidenca për raportimin nga komunat për tri periudhat e grumbullimit të të dhënave për monitorim dhe vlerësim të PKBGJ-së u pranuan nga komunat e shënuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Evidenca e raportimit të komunave për periudhën 2020-prill 2024

Nr.	Komunat që kanë raportuar për vitin 2023 dhe 4 muajt e parë të vitit 2024	Komunat që kanë raportuar për vitin 2022	Komunat që kanë raportuar për vitin 2020 dhe 2021
1	Deçan	Deçan	
2	Dragash	Dragash	Dragash
3	Drenas	Drenas	Drenasi
4	Fushë Kosovë	Fushë Kosovë	Fushë Kosovë
5	Gjakovë	Gjakovë	Gjakovë
6	Gjilan	Gjilan	Gjilan
7	Hani i Elezit		
8	Istog	Istog	Istog
9		Junik	
10	Kaçanik	Kaçanik	Kaçanik
11	Klinë	Klinë	Klinë
12	Lipjan		Lipjani
13	Malishevë	Malishevë	Malishevë
14		Mitrovicë e Jugut	Mitrovicë e Jugut
15		Obiliq	
16		Podujevë	Podujevë
17	Prishtinë	Prishtinë	Prishtinë
18	Prizreni	Prizreni	
19	Rahoveci		
20	Shtime		Shtime
21	Skenderaj	Skenderaj	Skenderaj
22	Suharekë	Suharekë	Suharekë
23	Viti	Viti	
24	Vushtrri	Vushtrri	Vushtrri
Gjithsej	20 komuna	20 komuna	17 komuna

Komunat që nuk kanë raportuar për asnjërin nga raportet monitoruese dhe vlerësuese të PKBGJ-së për vitet 2020-2024 janë:

- | | |
|-----------------------|-------------------|
| 1. Ferizaj | 8. Novobërda |
| 2. Graçanica | 9. Partesh |
| 3. Kamenica | 10. Peja |
| 4. Klokot | 11. Ranillug |
| 5. Leposaviç | 12. Shtërpca |
| 6. Mamusha | 13. Zubin Potoku, |
| 7. Mitrovicë e Veriut | 14. Zveçani |

Nga organizatat e shoqërisë civile dhe të tjera për vitin 2020 dhe 2021 raportuan: Rrjeti i Grave të Kosovës; dhe Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës. Për vitin 2022 raportuan Rrjeti i Grave të Kosovës dhe Organizata Gratë për Gratë. Për vitin 2023 dhe janar-prill 2024 kërkesa për raportim i është drejtuar këtyre organizatave të shoqërisë civile: Rrjeti të Grave të Kosovës, Gratë për Gratë; Rrjetit të Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës; Qendrës Kosovare për Studime Gjinore; Institutit Rinvest; Qendrës Kosovare për Rehabilitim e të Mbijetuarve të Torturës /KRCT; OJQ-së Medica Gjakova; OJQ-së Medica Kosova dhe OJQ-së Sheera, ndërsa raporte janë pranuar vetëm nga Gratë për Gratë dhe Rrjetit të Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase.

Nga organizatat ndërkombëtare për vitin 2020 dhe 2021 raportuan: UN Women; UNDP; UNFPA; Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe Projekti SUNREED për bujqësi i financuar nga financohet nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë/Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), Zyra e BE-së dhe OSBE.

Për vitin 2022 raportuan: Këshilli i Evropës; NDI; UN Women; UNDP; UNFPA, Zyra e BE-së dhe OSBE.

Për vitin 2023 dhe janar-prill 2024 kërkesa për raportim i është dërguar këtyre organizatave ndërkombëtare: UN Women, UNDP, MCC, UNFPA, OSBE; Zyrës së BE-së në Prishtinë; Këshillit të Evropës, dhe GIZ ndërsa raportuan vetëm NDI; OSBE, UN Women dhe Zyra e BE-së.

Burimet parësore të të dhënave

Përveç të dhënave dytësore për këtë vlerësim u realizuan edhe intervista me disa nga akterët aktiv në fushën e barazisë gjinore. Për të mbledhur informata lidhur me ndikimin e granteve të fituara nga ABGJ gjatë pandemisë COVID-19 intervista u realizuan me tri organizata të shoqërisë civile (Rrjetin e Grave të Kosovës; Organizatën Gratë për Gratë; dhe Qendrën Kosovare për Studime Gjinore) dhe me drejtoreshën e Kopshtit Bardha.

Intervista me Rrjetin e Grave të Kosovës u fokusua në vlerësimin lidhur me relevancën, efikasitetin, eficiencën, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e ndikimit të PKBGJ-së.

Për të njëjtat qëllime intervistat u realizuan edhe me organizatat ndërkombëtare: UN Women dhe UNFPA.

Ngase ABGJ mbështeti akademinë në integrimin e perspektivës gjinore në studime, objektiv i synuar në kuadër të PKBGJ-së intervistë u realizuar edhe me Prorektoren e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Intervistë u realizua edhe me udhëheqësen e projektit "Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinor në Kosovë" financuar nga Qeveria Suedeze, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Sida dhe zbatuar nga Kkonsorciumi: Niras & CPM Internacional.

Në fund, për vlerësimin e pyetjeve kyçe të këtij vlerësimi por edhe për të mësuar më shumë për sfidat gjatë zbatimit të PKBGJ-së intervista u realizua edhe me ushtruesen e detyrës së Kryeshefes Ekzekutive të ABGJ-së.

2.1. Kufizimet e vlerësimit

Rezultatet e prezantuara në këtë raport të vlerësimit janë të nënvlerësuara për shkak të arsyeve në vijim:

- ✓ Ndërsa indikatorët e synuar në PKBGJ i referohen fundit të vitit 2024, shumica e të dhënave të siguruara për treguesit i referohen fundit të vitit 2023;
- ✓ Mos raportimi nga të gjitha ministritë për të gjitha vitet e monitorimit dhe vlerësimit;
- ✓ Nuk raportuan të gjitha komunat, disa nga partnerët ndërkombëtarë multilateral dhe bilateral, dhe një numër i organizatave të shoqërisë civile;
- ✓ Mungesës së raportimit të rezultateve në përputhje me treguesit e përcaktuar në Planin e Veprimit të PKBGJ-së; dhe
- ✓ Raportimet e pranuar nga institucionet dhe organizatat nuk kanë qenë tërësisht plotë dhe kanë munguar të dhënat për buxhetin e shpenzuar për të gjitha aktivitetet e zbatuara.

Kufizime në vlerësim kishte edhe si rezultat i:

- ✓ Mungesës së të dhënave për disa nga indikatorët e PKBGJ-së; dhe
- ✓ Mungesës së vlerës bazë për një nga indikatorët e përcaktuar në PKBGJ.

Gjatë leximit të këtij raporti të vlerësimit duhet pasur parasysh se gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ ndikim negativ kishte pandemia COVID-19 që pengoi punën e të gjitha institucioneve dhe zhvendosi fokusin drejt mbështetjes emergjente si të institucioneve publike po ashtu edhe të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare.

3. GJETJET KRYESORE

3.1. Rëndësia dhe koherenca e objektivave të PKBGJ-së

Fokusi i këtij seksioni është vlerësimi i rëndësisë së PKBGJ-së dhe vlerësimi nëse nën-objektivat dhe aktivitetet e PKBGJ-së kanë qenë në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe qëllimin e përgjithshëm të PKBGJ-së. Deklarata e misionit të PKBGJ-së ishte *Kosova të sigurojë që barazia gjinore të jetë në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve*. Ky objektivi synon të arrihet duke punuar në tri drejtime/tri objektivave strategjike në tri shtyllat kryesore të PKBGJ-së:

- 1) Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;
- 2) Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore; dhe
- 3) Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore.

A kanë qenë të rëndësishme objektivat e PKBGJ-së ?

PKBGJ është obligim ligjor sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe direkt kontribuon në zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (e njohur si CEDAW) dhe Konventës së Stambollit të inkorporuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. PKBGJ përmes synimeve dhe aktiviteteve në shtyllën e tretë të saj i ka dedikuar këtë shtyllë zbatimit të parimeve dhe obligimeve që burojnë dhe janë në harmoni me Rezolutën 1325 së Kombeve të Bashkuara mbi *Gratë, Paqen dhe Sigurinë*, dhe të gjitha aktivitetet e kësaj shtylle i referoheshin parimeve dhe kërkesave të 1325 "*Gratë, Paqja dhe Siguria*".

Bazuar në intervistat e realizuara në kuadër të këtij vlerësimi qëndrim i përgjithshëm është se PKBGJ e periudhës 2020-2024 ka qenë shumë të rëndësishme. Qasja gjithëpërfshirëse gjatë hartimit të PKBGJ-së dhe Planit të Veprimit u theksuan të kenë kontribuar që PKBGJ të jetë në përputhje me nevojat dhe sfidat e kohës. U theksua se PKBGJ ka mbuluar çështjet kryesore/fushat/sfidat kryesore në fushën e: punësimit, mirëqenies sociale, arsimit, shëndetësisë, pjesëmarrjes së barabartë gjinore në legjislativ dhe ekzekutiv dhe në fushën e sigurisë.

PKBGJ ishte një dokument shumë i rëndësishëm edhe për faktin se ofroi një analizë të thellë jo vetëm të gjendjes aktuale por edhe të faktorëve që shkaktuan pabarazitë gjinore në sektorë dhe aspekte të ndryshme.

Si rezultat, PKBGJ shërbeu si burim informacioni për akterët relevant në identifikimin e intervenimeve dhe dizajnimin të programeve dhe masave për adresimin e pabarazive gjinore. Bazuar në të dy vlerësimet e para të PKBGJ-së dhe këtë vlerësim final vihet re se përfshirje më e kufizuar e aktiviteteve është në fushën e artit, kulturës, medias, energjisë, transportit, mbrojtjes së ambientit, dhe digjitalizimit. Po ashtu është vërejtur se ka pasur më pak aktivitete që lidhen me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore, por kjo ngase në kohën kur është hartuar PKBGJ veç ka qenë aktive Strategjia Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për periudhën 2016-2020.

Gjatë intervistave u theksua se në PKBGJ nuk u përfshi puna me Kuvendin e Kosovës një institucion që me rolin legjislativ dhe monitorues ka rol qenësor për avancim të barazisë gjinore. Nga intervistat po ashtu u theksua se Programi nuk ka përfshirë mjaftueshëm analizë dhe aktivitete për të adresuar nevojat e grave që u përkasin grupeve minoritare: LGBTQ+, grave dhe vajzave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas; grave në moshë të mesme; grave dhe vajzave me nevoja të veçanta, aspektet shëndetësore për djemtë dhe burrat (u theksua nevoja për vaksinimin edhe të djemve me vaksinën kundër virusit HPV).

Nga intervistat po ashtu u theksua se në PKBGJ kanë munguar edhe çështjet gjinore lidhur me dialogun në mes Kosovës dhe Serbisë duke ndikuar jashtë çështjet gjinore që të mbeten jashtë fokusit.

A kanë qenë aktivitetet dhe rezultatet në përputhshmëri me PKBGJ-në me misionin e gjithmbarshëm dhe me arritjen e objektivave të PKBGJ-së?

Aktivitet dhe rezultatet e përfshira në PRKBGJ janë në përputhje me misionin e gjithmbarshëm dhe në funksion të arritjes së objektivave të PKBGJ-së. Në kuadër të fushës së parë tematike 'Fuqizimi Ekonomik dhe Mirëqenia Sociale' - Objektivi strategjik synon "Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në/nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale" dhe përfshin aktivitete që synojnë uljen e varfërisë, rritjen e punësimit, ngritjen e shkathtësive në përputhje me nevojat e tregut të punës, përmirësimin e arsimit për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, aktivitete për nxitjen e aktivitetit ndërmarrës tek gratë, aktivitete për mbështetjen e organizimit të grave në kooperativa dhe instrumente të tjera mbështetëse për gratë në bujqësi. Këtë shtyllë përfshihen aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e instrumenteve për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në nivel qendror dhe lokal-që do të kontribuonin në pjesëmarrjen e barabartë në fonde publike dhe adresimin e nevojave dhe kërkesave të të dy gjinive.

Në këtë objektivi u parashikua edhe aktivitete që adresojnë sfidat e kohës si ‘Krijimi i linjës ndihmëse telefonike falas, dhe avancim i platformave elektronike me staf profesional për të rinjtë (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, identiteti seksual, substanca narkotike, etj.)’. Aktivitete specifike janë parashikuar për grupet e cënueshme duke përfshirë gratë në moshë të mesme, gratë me nivel të ulët të arsimit, gratë nga zonat rurale, dy aktivitete për gratë nga komuniteti LGBT, një aktivitet për personat me aftësi të kufizuara.

Është me rëndësi të theksohet se disa aktivitete të përfshira në këtë shtyllë ishin nga Strategjia Sektoriale të MPMS-së 2018-2021; Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali Në Shoqërinë Kosovare 2017-2022; dhe nga Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2022.

Objektivi strategjik 2 synon ‘Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore’.

Në kuadër të këtij objektivi përfshihen aktivitete në fushën e arsimit, sportit, kulturës, shëndetësisë dhe mediave. Në këtë fushë u përfshin edhe disa aktivitete të parashikuara në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2022; në Strategjinë Sektoriale të MPMS-së 2018-2021 me fokus në fushën e arsimit; dhe në fushën e shëndetësisë u integruan aktivitetet e planifikuara në Planin Strategjik për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetin Riprodhues 2020-2022.

Aktivitete u përfshin për integrimin e studimeve gjinore në sulabuseët e lëndëve dhe zhvillimi i lëndëve nga studimet gjinore në arsimin e lartë; integrimin e perspektives gjinore dhe eliminimi i stereotipeve gjinor në tekste shkollore dhe kurrikula në nivelin fillor dhe të mesëm. Aktivitete me synim rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme, rritjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në fushat deficitare të arsimit.

Program të trajnimit profesional për gazetarë në fushën e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm. Integrimin e të dhënave në Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijut.

Trajnime për ngritje të kapaciteteve profesionale për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojave specifike shëndetësore të grave dhe burrave; integrimin e vaksinës kundër virusit HPV në listën esenciale të barnave.

Ndërgjegjësimin e popullatës për shëndetin riprodhues dhe seksual dhe aktivitete të tjera.

Siç u theksua më lartë fusha e kulturës dhe e sportit nuk kanë qenë mjaftueshëm të përfshira. Në fushën e medias u planifikua zhvillimi i programit të trajnimit profesional për gazetarë në fushën e barazisë gjinore dhe në fushën e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Hartimi i politikave të reja, përplotësuese : për përfaqësim të barabartë gjinor në organizata mediatike dhe politika editoriale, hartim i modulit të trajnimit për media në trajtimin e koncepteve bazike gjinore, LGBTI, dhunën dhe sigurinë në bazë të gjinisë; rrezikun e bartjes së armëve; nevojat e veçanta; krijimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit për imazhin e grave (reprezentimet gjinore) në media; dhe Trajnim dhe ndërgjegjësim i mediave për informimin e qytetarëve për çështjet shëndetësore (shëndet riprodhues, të ushqyerit me qumësht gjiri, të ushqyerit e shëndetshëm, edukatë seksuale); dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë për raportim etik dhe profesional të çështjeve shëndetësore.

Në fushën e sportit ishin planifikuar vetëm këto dy aktivitete: përkrahje financiare për avancim profesional, infrastrukturë dhe ndërgjegjësim publik për ngritjen e pjesëmarrjes së vajzave grave në sport; dhe analiza të buxhetit me perspektivë gjinore në fushën e arsimit, shkencës, sportit, energjetikes, kulturës, rinisë, diasporës, shëndetësisë, kthimit dhe komuniteteve.

Objekti i tretë strategjik synonte *‘Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore’*. Fokusi i kësaj shtylle ishte në zbatim të parimeve dhe objektivave të Rezolutës 1325 Gratë, Paqja dhe Siguria, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë, mbrojtjes, përfaqësimit të grave në misione diplomatike dhe ballafaqim me të kaluarën si parakusht i sigurimit të paqes së qëndrueshme.

Në këtë Shtyllë, aktivitete ishin planifikuar për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore, dhe arritjen e pjesëmarrjes së barabartë dhe përmirësimin e kushteve të punës për gratë në politikë, vendimmarrje, dhe në fushën e sigurisë (Forcën e Mbrojtjes së Kosovës, Policinë e Kosovës).

Në këtë shtyllë ishin planifikuar aktivitete edhe për angazhimin e grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit dhe krijimin e bazës së të dhënave për gratë pjesëmarrëse në aktivitetet emergjente apo humanitare brenda dhe jashtë vendit. Në kohën kur PKBGJ u hartua Kosova kishte në zbatim Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2016-2021) dhe shumica e aktiviteteve të përfshira në PKBGJ ishin nga kjo Strategji. PKBGJ po ashtu përfshiu aktivitet për të analizuar situatën e grave të burgosura në shërbimin korrektues përfshi qasjen në të drejta, rehabilitim dhe re integrim dhe grave të dënuara për dhunën në familje përfshi politikat ndëshkimore. Në fokus të Planit të Veprimit të PKBGJ-së ishte edhe ofrimi i trajnimeve lidhur me të drejtat për gratë e burgosura përfshi qasjen në të drejta, rehabilitim dhe re integrimin e tyre.

Aktivitetet tjetër në këtë fushë ishte edhe fuqizimi i kapaciteteve të Komisionit Qeveritar për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe organizatave të përfshira në procesin e aplikimit për njohjen e statusit dhe krijimi i programeve specifike për qasjen në drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Nga analiza e treguesve të PKBGJ-së u vërejtën se këta indikatorë nuk ishin qartë të definuar:

- ✓ **Objektivi strategjik 1** në mes tjerash synonte që deri në vitin 2024: 40% e politikave të reja publike të kishin integruar perspektivën gjinore. Edhe pse tregues i vlefshëm në PKBGJ nuk ishte sqaruar se çka nënkuptonte me saktësi integrimi i perspektivës gjinore në politika publike (nëse ABGJ kishte komentuar dhe/ose komentuar dhe komentet e integruara; nëse dokumentet strategjike kishin indikatorë, aktivitete etj. të ndara dhe me perspektivë gjinore). Si pasojë të dhëna nuk u siguruan për këtë indikator. ABGJ potencoi se duhet vendosur mekanizmi monitorues-përmes sigurimit të opinionit specifik se inputet për integrim –qendërzim gjinor janë marrë në konsiderate nga institucionet. Përveç opinionëve të ABGJ të gjithë akterët e përfshirë në hartim të legjislacionit dhe politikave publike kanë përgjegjësi të sigurojnë-qendërzim gjinor- ‘gender mainstreaming’ konform kërkesave të LBGJ .
- ✓ **Në kuadër të Objektivit strategjik 2** ishte përcaktuar synimi që deri në vitin 2024 të “ndërtohej dhe funksionalizimi i sistemit monitorues në media për imazhin e grave” por nuk kishte sqarime se kush do duhej të inicioje, zhvillonte dhe të mirëmbante këtë sistem? Ky sistem nuk u zhvillua, dhe nga diskutimet dhe të dhënat e pranuar nuk u kuptua se çfarë ishte synuar dhe si? Një tjetër indikator jo mjaftueshëm i qartë ishte ai që synonte “Avancimin e edukimit dhe vendimmarrjes tek vajzat, djemtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual dhe riprodhues (%)” por nuk kishte vlerë bazë e as sqarime të nevojshme se si do matee progresi në arritjen e cakut të synuar? Për këtë indikator MASHTI raportoi se 100% edukimi mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesë e planeve mësimore, por në mungesë të definimit të qartë të indikatorit nuk është e ditur nëse caku i synuar është arrit në të vërtetë dhe në plotësi.
- ✓ **Tek Objektivi strategjik 3** janë tre indikatorë jo mirë të definuar e si rezultat pamundësoi matjen e progresit:
 - 1) indikator “përqindja e rasteve të dhunës në familje, që trajtohen nga gjyqësori” nuk ishte sqaruar se si do llogaritej dhe ku do gjendej kjo e dhënë, prandaj edhe mbetet indikator për të cilin nuk është raportuar nëse është arritur;
 - 2) indikator “hartimi i politikës ndëshkimore për zbatimin adekuat të sanksioneve për kryesit e dhunës në baza gjinore, përfshi edhe dënimet adekuate për rastet e trafikimit me qeniet njerëzore” nuk kishte sqarime se cili është mekanizmi monitorues i cili do të monitoronte zbatimin adekuat të sanksioneve; dhe
 - 3) indikator “përqindja e vajzave dhe grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike” në mungesë të të dhënave nuk kishte as vlerë bazë e as të synuar, e që pengon matjen e progresit.

3.1.1. Inputet gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, disa korniza të politikave publike, si dhe legjislacion dhe strategji kombëtare janë hartuar, si dhe janë zhvilluar kapacitetet e mekanizmave ekzistues duke kontribuar drejt progresit në arritjen e objektivave të përcaktuara të PKBGJ-së. Përshkrim i shkurtër i legjislacionit të ri, strategjive dhe mekanizmave prezantohet në vijim.

Shtylla 1: Qasja në fonde publike

- ✓ Është draftuar Koncept Dokumenti për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor, i aprovuar nga Qeveria në vitin 2022;
- ✓ Është realizuar studimi i fizibilitetit për buxhetimin e përgjegjshëm gjinnor;
- ✓ Është themeluar grupi punues për hartimin e kornizës ligjore për Buxhetimin e përgjegjshëm gjinnor; është hartuar metodologjia e punës dhe paketa informuese për Grupin Punues. Janë mbajtur 3 punëtori me grupet punuese.

Shtylla 1: Qasja në pronë

- ✓ Vit pas viti me propozim të ABGJ-së, Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdoi masën afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë, respektivisht Udhëzim Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve. Në vitin 2024 gjithsej ishin 17,592 prona të regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve në krahasim me 105 sa ishin në vitin 2016 kur filloi zbatimi i këtij UA.

Shtylla 2: Sektori i shëndetësisë

- ✓ Që nga viti 2024 në kalendarin e vaksinave është shtuar vaksina kundër virusit HPV i cili shkakton kancerin e qafës së mitrës, vakcina aktualisht po aplikohet tek vajzat deri në moshën 15 vjeçare;
- ✓ Është rritur numri i vizitave për nënat shtatzëna dhe për foshnjat: në periudhën janar 2023 deri në fund të prillit 2024 janë realizuar 36,336 vizita në shtëpi për fëmijë 0-3 vjeç; 5,668 vizita për gra shtatzëna të realizuara; 3,247 fëmijë të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes; 1,880 vizita për fëmijë të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian të realizuara.

Shtylla 2: Arsimi

- ✓ Është hartuar Strategjia e Arsimit 2022-2026;
- ✓ Është aprovuar Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme;
- ✓ Është themeluar Grupi Ndërinstitucional lidhur me parandalimin e martesave të hershme në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
- ✓ MASHTI aprovoi Doracakun për mësimdhënës: Edukimin Seksual dhe Shëndetin Riprodhues: Puberteti, dashuria dhe relacionet².

Shtylla 3: Qasja në drejtësi dhe shërbime

- ✓ Në vitin 2020 Parlamenti i Kosovës miratoi përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- ✓ U miratua Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në baza Gjimore;
- ✓ U hartua dhe aprovua Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe në baza Gjimore në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Konventën e Stambollit;
- ✓ Në vitin 2022 u miratua Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
- ✓ Me datë 13 Mars 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas, ku bazuar në këtë ligj janë shtuar kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas të cilët pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik, i ofrohet ndihma juridike falas;
- ✓ U hartua dhe miratua Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave;
- ✓ U lansua Protokolli Shtetëror për Trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale në Republikën e Kosovës;
- ✓ Është hartuar dhe publikuar raporti Buxhetimi Operacional i Strehimoreve në Kosovë dhe Udhëzuesi i Projektimit; nga ABGJ i cili udhëzon në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të strehimoreve duke identifikuar nevojat e tyre për një përgjigje sa më kualitative ndaj nevojave të viktimave, sipas kërkesave të Konventës së Stambollit, dhe njëkohësisht i ndihmon strehimoret të parashatrojnë kërkesat e tyre me kosto të mirë vlerësuar buxhetore³;

² <https://MASHT.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/doracaku-6-9.pdf>

³ https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/A4-ALB%20%20ShelterCosting_Kosovo%20DomesticViolence.pdf

- ✓ U miratua Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas. Ky plotësim mundëson ofrimin e ndihmës juridike falas pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale për viktimat e dhunës në familje; viktimat dëshmitare të dhunës, viktimat e dhunës në baza gjinore; viktimat e cilitdo lloji të dhunës seksuale, përfshirë dhe ngacmimin seksual;
- ✓ Është duke u hartuar Udhëzuesi për funksionalizimin e Mekanizmave Lokal kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore;
- ✓ U emërua Koordinatorja Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë Gjinore;
- ✓ U aktivizua Grupi Koordinues Ndërmënyor, i cili në baza të rregullta, adreson çështjet e dhunës në familje;
- ✓ Është emëruar Grupi i ri Koordinues ndërmënyor kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore;
- ✓ Është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit me Bashkësitë Fetare në Republikën e Kosovës;
- ✓ Është hartuar dhe miratuar Plani i Punës 2024 i Koordinatorës Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë Gjinore;
- ✓ Janë krijuar module të reja në data-bazën nacionale për evidentimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovës.
- ✓ Është lansuar Masa së punësimit për gratë viktimat të dhunës;

Shtylla 3: Pjesëmarrja e barabartë gjinore

- ✓ ABGJ ka mbështetur themelimin e Rrjetit të Grave në administratë publike në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, me qëllim të fuqizimit të rolit të grave në administratë publike dhe inkurajimit për të aplikuar për pozita vendimmarrëse.
- ✓ Gjatë periudhës raportuese institucionet dhe organizata vendore (niveli qendror dhe lokal) dhe ndërkombëtare organizuan aktivitete vetëdijësuese dhe trajnime në fushën e lidershit për nxitjen e angazhimit të grave në politikë dhe vendimmarrje.
- ✓ Komisioni Shtetëror i pranimit për 1 vit është udhëhequr nga një grua, ndërsa për 1 vit 2 nga 5 anëtarët ishin gra.

Gratë, paqja dhe siguria

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së u vazhdua afati i punës së Komisionit Qeveritar për identifikimin dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Që nga fillimi i procesit në shkurt të vitit 2018 e deri më 30.04.2024 Komisioni ka pranuar gjithsej 2,074 aplikacione për njohje të statusit viktimë e dhunës seksuale të luftës, ndërsa nga to janë trajtuar 2,033 aplikacione. Ne vazhdimësi, ABGJ dhe disa nga partnerët ndërkombëtarë si UN WOMEN kanë mbështetur punën e komisionit përmes mbështetjes së trajnimeve për komisionin, si dhe organizatave të grave të cilat kanë punuar drejtpërdrejtë me të mbijetuarat/it.

Presidentja e Republikës së Kosovës e ka vendosur Agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në qendër të angazhimit të saj për të fuqizuar sektorin e sigurisë dhe për të zhvilluar politika publike të qëndrueshme dhe në shërbim të avancimit të barazisë gjinore. Në vijim të këtij angazhimi, në vitin 2022, si pjesë e zotimeve të Republikës së Kosovës në kuadër të Samitit për Demokraci të Presidentit Biden dhe me iniciativë të Presidentes Osmani, u organizua edicioni i parë i Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, me temën boshte *“Ndërtimi i aleancave për paqe të qëndrueshme”*. Qëllimi kryesor i Forumit është fuqizimi i rolit të grave në proceset e paqes dhe sigurisë, si dhe avancimi i përgjithshëm i barazisë gjinore. Edicioni i parë i Forumit mbledhi në Kosovë pjesëmarrës nga 33 vende të ndryshme të botës, i cili njëherazi vendosi Kosovën në hartën globale të ngjarjeve ndërkombëtare dhe tashmë është bërë një platformë tradicionale që shërben si vendtakim për liderë botërorë, organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, akademikë, etj. Si rezultat i diskutimeve të mbajtura në marginat e Forumit janë identifikuar gjithsej 13 veprime, të cilat mund të ndërmerren kolektivisht nga akterët e ndryshëm nëpër botë, dhe 25 përfundime të cilat adresojnë sfidat dhe mundësitë për të ardhmen e Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Në prill të vitit 2024, Forumi realizoi edicionin e dytë, i cili u fokusua në dy tema qendrore: parandalimin e dhunës seksuale në luftë dhe garantimi i sigurisë për gratë dhe vajzat përballë sfidave të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Qëllimi kryesor i këtij edicioni ishte që nëpërmjet diskutimeve të adresojë kërcënimet historike për sigurinë e grave, së bashku me sfidat e reja të sigurisë, me synimin përfundimtar për të bashkuar forcat për të avancuar më tej Agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Me mbi dhjetëra diskutime dhe ngjarje anësore janë mbajtur gjatë forumit, edicioni i dytë mbledhi mbi 2,000 pjesëmarrës nga më shumë se 40 shtete në Prishtinë.

Si rezultat i angazhimit të vazhdueshëm, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës është përzgjedhur si partnere për themelimin e Qendrës Rajonale të Ekselencës, me ç’ rast Republika e Kosovës është përzgjedhur të jetë një nga tre vendet nikoqire së bashku me Kolumbinë dhe Filipinet. Ceremonia zyrtare e nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit për themelimin e Qendrës rajonale të Ekselencës në Kosovë u mbajt në edicionin e dytë të Forumit ndërsa Qendra u lansua me datë 17 shtator 2024. Qëllimi kryesor i Qendrës rajonale të Ekselencës në Kosovë është që nëpërmjet ofrimit të një kuptimi më të thellë për Agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe zbatimit të saj, të fuqizojë gratë në të gjitha nivelet e proceseve të paqes dhe sigurisë, sidomos në rolet udhëheqëse dhe vendimmarrëse.

Konferenca dhe aktivitete informuese e vetëdijësuese:

Gjatë periudhës 2020-prill 2024, ABGJ ishte organizatore ose bashkë organizatore e konferencave në vijim:

2020

- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Kryeministrin e RKS Albin Kurti, kanë shënuar 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas përmes lansimit të Amandamentimit të Kornizës Ligjore për Mbrotje nga Dhuna në Familje, si dhe prezantimit të draftit final të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, organizuan takim konsultativ të nivelit të lartë, me temën “Fuqizimi ekonomik si parakusht i parandalimit të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore”. Në kete takim janë shënuar dy ngjarje me rëndësi historike për barazinë gjinore - 25 vjetori i Platformës së Pekinit dhe 20 vjetori i Rezolutës 1325 – “Gratë, Paqja dhe Siguria”.

2021

- ✓ 16 ditët e aktivizimit: ABGJ nën udhëheqjen e Kryeministrit Kurti, në bashkëpunim me MD, realizoi Fushatën e 16 Ditëve të Aktivizimit, dhe shënimin e 25 Nëntorit Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas.
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore kanë mbajt Konferencën e nivelit të lartë me akterë institucionalë, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile “Përgjigjja institucionale ndaj dhunës kundër grave në periudhën (post) COVID-19”

2022

- ✓ ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me temën “ *Zhbëjmë paragjykimet, synojmë gjithë përfshirjen*” me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së grave në procese vendimmarrëse në nivelin: legjislativ ekzekutiv, misione diplomatike dhe shërbimin civil, dhe akademi.
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me QKSGJ kanë mbajt takimin tradicional, konsultativ të nivelit të lartë, me temë “ *Pjesëmarrja e Grave në Tregun e Punës*”. Janë publikuar rekomandimet për fushat përkatëse të rritjes së pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në administratën publike dhe në tregun e punës.

2023

- ✓ ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me dedikimin në kujtimi të grave krijuese, artiste, profesoresha universitare dhe gazetare që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje dhe te cilat nuk jetojnë me". Ku me këtë rast u organizuan 3 panele diskutimi me gratë krijues, profesoresha universitare dhe gazetare. Konferencën e ndoqën 90 pjesëmarrës. Me këtë rast është ndriçuar Ndërtesa se Qeverise as me dedikimin në kujtimi te grave krijuese. Buxheti i ABGJ.
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), ne muajin nëntor ka organizuar takimin e rregullt konsultativ vjetor të nivelit të lartë, të gjashtin me radhë, me akterë institucional, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile. Takimi u fokusua në përkushtimin e Kosovës drejt procesit të Integritimit Evropian nga perspektiva gjinore

2024:

- ✓ ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas nën sloganin **"Bashkë për barazi"** duke bërë thirrje për unitet në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave çdokund. Në linjë me temën globale "Investimi në gra përshpejton progresin", në këtë konferencë u diskutua për qasjet që nevojiten në mënyrë që të rritet ndikimi, dhe të forcohet roli i grave në proceset dhe agjendat e zhvillimit socio ekonomik te vendit, për një transformim shoqëror te qëndrueshëm dhe te barabartë. Konferencën e ndoqën rreth 75 pjesëmarrës.
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës/ Fakulteti Ekonomik dhe me mbështetje të Un Women kanë realizuar Konferencën: "Mbyllja e hendekut gjinor". Konferenca ka sjell së bashku studiues/e, politikëbërës/e, aktivistë/e, dhe individë të pasionuar pas barazisë gjinore për t'u angazhuar në dialog, për të ndarë njohuri dhe për të diskutuar praktikat e mira ndërkombëtare dhe vendore për krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe të barabartë.
- ✓ ABGJ vazhdoi angazhimin për integrim gjinore në edukim përmes bashkëpunimit me NDI në organizimin e dy shkollave verore për "Gjininë, Ekonominë dhe Politikat" me program 5 ditor ku janë certifikuar afër 60 studentë, të moshës 18 deri 29 vjeçare.

ABGJ gjatë kësaj periudhe raportimi realizoi produkte mediatike senzibilizuese dhe i shfaqti video spotet me temat si në vijim (të renditura sipas rendit alfabetik):

1. *Bashkë për barazi;*
2. *E drejta trashëgimore dhe institucionet përgjegjëse për iniciimin e procedurës së trashëgimisë;*
3. *Gratë Krijuese që ndryshuan historinë;*
4. *Identifikimi dhe pasojat e dhunës psikologjike dhe atë për shënimin e 10 vjetorit të Konventës së Stambollit;*
5. *Identifikimi i dhunës psikologjike;*
6. *Kanceri i gjirit;*
7. *Kosova Nderon kujtimin e Grave të Ndërra Viktima të Dhunës në Familje;*
8. *Parandalim ndaj diskriminimit;*
9. *Parandalimi i abortit selektiv;*
10. *Parandalimi i Dhunës të çiftet adoleshente;*
11. *Parandalimi i ngacmimit seksual në vendin e punës;*
12. *Parandalimi i stereotipave gjinore në tekstet shkollore;*
13. *Raportimi i dhunimeve seksuale- Rëndësia e marrjes së Provave; dhe*
14. *Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.*

Institucionet publike dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare organizuan fushata të rregullta vjetore në tematikat si në vijim:

- ✓ 16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Familje, që mbahet çdo vit nga 25 nëntori deri më 16 dhjetor, (që nga vitit 2009, ky është një aktivitet i rregullt në kalendarin e aktiviteteve të të gjitha institucioneve të Kosovës);
- ✓ Dita e grave organizuar më 8 mars;
- ✓ Konferenca Rajonale në kuadër të dhunës në familje, Konferenca “Të bashkuar kundër dhunës – mjaft”.
- ✓ Konferenca e rregullt e organizuar nga NDI “Java e gruas” të cilën në vitin 2024 e mbështeti edhe ABGJ;

- ✓ Çdo tetor në Kosovë shënohet Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e gjirit;
- ✓ Java Evropiane për testim për HIV/AIDS;
- ✓ Aktivitete ndërgjegjëse mbi të drejtat e pronësore dhe trashëgimisë;
- ✓ Në disa komuna u organizua Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale.

Për shkak të numrit të madh të rasteve të femicidit, gjatë periudhës raportuese shoqëria civile organizoi protesta dhe aktivitete të ndryshme për të shprehur shqetësimin dhe kërkuar reagimin e qeverisë dhe shoqërisë kundër këtij fenomeni shkatërrues që merr jetë grash.

Masat të targetuara

Gjatë kohës së zbatimit të PKBGJ-së është integruar perspektiva gjinore në kuadër të: *Fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike 2020, si dhe Pakos për Ringjallje Ekonomike të qershorit 2021*. Kjo e vendosë RKS ndër vendet të cilat me sukses kanë arrite ti përgjigjen situatës së Covid-19 me perspektivë gjinore me masa të ndjeshme në aspektin e gjinisë dhe mjeteve buxhetore të dedikuara për këtë qëllim. Kjo është një ndër praktikatat e suksesshme të Buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Gjatë kohës së pandemisë, është krijuar *Strehimorja në karantinë* e cila ka ofruar ambient të sigurt për rastet e reja, të nivelit të sigurisë së lartë, dhe ka përmbush nevojat e përkujdesjes duke përfshirë (strehimin e sigurt, shërbime shëndetësore të sigurta, shërbime psikologjike, ushqim dhe higjienike).

Në vitin 2020 është ndarë fond i veçantë për ABGJ në vlerë prej 1 milionë Euro, nga të cilat janë mbështetur: 115 kopshteve private dhe në partneritet publiko-privat (të udhëhequra nga 108 gra; 7 burra); 6,638 fëmijë nga të cilët 3,249 vajza dhe 3,389 djem, të përfshirë në këto kopshte; 1,145 gra të punësuar në 115 çerdhet e mbështetura.

Në vitin 2021 ABGJ Fondi në vlerë prej 1 milionë Euro ka mbështetur 273 bizneseve të vogla në pronësi të grave, në vlerë totale prej 207,284.00 Euro; dhe 24 OJQ - organizata në vlerë prej 647,000 Euro. Përmes financimit të këtyre 24 OJQ-ve janë mbështetur 1,296 gra dhe vajza nga ky numër: 296 gra dhe vajza kanë përfituar shërbimeve si: këshilla juridike, shërbime dhe iniciativa të fuqizimit ekonomik; 185 gra dhe vajza -persona fizik përfituan grante për zgjerim biznesi; 48 OJQ përfituan (sub) grante; 803 gra dhe vajza, janë trajnuar për hapje e bizneseve të reja, shitjen e produkteve online, marketingun e produkteve, themelimin e brendit, funksionalizimin të faqeve për shitje të produkteve të bizneseve individuale.

Në kuadër të Fondit për Garanci Kreditore është hapur *dritare specifike e mbështetjes për bizneset në pronësi të grave*. Garancia kreditore deri në 80% të kolateralit si mbështetje e rëndësishme për bizneset në pronësi të grave, të cilat, për shkak të mungesës së pronësisë, kolateral), përballen me vështirësi për qasje në financa. Në fund të vitit 2021, Fondi ka mbështetur 269 biznese të grave me garanci në vlerë prej 8.6 milionë Euro, vlera e kredisë ishte 11.7 milionë Euro.

Në vitin 2022 *Fondi për Garantimin e Kredive* ka mbështetur me garanci kredituese 269 biznese të grave, vlera e garantuar e kredisë prej 5.7 milionë Euro ndërsa në vitin 2023 u mbështetën 340 kredi të bizneseve në pronësi të grave me vlerën e garantuar prej 8.4 milionë Euro.

Në vitin 2021, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ndau fond të veçantë prej 470,000 Euro për të mbështetur bizneset në pronësi të grave-32 subvencione u shpërndanë bizneseve në pronësi të grave

Gjatë kohës së zbatimit të PKBGJ-së qeveria ndërmori masa në kuadër të *Pakos për Ringjallje Ekonomike*, masa të cilat kishin integruar perspektivën gjinore. Bazuar në të dhënat nga MFPT masat mbështetëse janë si në vijim:

- ✓ *Shtesat për Fëmijë* - mbi 403,000 përfitues dhe është me rëndësi të theksohet se këto shtesa për fëmijë transferohen në llogarinë bankare të nënës;
- ✓ *Shtesat për Lehona* - me mbi 50,000 mijë gra përfituese;
- ✓ *Masa 1.3 - Mbështetja e Punësimit të Grave* - Në kuadër të masës është mbështetur punësimi i grave përmes subvencionimit të pagës së punëtores, deri në 50% të pagës bruto. Kjo masë është realizuar në 2 faza, të cilat kanë rezultuar në mbi 6,000 gra të punësuar;
- ✓ *Masa 2.1.2 - Mbështetja e bizneseve që janë në pronësi të grave* - Kjo nën-masë ka për qëllim mbështetjen e bizneseve që janë në pronësi të grave. Mbështetja është realizuar përmes mbulimit të 20% të kryegjësë së kredisë për rritje të kapaciteteve pavarësisht sektorit në të cilin operon biznesi. Nga kjo masë kanë përfituar 44 biznese, ku vlera e subvencionimit ka qenë 801 mijë Euro, ndërsa vlera e kreditimit 4.2 milionë Euro;
- ✓ *Superpuna* - platformë punësimi e krijuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila synon garantimin nga Qeveria të një vendi pune për çdo të ri nga 18 deri në 29 vjeç, përmes ndërmjetësimit midis punëdhënësve dhe punëkërkuesve. Pas ndërmjetësimit të suksesshëm, Qeveria bën subvencionimin e pagës mujore të punëtorit, në vlerë prej 264 Eurosh për 6 muaj. Deri më tani, nga kjo skemë kemi mbi 12,000 të rinj përfitues, prej të cilëve gjysma janë vajza e gra të reja.

- ✓ *Kosovo Generation Unlimited* -është platformë që lidh kompanitë, organizatat dhe institucionet me praktikantë. Përveç punës praktike, të rinjtë përmes kësaj skeme kanë qasje edhe në mentorim e trajnime pa pagesë. Deri më tani, nga kjo skemë kemi mbi rreth 1,100 praktikantë të angazhuar, prej të cilëve mbi 700 janë vajza.
- ✓ *Masa të targetuara për zbutjen e varfërisë në energji dhe energjisë eficiente* u zbatuan nga Ministria e Ekonomisë duke mbështetur 6,353 gra në vlerë prej 1.8 milionë Euro; 24 biznese të vogla dhe të mesme në pronësi të grave me vlerë prej 6,373 Euro; dhe u mbështetën aktivitetet e disa OJQ-ve në fushën e TIK-ut dhe eficiencës së energjisë me vlerë prej 44,715 Euro. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë mbështeti 157 familje përfituese gra në vlerë prej 591,354 Euro.

Të dhëna të detajuara për këto aktivitete janë të shënuara në Shtojcën 1 të këtij raporti.

Ngritja e kapaciteteve

- ✓ Rreth 700 zyrtarë publik janë trajnuar për vlerësimin e ndikimit gjinore në politika publike;
- ✓ Në çdo vit ABGJ ka realizuar ciklin e trajnimeve për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për nevojat e Policisë së Kosovës (të dhëna të detajuara për secilin vit janë prezantuar në seksionet përkatëse në këtë raport);
- ✓ ABGJ ka ofruar trajnime për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës me zyrtarë nga niveli qendror dhe lokal; 375 pjesëmarrës të certifikuar për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës në nivel Qendror dhe lokal; dhe
- ✓ ABGJ 2 trajnime, 37 pjesëmarrës për rritjen e pjesëmarrjes së grave në administratë publike.

Dokumentet kombëtare strategjike të miratuara gjatë ekzistencës së PKBGJ

Gjatë periudhës 2020-prill 2024 u hartuan një numër i dokumenteve strategjike. Një përmbledhje e shkurtër e qëllimeve të këtyre dokumenteve strategjike dhe vështrim lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në këto dokumente ofrohet në vijim.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026⁴ e miratuar në vitin 2022 me vizion që deri në vitin 2026, Qeveria e Kosovës së bashku me institucionet përgjegjëse dhe palët mbështetëse do të: marrin përgjegjësi për trajtimin me prioritet të të gjitha rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; sigurojnë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për të luftuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave; sigurojnë qasje në shërbime cilësore të integruara; garantojnë drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarat; sigurojnë riintegrim dhe fuqizim të viktimave /të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; ndëshkojnë, ri-socializojnë dhe rehabilitojnë kryerësit e dhunës; rrisin vetëdijesimin e mbarë shoqërisë kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Katër objektivat strategjike janë:

1. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijesimit;
2. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare;
3. Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave; dhe
4. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031⁵ me vizion për një sektor energjetik i qëndrueshëm, i integruar në tregun Pan-Evropian, që garanton siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përballueshme për qytetarët. Ky vizion synohet të realizohet përmes veprimeve të planifikuara brenda këtyre objektivave strategjike:

- 1) Përmirësimit të besueshmërisë së sistemit;
- 2) dekarbonizimit dhe promovimit të energjisë së ripërtëritshme;
- 3) rritjes së efikasitetit të energjisë;
- 4) forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut; dhe
- 5) mbrojtjes dhe fuqizimit të konsumatorëve.

⁴<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

⁵ <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Shqip-Strategjia-e-Energjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf>

Objektivi specifik 4.3 synon aftësimin në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave me qëllim që të mundësojë pjesëmarrjen e barabartë të grave në programet e arsimit dhe trajnimit (përfshirë potencialisht skemat e bursave) dhe përkrahjen e përfshirjes së tyre në kompanitë dhe institucionet e sektorit të energjisë. Ministria e Ekonomisë ka aprovuar edhe Programin e zbatimit të strategjisë së energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2025⁶, në të cilin program është planifikuar aktiviteti për përgatitjen e infrastrukturës gjithëpërfshirëse gjinore dhe planifikimi i politikave.

Strategjia e Punësimit 2024-2028 synon të sigurojë punësim të denjë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë përmes arritjes së objektivave në vijim:

- 1) zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të fuqisë punëtore dhe ulja e mospërputhjeve të aftësive;
- 2) rritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës të grupeve të tjera në rrezik përjashtimi (grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve etnike); dhe
- 3) përmirësimit të kushteve të punës dhe mundësi të mira për punë. Strategjia synon që deri në vitin 2027 hendeuku gjinor në punësim do të jetë më i ngushtë se 20 pikë përqindjeje.

Strategjia e Arsimit 2022-2026⁷ dhe Plani i Veprimit 2022-2026⁸ synon arritjen e këtyre objektivave:

- 1) rritjen e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme;
- 2) ngritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore;
- 3) harmonizimin e arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimi gjatë gjithë jetës;
- 4) përmirësimin e cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë;
- 5) përdorimin e teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital.

⁶ https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/PZSEK-2022-2025_SHQ.pdf

⁷ <https://MASHT.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

⁸ <https://MASHT.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/04-Plani-i-Veprimit-te-Strategjise-per-Arsim-2022-2026-ALB-WEB-1.pdf>

Perspektiva gjinore është integruar në analizën e gjendjes dhe shumica e treguesve të ndikimit dhe të rezultateve janë të ndarë sipas gjinisë. Në mënyrë specifike Strategjia synon rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme (grup-mosha 0 deri në 5); eliminimin e stereotipeve gjinore në përputhje me udhëzuesin metodologjik të hartuar nga ABGJ për Parandalimin e stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore; adresimin e ndarjes gjinore në profesione; përfaqësimin e barabartë gjinor në angazhimin e inspektorëve të ri të arsimit; ndërmarrjen e masave afirmative për ngritjen e numrit të grave dhe vajzave në pozita menaxheriale në arsimin parauniversitar; rritjen e mundësive për punë praktike të studentëve, me fokus të veçantë te vajzat dhe gratë.

Në Mars të vitit 2023 Qeveria miratoi **Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030**⁹ me katër synimi kryesore:

- 1) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- 2) Zhvillimin e Barabartë Njerëzor;
- 3) Siguri dhe sundim të ligjit; dhe
- 4) qeverisja e mirë.

Në kuadër të Strategjisë dhe Planit Kombëtar synohet rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës; përfshirjen e vajzave dhe grave në aktivitetet sportive; rritja e pjesëmarrjes së grave në institucionet e sigurisë; rritjen e qasjes në pronë tek gratë; përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në institucionet publike dhe respektimin e obligimit për buxhetim të përgjegjshëm gjinor; qasjen e grave në drejtësi; mbështetjen e ndërmarrjeve në pronësi të grave për digjitalizim.

Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030¹⁰ synon që deri në vitin 2030, industria e Kosovës do të transformohet në një industri më të integruar globalisht që është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të denjë. Objektivat strategjike të Strategjisë janë:

- 1) Zgjerimi (shtrirja) e Prodhimit Industrial;
- 2) Reduktimi i deficitit tregtar industrial;
- 3) Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës;
- 4) Lehtësimi i Industrisë së Gjelbër;
- 5) Maksimizimi i rritjes të vlerës së brendshme.

⁹ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

¹⁰ <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/606F831F-95B2-4CCA-8BBF-C70C5E60A7F1.pdf>

Si objektive specifike Strategjia synon Integrimin e grave dhe të rinjve në tregun e punës. Një skemë e veçantë kreditimi për aftësim është planifikuar e dizajnuar për individët nga 18 deri në 35 vjeç të interesuar për t'u pajisur me aftësi dhe njohuri të rëndësishme për industrinë, ku përparësi do të kenë gratë aplikante.

Në vitin 2024 Qeveria e Kosovës **aprovoi Strategjinë për Drejtësi Tranzicionale të Republikës së Kosovës 2024-2034**¹¹ me vizion krijimin e një platforme strategjike që synon realizimin e të drejtës së viktimave dhe shoqërisë për të vërtetën, reparacionin, drejtësinë dhe garancitë për mos përsëritje. Strategjia synon arritjen e këtyre objektivave strategjike:

- 1) E drejta për të vërtetën- Dokumentimi dhe publikimi i fakteve dhe rrethanave të krimeve të kryera gjatë luftës;
- 2) E drejta për drejtësi- Qasja në drejtësi dhe luftimi i mosndëshkimit për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga shteti i Serbisë, si çështje e drejtësisë për viktimat;
- 3) Mbështetja për viktimat- Qasje e barabartë në mbështetjen e nevojshme për viktimat e krimeve të kryera gjatë luftës përmes institucioneve lokale dhe qendrore; dhe
- 4) Garantimi i mos përsëritjes- Eliminimi i mundësive për përsëritjen e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut përmes reformës institucionale.

Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023¹² përfshin veprime për realizimin e objektivave strategjike si në vijim:

- 1) përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara;
- 2) krijimi i sistemit funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- 3) krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara;
- 4) krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
- 5) krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Dokumenti nuk ka integruar perspektivën gjinore.

¹¹ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-PER-DREJTESI-TRANZICIONALE-E-REPUBLIKES-SE-KOSOVES-2024-2034.pdf>

¹² <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/06/Plani-i-Veprimit-PAK-Pjesa-1-Shqip.docx>

Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të njeriut 2021-2025¹³ synon arritjen e këtyre objektivave strategjike:

- 1) përmirësimin e qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;
- 2) mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;
- 3) sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë; dhe
- 4) lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.

Analiza e situatës së Programit prezanton të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe ka përcaktuar dy objektiva specifike

- 1) lehtësimi i barrierave për mbrojtjen e viktimave të krimit në veçanti për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje; dhe
- 2) Realizimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave, të drejtave pronësore të komuniteteve.

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024¹⁴ ka pesë objektiva strategjike:

- 1) rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet Rom dhe Ashkali;
- 2) rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve Rom dhe Ashkali;
- 3) përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore;
- 4) rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike, për komunitetet Rom dhe Ashkali; dhe
- 5) parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjytimeve, stereotipeve, dhe bullizmit.

¹³ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/SHQIP-PROGRAMI-PER-MBROJTJEN-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT-2021-2023.pdf>

¹⁴ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/Strategjia-per-avansimin-e-te-drejtave-te-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-Republiken-e-Kosoves-2022-2026-dhe-Plani-i-veprimit-2022-2024.pdf>

Analiza e situatës përfshin perspektivë gjinore dhe është një tregues tregues specifik gjinor që synon zvogëlimin e hendeut gjinor në shkathtësitë themelore (shkrim-lexim dhe numërim) ndërmjet vajzave dhe djemve të moshës 7 – 14 vjeç që i përkasin komunitetit rom dhe ashkali të Kosovës. Në mesin e aktiviteteve vetëm dy aktivitete ka shënim specifik gjinor që lidhet me organizimin e fushatave vetëdijësuese lidhur me dhunën në familje dhe kundër diskriminimit.

Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026¹⁵ ka përcaktuar pesë objektiva strategjike: forcimi i mekanizmave institucionalë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore; parandalimi i dukurisë së trafikimit me njerëz; përmirësimi i identifikimit, mbrojtjes dhe ri-integritimit të viktimave dhe viktimave të supozuara të trafikimit; hetimi, ndjekja penale dhe ndëshkimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore; dhe fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Me përjashtim të të dhënave për strukturën gjinore të viktimave, Strategjia nuk ka integruar perspektivën gjinore në analizë e as në objektiva, tregues e aktivitete.

Strategjia për Sundimin e ligjit 2021-2026¹⁶ synon rikthimin e besimit të qytetarëve në drejtësi, sistem gjyqësor e prokurorial. Objektivat strategjike të Strategjisë janë:

- 1) fuqizimi i sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial;
- 2) fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Penale;
- 3) Fuqizimi ¹⁷i Qasjes në Drejtësi;
- 4) Fuqizimi i luftës anti-korrupsion. Analiza e situatës përfshin perspektivën gjinore në disa nga shtyllat por vetëm një aktivitet që synon luftimin e dhunës në baza gjinore, dhe mbështetje më të madhe financiare për strehimoret e viktimave të dhunës në baza gjinore.

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës 2022-2026 ¹⁸synon:

- 1) Sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme;
- 2) Rritja e mëtejshme e efikasitetit Alokues;
- 3) Përmirësimi i Mëtejshëm i Efikasitetit Operacional;
- 4) Kapitali njerëzor dhe infrastruktura e TIK-ut të fuqizuara për të mbështetur sistemin digjital dhe transparent të MFP-së në Kosovë. Strategjia nuk ka integruar perspektivën gjinore.

¹⁵ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/Strategjia-TQNJ-2022-2026.pdf>

¹⁶ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/04/Strategjia-per-Sundimin-e-Ligjit.pdf>

¹⁷ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike.pdf>

¹⁸ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike.pdf>

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2028¹⁹ ka për vizion zhvillimi i sektorit agro-rural konkurrent dhe inovativ i bazuar në njohuri, teknologji dhe standarde moderne, duke ofruar produkte të cilësisë së lartë në tregun e brendshëm, të regjionit dhe BE-së, si dhe zhvillim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mjedisit, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi të jetës për banorët në zonat rurale. Objektivat strategjike janë:

- 1) Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës;
- 2) Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore;
- 3) Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale;
- 4) Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase.

Analiza e situatës përfshin perspektivën gjinore dhe ka përcaktuar një objektivë specifike që synon promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme por matur me pronësinë e grave në tokë që nuk përkon me objektivin e synuar.

Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022-2027²⁰ synon një administratë publike efikase dhe efektive, që i shërben interesit publik, i plotëson nevojat e qytetarëve dhe bizneseve dhe e kryen me sukses procesin e anëtarësimit në BE, duke përkrahur demokracinë dhe sundimin e ligjit. Strategjia ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- 1) planifikimi dhe koordinimi i politikave i orientuar drejt rezultateve;
- 2) ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë;
- 3) Shërbim publik profesional dhe menaxhim efektiv i burimeve njerëzore;
- 4) Rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike. Strategjia nuk ka integruar perspektivën gjinore në analizën e situatës as tek objektivat dhe aktivitetet strategjike.

¹⁹ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/01/STRATEGJIA-PER-BUJQESI-DHE-ZHVILLIM-RURAL.pdf>

²⁰ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/01/STRATEGJIA-E-REFORMES-SE-ADMINISTRATES-PUBLIKE-2022-2027.pdf>

Strategjia e Sigurisë e Kosovës 2022 - 2027²¹ duke qenë e përkushtuar për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve si dhe duke promovuar paqe, stabilitet dhe bashkëpunim të ndërsjellë me vendet e tjera. Interesat jetike të sigurisë janë: mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial; ruajtja e rendit kushtetues dhe siguria publike; dhe siguria njerëzore dhe zhvillimi shoqëror; integrimi në strukturat Euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë. Strategjia nuk ka integruar perspektivën gjinore në analizën e situatës edhe tek objektivat dhe aktivitetet strategjike.

Si përmbledhje mund të theksohet se ka hapësirë për të përmirësuar integrimin e perspektivës gjinore në dokumente strategjike, duke përfshi integrimin gjinor në analizën e situatës, përcaktimin e indikatorëve dhe masave.


3.2. Efektiviteti i PKBGJ-së

Ky seksion vlerëson shkallën në të cilën janë arritur dhe zbatuar objektivat e përcaktuara dhe aktivitetet e parapara në kuadër të Planit të Veprimit të PKBGJ-së. Nga intervistat u theksua se gjatë zbatimit të PKBGJ-së ekzistoi një vullnet politik për avancim të barazisë gjinore, dhe stabiliteti i lidhshëm në ABGJ dhe në mekanizmat institucional gjinor kontribuan në zbatim të PKBGJ-së. Siç u theksua më lartë pandemia COVID-19 ishte një faktorë pengues në punën e institucioneve e që ka ndikuar edhe në rezultatet e shënuara.

Siç është prezantuar në Figurën 1 nga gjithsej 36 indikatorëve të synuar në kuadër të PKBGJ-së vetëm 8 janë arritur (22% të caqeve), 14 nuk janë arritur, për 12 indikatorë nuk janë siguruar të dhënat ndërsa për 2 indikatorë në Objektivin e 3-të njëri nuk ka qenë e mundur të raportohet ngase njëri objektivi nuk ishte mirë i definuar dhe për tjetrin në mungesë të vlerës bazë nuk ishte caktuar as caku. Në përqindje në Objektivin e parë nga 10 caqet e synuara për vitin 2024, 30% u arritën, në Objektivin e dytë nga 12 caqe u arritën 25% e caqeve të caktuara ndërsa në Objektivin e tretë nga 14 caqe u arritën caqet për vetëm 14% të indikatorëve. Elaborim i detajuar do të prezantohet sipas Objektivave veç e veç në këtë seksion.


²¹ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/1-Strategjia-e-Sigurise-e-Kosoves-ALB.pdf>

Figura 1: Statusi i arritjes së caqeve të indikatorëve të PKBGJ-së, sipas shtyllave



Sa i përket realizimit të aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit të PKBGJ-së në mesin e 178 aktiviteteve të planifikuara u punua në 147 sosh do të thotë në 83% e aktiviteteve u punua (Figura 2). Sipas shtyllave shkalla më e lartë e zbatimit është në Objektivin e dytë strategjike (u puna në 97% të aktiviteteve të planifikuara), pasuar me Objektivin strategjik 1 (u realizuan aktivitete në 81% të të planifikuarave) ndërsa të dhënat tregojnë se më së paku është punuar në aktivitetet e përfshira në Objektivin Strategjik të tretë-në vetëm 61% të aktiviteteve të planifikuara.

Figura 2: Të dhënat përmblledhëse lidhur me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në PKBGJ-së, numri i aktiviteteve



Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në/nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale-Objektivi 1

Objektivi kishte për qëllim të avancoj fuqizimin ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale të grave, duke përmirësuar shpërndarjen e barabartë të fondet publike dhe pjesëmarrjen e grave në menaxhimin e burimeve. Indikatorët kryesorë të këtij objektivi ishte arritja e normës së punësimit të grave në 20% e që të dhënat për vitin 2023 tregojnë për një rezultat 19.8%-pothuajse arritje e caktuar të përcaktuar. Lidhur me mirëqenien sociale, në mungesë të të dhënave për shkallën e varfërisë në Kosovë të vlerësuar nga PKBGJ nuk mund të raportohet nëse synimi prej 13% është arritur. Një vlerësim i Bankës Botërore vlerëson se në vitin 2023 varfëria në Kosovë ishte 21.7%²², megjithatë në mungesë të vlerësimit nga ASK duke përdorur metodologjinë e njëjtë të aplikuar për caktimin e vlerës bazë nuk mund të raportojmë se varfëria është rritur dhe caku nuk është arritur.

Gjatë periudhës 2020-prill 2024 institucionet në nivelin qendror dhe lokal, OJQ dhe organizata ndërkombëtare realizuan një gamë të gjerë të aktiviteteve për mbështetur fuqizimin ekonomik të grave dhe përmirësuar mirëqenien ekonomike dhe sociale të grave dhe vajzave në vend. Aktivitetet e realizuara janë të listuara në Shtojcën 1 ndërsa në vijim do të ofrohet një përmbledhje e përgjithshme e aktiviteteve.

Rritja e punësimit të grave dhe vajzave

Të dhënat e prezantuara në Tabelën 2 tregojnë se përkundër angazhimit të Qeverisë përmes masave aktive të punësimit, trajnimeve, masave afirmative në sektorin e bujqësisë, projekteve të realizuara nga ministritë dhe komunat në vitin 2023 vetëm 24.2% e grave në moshë pune ishin aktive në tregun e punës (të punësuar apo duke kërkuar punë) tregues dukshëm larg synimit prej 40% të përcaktuar në PKBGJ.

Në vitin 2023, 33.9% e vajzave të moshës 15-24 vjeçare nuk ishin as të punësuar, as duke ndjekur shkollim ose trajnim, tregues ky shumë më i lartë se ai i parashikuar prej 20% sa ishte synuar.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete ndërmarrëse, në vitin 2023, 18% e bizneseve aktive ishin të regjistruara në emër ose bashkëpronësi të grave dhe ky objektivi u realizua.

Në kuadër të Objektivit specifik 1 u synua edhe rritja e qasjes së grave në pronë me synim që deri në fund të vitit 2024, 25% e pronave të ishin në pronë ose bashkëpronësi të grave. Sipas të dhënave të Agjencisë Kadastrale në janar të vitit 2024 19.8% e pronarëve ishin gra. Një kontribut të rëndësishëm në këtë rezultat mund të thuhet se ka pasur edhe masa afirmative e zbatuar përmes Udhëzimit Administrativ (UA) për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së

²² <https://thedocs.worldbank.org/en/doc/d5f32ef28464d01f195827b7e020a3e8-0500022021/related/mpo-xkx.pdf>

Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve. Në vitin 2024 gjithsej ishin 17,592 prona të regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve në krahasim me 105 sa ishin në vitin 2016 kur filloi zbatimi i këtij UA, dhe u vazhdua ndër vite.

Për rritjen e punësimit të grave në periudhën 2020-prill 2024, u realizuan një numër i madh i aktiviteteve. Agjencia e Punësimit në kuadër të MFPT gjatë kësaj periudhe trajnoi 3,827 vajza dhe gra, dhe mbështeti përmes masave aktive të punësimit 7,732 vajza dhe gra (**Lista e plotë e të gjitha aktiviteteve gjendet në Shtojcën 1 ndërsa në këtë seksion do të përmenden vetëm disa aktivitete.**

Në zbatim të drejtpërdrejtë të PKBGJ-së, 2020-2024, ABGJ përmes Fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike në Maj të 2021 ka mbështetur 24 OJQ - organizata të grave, në vlerë prej 647.000 Euro të cilat të cilat zbatojnë iniciativë në fushën e përmirësimit të mundësive të punësimit të grave përmes skemave të mbështetjes së biznesit, trajnimit dhe orientimit në menaxhimin e biznesit, përmirësimin e cilësisë së produktit dhe mbështetjen e skemave të biznesit në biznes (B2B), përmirësimin e marketingut dhe rrjeteve sociale dhe licencimin dhe regjistrimin e patentave dhe nismat kërkimore që kërkojnë të përmirësojnë të drejtat e grave në sektorin ekonomik - të gjitha për të mbështetur pjesëmarrjen dhe gratë në tregun e punës dhe për të rritur rritjen ekonomike të qëndrueshme përfshirëse për të gjithë.

Po ashtu, ABGJ ka mbështetur drejtpërdrejtë 273 biznese të vogla në pronësi të grave, në vlerë totale prej 207.284 Euro, këto janë gra të vetëpunësuar apo që punësojnë maksimalisht 2-3 gra. Përmes financimit të këtyre 24 OJQ ve të dhënat e para të monitorimit tregojnë se kanë përfituar në tërë territorin e RKS pa dallim etnie: totali i përfitueseve 1,296 gra dhe vajza të cilat përfituan shërbime: trajnime, grante, pjesëmarrje në trajnime për të promovuar produktet e biznesit, të marketingut të produkteve, monitorim, këshilla juridike, psiko-sociale, prezantimit në publik, të identifikimit të sëmundjeve të hershme. Janë targetuar po ashtu gratë të mbijetuara të dhunës, nëna vetushqyese-, dhe gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

- a) 185 gra dhe vajza -persona fizik përfituan grante për zgjerim biznesi;
- b) 48 gra dhe vajza persona juridik (OJQ -organizata të grave) përfituan grante;
- c) 803 gra dhe vajza, janë trajnuar për hapje e bizneseve të reja, shitjen e produkteve online, marketingun e produkteve, themelimit të brendit, funksionalizimit të faqeve për shitje të produkteve të bizneseve individuale; dhe
- d) 260 gra dhe vajza kanë përfituar shërbimeve si: këshilla juridike, shërbime dhe iniciativë të fuqizimit ekonomik të mbijetuarat e dhunës ndaj grave, shërbime psikologjike, si edhe pjesëmarrje në panairë ku kanë pasur mundësi promovimin e produkteve të bizneseve të grave.

Në vitin 2021 MBPZHR mbështeti gratë përmes pagesave direkte në vlerë prej 5.8 milionë Euro (për burra: 92,7 milionë Euro) dhe për grante për gra në vlerë prej 2.1 milionë Euro (12.6 milionë Euro për burra). Në vitin 2022 pagesa direkte përfituan 1,265 gra (23,469 burra) në vlerë prej 2.65 milionë Euro për gra (51.3 milionë Euro për burra); nga grantet kanë përfituar 145 gra (350 burra) në vlerë prej 7.2 milionë Euro për gra (për burrat 16.9 milionë Euro).

Me mbështetjen e UN Women, analiza gjinore specifike sektoriale në sektorin e bujqësisë në komunat e synuara u realizua e shoqëruar me sesione ndërgjegjëse. Në nivel lokal, 50 gra fermerë dhe zyrtarë komunale në vitin 2023 mësuan për rëndësinë e sigurimit të mjeteve për gratë për të përmirësuar agrobiznesin e tyre dhe për të kuptuar se si dixhitalizimi mund të hapë dyert për mundësi të reja ekonomike.

- ✓ *Komuna e Suharekës* për vitin 2023 subvencionoi 14 biznese të grave me nga 2,000 Euro.
- ✓ *Komuna e Rahovecit* në vitin 2023 subvencionoi 11 biznese artizanale që menaxhohen nga gratë;
- ✓ *Komuna e Gjilanit* subvencionoi 128 gra ndërmarrëse (40 nga komunitetet pakicë) me vlerë totale prej 40,800 Euro.
- ✓ Në vitin 2020 dhe 2021 janë organizuar 21 panairë për gratë në biznes nga MBPZHR dhe në 9 komuna (Podujevë, Shtime, Gjilan, Mitrovicë, Lipjan, Vushtrri, Hani i Elezit, Viti, Ferizaj).
- ✓ *MINT ka organizuar Panairin Gratë në Biznes 2022*, i cili është mbajtur në Prishtinë dhe ka zgjatur tri ditë. Në këtë panair kanë ekspozuar produktet e veta rreth 40 gra ndërmarrëse dhe panairë nga komunat.
- ✓ Gjatë vitit 2023 dhe 2024 u organizuan panairë vendore dhe ndërkombëtare të ndërmarrjeve në pronësi të grave nga komuna e : *Malishevës, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Lipjanit, Prishtinës, Rahovecit, Shtimes, Vitisë, dhe Skenderajt*.
- ✓ Në vitin 2020 dhe 2021 komunat që raportuan subvencionuan çerdhet nga komunat për 67 fëmijë të prindërve vetushqyes, me nevoja të veçanta dhe atyre nga skemat sociale janë: *Prishtina (93 fëmijë); Mitrovica e Jugut (11); Gjilani (5); Fushë Kosova (21); Kaçaniku (1); Skënderaj (8)*.
- ✓ Në vitin 2022 subvencionim për çerdhe për fëmijët e nënave vetushqyese kanë ofruar këto komuna: *Vitia, Gjilan, Obiliq, Fushë Kosovë, Suharekë, Prishtina, Prizren, Vushtrri, Klinë, Mitrovicë, Malishevë, Skenderaj, Klinë*.

- ✓ Në vitin 2023 dhe 2024, Komuna e Prishtinës, ka ofruar subvencionim të pagesës për 24 fëmijë të nënave vetë-ushqyese në kopshte, nëna përfituese të skemave sociale në vitin 2023, në vlerë prej 13,200 Euro. Komuna po ashtu ka subvencionuar 131 fëmijë të kopshteve private me vlerë totale 55,020 euro për gjashtë (6) muaj Nëntor 2023 deri më Prill 2024
- ✓ MASHTI përmes pakos së Ringjalljes Ekonomike, Masa 1.5, ka ndarë 957 kuponë për maturantë që janë trajnuar në fushën e TI (600 Euro për kandidat) dhe janë ndarë 112 bursa për drejtimet deficitare të AAP dhe drejtimet teknike për vajza (500 Euro për nxënës) në vlerë prej 56,000 Euro.
- ✓ Bursa për studente janë ndarë edhe nga komuna e *Podujevës, Prishtinës, Deçanit, Skenderajt, Prishtinës; Drenasit.*
- ✓ Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë-AWESK-ka mbajtur pesë ligjërata, në disa qytete të Kosovës në kuadër të projektit në muajt janar dhe shkurt të vitit 2020.

Në mesin e partnerëve ndërkombëtar, **MCC përmes Programit WEE-** Women in Energy Entrepreneurs mbështeti 174 gra sipërmarrëse me asistencë teknike dhe grante për të ndihmuar në rritjen e bizneseve të tyre nëpërmjet përdorimit efikas të energjisë. Programi WES- Women in Energy Scholarship mbështeti 28 gra me bursa nga të cilat në vitin 2021, 26 përfituese të bursave u diplomuan dhe iu dhanë Diploma Associate në kolegjin DMAC, Iowa (SHBA) në lëndë të ndryshme të lidhura me energjinë. Ky grup grash fitoi diploma në fusha si teknologjia e erës, teknologjia diellore, teknologjia rinovueseve, teknologjia e termocentraleve, prodhimi etj. WWI-Programi i praktikave të grave në energji gjatë kësaj periudhe mbështeti rreth 100 gra dhe vajza studente të larta dhe/ose të sapo diplomuara duke ofruar praktika me pagesë për 6 muaj në kompani dhe organizata të sektorit të energjisë.

Zyra e Bashkimit European mbështeti:

- ✓ OJQ-në Syri i Vizionit me 325,420 Euro (2020-2022) për të rritur mundësitë e punësimit dhe perspektivat e qëndrueshme për të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet etnike pakicë në Kosovë;
- ✓ Mbështeti Jakova Innovation Center me 232,260 Euro (2020-2022) për të rritur punësueshmërinë e të rinjve, grave dhe grupeve të pafavorizuara përmes zhvillimit të aftësive dhe njohurive të kërkuara në tregun lokal të punës;
- ✓ Mbështeti Business Support Center Kosovo(BSCK) me 308,037 Euro (2020-2022) për të rritur punësueshmërinë dhe perspektivat e qëndrueshme të punësimit për të rinjtë dhe gratë në sektorin e energjisë në Kosovë.

- ✓ Zyra e BE-së në vitin 2022 ka përkrahur me 1,500,000 Euro Zyren e UN Women për mbështetje për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave që integrojnë perspektivën gjinore, forcimin e kapaciteteve institucionale në Kosovë në të gjitha nivelet dhe përmirësimin e koordinimit mes mekanizmave për barazi gjinore dhe shoqërisë civile.
- ✓ Zyra e BE-së përmes WE Global ka nda 21 grante në vlerë prej 105,000 Euro për OJQ-të e drejtuara nga gratë për të përkrahur projektet që synojnë të nxisin angazhimin qytetar, barazinë gjinore dhe demokracinë gjithëpërfshirëse, duke rritur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje në Kosovë;
- ✓ BE një financim prej 384,756.5 Euro për vitin 2022-2023, ka mbështetur Qendrën për Trajnim dhe Burime të Avokimit në përmirësimin e kushteve të punës për grupet e cënueshme, forcimin e standardeve të sigurisë dhe promovimin e dialogut social. Projekti synon monitorimin e shkeljeve të të drejtave në punë, fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve dhe OJQ-ve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi ligjin e punës.
- ✓ Zyra e BE-së ka mbështetur UNDP-në me një buxhet prej 4,999,961 Euro për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale nga QPS-të dhe për të siguruar qasje të barabartë dhe cilësore në mbrojtjen sociale për grupet më të cënueshme, përfshirë gratë dhe vajzat.
- ✓ Zyra e BE-së, përmes programit Young Cell Scheme Round, ka mbështetur me 4,500,000 Euro nga viti 2022-2027 zhvillimin profesional të burrave dhe grave në shërbimin civil për t'i shërbyer më mirë qytetarëve të Kosovës. Programi ofron bursa për studime master në universitetet e BE-së, sipas sektorëve prioritarë të përcaktuar nga qeveria. Pas diplomimit, përfituesit angazhohen të punojnë për tre vite radhazi në institucionet e Kosovës.
- ✓ OSBE në vitin 2020, mbështeti me 10,907 Euro programi promovon rritjen e mundësive të punësimit për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës përmes praktikave profesionale në bashkëpunim me institucionet publike.
- ✓ Agjencioni Kosovar për Eficiencë të Energjisë/projekti nga Millenium Foundation Kosova ndau grante për Eficiencë të Energjisë për 410 gra, ndërsa 100 gra kanë përfituar praktikë profesionale në vitin 2021.
- ✓ Gjatë vitit 2022, *MCC nga Programi Gratë në Energji Praktika në Punë* kanë përfituar 237 gra dhe vajza, ka ofruar 6 muaj praktikë në punë me pagë mujore prej 250 Euro në ndërmarrje të sektorit të energjisë. Po ashtu, nga Programi Gratë Ndërmarrëse në Energji, kanë përfituar 387 gra dhe vajza me grante në blerjen e pajisjeve të ndryshme për shfrytëzim eficient të energjisë për veprimtarinë e bizneseve të tyre.
- ✓ Organizata Gratë për Gratë ka ofruar trajnime për 629 gra pjesëmarrëse; ka përkrahur me grante 25 biznese/start-up të grave; dhe 500 gra janë organizuar në rrjetëzime, takime dhe diskutime për mundësitë e bashkëpunimit dhe zgjerimit të tregut.

- ✓ Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) gjatë Vitit 2022 përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar/PZHRB ka përkrahur gjithsej 332 projekte ku nga to: 134 projekte të përfaqësuara nga gratë (shuma 1,014,883 Euro), dhe 198 projekte të përfaqësuara nga burrat (shuma 2,016,050 Euro).
- ✓ Në Programin për Mbështetje Financiare të OJQ-ve- për vitin 2022 në total kanë përfituar 38 projekte, prej tyre 16 përfituese kanë qenë gra dhe 22 përfitues burra. Në kuadër të thirrjes në Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB- Biznese) për vitin 2023 në total kanë përfituar 132 Projekte ku prej tyre kanë përfituar 45 gra dhe 87 burra.
- ✓ MZHR, gjatë vitit 2023, në kuadër të implementimit të projekteve nga “Thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve/ programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, OJQ “Asociacioni i Gruas Feminae” ka realizuar trajnimin me temën, “Përgatitja e grave për tregun e punës “ trajnim i cili u mbajt në kuadër të projektit “Potenciali i grave dhe vajzave për një të ardhme të fuqishme”.
- ✓ Trajnime dhe aktivitete informuese u organizuan nga komunat. Në vitin 2023 dhe 2022. Prishtina mbajti 10 takime këshilluese për gratë fermere për aplikim në subvencione dhe grante dhe organizoi punëtorinë me temë “Veglat Digjitale në agrobiznes”, e fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve digjitale për gra fermere në sektorin e bujqësisë;
- ✓ Komuna e Malishevës organizoi 10 trajnime – lidhur me avancimin e njohurive financiare dhe trajnoi 13 gra për biznes dhe mbajti 4 trajnime lidhur me drejtën në pronë, kujdesin për fëmijë dhe trajnim profesional;
- ✓ Komuna e Prizrenit organizoi 3 punëtori me gra nga OJQ ,studente dhe gra pa punë në temën e sfidave në punë dhe vështirësitë gjatë punësimit të grave .(rreth 40 gra dhe vajza përfituese) dhe 3 punëtori mbi administrimit të biznesit dhe avokim me 17 gra dhe vajza;
- ✓ Komuna e Shtimes organizoi aktivitet me Grupin e Grave/Instituti LCHT lidhur me ndërmarrësinë;
- ✓ Komuna e Skenderaj organizoi trajnim për 20 gra në fushën e dizajnit grafik.
- ✓ U organizuan fushata vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë në komunën e Drenasit, Dragashit, Malishevës, Gjakovës, Istogut, Kaçanikut, Fushë Kosovës, Lipjanit, Suharekës, Prishtinës, Rahovecit, Shtimes, dhe Skënderaj-it. Fushata vetëdijësuese për respektimin e kuotës të punësimit për personat me aftësi të kufizuara dhe evitimin e stigmatizimit në shoqëri u mbështetën nga Komuna e Prishtinës dhe Skenderajit. Komuna e Skënderajit ka hartuar Planin lokal të veprimave për punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Një ndër synimet e PKBGJ-së ishte edhe ndërlidhja e arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës, aktivitete të reflektuara nga Strategjia e Arsimit. Në kuadër të këtij

synimi, Qeveria e Kosovës themeloi Komisionin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe ndërlidhjen me tregun e punës në nivel të Kryeministrit me qëllim të avancimit të mëtejshëm të AAP-së përmes koordinimit ndërinstitucional. Është iniciuar finalizimi i draft dokumentit të kornizës kurrikulare për AAP dhe finalizimi i një numri të kurrikulave të rishikuara të profileve profesionale. Është themeluar grupi punues, i cili do të merret me standardizimin dhe unifikimin e modelit të qendrave të karrierës për nivelin e shkollave profesionale si dhe janë ndërmarrë hapa drejt definimit të formulës financiare për AAP përfshirë arsimin e përgjithshëm).

Qasje e barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime

Një synim i PKBGJ-së ishte të siguronte qasje të barabartë në fondet publike përmes integritit të perspektivës gjinore në 40% të politikave të reja publike dhe përmes sigurimit se 40% e fondeve publike do të përfitonin direkt gratë dhe vajzat në Kosovë. Në mungesë të evidencës dhe të dhënave nuk është e mundur të raportohet për përqindjen e politikave të reja publike që kanë integruar perspektivën gjinore. Duhet theksuar se ABGJ rregullisht komenton në të gjitha politikat publike duke përfshirë konceptet dokumentet, rregulloren, strategjitë e të tjera. Gjatë vitit 2020 ABGJ ka komentuar 30 ligje, ligje nënligjore dhe politika publike. Gjatë vitit 2021, ABGJ ka komentuar në 27 koncept dokumente, 12 projektligje, 9 udhëzime administrative, 4 draft rregullore dhe 3 strategji dhe plane veprimi.

Gjatë vitit 2022 ABGJ komentoi në 12 Udhëzime Administrative, 10 Projekt Ligje, 5 Rregullore, 4 Koncept Dokument, 3 Draft strategji dhe 1 Raport për të drejtat e njeriut. Në vitin 2023 ABGJ komentoi për 5 Udhëzime Administrative, 3 Projekt- Program kombëtare, 3 Projekt Ligje, 1 Rregullore dhe 1 draft strategji. Kjo u realizua përmes asistencës teknike e siguruar përmes UN Women.

Në vitin 2024, ABGJ ka ofruar komente për 3 projekt ligje, 1 draft - program kombëtar dhe një strategji. Duhet theksuar se në mungesë të një mekanizmi për të siguruar integritimin e komenteve të ABGJ-së nuk ka informatat nëse komentet janë integruar. Është e domosdoshme që të krijohet mekanizmi që monitoron përmes ABGJ mbi nivelin e integritimit të komenteve që lidhen me perspektivën gjinore në të gjitha politikat publike.

Në vitin 2022 Qeveria e Kosovës aprovoi Koncept dokumentin për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor të hartuar nën udhëheqjen e ABGJ-së. U themelua grupi punues për hartimin e kornizës ligjore për Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Është hartuar metodologjia e punës dhe paketa informuese për Grupin Punues. Në vitin 2023 në mbështetje nga UN Women u realizua studimi i fizibilitetit për integritimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në sistemin buxhetor të Kosovës. ABGJ ka organizuar 3 punëtori për draftimin e aktit nënligjor për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Lidhur me qasjen e barabartë në fonde publike nuk është arritur të sigurohen të dhënat për këtë indikatorë por nga të dhënat që janë siguruar vihet re masa afirmative për tu siguruar qasje e në fonde publike specifiku për gra dhe vajza janë ndërmarrë nga pothuajse të gjitha ministritë dhe komunat, si në vijim:

- ✓ MASHTI ofron bursa për vajzat në STEM
- ✓ MFPT mbështet në vazhdimësi strehimoret për rastet e dhunës në familje,
- ✓ MBPZHR zbaton masë afirmative gjatë ndarjes së granteve për bujqësi dhe zhvillim rural;
- ✓ Ministria e Ekonomisë ka zbatuar masë afirmative në masat për efikasitet të energjisë jo vetëm për gratë, por mbështetje edhe më të veçantë për nënat vetushqyese;
- ✓ Fondi për Garantimin e Kredive ka hapur dritare të veçantë për bizneset në pronësi të grave;
- ✓ Komunat kanë subvencionuar pagesat për fëmijët për nënat vetushqyese në çerdhe publike.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së trajnime të shumta u organizuan për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve në nivelin qendror dhe lokal lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Këto trajnime u mbështetën nga ABGJ, ministritë, komunat, SHC dhe organizatat ndërkombëtare.

Përmirësimi i kushteve të punës

Me synim përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale në PKBGJ u synua përmirësimi i kushteve të punësimit përmes zvogëlimit të punësimit joformal. Në vitin 2023, 9% e të punësuarve nuk kishin kontratë pune, tregues që ishte synuar të arrinte në 8% në vitin 2024. Në funksion të përmirësimit të kushteve të punës, në tetor 2021, UN WOMEN, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, lansoi Task Forcën Joformale të Avokimit mbi Standardet e ndjeshme gjinore për sigurinë dhe shëndetin në punë (SSHP), dhe punën e denjë.

- ✓ Në vitin 2022, MFPT ka licencuar mbi 17 kompani që kryejnë aktivitete nga siguria e shëndeti në punë dhe janë certifikuar mbi 300 persona për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SSHP). Në vitin 2022 është filluar me fushatën vetëdijësuese "Punë e denjë për jetë të dinjitetshme", fushatë nën udhëheqjen e MFPT-së dhe mbështetur nga Ambasada Suedeze në Kosovë, ndërsa partneri ishin IP, ATK ILO, UN WOMEN, CDF, IKS, QPA dhe Lens.
- ✓ Gjatë vitit 2023, ABGJ realizoi 16 trajnime dhe 375 pjesëmarrës janë certifikuar për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës në nivel

Qendror dhe lokal. Këto trajnime u realizuan ne bashkëpunim me IKAP dhe mbështetjen e UN WOMEN.

- ✓ Në vitin 2023, UN WOMEN trajnoi 24 inspektorë të punës (6 gra dhe 18 burra), nga rajone të ndryshme të Kosovës lidhur me dallimet gjinore në SSHP dhe ngacmimet seksuale në mjediset e punës, të mbështetur nga UN WOMEN dhe të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe i miratuar nga Inspektorati i Punës.
- ✓ RrGK dhe Institucioni i Avokatit të Popullit realizuan fushatë vetëdijësuese mbi ngacmimin seksual në tregun e punës.
- ✓ Në fushën e përmirësimit të kushteve të punës, në vitin 2021, UNFPA në partneritet me Rrjetin e Grave të Kosovës lansoi raportin *“Zgjerimi i zgjedhjeve përmes politikave miqësore ndaj familjes”* pasqyron shkallën në të cilën Kosova e ka harmonizuar kornizën me Direktivën e Bashkimit Evropian (BE) për balancën e punës dhe jetës. Raporti përmban tabelën e transpozimit për Direktivën e BE-së 2019/1158 në **Aneksin 1**.
- ✓ Në vitin 2022, UN WOMEN organizoi trajnim për ngritjen e kapaciteteve të 82 përfaqësuesve lidhur me parandalimin e ngacmimit seksual në vendin e punës; 10 gra ndërmarrëse, 36 zyrtarë publik të nivelit qendror dhe lokal dhe 31 përfaqësues të Qendrave të Arsimit Profesional dhe Qendrat e Kompetencës dhe 3 nga universitetet u trajnuar lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe ngacmimin dhe ngacmimin seksual.
- ✓ Në vitin 2023 aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë dhe prindëror u organizuan nga komuna e Drenasit, Gjakovës, Gjilanit, Istogut, Lipjanit, Prishtinës, Skenderajt, dhe Vushtrrisë.

Mirëqenia sociale dhe ekonomike

Skema e ndihmës sociale për zvogëlimin e varfërisë

Objektivi specifik 2 synonte që deri vitin 2024, 70% e të të varfërve të ishin mbuluar nga skemat e ndihmës sociale. Në mungesë të ndonjë vlerësimi nuk është e mundur të vlerësohet nëse është arritur ky objektivi.

Një raportim i Bankës Botërore në vitin 2022²³ thekson se nga 20% më të varfrit në Kosovë vetëm 25% përfitojnë nga ndihma sociale prandaj rekomandohej që të ndërmerrej një reformë për të siguruar rritjen e mbulueshmërisë dhe ofrimin e ndihmës sociale të mjaftueshme për të siguruar kushte minimale për jetesë.

Në tetor 2023, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve prezantoi projektin për reformën e asistencës sociale të mbështetur nga Banka Botërore, reformë që synon një skemë më efektive dhe gjithëpërfshirëse. Në vitin 2024 filloi pilotimi si ndryshim thelbësor që e trajton diskriminimin prezent në skemën aktuale. Përmes skemës së re sigurohet testimi i varfërisë

²³ <https://www.worldbank.org/en/news/opinion/2022/09/23/without-reform-on-social-protection-kosovo-s-poorest-and-most-vulnerable-will-be-left-behind>

përmes kalkulimit të të ardhurave në tre muajt e fundit, dhe pilotimi bëhet për të gjitha familjet që janë diskriminuar në kuadër të projektligjit aktual.

Trajnime për stafin e Qendrave për Punë Sociale u organizua nga UN Women (10 përfaqësues nga Divizioni i Ndihmës Sociale dhe 40 përfaqësues nga Qendrat për Punë Sociale për ofrimin e shërbimeve sociale²⁴.

Shërbimet sociale

Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare është miratuar nga Kuvendi me datë 14 dhjetor 2023, si dhe ka hyrë në fuqi me 5 janar të viti 2024. Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale Familjare, është themeluar me vendimin Nr. 25 të datës 25.01.2023 nga Ministria e Drejtësisë në përbërje të 21 anëtarëve, që ka për mandat zhvillimin profesionistëve ofruesve të shërbimeve sociale familjare dhe i cili është përgjegjës për të gjitha çështjet nga fusha e shërbimeve sociale familjare në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Gjatë vitit 2024 në bazë të vendimit Nr. 01/131 të datës 31.03.2023, Këshilli është Akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit për periudhën tri vjeçare me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, janë validuar 24 Module Trajnimi. Trajnime për punëtorët social të Qendrave për Punë Sociale janë ofruar edhe nga komunat.

MFPT me mbështetje me UNDP në vitin 2021, përmes Programit Aktiv të Tregut të Punës ka zhvilluar manualin operativ për avancimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës sociale në komuna në përputhje me kornizën ligjore për MFPT/Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjeve (DSPF); Udhëzimin Administrativ për llogaritjen e shumës mujore të Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për Procedurat Administrative për kthimin e pagesave nga përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për pagesën e ndihmës së njëhershme të ndihmës sociale; Udhëzimin Administrativ për llogaritjen e shumës mujore të Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për Procedurat Administrative për kthimin e pagesave nga përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për pagesën e ndihmës së njëhershme sociale.

Në vitin 2022, MFPT trajnoi rreth 200 ofrues të shërbimeve sociale familjare, punëtorë socialë të tre niveleve nga sektori qeveritar dhe joqeveritar.

Nga pesë modul-trajnimet e Organizuara nga Këshilli me mbështetjen Organizatës “Save dhe Children”, janë trajnuar 330 ofrues të shërbimeve sociale familjare nga sektori publik dhe sektori joqeveritar, ndërsa në total nga gjashtë modulet 462 profesionist, me 79 ditë trajnimi.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së u investua dhe u përmirësuan kushtet për personat më aftësi të kufizuara. Qendër rezidenciale ditore, për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara është ndërtuar në **Vushtrri**, komuna e **Podujevës** ka ofruar një ambient në objektin e komunës; **Komuna e Mitrovicës** ka ofruar në shërbim një objekt për shërbime ditore për

²⁴ <https://kryeministri.rks-qov.net/blog/fillon-pilotimi-i-skemes-se-reformuar-te-asistences-sociale-ne-kosove-2/>

personat me aftësi të kufizuara; në kompleksin social në **Gjilan** është ndërtuar edhe qendra rezidenciale për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Komuna e Skenderajt është në fazën përfundimtare të përfundimit të qendrës rezidenciale dhe rehabilituese për personat me nevoja të veçanta;

Komuna e Kaçanik ka ofruar një ambient në objektin e shtëpisë së kulturës nga komuna si hapësirë me e përshtatshme për aktivitete.

Komuna e Gjilanit me donatorë nga Kuvajti ka realizuar ndërtimin e kompleksit social ku është ndërtuar edhe qendra rezidenciale për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe pa përkujdesje sociale.

Komuna e Vitisë ka ndarë lokacionin për ndërtimin e një qendre rezidenciale për personat e moshës së tretë pa përkujdesje familjare.

Komuna e Podujevës ka ndarë parcelën dhe një pjesë të buxhetit për ndërtimin e kësaj qendre në bashkëpunim me OJQ, Jetimat e Ballkanit-Halil Kastrati.

Komuna e Gjakovës ka subvencionuar Handakosin në Gjakovë me vlere prej 20, 000 Euro, ku të njëjtin objekt iu ofron shërbime edhe për 3 shoqata me persona me aftësi të kufizuara.

Komuna e Suharekës: është ndërtuar objekti i ri i, "Handikos" nga firma ndërtimore "EURO ING".

Komuna e Prishtinës: ndërtoi qendrën për personat me Down Syndrom dhe autizëm.

Komuna e Prizrenit ka funksionalizuar Qendrën për strehimin dhe ofrimin e shërbimeve për persona me të meta mendore.

Në Viti, Kuvendi i Komunës ka ndarë lokacionin për ndërtimin e një objekti rezidencial për personat me aftësi të kufizuara mendore, qëndrim 24 orë.

UNDP gjatë vitit 2021 ka ofruar mbështetje në rindërtimin, rehabilitimin dhe rinovimin për 11 qendra të kujdesit rezidencial të OJQ-ve (strehëza urgjente, shtëpi për të moshuarit dhe fëmijët e braktisur, strehimoret e grave, qendrat e rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara) përmes skemave të granteve të ofruara për OJQ-të.

Tabela 2: Statusi i arritjes së caqeve të synuara në Objektivin strategjik 1

Indikatori	Synimi 2024	Realizimi 2023	Caku i arritur Po/Jo
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) grave të moshës 15-64 vjeçare-shkalla e punësimit	20%	19.8% (2023)	JO
Përqindja e Kosovareve që jetojnë në varfëri	13%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Objektivi specifik 1.1: Rritja e punësimit të grave dhe vajzave			
Shkalla e pjesëmarrje së grave të moshës 15-64 vjeçare në tregun e punës	40%	24.2% (2023)	JO
Përqindja e bizneseve aktive, në pronësi ose bashkëpronësi të grave	18%	18% (ARBK, 2023 ²⁵)	PO
Përqindja e të rinjve të moshës 15-24, që nuk janë as në punësuar, as në arsim e as në trajnime	20%	33.9% (G) 32.9% (B)	JO
Përqindja e pronave (shtëpive/banesave) të regjistruara në pronë ose bashkëpronësi të grave	25%	19.8% e pronarëve (Janar 2024) Agjencia Kadastrale	PO
Objektivi Specifik 1.2 Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime			
Përqindja e politikave publike me perspektivë gjinore të integruar	40% e politikave publike të reja	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Përqindja e fondeve publike që përfitohen nga gratë	40%	Nuk ka të dhëna për të gjitha fondet	Nuk ka të dhëna për të gjitha fondet
Norma e punësimit joformal (pa kontrata pune), përjashtuar sektorin e bujqësisë	8%	9% (2023)	JO
Shkalla e mbulueshmërisë së familjeve të varfëra nga Skemat e Ndihmës Sociale	70%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

²⁵ Raportuar në raportin e Institutit GAP:

https://www.institutigap.org/documents/90297_Ndermarresia%20e%20grave%20dhe%20pacicave.pdf

Në kuadër të Objektivit Strategjik 1 gjatë periudhës 2020-prill 2024 nuk është punuar në aktivitetet e shënuara në vijim:

- ✓ Analiza dhe vlerësimi i koston financiarë për subvencionimin e pagesës për edukimin parashkollor, për fëmijët nga familjet që janë në skema sociale;
- ✓ Hulumtim / analizë e situatës për mundësinë e themelimit të bashkimeve kreditore;
- ✓ Analizë dhe integrimi i perspektivës gjinore në Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK) për mbështetjen e grave. Siç u raportua në këtë raport Fondi ka ofruar mbështetje për bizneset e grave përmes dritares së veçantë por aktiviteti i planifikuar në Planin e Veprimit të PKBGJ-synonte analizën dhe integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha masat dhe mbështetjen e Fondit.
- ✓ Identifikimi i treguesve gjinor, për secilin institucion në nivel qendror dhe lokal, dhe raportimi i rregullt i tyre.
- ✓ Përgatitja e vlerësimit të ndikimit rregullativ për sigurimet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- ✓ Zhvillimi i metodologjisë dhe analiza për matjen e pabarazisë gjeografike/zonat më pak të favorizuara, me perspektivë gjinore, konsidero minoritet brenda minoritetit;
- ✓ Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.04/2024 për Tarifat për Produktet Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave, është miratuar në Mbledhjen e 211-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 02/211, aprovuar në qershor 2024;
- ✓ Informimi i grave për mundësitë dhe përparësitë e organizimit në kooperativa (takime, broshura);
- ✓ Ofrimi i trajnimeve në fushën e ndërmarrësisë dhe shkëmbimi i përvojave të mira me kooperativat e suksesshme;
- ✓ Ofrimi i mbështetjes (konsulenca, ndihmë juridike falas, rrjetëzimi, etj.) për themelimin e kooperativave;
- ✓ Mbështetja financiare për kooperativat e reja;
- ✓ Studimi lidhur me realizimin e të drejtës për alimentacion dhe analiza e praktikave të mira për të siguruar realizimin e alimentacionit;
- ✓ Hartimi i manualit dhe kornizës ligjore për monitorimin e LBGJ.

OBJEKTIVI 2

Objektivi specifik

2.1 Barazia gjinore trajtohet si kusht për arsim cilësor, gjithëpërfshirës

Qëllimi i këtij objektivi është të rritet pjesëmarrja e vajzave në arsim, adresimin e ndarjes së profesioneve në baza gjinore, avancimin e qasjes së vajzave dhe grave në grante hulumtuese dhe zhvillim profesional akademik, rritja e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në institucionet e arsimit, dhe eliminimin e stereotipeve gjinore nga plan programet dhe tekstet mësimore. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi direkt kontribuojnë në zbatimin e Nenit 21 “Edukimi për barazinë gjinore” të Ligjit për Barazi Gjinore përcakton obligimet dhe masat në fushën e arsimit. Në mesin e tyre theksohet *“Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor – edukativ, hartimit të materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektivës gjinore dhe eliminimin e stereotipeve negative, paragjykimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore”*.

Në kuadër të këtij objektivi u synua të arrihej përfaqësimin i barabartë gjinor në pozita vendimmarrëse në shkolla por synim që nuk u arrit në vitin shkollor 2022-23 ngase vetëm 35.8% e drejtorëve të shkollave ishin gra. Megjithatë përmirësim është vërejtur ngase në vitin 2017/17 vetëm 13% të drejtorëve ishin gra dhe caku prej 30% i synuar për vitin 2022 është tejkaluar-është duke u lëvizur në drejtim të përmirësimit.

Në përputhje me Nenin 21 të LBGJ-së PKBGJ përmes një game të gjerë të aktiviteteve synoi që 100% e teksteve shkollore të botuara dhe të rishikuara për qasje gjinore, nga të cilat janë eliminuar stereotipat gjinore, indikator për të cilin nuk janë siguruar të dhëna në formën e kërkuar të indikatorit. Për adresimin e stereotipave në tekste mësimore në vitin 2019 ABGJ ka hartuar dhe publikuar Manualin për Parandalimin e Stereotipeve Gjinore në Tekstet Shkollore²⁶:

- ✓ Gjatë procesit të botimit të teksteve të reja, MASHTI ka organizuar sesione informues me të gjithë recensentët (të cilët kanë pranuar edhe manualin) rreth respektimit të barazisë gjinore në tekstet shkollore si dhe parandalimit të stereotipave në tekstet shkollore. Sipas të dhënave të siguruara nga MASHTI në gusht të vitit 2023 janë trajtuar tekstet e lëndëve: Gjuhë shqipe, Histori, Shoqëria e mjedisi, Edukatë qytetare me plan për analizën e teksteve të klasave 10, 11 dhe 12, të lëndëve: Gjuhë Shqipe, Letërsi, Histori, Sociologji, filozofi, Psikologji, dhe Edukatë Qytetare.

²⁶ [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Manual%20SteriotipetGjinore-ALB\(1\).pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Manual%20SteriotipetGjinore-ALB(1).pdf)

- ✓ Në vitin 2023 MASHTI ka angazhuar projektin KosEd për shqyrtimin e teksteve dhe fillimisht janë shqyrtuar tekstet e gjuhës shqipe dhe të matematikës nga klasat 1-9. Tekstet në mënyrë të veçantë janë shikuar edhe nga aspekti gjinor. Në vitin 2023 MASHTI ka përkrahur hulumtimin mbi gjuhën e përdorur në tekste shkollore të realizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka realizuar dhe publikuar raportin Ex-officio për gjuhën e përdorur në tekstet mësimore të arsimit fillor. Raporti ka konstatuar që tekstet nuk janë diskriminuese. Lidhur me rritjen e përfaqësimit të autoreve gra, dhe eksperteve gjinor, në përpilimin e teksteve, kurrikulave, dhe recensione, MASHTI ka raportuar se nga shtatë fushat kurrikulare që janë, 4 koordinatorë të fushave janë gra.
- ✓ Qasja e fëmijëve të moshës 0-4 vjeçare është rritur nga 3% sa ishte në vitin 2018/18 në 7.2% në vitin shkollor 2022/23 duke e tejkaluar cakun prej 6% të përcaktuar në PKBGJ për vitin 2024. Një sërë aktivitete janë realizuar gjatë jetëgjatësisë së PKBGJ-së.
- ✓ Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me partnerët janë realizuar 3 analiza për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme si: me Bankën Botërore kemi realizuar analizën *“Nxjerrja e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private dhe të partneriteteve publiko-private për edukim parashkollor në Republikën e Kosovës”*.
- ✓ Me UNICEF-in *Zgjerimi i edukimit parashkollor në Kosovë* - Një instrument model për llogaritjen e projeksioneve si bazë për zgjerimin e infrastrukturës parashkollore në Kosovë.
- ✓ MASHTI në bashkëpunim me UNICEF-in ka realizuar *studimi i Fizibilitetit të Kopshteve Modulare për rritjen e qasjes në Edukimin e Hershëm në Kosovë*.
- ✓ Në vitin 2023 MASHTI ka hartuar dhe aprovuar Ligjin Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme me qëllim ofrimin e edukimit cilësor gjithëpërfshirës në të gjitha format e organizimit të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme për fëmijët prej lindjes deri në moshën 6 vjeçare, si dhe përcakton normat për organizimin, funksionimin, mbikëqyrjen, përgjegjësitë institucionale dhe profesionale të të gjithë akterëve për edukimin në fëmijërinë e hershme.
- ✓ Gjatë periudhës së raportimit për PKBGJ-së komunat dhe MASHT kanë raportuar për fillimin e ndërtimit të rreth 15-20 çerdheve dhe janë adaptuar disa objekte të shkollave mirëpo, të dhënat nga MASHT tregojnë se në vitin 2022/23 shkalla bruto e regjistrimit të fëmijëve të moshës 0-4 vjeçare në arsimin para fillor dhe parashkollor ishte vetëm 7.2%²⁷, dhe gjithsej ishin vetëm 54 institucione parashkollore/çerdhe në krahasim me 44 sa ishin në vitin 2020/21²⁸.

²⁷ <https://MASHT.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2022-2023.pdf>

²⁸ <https://MASHT.rks-gov.net/statistikat-e-arsimitne-kosove-2022-2023/>

MASHTI ka formuar grupin punues për hartimin e udhëzimeve administrative që dalin nga ky Ligj dhe sa i përket rritjes së shkallës së përfshirjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme, është draftuar udhëzimi administrativ për përfshirjen e fëmijëve në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe po ashtu është duke hartuar udhëzimin administrativ për format e organizimit të edukimit në fëmijërinë e hershme.

MASHTI, ka hartuar kurrikulën për edukimin në fëmijërinë e hershme, e cila në muajin shkurt të vitit 2024, ka filluar pilotimin në 10 komuna në 12 institucione parashkollore dhe në 17 klase para fillore. Kurrikula e re është hartuar për nivelin 0 të edukimit dhe përfshinë moshën 0-6 vjeç. MASHTI ka hartuar planin e procesit të pilotimit, janë aftësuar 11 trajnerë për trajnimin e edukatorëve për pilotimin e kurrikulës për EFH dhe 186 pjesëmarrës për pilotimin e kurrikulës për EFH. Janë përgatitur edhe dokumentacionin pedagogjik për procesin e pilotimit për kopshtet në pilotim. Janë aftësuar për kurrikulën e re 13 Inspektorë të Arsimit që mbulojnë 10 komunat ku është duke u pilotuar kurrikula.

Me qëllim të rritjes së qasjes dhe ofrimit të arsimit cilësor për fëmijët me nevoja të veçanta, gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, janë punësuar asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta (103 asistentë vetëm në vitin 2022) dhe janë ofruar trajnime për mësuesit e qendrave burimore për përdorimin e instrumentit për vlerësimin pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta në komuna. Në mungesë të të dhënave nuk mund të vlerësohet nëse caku për pjesëmarrjen e fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në sistemin e arsimit është arritur.

MASHTI ka raportuar se në vitin 2023 arsimin parafillor ishin të regjistruar 378 fëmijë të tri komuniteteve, 1,980 nxënës në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët dhe 413 nxënës në arsimin e mesëm të lartë. Rregullisht, MASHTI ka mbështetur me bursa çdo vit për komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptian.

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në arsimin e lartë të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptianë, në vitin 2022 MASHTI mbështeti me bursë prej 1,000 Euro 26 studentë, ndërsa 55 studentë në vitin akademik 2022/23. MASHTI, komunat, SHC dhe organizatat ndërkombëtare në vazhdimësi kanë organizuar aktivitete informuese për të nxitur pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në arsim: për shembull në vitin 2021 UN Women ka organizuar aktivitete me 300 individë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë më të informuar për rëndësinë e arsimit për gratë dhe vajzat përmes fushatës “derë më derë” dhe me 57 drejtorë dhe mësuesit e shkollave janë informuar se si të reduktojnë shkallën e braktisjes së shkollës për vajzat dhe vajzat e reja nga komunitetet pakicë. MASHTI ka mbështetur qendrat mësimore që merren më fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. MASHTI ka hartuar politikën për parandalimin e braktisjes së shkollimit brenda shkollës përmes aktiviteteve vetëdijësuese si dhe çdo shkollë brenda territorit të Kosovës e ka të themeluar ekipet e braktisjes, dhe menaxhohet si sistem nga MASHTI përmes sistemit SMIA.

Një nga indikatorët e synuar të PKBGJ-së ishte që deri në vitin 2024, 30% e grave të moshës 25-64 vjeçare të kishin të përfunduar arsimin e lartë. ASK ofroi të dhënat për grup-moshën 20-64vjeçare duke raportuar se 19.3% të grave të kësaj grup moshe kishin përfunduar arsimin e lartë, përqindje dukshëm më e ulët se ajo e synuar. Megjithatë, duke pasur parasysh rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në arsimin e lartë në vitet e fundit është e pritshme që ky indikator për grup-moshën 25-64 vjeçare të jetë mbi 19.3%.

Për adresimin e ndarjes gjinore në profesione MASHTI ndër morri një sërë masash. Gjatë periudhës 2020-2023, MASHTI ofroi këto mbështetje për vajzat:

- a) Ndau bursat për fushat STEM për 4,630 vajza në vlerë prej 4.6 milionë Euro;
- b) Ndau 112 bursa për drejtimet deficitare të AAP dhe drejtimet teknike për vajza në vlerë prej 56,000 Euro;
- c) Nga 24 kandidatë për bursë të doktoratës për studentët që studiojnë në 500 universitet me të mira të botës, prej tyre 10 vajza (2021);
- d) Mbështeti 28 studentë me aftësi të kufizuara (11 vajza dhe 17 djem) në shumë prej 1,000 Euro.
- e) MASHTI mbështeti edhe gratë në akademi: në 2023 - 41 përfitues të mobiliteteve akademike 12 gra vs. 29 burra, dhe mbështeti 7 gra në projekte të vogla kërkimore me shumë prej 61,000 Euro (ndërsa 11 burra u mbështetën me shumën prej 92,838 Euro).
- f) Përmes pakos së Ringjalljes ekonomike, Masa 1.5, ka ndarë 957 kuponë për maturan të që janë trajnuar në fushën e TI (600 Euro për kandidat);
- g) Janë ndarë 112 bursa për drejtimet deficitare të AAP dhe drejtimet teknike për vajza (500 Euro për nxënëse) në vlerë prej 56,000 Euro.
- h) MASHTI në vitin 2023 organizoi konferencën STEMins'ts'24 për gratë dhe vajzat në shkencë/promovimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës.

Bursa për studentë ofruan edhe komunat dhe po ashtu organizuan panairë për edukimin në karrierë dhe po ashtu ka integruar modulet e shërbimeve në karrierë janë të përfshira në Kurrikulën e Kosovës duke filluar prej fëmijërisë së hershme deri gjimnazet dhe shkollat profesionale.

Në përputhje me obligimin ligjor nga LBGJ për integrimin e perspektivës gjinore në programet e studimit, PKBGJ synoi që së paku 15 programeve në kurrikulat e arsimit të lartë të integrojnë perspektivën gjinore. Nga të dhënat e siguruar vetëm nga Universiteti i Prishtinës në vitin akademik 2023/24 ishin 16 lëndë me perspektivë gjinore të ofruara në 4 fakultete.

Një kontribut në këtë progres ofroi edhe ABGJ në kuadër të projektit të mbështetur nga SIDA Suedeze. Përmes kësaj mbështetje lënda Ekonomiksi Gjinor është integruar në studimet master në Fakultetin Ekonomik/Universiteti i Prishtinës. Për më tepër, ABGJ me mbështetje të Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung ka përkthyer në shqip librin “The Economics of Gender” nga autorja Joyce.P. Jacobsen, si tekst universitar dhe ABGJ botoi dhe ndau 230 kopje të librit donacion per UP/FE; dhuroi 20 kopje per Fakultetin Filozofik, dhe 5 Bibliotekës Kombëtare Universitare, 10 Bibliotekës Hivzi Sylejmani në Prishtinë, 20 kopje për Fakultetin Ekonomik Tiranë; 5 kopje Fakultetin Shtul-Tetovë.

ABGJ dhe NDI mbështetën përkthimin dhe botimin e librit “Hyrje e avancuar në ekonomiksin feminist” të autores Joyce.P. Jacobsen, ABGJ botoi dhe ndau 180 kopje për bibliotekën e Fakultetit Ekonomik. Në vitin 2023 ABGJ në bashkëpunim me NDI ka organizuar “Shkollën Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikën” me program 5 ditor ku janë certifikuar 30 studentë të moshës 18 deri 29 vjeç.

ABGJ dhe UN Women mbështetën hartimin e Planit të Veprimit të parë për Barazi Gjinore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina për periudhën 2023/4- 2025/6. Po i njëjti është miratuar nga Senati i UP, është publikuar dhe promovuar. Në zbatim të Planit, Universiteti i Prishtinës dhe ABGJ me mbështetje edhe të UN Women organizoi konferencën “Mbyllja e hendekut gjinor në Kosovë” në maj të vitit 2024 me folës nga universitetet Evropiane dhe ato regjionale dhe me më se 80 pjesëmarrës.

Në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina aktualisht janë 16 lëndë të cilat hynë në domenin e studimeve gjinore. Ofrimi i këtyre kurseve thekson përkushtimin e UP-së për edukimin e gjeneratave të reja, njohjen e koncepteve gjinore dhe integritetit gjinor, të cilët në të ardhmen mund të luajnë rol vendimmarrës në shoqëri.

Tabela 3: Lëndët me perspektivë gjinore në Universitetin e Prishtinës

	Titujt e lëndëve lidhur me gjininë	Fakulteti	Niveli i studimeve	Programi
1	Ekonomiksi gjinor	Ekonomik	Master	Ekonomiks
2	E drejta e barazisë gjinore	Juridik	Bachelor	LL. B.
3	Çështjet gjinore dhe politika	Filozofik	Bachelor	Shkenca Politike
4	Çështjet gjinore dhe politika	Filozofik	Bachelor	Sociologji
5	Studime dhe Hulumtime Gjinore	Filozofik	Bachelor	Antropologjia Kulturore
6	Gjinia dhe reprezentimi	Filozofik	Master	Sociologjia
7	Psikologji gjinore	Filozofik	Bachelor	Psikologjia
8	Gjinia dhe diversiteti	Filozofik	Bachelor	Punë Sociale
9	Histori gjinore	Filologjik	Bachelor	Histori
10	Hyrje në teoritë kulturore	Filologjik	Master	Orientalistika
11	Teoria postkoloniale	Filologjik	Master	Orientalistika
12	Shkrimi femëror	Filologjik	Bachelor	Letërsi Angleze
13	Krtika letrare feministe	Filologjik	Bachelor	Letërsi Angleze
14	Studime Gjinore në Art	Arte	Bachelor	Pikturë
15	Studime Gjinore në Art	Arte	Bachelor	Skulpturë
16	Studime Gjinore në Art	Arte	Bachelor	Art Konceptual dhe Mediat e reja

Aktivitete informuese dhe vetëdijësuese

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së MASHTI, komunat, SHC dhe partnerët ndërkombëtar organizuan aktivitete informuese dhe vetëdijësuese në fushat në vijim:

- ✓ Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në shkollë, bulëzimin dhe ngacmimin seksual;
- ✓ Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore;
- ✓ Ndërgjegjësim lidhur me parandalimin e martesave të hershme;
- ✓ Aktivitete informuese për sigurinë në rrugë si një e drejtë dhe përgjegjësi për të gjithë; “delikuenca e të miturve, dhuna në baza gjinore”; Droga, duhani, alkooli”; Mbrojtja nga trafikimi me qenie njerëzore; informim lidhur me pasojat nga përdorimi i substancave narkotike.

Aktivitetet që nuk u realizuan në fushën e arsimit

Bazuar në raportimet për monitorimin dhe vlerësimin e PKBGJ-së për periudhën 2020 deri në prill 2024, në fushën e arsimit nuk u realizuan këto aktivitete të planifikuara në Planin e Veprimit:

Nuk u ofruan bursa për studime gjinore jashtë vendit për djem dhe vajza (Young Cell Scheme) skemë e cila vazhdon por nuk është mbështetur ndonjë bursë në studime gjinore;

Nuk u zhvilluan treguesit e ndjeshëm gjinor të performancës në arsimin e ulët dhe të mesëm; dhe nuk u organizuan fushata vetëdijësuese për mundësitë e pjesëmarrjes në Arsim Profesional Joformal, në shkolla profesionale, dhe programe të përshpejtuara e të cilat do të ishin veçanërisht për gratë në moshën e mesme. Megjithatë duhet theksuar se trajnime të shkurtra profesionale ofrohen falas në 7 QAP-at regionale të Agjencisë së Punësimit.

Objektivi specifik 2.2. Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore

Ky objektivi specifik synon të kontribuoj në avancimin e barazisë gjinore duke theksuar të drejtën themelore për mundësi të papenguar në realizimin e kapaciteteve dhe potencialeve të vajzave dhe grave, eliminimin e praktikave diskriminuese shoqërore (në bazë të gjinisë, etnisë, moshës, dhe aftësisë) dhe krijimin e politikave të cilat përkrahin dhe avancojnë pjesëmarrje të barabartë të grupeve të marginalizuara. Specifikisht ky objektivi synon rritjen e përfshirjes së vajzave dhe grave në sport, dhe përfaqësimin adekuat të imazhit të grave në media.

Në fushën e medias PKBGJ së pari synoi krijimin dhe funksionalizimin e sistemit monitorues dhe raportues për imazhin e grave në media, por që ky sistem nuk u krijua. Për të analizuar prezantimin e grave më media në vitin 2021 ABGJ realizoi hulumtimin *“Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2016-2019”*. ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, me Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe UN WOMEN ka nënshkruar deklaratë të përbashkët me transmetuesin publik RTK për luftimin dhe parandalimin e seksizmit. Nga MASHTI u raportua se lënda e edukimit medial zhvillohet në të gjitha shkollat e mesme të larta në lëndët ekstrakurrikulare .

Trajnime për gazetarë u organizuan nga UN WOMEN dhe NDI në fushën e barazisë gjinore duke përfshi edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me dedikimin në kujtimin të grave krijuese, artiste, profesoresha universitare dhe gazetare që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje dhe të cilat nuk jetojnë më. Ku me këtë rast u organizuan 3 panele diskutimi me gratë krijuese, profesoresha universitare dhe gazetare. Konferencën e ndoqën 90 pjesëmarrës.

MKRS ofroi mbështetje për gratë në art dhe trashëgimi kulturore. Në vitin 2020 dhe 2021 mbështetja totale për gratë ishte 315,297 Euro, duke ofruar mbështetjen si në vijim. Në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike ka mbështetur :

- a) 8 OJQ të grave në vlerë prej 29,400 Eur dhe 4 projekte në vlerë prej 31,000 Euro;
- b) 10 gra krijuese janë mbështetur me 25,800 Eur (nga shuma totale prej 71,100 Euro);
- c) 5 gra në vlerë prej 12,900 Eur nga vlera totale prej 63,240 Eur;
- d) 10 OJQ të udhëhequra nga gratë për aktivitete projekte në vlerë prej 82,000 Euro; në fushën e diversitetit dhe dialogut kulturor.

Gjatë vitit 2020 dhe 2021 në kuadër të pakove mbështetëse, MKRS ka ofruar këto mbështetje: në fushën e diversitetit dhe dialogut kulturor ka mbështetur:

- a) 37 gra në vlerë prej 83,697 Euro;
- b) Me 19,500 Euro janë mbështetur 7 gra në fushën e arteve pamore.
- c) Për kulturë janë mbështetur 8 OJQ të grave në vlerë prej 29,400 Euro (nga vlera totale prej 82,600 Euro) dhe 4 projekte në vlerë prej 31,000 Euro (nga gjithsej 169,000 Euro).

Në vitin 2022 MKRS:

- a) mbështeti 104 projekte të grave në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore me shumën prej 929,763 Euro.

Në vitin 2023:

- a) u mbështetën 260 projekte të grave në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore në vlerë prej 2,428,384 Euro.

SPORTI

Në kuadër të këtij objekti u synua edhe rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në sport përmes mbështetjes së organizimit në klube dhe rritjes së qasjes në fondet publike për sport. Siç i PKBGJ-së ishte që të krijoheshin 6 klube të reja të sportive të udhëhequra nga gratë dhe vajzat, dhe që 50% e buxhetit për sport t'iu dedikohej aktiviteteve sportive të vajzave, nuk janë ofruar të dhëna për këtë indikator. Lidhur me shpërndarjen e fondeve për sportin e grave dhe vajza të dhënat nga MKRS janë ofruar vetëm në vlerë absolute por jo për përqindjen e fondeve të ndara për sport.

Përveç mbështetjes së ofruar në kuadër të masave mbështetëse gjatë pandemisë COVID-19 MKRS ka mbështetur vajzat në sport:

- ✓ Në vitin 2020 MKRS ka ndarë buxhet të veçantë për avancimin e femrave në sport, rreth 15% e totalit të kodit të subvencioneve dhe Departamenti i Sportit në kuadër të politikave programore të vitit 2020 për kundër që ka ndarë buxhet të veçantë për gra me rreth 380,000 Euro ka dizajnuar programe dhe mundësi të përfitimeve edhe në të gjitha politikat programore të Departamentit të Sportit.
- ✓ Në vitin 2022, nga 40% e fondeve të MKRS për klube kanë qenë klube të grave ndërsa nga thirrjet e veçanta individuale kategorizimi, shpërblimet, bursat, lëndimet dhe mobiliteti ishin gjithsej 61 përfituese gra me vlerë prej 310,266 Euro.
- ✓ Në vitin 2023 MKRS mbështeti mbajtjen e 36 kampionateve shtetërore për vajza dhe gra, buxheti për këto aktivitete ishte 242,924 Euro dhe ofroi mbështetje financiare për ngritje të kapaciteteve profesionale në sport për gjashtë vajza dhe gra.
- ✓ Përmes thirrjes publike, MKRS në vitin 2023 mbështeti publikimin e një libri dhe dy dokumentarëve për promovimin e vajzave dhe grave në sport dhe krijoi platformën dhe udhëzuesit për sport të sigurt.
- ✓ Përmes subvencionimit të ABGJ-së, QKSGJ ka realizuar hulumtimin *“Gratë dhe vajzat në fushën e sportit: hulumtimi mbi stereotipat gjinore dhe barrierave që pengojnë qasje të barabartë në sport”*²⁹. ABGJ ka mbështetur realizimin dhe shfaqur videospotin *“Parandalimi dhe trajtimi i ngacmimit seksual në sport”*.
- ✓ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë vitit 2020, nga fondi emergjent kanë ofruar mbështetjen si në vijim: gjatë vitit 2020, nga fondi emergjent ka ofruar mbështetjen për 91 klube me vlerë buxhetore 442,750 Euro dhe 134,640 Euro për klube të përziera.

²⁹ <https://abgj.rks.gov.net/assets/cms/uploads/files/Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20dhe%20Vajzat%20n%C3%AB%20Fush%C3%A8%20e%20Sportit.pdf>

- ✓ Në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike të vitit 2021, MKRS ka ndarë 118,500 Euro për 38 sportiste gra dhe janë mbështetur edhe 42 klube të vajzave në vlerë prej 150,979 Euro.
- ✓ Në vitin 2023 dhe 2024, MKRS ofroi mbështetje financiare për ngritje të kapaciteteve profesionale në sport për 6 vajza dhe gra përmes thirrjes publike. MKRS mbështeti publikimin e 1 libri dhe 2 dokumentarëve për promovimin e vajzave dhe grave në sport. Buxheti për këto aktivitete ishte 242,924.00 Euro.
- ✓ Mbështetje për vajzat në sport dhe investim në infrastrukturë sportive kanë ofruar/realizuar edhe komuna, si ajo e Deçanit, Prishtinës, Malishevës, Suhareka, Skënderaj, kanë mbështetur klubet sportive të grave dhe investimet në infrastrukturën sportive. Në mungesë të raportimit të plotë nuk mund të raportohet vlera e totaleve e investimeve dhe subvencionimit në nivel vendi.
- ✓ Në vitin 2021, komuna e Suharekës ka krijuar 5 fusha rekreative-sportive për gratë dhe fëmijët.
- ✓ Komuna e Gjilanit ka realizuar projektin në fushën e sportit “Barazia gjinore në Sport” Debat i organizua me të rinjtë dhe profesionistët e fushës, me temën “Pasioni s’ka gjini”. Financuar nga DKRS dhe realizuar nga ZBGJ dhe OJQ Gruaja Hyjnore.
- ✓ Në vitin 2022, komuna e Deçanit, Prishtinës, Malishevës, dhe Skenderajt kanë mbështetur klubet sportive të grave ndërsa komuna e Dragashit, Suharekës, Prizrenit, Shtimes dhe Lipjanit në mbështetje të UN Women ka realizuar analizën gjinore në Drejtorinë e Artit të Kulturës Rinisë dhe Sportit.
- ✓ Në vitin 2023, mbështetje për klubet sportive të vajzave ofruan komunat si ajo e Malishevës, Gjilani, Prizrenit, Hanit të Elezit.

Në fushën e mjedisit janë organizuar një sërë aktivitete:

- ✓ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka mbajtur ligjërata për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor; shënoi Ditën Botërore e Ujërave; Ditën Botërore të Tokës; Ditën Botërore të Biodiversitetit 22 Maj 2021, Ditën Botërore ‘Pa makina’; Ditën Ndërkombëtare të Ecjes së Lirë në Natyrë; dhe Ditën Ndërkombëtare të Meteorologjisë.
- ✓ Aktivitete për vetëdijësim për mbrojtjen e ambientit janë raportuar edhe nga komunat si ajo e Fushë Kosovës, Junikut dhe Gjakovës, Prishtinës, Podujevës, Klinës, Deçanit, Obiliqit dhe Skenderajt;

- ✓ Aktivitete informuese në fushën e mjedisit organizuan edhe Universiteti i Prishtinës dhe Prizrenit. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkë organizim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës;
- ✓ Në vitin 2023, MMPHI ka mbajtur aktivitete vetëdijesuese lidhur me cilësinë e ajrit dhe mbrojtjen e natyrës janë mbajtur edhe në kuadër të projektit të bashkëpunimit në mes të AMMK dhe Agjencisë së Mjedisit të Suedisë dhe punëtorinë dy ditore “Kontributi i Grave në mbrojtjen e resurseve ujore dhe përfshirja e barabartë gjinore” përkrahur nga Programi i Menagjimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë. Te kuptuarit e roleve, përgjegjësi, përparësi dhe nevojave të ndryshme thelbësore për çdo projekt në lidhje me menaxhimin e ujërave. Është mirëmbajtur dhe përmirësuar portali për cilësinë e ajrit si dhe janë publikuar të dhëna dhe informata në ueb faqen e AMMK dhe të IHMK.
- ✓ Në mbështetje të UNDP-së u lansua skema e parë e mentorimit për ndryshimet klimatike për 28 studentë universitare (18 femra/10 burra), duke rritur njohuritë dhe interesin për mjedisin, ndryshimet klimatike dhe zhvillimin rural, dhe për të rritur përpjekjet për të përshpejtuar veprimet për klimën.

Objektivi specifik 2.3 Gjithë përfshirja në kujdesin cilësor shëndetësor dhe edukimi shëndetësor i popullatës mbi barazinë gjinore, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues

Kjo objektivi thekson nevojën për përkushtim politik dhe profesional të institucioneve dhe punëtorëve shëndetësor ndaj grupeve vulnerable të cilat ballafaqohen me barriera të ndryshme në shërbimet shëndetësore (gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuar dhe banorët e zonave rurale, minoritetet etnike etj). Aktivitetet e identifikuara mund të përmbledhen në tri fusha të veprimit:

- a) Parandalimi, Mjedisi dhe Edukimi;
- b) Qasja në shërbime; dhe
- c) Shëndeti riprodhues dhe planifikimi familjar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave për shëndetin në PKBGJ u synua që deri në vitin 2024 të zhvillohej sistemi për informatat shëndetësore (SISH) i cili nuk është funksionalizuar ende.

Për të siguruar qasje në shërbime u synua që së paku 30% e lehonave/foshnjave të vizitoheshin në shtëpi: të dhëna në përqindje nuk janë ofruar nga Ministria e Shëndetësisë por është raportuar se në vitin 2023 u realizuan 36,336 vizita në shtëpi për fëmijë 0-3 vjeç, 668 vizita për gra shtatzëna, dhe 3,247 fëmijë dhe lehona të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes.

Gjatë vitit 2021, Ministria e Shëndetësisë në kuadër të programit të “vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë nga 22 komuna numri total i vizitave është 22,888; 19,182 vizitave shtëpiake për fëmijë; 3,695 vizita të grave shtatzëna dhe 813 vizita fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Gjatë vitit 2022, Janar-Qershor në kuadër të programit të “Vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë ” nga 22 komuna numri total i vizitave ishte 22,888, numri i vizitave shtëpiake për fëmijë është 19,182 ndërsa numri i grave shtatzëna 3,695.

Në vitin 2023 u pilotua ofrimi i vaksinës kundër virusit papilloma virus-HPV ndërsa u përfshi në kalendarin e vaksinave që nga viti 2024. ABGJ në kuadër të muajit tetor-muaji kundër kancerit të gjirit ka ndriçuar ndërtesën e Qeverisë me ngjyrë rozë dhe kordelen e bardhë, simbol i luftës kundër kancerit të gjirit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për kontrolle parandaluese dhe realizoi video spotin për kancerin e gjirit.

Ministria e Shëndetësisë ka trajnuar 45 punëtorë shëndetësor (PSH): për identifikimin dhe menaxhimin dhe referimin e të mbijetuarave nga dhuna në bazë gjinor; 19 punëtorë shëndetësor në menaxhimi sindromit IST-ve dhe 21 për planifikimin familjar; 25 PSh -trajnimi për shëndetin e adoleshentëve; 44 profesionistë nga KPSH janë trajnuar për kodin etik dhe deontologji; trajnime të Trajnerëve; Edukimi Bashkëmoshatar; 16 TIT 2020, të certifikuar 560 Edukator Bashkëmoshatar; 15 trajnerë për trajnerë 2022, të certifikuar dhe 239 Edukator Bashkëmoshatar.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Shëndetësisë ka organizuar Java e kancerit të qafës së mitrës 26 - 31 Janar 2022 (në bashkëpunim me ‘Smear to smear’ 42 pjesëmarrës, janë shpërndarë 1,562 fletëpalosje. Ministria e Shëndetësisë ofroi trajnim për 1,436 adoleshentë lidhur me Shëndetin Riprodhues;

QKUK ka raportuar për 130 ekzaminime me mamograf. Ministria e Shëndetësisë ka organizuar 30 Trajnime të mësimdhënësve mbi Shëndetin Riprodhues dhe Edukimin Seksual Gjithëpërfshirës dhe bashkë me UNFPA ka hartuar tre doracak për mësimdhënës për edukimin për shëndetin riprodhues dhe edukimin seksual. Janë trajnuar gjatë vitit 2022: 839 mësimdhënës gjithsej 645 mësimdhënëse gra dhe 194 burra

Gjatë zbatimit të PKBGJ-së, me aktivitete u shënuan ditët në vijim:

- ✓ Dita botërore e kontraktivëve 2020-2021 me 1,750 përfitues;
- ✓ Java Evropiane e testimit për HIV 2020-2021, me përfitues 1,550;
- ✓ Dita botërore lidhur me AIDS-it 2020-2021, me përfitues 2,050;
- ✓ Dita Botërore të Turbekulozit.

Lidhur me edukimin lidhur me planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues MASHTI raportoi se edukimi mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesë e planeve mësimore. MASHTI ka hartuar edhe doracak të veçantë për mësimdhënës për edukimin seksual dhe shëndeti riprodhues për klasën 1-5, 6-9 dhe 10-12 dhe 60% e mësimdhënësve janë trajnuar. Është mbajtur trajnimi për MISP-pako Minimale Iniciale për Shëndetin riprodhues në situatë emergjente- 17 trajnime me 290 profesionistë shëndetësor të trajnuar. Gjatë vitit 2020 dhe 2021, UNFPA ka organizuar 45 trajnime të mësimdhënësve mbi Shëndetin Riprodhues dhe Edukimin Seksual Gjithëpërfshirës.

Trajnime dhe aktivitete lidhur me edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojave specifike shëndetësore të femrave dhe meshkujve organizuar nga komuna e Gjakovës; Vitisë, Obiliqit, Fushë Kosovës, Suharekës, Prishtinës, Suharekës, Mitrovicës, Klinës dhe Dragashit.

MASHTI ka hartuar doracakët për mësimdhënës dhe për prindër për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues. Janë realizuar 12 video për 12 klasë dhe është përgatitur broshura për prindër dhe Doracaku për fëmijët me aftësi të kufizuara. Po ashtu janë mbajtur trajnime me 2,040 mësimdhënës bazuar në lëndët që trajtojnë shëndetin seksual riprodhues.

Indikator i fundit në kuadër të Objektivit 2.3 është zvogëlimi i martesave tek adoleshentët e moshës 10-14 dhe 15-19 vjeçare, nga 761 sa ishin në 2018 në 190 në vitin 2024. Të dhënat nga ASK tregojnë se në vitin 2023 ishin 2 martesa të vajzave të moshës 14 e më pak dhe 338 të atyre në moshë 15-19 vjeçare.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ u organizua një numër i fushatave dhe sesioneve informuese dhe ligjërata mbi martesat e hershme në 12 shkolla fillore dhe të mesme, në parandalimin e martesave të hershme: 6 fushata gjatë vitit 2020 dhe 2021 të organizuara nga RROGRAE klasët me nxënës nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian;

Në vitin 2023 një fushatë nga Komuna e Fushë Kosovës dhe 2 nga ajo e Prishtinës; dhe një sesion informues me gra të Këshillit të Prindërve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në komunën e Gjakovës-organizuar nga OSBE dhe MASHTI.

Në funksion të këtij objekti mund të raportohen edhe këto aktivitete: UN Women ka organizuar aktivitete me 300 individë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë më të informuar për rëndësinë e arsimit për gratë dhe vajzat përmes fushatës “derë më derë” dhe me 57 drejtorë dhe mësues të shkollave janë informuar se si të reduktojnë shkallën e braktisjes së shkollës për vajzat dhe vajzat e reja nga komunitetet pakicë.

UN Women mbështeti zhvillimin e platformës dhe raportit të hartës dixhitale për të identifikuar komunat me rrezik të lartë të braktisjes së shkollës për gratë dhe vajzat e reja nga komunitetet pakicë.

Në nëntor-dhjetor 2022, OSBE me buxhet 1,220 Euro, i ofroj 11 seanca edukative shëndetësore për gratë në gjithë Kosovën, duke përfshirë mamografinë falas për pjesëmarrëset.

Tabela 5: Statusi i arritjes së cageve të synuara në Objektivin strategjik 2

Indikatori	Synimi 2024	Realizimi 2023	Caku i arritur Po/Jo
Objektivi specifik 2.1 Barazia gjinore trajtohet si kusht për arsim cilësor, gjithëpërfshirës			
Përqindja e grave drejtore në shkollat e arsimit para-universitar	50%	35.8% (2022-23) MASHTI	JO
Përqindja e teksteve shkollore të botuara dhe të rishikuara për qasje gjinore, nga të cilat janë eliminuar stereotipat gjinore	100%	Nuk ka të dhëna për % e teksteve të rishikuara Janë rishikuar tekstet e gjuhës shqipe dhe të matematikës nga klasat 1-9 dhe janë nxjerrë rekomandime.	Nuk ka të dhëna për % e teksteve të rishikuara
Përqindja e fëmijëve të moshës 0-4 vjeçare, në institucione parashkollore-shkalla bruto e regjistrimit	6%	7.2% (2022/23) ³⁰	PO
Përqindja e vajzave/grave të moshës 25-64 vjeçare që kanë përfunduar arsimin e lartë	30%	19.3% (2023)	JO
Përqindja e fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në sistemin e arsimit	Rritje prej 10% në arsimin e obligueshëm dhe rritje prej 20% në arsimin e mesëm të lartë	Nuk ka të dhëna në%: në arsimin parafillor 378 fëmijë, në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët 1,980 dhe në arsimin e mesëm të lartë janë 413 nxënës.	Nuk ka të dhëna
Numri i programeve në kurrikulat e arsimit të lartë që kanë të integruar perspektivën gjinore	15	17 (ne UP)	PO
Objektivi specifik 2.2 Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore			
Ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemit në media monitorues për imazhin e grave	Sistemi monitorues funksional 6 hulumtime	Nuk ka sistem	JO
a) Numri i klubeve sportive të udhëhequra nga vajzat b) % e buxhetit për sport alokuar aktiviteteve sportive të vajzave	a) 6 klube b) 50% e buxhetit për sport i dedikuar aktiviteteve sportive të vajzave		Nuk janë ofruar të dhëna në % për indikatorin a dhe b.
Objektivi specifik 2.3 Gjithë përfshirja në kujdesin cilësor shëndetësor dhe edukimi shëndetësor i popullatës mbi barazinë gjinore, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues			
Përqindja e të dhënave shëndetësore të përfshira në sistemin informativ të shëndetësisë	Sistemi funksionalizuar	Sistemi nuk është zhvilluar por vetëm pilotuar në disa komuna	JO
Përqindja e lehonave/ foshnjave të vizituara në shtëpi	30%	36,336 vizita në shtëpi për fëmijë	Nuk ka të dhëna në %

³⁰ <https://MASHT.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2023/12/Raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2022-2023.pdf>

		0-3 vjeç të realizuara; 668 vizita për gra shtatzëna të realizuara; 3,247 fëmijë dhe lehona të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes (2023)	
Avancimi i edukimit dhe vendimmarrjes tek vajzat, djemtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual dhe riprodhues (%)	Zbatimi i programit në të gjitha nivelet dhe institucionet (100%)	100% edukimi mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesë e planeve mësimore. MASHTI ka hartuar edhe doracak të veçantë për mësimdhënës për edukimin seksual dhe shëndeti riprodhues për klasën 1-5, 6-9 dhe 10-12. Prej këtyre mësimdhënësve janë trajnuar 60% për qind e tyre.	PO
Numri i lindjeve tek adoleshentët 10-14 dhe 15-19 vjeçare	190	Mosha 14 e më pak=2 Mosha 15-19: 338 (2023) ³¹	JO

Gjatë periudhës 2020-prill 2024 nuk është punuar në këto aktivitete:

Në kuadër të Objektivit të dytë strategjik, gjatë periudhës 2020-prill 2024 nuk është punuar në këto aktivitete, pra nuk u realizuan këto aktivitete:

1. Hulumtime mbi hapësirat publike, trashëgiminë kulturore, dhe gjininë;
2. Trajnim dhe ndërgjegjësim i mediave për informimin e qytetarëve për çështjet shëndetësore (shëndet riprodhues, të ushqyerit me qumësht gjiri, të ushqyerit e shëndetshëm, edukatë seksuale) dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë për raportim etik dhe profesional të çështjeve shëndetësore; dhe
3. Finalizimi i hulumtimit mbi praktikën e planifikimit familjar dhe abortit selektiv, aktivitet i raportuar të jetë në progres.

³¹ <https://askapi.rks-gov.net/Custom/517ac5fd-4733-415b-9273-555282234314.pdf>

Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore

Në nivel të objektivit strategjik u synua shkalla e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në institucione publike (në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror) në vitin 2024 të arrinte së paku 40%, cak i tejkaluar ngase në vitin 2024 45.6% e të punësuarve në ministri dhe agjenci ekzekutive janë gra.

Për të matur qasjen në drejtësi në PKBGJ u synua që deri në vitin 2024 të gjitha rastet e dhunës në familje të trajtoheshin nga gjyqësori. Përgjatë dy vlerësimeve të para dhe të këtij final është konsideruar se ky indikator nuk është definuar mirë dhe është vështirë i matshëm dhe e pamundur të sigurohen të dhënat.

Objektivi specifik 3.1. Fuqizimi i mekanizmave institucional dhe ngritja e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi

Përmes një liste të gjerë aktiviteteve PKBGJ synoi në ngritjen e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi. Treguesi matës për arritjen e këtij objekti ishte hartimi dhe aprovimi i politikës ndëshkimore për zbatimin adekuat të sanksioneve për kryesit e dhunës në baza gjinore, përfshi edhe dënimet adekuate për rastet e trafikimit me qeniet njerëzore. Në PKBGJ nuk kishte sqarime se çfarë synohej specifikisht prandaj edhe nuk është e mundur të vlerësohej nëse caku është arritur. Megjithatë, gjatë kohës së zbatimit të PKBGJ-së janë bërë disa investime madhore si në vijim.

- ✓ Në Kushtetutën e Kosovës u përfshi Konventa e Stambollit, instrument ligjor për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës familjare, si dhe për mbrojtjen e viktimave;
- ✓ Ministria e Drejtësisë ka plotësuar dhe ndryshuar Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit i cili ka hyrë në fuqi më 17 nëntor 2022, më të cilin janë adresuar një mori ndryshimesh si zgjatja e afatit për aplikim nga 6 muaj sa ka qenë në ligjin e vjetër, në 3 vjet pas pranimit të aktgjykimit të formës së prerë; është krijuar mundësia e qasjes së menjëhershme në kompensim të viktimave të dhunës në familje, viktimave fëmijë, etj.; janë ndryshuar mënyrat dhe lartësia e kompensimit sidomos veprat penale të dhunës në familje të cilat me lehtësi, sipas ligjit për kompensim e që në të kaluarën janë refuzuar; janë thjeshtësuar formularët për aplikim si dhe mënyrat e aplikimi. Parashtruesit e kërkesave mund të dërgojnë në adresë elektronike në adresën elektronike të komisionit, në mënyrë fizike, apo edhe me postë;
- ✓ Gjatë vitit 2023 Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsejtë 129 kërkesa për kompensim. Prej tyre janë aprovuar 98 kërkesa, kurse janë refuzuar 24 dhe 7 kërkesa janë bartur për vitin 2024. Prej tyre janë 86 femra dhe 43 meshkuj. Vlera totale e kompensimit në vitin 2023 ishte 221,250 Euro;

- ✓ Në mars të vitit 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ku bazuar në këtë ligj janë shtuar kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas të cilave kategori u ofrohet ndihma juridike falas;
- ✓ Kuvendi i Republikës së Kosovës në tetor të vitit 2023, ka miratuar Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Përveç dënimeve të parapara në Kodin Penal janë shtuar vepra të reja penale dhe dënimet plotësuese, për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje: ndalimi i blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, aseteve publike apo licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga 3-10 vjet; ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo forme tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislacioni në fuqi nga 3-10 vjet; ndalon të drejtën e kandidimit në çdo pozite publike nga 3-10 vjet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje; ndalon punësimin në sektorin publik në të gjitha nivelet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit; ndalon të drejtën në përfitimin e patente shoferit dhe të drejtën në drejtimin e automjetit në çdo lloj të kategorisë, nga një 1-5 vjet, personit që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit; gjykata urdhëron publikimin e aktgjykimit për personin që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit, sulmit seksual si dhe dhunës në familje. U shtuan këto vepra të reja penale: testimi i virgjërisë; dhuna kundër grave në jetën publike; krimet kibernetike;
- ✓ Në vitin 2023 u aprovua Ligji Nr. 08/L-185 Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore;
- ✓ Ministria e Drejtësisë/ Zyra e Koordinatorës Nacionale Kundër Dhunës në Familje, në Planin e Punës për vitin 2024, ka planifikuar Plotësim/Ndryshimin e Kodit Penal për përfshirjen e femicidit si vepër të veçantë penale;
- ✓ Në vitin 2024 ABGJ ka themeluar grupin punës për plotësimin dhe ndryshimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore.
- ✓ ABGJ rregullisht ka mbajtur ciklin e trajnimeve për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për nevojat e Policisë së Kosovës, ku përmes këtij trajnimi policia informohet, orientohet për përgjegjësitë institucionale konform Procedurave Standarde të Veprimit dhe obligimeve të reja që derivojnë nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjimore: vetëm në periudhën 2023-2024 ABGJ organizoi 9 trajnime me 307 zyrtarë policor të certifikuar për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
- ✓ ABGJ ka mbështetur tërë procesin e amabamentimit të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, me ekspertizë dhe financim të punëtorive.

Në PKBGJ u synua të zvogëlohej përqindja e vajzave dhe grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike por në mungesë të të dhënave-baseline në kohën e hartimit të PKBGJ-së për këtë indikator nuk u caktua vlera e synuar. Në vitin 2023, ky hendek u plotësua me hulumtimin e realizuar nga ASK me titull "Dhuna në Baza Gjinore". Ky studim u realizua përmes anketimit të 3,000 ekonomive familjare në periudhën 8 nëntor 2021 dhe ka përfunduar më 15 prill 2022-studimi gjeti se 25.6% e grave të anketuara kishin përjetuar dhunë fizike, psikologjike ose seksuale, hulumtimi do të duhej të validohet.

Gjatë zbatimit të PKBGJ-së, ABGJ, ministritë dhe komunat organizuan çdo vit aktivitete të shumta gjatë fushatës 16 Ditëve të Aktivizim, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në baza gjinore.

Gjatë vitit 2021 ABGJ nga buxheti vetanak ka financuar /subvencionuar projektet /programet e 4 OJQ-ve në vlerë totale prej 40,000 Euro që kontribuojnë në: Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore përmes realizimit të programeve trajtuese psiko sociale të dhunuesve/abuzuesve, ofrimin e këshillimeve psikologjike përmes telefonit për të gjitha kategoritë në nevojë që kanë shqetësime emocionale dhe psikologjike sidomos nën efektin e situatës së pandemisë COVID 19.

- ✓ Strehimorja Gjilan OJQ- Liria është mbështetur me 12,000 Euro për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetje në inicimin e bizneseve /sigurimi i pajisjeve për biznes, për të mbijetuarat e dhunës të cilat ishin përkohësisht të strehuara në strehimore.
- ✓ Strehimorja e Gjakovës - OJQ "Shtëpia e Sigurt" Gjakovë është mbështetur me 8,500 Euro (janë financuar seanca këshillimi/trajtimi psiko-social të dhunuesve, dhe është financuar themelimi i linjës telefonike falas për ofrimin e këshillimit falas për gra dhe vajza për Komunën e Gjakovës).
- ✓ Këshillim për parandalim - OJQ SIT Qendra për Këshillime Sociale dhe Hulumtime në vlerë prej 14,500 Euro. Janë ofruar 25 seanca këshilluese për djem/burra -kryerësit e dhunës dhe me probleme të dhunës; po ashtu është projektuar dhe dizajnuar platforma për këshillim online " Këshillim për Parandalim" e para e llojit të tillë në Kosovë dhe rajon, e funksionalizuar në dhjetor të vitit 2021.
- ✓ Është financuar fletushka me informacione të detajuara se ku mund të kërkojnë ndihmë burrat dhe djemtë të cilët dhe manifestojnë sjellje të dhunshme apo kanë probleme zemërimi, ndryshimit të sjelljes dhe qëndrimeve të kryerësve të dhunës.
- ✓ Qendra për informim dhe përmirësim social -Linja e jetës u mbështet me 14,500 Euro.
- ✓ Gjatë periudhës 2020-prill 2024, aktivitete të rregullta e të shumta u organizuan dhe u mbështetën nga SHC, organizata ndërkombëtare si UN Women, UNDP, OSBE, Këshilli i Evropës, etj. (aktivitetet janë të listuar në Shtojcën 1).

- ✓ Për parandalimin e dhunës, MPB ka lansuar fushatën për parandalimin e gjuajtjeve festive me armë dhe keqpërdorimit të tyre gjatë ahengjeve familjare, motoja e kësaj fushate ishte “Çdo plumb ka një shënjestër, Festo me zemër, jo me armë”, janë mbajtur takime me përfaqësuesit e komunitetit, nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe prindër.
- ✓ Aktivitete vetëdijësuese për rrezikun e bartjes së armëve, veprimeve të rrezikshme në komunikacion, abuzimin e substancave psikotrope, alkoolit, duhanit janë organizuar edhe në komunën e Suharekës, Vushtrrisë, Malishevës dhe Klinës.
- ✓ MASHTI edhe gjatë vitit 2022 ka organizuar sesione informuese me nxënës të 4 komunave me qëllim të parandalimit të ngacmimeve seksuale. Aktivitete kanë organizuar edhe komuna e Prishtinës, Suharekës dhe Gjakovës.
- ✓ Përmes fuqizimit të kapaciteteve të Komisionit Qeveritar për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës dhe organizatave të përfshira në procesin e aplikimit për njohjen e statusit të Komisionit për Verifikimin e statusit të të mbijetuarve/ave nga dhuna seksuale gjatë luftës dhe aktiviteteve informuese, u synua të rritet efikasiteti i trajtimit të aplikacioneve me synim që të trajtohen 100% e aplikacioneve brenda afatit ligjor -të dhënat tregojnë se deri në fund të prillit 2024 janë trajtuar 98% e aplikacioneve të pranuar, që tregon për një shkallë të lartë të efikasitetit në punën e Komisionit.
- ✓ Gjatë periudhës 2020 deri në prill 2024 gjithsej nga Buxheti i Republikës së Kosovës janë paguar rreth 11.3 milionë Euro për pensionet e të mbijetuarve/ave nga dhuna seksuale gjatë luftës, dhe është mbështetur Komisionit për Verifikimin e Statusit dhe OJQ-të mbështetëse në këtë proces.
- ✓ Gjatë vitit 2020, ABGJ ka mbështetur me 10,185 Euro dy OJQ të cilat kanë punuar me të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, dhe të mbijetuarat e dhunës ndaj grave, duke financuar iniciativat për fuqizim ekonomik, inicim dhe zhvillim të bizneseve të vogla për të dy kategori të mbijetuarave të dhunës. OJQ Medica Kosova është mbështetur me 5,485 Euro për fuqizim ekonomik të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës dhe OJQ Mundësia për fuqizim ekonomik të mbijetuarave/gra të mbijetuara të dhunës) në vlerë prej 4,700 Euro.
- ✓ Ministria e Drejtësisë përmes Ligjit Nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ka paraparë ofrimin e ndihmës juridike falas pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale, edhe personat e dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë gjatë vitit 1998-1999.
- ✓ Ministria e Drejtësisë hartoi Protokollin shtetëror për Trajtimin e rasteve të dhunës seksuale me qëllim të standardizimit të veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe ri-integrimin e viktimave, të mbijetuarave të dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse. Protokollin përmban edhe informacion të përgjithshëm mbi trajtimin e rasteve të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës.

Objektivi specifik 3.2. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore

Ligji për Barazi Gjinore thekson se *“përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej 50% për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”*.

Në përputhje me këtë PKBGJ synoi që deri në vitin 2024, 30% e pozitave drejtuese dhe të larta drejtuese (sekretar të përgjithshëm dhe drejtor ekzekutiv) në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror të ishin të mbuluara nga gratë ndërsa në fund të vitit 2023 gratë përbënin vetëm 23.1% të këtyre pozitave.

Synimi e përfaqësimit prej 30% në pozitat drejtuese dhe të larta drejtuese në nivelin komunal (drejtor të drejtorive) u tejkalua duke arritur pjesëmarrje prej 40.8%.

Në PKBGJ po ashtu u synua përfaqësimi i barabartë prej 50% në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale-këta indikatorë nuk arritën ngase në Kuvendin Qendror gratë përbëjnë vetëm 33% të deputetëve ndërsa 37% në kuvendet komunale.

Është me rëndësi të raportohet se gjatë kohës së zbatimit të PKBGJ-së u shënuan disa rezultate të rëndësishme në përfaqësimin e grave në institucione publike. *Në vitin 2024, gratë përbëjnë 45.6% e të punësuarve në institucione publike (në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror); përbëjnë 36.4% të pozitave drejtuese të ulëta (udhëheqëse të divizioneve/sektorëve); dhe 20.4% të atyre të mesëm (drejtor të departamenteve). Pjesëmarrja e grave në bordet e ndërmarrjeve publike u rritë nga 10% sa ishte në vitin 2017 në 43% në vitin 2024.*

Për të siguruar përfaqësimin e barabartë në legjislativ në PKBGJ planifikoi harmonizimin dhe plotësimin e ligjit për zgjedhje, ligjit për financimin e partive politike dhe rregullores së Punës së Kuvendit me LBGJ-në. Megjithatë projektligji për zgjedhjet e përgjithshme nuk aplikoi parimin unitar të LBGJ-së e që ndikoi që Institucioni i Avokatit të Popullit ta dërgoi Gjykatën Kushtetuese kërkesën për vlerësim të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme, duke kontestuar dispozitën 28 të Ligjit që ka përcaktuar se *“në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku 30% janë meshkuj dhe së paku 30% janë femra, me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”*.

Në këtë fushë, një nga indikatorët e përcaktuar ishte ndërmarrja e masave afirmative të ndërmarrja për promovimin e barazisë gjinore dhe parimeve jo-diskriminuese të ndërmarrja nga institucionet, për të promovuar barazinë gjinore. Nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë për arritjen e këtij caku. ABGJ themeloi një grup punues për hartimin e një mase afirmative për mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në administratë publike, mirëpo për arsye të paqartësive dhe mos aprovimit final të Ligjit për Zyrtarët Publik, i cili dy herë përfundoi në Gjykatë Kushtetuese, u detyrua që hartimin e masës afirmative ta shtyjej për kohë të pacaktuar.

- ✓ ABGJ ka mbështetur themelimin e Rrjetit të Grave në administratë publike në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, me qëllim të fuqizimit të rolit të grave në administratë publike dhe inkurajimit për të aplikuar për pozita vendimmarrëse, shkëmbimit të përvojave dhe ndarjes së sfidave. ABGJ organizoi dy punëtori me anëtarët e Rrjetit dhe një trajnim dy ditor për Grupin e Grave deputete dhe komisionin Parlamentar për buxhet dhe financa lidhur me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor si instrument i politikave drejt arritjes së barazisë gjinore.
- ✓ Në vitin 2022, ABGJ ka realizuar një konferencë e nivelit të lartë për të shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me temën "Zhbëjmë paragjykimet, synojmë gjithë përfshirjen me qëllim të pjesëmarrjes së grave në procese vendimmarrëse në nivelin legjislativ ekzekutiv, misionë diplomatike dhe shërbimin civil. ABGJ në bashkëpunim me QKSGJ kanë mbajtur takimin tashmë tradicional, konsultativ i nivelit të lartë, me temë "Pjesëmarrja e Grave në Tregun e Punës";
- ✓ Gjatë vitit 2022, trajnime për lidhshmëri të grave për mundësinë e kandidimit për pozita vendimmarrëse në nivel lokal dhe qendror janë organizuar nga komuna e Gjilanit dhe Vushtrrisë dhe aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe vetëdijësuëse mbi barazinë gjinore për grupin e grave deputete janë organizuar nga komuna e Gjilanit, Vushtrrisë, Malishevës dhe Skenderajt.
- ✓ NDI mbështeti organizimin e Konferencës Rajonale të Grupit të Grave për Parlamentarizëm dhe Rezolutën 1325 nga Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo ngjarje e rëndësishme synonte të eksploronte rolin e parlamenteve në avancimin e agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë (WPS) në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë në zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. NDI organizoi Platformën e dialogut Java e Grave, më shumë se 120 pjesëmarrës ishin pjesë e grupit të Javës së Grave 2023 dhe për të rritur vetëdijësimin lidhur me dhunën ndaj grave në politikë NDI organizoi pesë episodet e programit "Prijmë ". Në vitin 2022, NDI ka trajnuar 120 burra dhe gra nga partitë politike, shoqëria civile, media dhe akademja për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike dhe janë trajnuar 12 udhëheqëse gra në politikë.
- ✓ Shkurt – Nëntor 2022, OSBE mbështeti 34 gra politike lokale dhe anëtarë të LWCs në mbarë Kosovën (31 shqiptarë dhe 3 serbë) që morën pjesë në të paktën një nga katër sesione. OSBE, ndau 2,350 Euro në vitin 2021, mbi 40 gra morën pjesë aktive në pesë takime dhe dy trajnime, ku dy nga tre trajnerët ishin gra. OSBE ndau 10,000 Euro nga 28 qershori deri më 2 korrik 2021 për fuqizimin dhe avancimin e grave të reja. Aktiviteti përfshiu 16 pjesëmarrës dhe të katër trajnerët ishin gra.

- ✓ UN Women ka mbështetur studimin lidhur me Dhunën ndaj Grave në Politikë.
- ✓ RrGK ka organizuar tri takime me Lobin për Barazi Gjinore i cili përbëhet nga asambleiste komunale, zyrtare për barazi gjinore, përfaqësuese të partive politike. RrGK ka realizuar 2 fushata për zgjedhjet lokale dhe qendrore, ka organizuar diskutime publike me vajza nga nëntë komuna të ndryshme me rastin e lansimit të raportit “Një ulëse në tryezë”.

Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë

Në përputhje me LBGJ dhe në funksion të zbatimit të Rezolutës 1325, PKGJ synoi rritjen e pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë dhe në drejtësi. Për vitin 2024 ishte synuar që gratë të përbënin 15% e FSK-së, 20% të Policisë së Kosovës dhe 50% të sistemit të drejtësisë. Asnjë nga këta indikatorë nuk u arritën deri në prill të vitit 2024 kur gratë përbënin vetëm 9.2% të FSK-së, 20% të PK-së dhe 34.6% të gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë:

- ✓ Në vitin 2021 është aprovuar Agjenda për Barazi Gjinore në Policinë e Kosovës dhe Plan i veprimit 2021-2023 ndërsa në vitin 2024 në mbështetje të OSBE-së organizoi punëtori për rishikimin vjetor të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shoqatës së Grave në Policinë e Kosovës (ASHKP) 2022-2024.
- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka realizuar një hulumtim duke anketuar 175 gra dhe vajza ushtarake lidhur me diskriminimin dhe mjedisin e sigurt, për burrat dhe gratë në sektorin e sigurisë dhe analizën lidhur me përfaqësimin e grave dhe vajzave në pozita vendimmarrëse në Ministrinë e Mbrojtjes.
- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka raportuar se ka rishikuar dhe avancuar kurrikulën e Forcave të Sigurisë së Kosovës nga perspektiva gjinore në përputhje me LBGJ-në dhe praktikat ndërkombëtare.

Gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ-së, rregullisht u organizuan fushata dhe takime informuese e vetëdijesuese për të inkurajuar gratë për tu bërë pjesë e FSK-së dhe PK-së. Policia e Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes kanë organizuar fushata informuese dhe inkurajuese për përfshirjen e grave në Policinë e Kosovës dhe në FSK:

- ✓ Vetëm në vitin 2022, Ministria e Mbrojtjes ka mbajtur 25 takime me qytetarë, OJQ, zyrtarë komunal në të gjitha komunat, me qëllim të inkurajimit dhe informimit të grave dhe vajzave të reja si dhe komuniteteve, për tu bërë pjesë e FSK.

- ✓ Ministria e Mbrojtjes dhe Policia e Kosovës organizuan trajnime për anëtarët e institucioneve të sigurisë lidhur me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore. Vetëm në vitin 2022 Ministria e Mbrojtjes realizoi shtatë takime me komandantët e Regjimenteve dhe Njësi të FSK, lidhur me funksionimin e rrjetit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në FSK dhe trajnim për kadetët lidhur me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore përfshi buxhetimin gjinor dhe integrimin e perspektivës gjinore e Qendrës për Studime universitare.
- ✓ Ministria e Mbrojtjes në kuadër të Programit të Qendrës për Studime Bazike (QSB) në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) ofron ligjërata për Trajnimin Bazik për Komponentin aktiv dhe rezervë, ndërsa Shkolla e Nën Oficerëve në tri programet zhvillimore për nënoficerët e FSK, realizon orë mësimore për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe parandalimin e ngacmimit seksual.
- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka finalizuar “Analizën lidhur me përfaqësimin e Grave dhe Vajzave në Pozita Vendimmarrëse” në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe ka realizuar pesë takime në kazemat e FSK –së me qëllim të identifikimit të sfidave dhe vështirësive të grave/vajzave në uniformë dhe adresimi i tyre. Në kuadër të Qendrës për Stërvitje Bazike, Ministria e Mbrojtjes ofron ligjërata në trajnimin Bazik për komponentin aktiv dhe rezervë me temën – Parandalimi i ngacmimit Seksual në Ushtri.
- ✓ Policia e Kosovës ka mbajtur në vazhdimësi trajnime me zyrtarë policor lidhur me dhunën në familje, perspektivës gjinore, për të drejtat e grave etj. Në vitin 2020 janë mbajtur 21 punëtori, trajnime dhe kanë marrë pjesë 254 zyrtarë policor kryesisht të gjinisë femërore. Ndërsa në vitin 2021 janë mbajtur trajnime e punëtori ku kanë marrë pjesë: 4,816 zyrtarë policor të të dy gjinive.
- ✓ Në vitin 2020 u organizuar takimi vjetor i Bordit të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police (IAWP) dhe Konferencën Ndërkombëtare, ‘Roli i zyrtareve policore në reagim ndaj kërcënimeve transnacionale’.
- ✓ UN Women në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka lansuar Doracakun mbi shërbimet policore me ndjeshmëri gjinore për rastet kur vajzat dhe gratë i nënshtrohen dhunës;
- ✓ UN Women në vitin 2021 ka organizuar trajnim për 40 oficerë të Policisë së Kosovës për Reagimet Efektive të Policisë ndaj dhunës me bazë gjinore ndërsa në vitin 2021 ka mbështetur studimin 2021 “Perceptimet publike për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj Grave në Kosovë.
- ✓ Në periudhën shkurt-mars 2022, OSBE ka financuar 12,300 Euro për trajnimin e 39 zyrtarëve të Policisë së Kosovës nga tetë rajone mbi vlerësimin e rreziqeve dhe hartimin e planeve të sigurisë për rastet e dhunës në familje, me qasje të ndjeshme gjinore. Trajnimi përfshiu 24 gra, 15 burra dhe katër pjesëmarrës nga komunitetet joshumicë.

- ✓ Në tetor 2022, OSBE ka mbështetur Policinë e Kosovës me 2,600 Euro për organizimin e pesë punëtorive për zyrtarët e rinj. Trajnimet adresuan legjislacionin mbi dhunën ndaj grave/dhunën në familje, mekanizmat ndër-institucionalë dhe procedurat standarde të policisë, me fokus te urdhrat mbrojtës, vlerësimet e rrezikut dhe shmangia e ri-viktimizimit. Morën pjesë 144 zyrtarë, përfshirë 40 gra, 104 burra dhe 21 përfaqësues nga komunitetet joshumicë.
- ✓ OSBE ndau 6,600 Euro në vitin 2022 për një analizë gjinore me 5 kryetare komisionesh të Kuvendit të Kosovës, duke identifikuar sfida dhe perspektiva për lidhshirësi të grave.
- ✓ Zyra e BE-së mbështeti Solidar Suisse (2023-2025) me 193,982 Euro për të rritur ndërgjegjësimin se dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe për të inkurajuar qytetarët ta sfidojnë atë. Projekti promovon masa efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave në nivel qendror dhe lokal.
- ✓ OSBE, me buxhet prej 1,889 Eurosh, organizoi më 23 dhe 25 nëntor 2021 dy trajnime për Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës (AWKP) për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë praktike në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Trajnimet synuan të forcojnë rolin e grave në PK për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të trafikimit. Në aktivitet morën pjesë 50 persona (45 gra dhe 5 burra), të cilët fituan aftësi praktike për identifikimin e viktimave, një hap i rëndësishëm në luftimin e këtij krimi.
- ✓ OSBE, gjatë vitit 2022, mbështeti zhvillimin e aftësive lidhshirësi dhe inteligjencës emocionale të oficerët e policisë, për të përmirësuar ndikimin e tyre në kulturën organizative me praktika bashkëkohore. Trajnimi përfshiu 11 pjesëmarrës, prej tyre 8 gra, 3 burra dhe 2 nga komunitetet joshumicë.
- ✓ OSBE, me buxhet prej 7,862 Eurosh në nëntor 2022, organizoi një aktivitet me mbi 100 zyrtarë të sigurisë publike, studiues dhe akademikë për të diskutuar ndikimin e pandemisë COVID-19 mbi integritetin e policisë, masat ligjzbatuese dhe rritjen e dhunës në familje ndaj grave dhe vajzave. U theksua roli i grave në polici dhe sfidat në mbrojtjen e viktimave. Pjesëmarrësit përfshinin 35 gra, 65 burra dhe 15 nga komunitetet joshumicë.
- ✓ Janë publikuar disa raporte për situatën e grave të burgosura në shërbimin korrektues: raportet vjetore nga QKRMT 2020 dhe 2021; raporti i Këshillit të Sigurisë 2020/21; raporti i CPT për vitin 2020; raporti për të drejtat e njeriut për Kosovë për vitin 2020 dhe 2021 nga SHBA; dhe raporti nga Bashkimi Evropian/Programi për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST). Gratë e burgosura kanë ndjekur trajnime në menaxhimin e zemërimit, shkathtësi për vendin e punës, trajnim për mënyrën e të menduarit dhe reagimin në situata të vështira, etj.

Objektivi specifik 3.3. Ngritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit, përfaqësive diplomatike dhe misioneve jashtë vendit

PKBGJ synoi ngritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit, përfaqësive diplomatike dhe misioneve jashtë vendit. Në kuadër të këtij objektivi specifik u synua rritja e përfaqësimit të grave në misionet diplomatike në përputhje me kërkesat e LBGJ-së për përfaqësimin të barabartë prej 50% të të dy gjinive. Të dhënat nga Ministria e Punëve të Jashtme tregojnë se ky synim nuk është arritur ende ngase gratë përbëjnë 35% të personelit në misionet diplomatike. Të dhëna për atashe ushtarak dhe policor nuk janë ofruar. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme databaza me shënimeve për gratë të cilat janë pjesëmarrëse në aktivitete emergjente dhe humanitare jashtë vendit ekziston, aktivitet që ishte planifikuar në PKBGJ.

- ✓ Në fushën e paqes dhe pajtimit u organizua numër i kufizuar i aktiviteteve. Organizata "Gratë për Gratë" 30 gra nga Mitrovica nga komuniteti shqiptar, serb, romë, ashkali dhe egjiptian kanë marrë pjesë në debate publike lidhur me përfaqësimin e grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit dhe në vitin 2022.
- ✓ Komuna e Mitrovicës organizoi një debat publik për përfaqësimin e grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit.
- ✓ Në vitin 2021, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës mbështetur nga UN Women ka përfunduar ciklin e trajnimeve për rolin e mediave në ndërtimin e paqes.
- ✓ OSBE, me buxhet prej 4,000 Eurosh, organizoi një aktivitet më 23-25 mars 2022 për të forcuar leadershipin dhe pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë, në kuadër të zbatimit të Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria në Kosovë. Aktiviteti përfshiu 14 pjesëmarrës, ndër ta 10 gra dhe 4 burra.

Gjatë intervistave u theksua se PKBGJ duhet adresuar edhe çështja e reparacionit për të mbijetuarat e dhunës seksuale në mënyrë që proceset e dialogut përfshirë edhe dialogun e tanishëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të diskutohet edhe çështja e krimeve të luftës dhe dhunës seksuale të ushtruara ndaj grave në periudhën e luftës në Kosovë 1998-1999.

Tabela 6: Statusi i arritjes së cageve të synuara në Objektivin strategjik 3

Indikatori	Synimi 2024	Realizimi 2023	Caku i arritur Po/Jo
1. Shkalla e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në institucione publike (në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror) ³²	40%	45.6% (2024)	PO
Përqindja e rasteve të dhunës në familje, që trajtohen nga gjyqësori	100%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Objektivi Specifik 3.1 Fuqizimi i mekanizmave institucional dhe ngritja e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi			
Numri i masave afirmative të ndërmarra për promovimin e barazisë gjinore dhe parimeve jo-diskriminuese të ndërmarra nga institucionet, për të promovuar barazinë gjinore	1 shtesë	Ministria e Ekonomisë MASHTI	PO
Politika Ndëshkimore për zbatimin adekuat të sanksioneve për kryesit e dhunës në baza gjinore, përfshi edhe dënimet adekuate për rastet e trafikimit me qeniet njerëzore është e aprovuar	Kompletuar	Paqartë	n/a
Përqindja e aplikacioneve dhe numri i aplikacioneve të shqyrtuara nga Komisioni për Verifikim	100%	98% ³³	PO
% ja e vajzave dhe grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike	Nuk ishte caktuar në mungesë të të dhënave	25.6% që kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike ose seksuale (2021-2022) ³⁴	n/a nuk ka pasur vlerë bazë
Objektivi Specifik 3.2 Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore			
Shkalla e përfaqësimit të grave në pozita drejtuese dhe të larta drejtuese (sekretar të përgjithshëm dhe drejtor ekzekutiv) në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror (%)	30%	23.1% (dhjetor 2023)	JO
Përqindja e pozitave drejtuese dhe të larta drejtuese në nivelin komunal (drejtor të drejtorive), të mbuluara nga gratë	30%	40.8% (2024)	PO
Përqindja e deputeteve gra në Kuvendin e Kosovës	50%	33%	JO
Përqindja e deputeteve gra në kuvendet komunale	50%	37% (2022)	JO
Objektivi Specifik 3.3 Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë			
Përqindja e grave në FSK	15%	9.2%	JO
Përqindja e grave në Policinë e Kosovës	20%	14.8%	JO
Përqindja e grave gjyqtare në sistemin e drejtësisë	50%	34.6%	JO
Objektivi Specifik 3.3 Ngritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit, përfaqësive diplomatike dhe misioneve jashtë vendit			
Shkalla e përfaqësimit të grave në misionet diplomatike jashtë vendit në përputhje me kërkesat e LBGJ-se duke përfshirë përfaqësimin e barabartë gjatë emërimit të atashëve ushtarak dhe policore	50%	36% (misione diplomatike)	JO

³² Numri i grave në të gjitha pozitat në institucionet publike të cilat paguhen përmes Thesarit është 38,065 apo rreth 45.6% të të punësuarve, nga 83,605 të punësuar në institucione publike.

³³ Në periudhën 5.02.2018 e deri më 30.04.2024 Komisioni ka pranuar gjithsej 2,074 aplikacione për njohje të statusit viktimë e dhunës seksuale të luftës, nga të cilat janë trajtuar 2,033 aplikacione. Duke pasur parasysh se disa aplikacione mund të jenë pranuar afër datës së raportimit është vlerësuar se caku është arritur.

³⁴ <https://askapi.rks-gov.net/Custom/e66b9d42-24e0-487a-8da8-25f28d3d6cb7.pdf>

Në kuadër të Objektivit Strategjik 3 nuk është punuar në këto aktivitete

Për rritjen e qasjes në drejtësi nuk u realizua këto aktivitete:

- ✓ Analiza e situatës nga aspekti gjinor i pozitës së grave të dënuara për dhunën në familje përfshi politikat ndëshkimore;
- ✓ Konferenca e planifikuar Ndërkombëtare për Procesin e Verifikimit të Statusit të të mbijetuarave nga dhuna seksuale gjatë luftës. Megjithatë siç u raportua më lartë Presidenca e Kosovës në edicionit të dytë të Forumit të mbajtur në prill të vitit 2024 u fokusua edhe në parandalimin e dhunës seksuale në luftë.
- ✓ Zhvillimi i programe specifike për qasjen në drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës.
- ✓ Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme është ende për vlerësim në në Gjykatën Kushtetuese;
- ✓ Mos harmonizimi i Rregullores së e Punës së Kuvendit (aprovuar në vitin 2022) me kërkesat e LBGJ-së;
- ✓ Zhvillimi i masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore në pozitë vendimmarrëse. ABGJ e inicioi procesin për hartimin e kësaj mase afirmative, por për arsye të mos aprovimit në tërësi të Ligjit për Zyrtarët Publik procesi është pezulluar deri në aprovimin e ligjit;
- ✓ Organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për rritjen e numrit të grave në procesin e menaxhimit dhe monitorimit të procesit zgjedhor në përputhje me LBGJ-në;
- ✓ Hulumtimi lidhur me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave brenda partive politike përmes strukturave dhe mekanizmave të partive politike dhe sondazheve të opinionit publik.

Në fushën e sigurisë nuk u realizuan këto aktivitete:

- ✓ Zhvillimi i masave afirmative me qëllim të rritjes së numrit të grave në sektorin e sigurisë; në Policinë e Kosovës;
- ✓ Realizimi i analizave lidhur me pozitën e grave në Polici;
- ✓ Krijimi i Bordit Këshillues Gratë, Paqja dhe Siguria brenda institucioneve të sigurisë;

- ✓ Realizimi i studimit lidhur me ndikimin e armëve të vogla në sigurinë e burrave dhe grave nga perspektiva gjinore.
- ✓ Në fushën e pjesëmarrjes së grave në procesin e negocimit, paqes dhe pajtimit nuk kishte lobim dhe avokim që do të ndikonte në integrimin e çështjeve gjinore në procesin e dialogut, paqes dhe pajtimit.

3.3. Vlerësimi i efijencës

Ky seksion fokusohet në vlerësimin se sa burimet e financimit, personelit, ato rregullative, administrative, kohore dhe të tjera i kanë kontribuar ose kanë penguar arritjen e rezultateve të PKBGJ-së.

Vlerësimi i strukturave koordinuese dhe sistemeve të monitorimit

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, përveç ABGJ-së dhe institucioneve të tjera në nivel qendror dhe komunal ka pasur shumë akterë që janë angazhuar dhe kanë punuar në fusha të ndryshme për të avancuar barazinë gjinore, përs hirë këtu OSHC-të dhe donatorët. Bazuar në të dhënat e siguruar gjatë dy vlerësimeve të para për periudhën 2020-2022 dhe të dhënave të grumbulluara për vlerësimin final është gjetur dhe theksuar se PKBGJ-ja ka shërbyer në hartimin e programeve dhe dizajnimin e aktiviteteve të institucioneve publike, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. PKBGJ si dokument shumë gjithëpërfshirës ka ofruar mundësi për institucionet dhe akterët e tjerë të dizajnojnë intervenime, programe e projekte për të kontribuar në të tri shtyllat e PKBGJ-së.

Sa i përket donatorëve u theksua se një pjesë e konsiderueshme e donatorëve përjashton/nuk përfshin ABGJ-në në fazat e planifikimit dhe zbatimit të programeve dhe projekteve të tyre. U theksua se donatorët vonë filluan ndërlidhjen e punës së tyre me PKBGJ-në, e kjo lidhje ndodhi kryesisht me ftesë e insistim nga ana e ABGJ-së.

Megjithatë procesi i monitorimit dhe vlerësimit vjetor të PKBGJ-së ka shërbyer si një burim i rëndësishëm për të përcjellur angazhimin e të gjithë akterëve por edhe për ti informuar akterët për angazhimin e të gjithëve në zbatim të aktiviteteve të PKBGJ-së dhe për të përcjellë progresin e shënuar në fushat e përfshira në PKBGJ.

Bazuar në takimet me ZBGJ-të në nivelin qendror dhe komunal instrumenti i monitorimit dhe vlerësimit të PKBGJ-së ishte i qartë dhe i thjeshtë për tu plotësuar. Kjo ishte edhe si rezultat i takimeve të rregullta të organizuara nga ABGJ duke ofruar sqarime metodologjike dhe adresuar në kohë paqartësitë lidhur me raportimin në formatin e dizajnuar për monitorim dhe vlerësim. Megjithatë një nga të intervistuarat për këtë vlerësim theksoi se ka pasur situata kur kishin vështirësi për të ndërlidhur aktivitetet e tyre me ato të parashikuara në PKBGJ-së. Kjo lidhet edhe me vlerësimin e raportuar më lartë për fushat që nuk ishin mjaftueshëm të trajtuara në kuadër të PKBGJ-së.

Është rekomanduar se do ishte e dobishme të formohej një grup koordinues për të koordinuar zbatimin e PKBGJ-së dhe adaptimin e Planit të Veprimit në hap me ndryshimet që ndodhin vit pas vit.

3.4. Ndikimi i PKBGJ-së

Edhe pse të gjithë indikatorët e synuar nuk janë arritur të gjithë dhe të gjitha aktivitetet e planifikuara nuk u zbatuan, gjithmonë bazuar në të dhënat e pranuar nga institucionet publike, SHC dhe organizatat ndërkombëtare, mund të thuhet se PKBGJ-ja ka pasur një ndikim të përgjithshëm në promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Po ashtu, duhet pasur parasysh ndikimin që pandemia COVID-19 ka pasur në punën e institucioneve dhe efektet negative që ka shkaktuar në jetën e grave dhe burrave në Kosovë. Fushat kryesore të ndikimit të vërejtur gjatë këtij vlerësimi sipas objektivave strategjike janë të listuara në vijim.

Objektivi strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar në dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale u shënuan këto arritje

- ✓ dallimi gjinor në punësim u zvogëlua dhe gratë morën pjesë në trajnime profesionale të ofruara nga institucionet publike por edhe jo publike;
- ✓ u rrit qasja e grave në pronë të pasurisë së paluajshme dhe si pronare të bizneseve;
- ✓ qasja në fonde publike u rrit si rezultat i masave afirmative të ndërmarra nga qeveria;
- ✓ u punua në avancimin e kornizës ligjore për integrimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;
- ✓ u dizajnuan masa afirmative për rritjen e qasjes së vajzave dhe grave në fonde publike;
- ✓ perspektiva gjinore u integrua në pothuajse të gjitha masat e dizajnuara në kuadër të masave mbështetëse gjatë pandemisë COVID-19;
- ✓ u avancua vetëdija dhe vullneti për analizën e nevojave dhe sfiave sipas gjinisë që shërbyen në dizajnim të masave afirmative për të mbështetur vajzat dhe gratë në Kosovë.

Objektivi strategjik 2: Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore u shënuan këto arritje

- ✓ dallimet gjinore në shumicën e treguesve të arsimit janë përmirësuar duke përfshi edhe ndarjen gjinore në profesione;
- ✓ avancoi adresimi/eliminimi i stereotipave gjinore në tekstet mësimore dhe u integrua perspektiva gjinore në arsimin e lartë dhe u rrit pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në shkolla;
- ✓ u rrit pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme dhe u avancua korniza ligjore mbështetëse për rritjen e mëtejme të pjesëmarrjes në edukimin në fëmijërinë e hershme;
- ✓ u rrit pjesëmarrja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim duke përfshi edhe atë të lartë;
- ✓ është rritur mbështetja nga MKRS për vajzat dhe gratë në sport ;
- ✓ u rrit qasja në shërbime shëndetësore për gratë shtatzëna dhe foshnjat;
- ✓ filloi aplikimi i vaksinës kundër virusit HPV për herë të parë në Kosovë;
- ✓ është zvogëluar numri i lindjeve tek vajat e moshës 10-14 dhe 15-19 vjeçare.

Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore u shënuan këto arritje

- ✓ përmirësime në pjesëmarrjen e grave në institucionet publike dhe në pozita vendimmarrëse;
- ✓ është rritur efikasiteti në vlerësimin e aplikacioneve për verifikimin e statusit të të mbijetuarve/ave nga dhuna seksuale gjatë luftës;
- ✓ korniza ligjore kombëtare për dhunën në familje dhe dhunën në bazë gjinore u hartua dhe aprovua në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me praktikën më të mira dhe në përputhje me obligimet që burojnë nga Konventa e Stambollit tani më e integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- ✓ është investuar në vazhdimësi në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve në ofrimin e shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore.

Siç është prezantuar në fillim të këtij raporti, për këtë vlerësim nuk janë ofruar të dhënat mbi numrin e grave përfituese nga secili aktiviteti realizuara të parapara sipas PKBGJ-së. Prandaj, numri i përgjithshëm dhe grupet e grave si përfituese të drejtpërdrejta nga intervenimet e PKBGJ-së mbetet një gjë e panjohur. Prandaj mbetet rekomandim i qëndrueshëm përmirësimi i cilësisë së mbledhjes së të dhënave të rregullt statistikore të ndara sipas seksit, dhe bërja publike e të dhënave.

3.5. Vlerësimi i qëndrueshmërisë

Për të vlerësuar nëse ndikimi i arritur gjatë PKBGJ-së është i qëndrueshëm, në këtë seksion vlerësohet qëndrueshmëria institucionale dhe ajo financiare. Përveç kësaj, gjithashtu rishikohen politikat dhe udhëzimet ekzistuese, përdorimi i statistikave dhe treguesve, konsultimet aktive të akterëve, etj. të cilat kontribuojnë që problemet sa i përket barazisë gjinore bëhen më të dukshme në politikat publike të Kosovës dhe bazat e të dhënave, si dhe analizon dhe shqyrton se a janë ndërmarrë masa pozitive/veprime afirmative gjatë periudhës 2020-2024 të PKBGJ-së, dhe çfarë lloji ndikimi kanë pasur mbi statusin e vajzave dhe grave.

3.5.1. Qëndrueshmëria institucionale

Fuqizimi i Agjencisë për Barazi Gjinore

ABGJ në vitet e fundit ka shënuar një rritje të aktivitetit por edhe është forcuar si një institucion me kredibilitet të lartë si udhëheqëse në hartimin e politikave dhe ofrimin e mbështetjes në avancim të barazisë gjinore. Një rol kyç në këtë rrugëtim të ABGJ ka pasur mbështetja e ofruar nga projekti “*Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinore në Kosovë*” financiar nga Qeveria Suedeze, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sida dhe zbatuar nga konsorcium: Niras & CPM International. Kjo mbështetje “shkundi ABGJ-në” duke dal në realitet dhe ballafaquar me jashtë dhe me të gjithë akterët aktiv në fushën e barazisë gjinore.

Megjithatë, mbështetja financiare ishte e kufizuar për nevojat e ABGJ-së dhe të Kosovës. Suksesi të kësaj ndihme i kontribui liderhipi i mirë që progresoi dhe ishte stabil-8 vite stabilitet në ekzekutiv dhe në nivelin e mesëm. *Gjatë kësaj periudhe ABGJ rriti komunikimin me publikun dhe ishte proaktive.* Përmes këtij projekti ABGJ hartoi një sërë instrumentesh, vlerësoi PKBGJ-në e parë 2008-2012, krijoi sistem dhe metodologji për analiza dhe hartoi PKBGJ-në e vitit 2020-2024.

Siç u raportua më lartë, gjatë kohës së pandemisë ABGJ vazhdoi angazhimin e saj dhe menaxhoi me sukses një fond prej 2 milionë Eurosh, fondi më i madhë që kishte pranuar nga Buxheti i RKS-së në kuadër të Fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike 2020, si dhe Pakos për Ringjallje Ekonomike të qershorit 2021.

Për këtë vlerësim intervista u realizuan me dy organizata të shoqërisë civile dhe një kopsht i fëmijëve që përfituan nga ky fond. Nga këto intervista u kuptua se masa mbështetëse ishte jashtëzakonisht e qëlluar dhe e rëndësishme jetike për organizata të përfituesve por edhe për përfituesit që organizata i mbështetën nga këto fonde. Për Kopshtin e fëmijëve mbështetja ishte shumë domethënëse ngase parandaloi mbylljen e së paku tri kopshteve për të cilat po bëhej e pamundur të mbulohehin shpenzimet rrjedhëse duke përfshi edhe pagat. Gjatë kohës së pandemisë puna e OJQ u vështirësua ngase fondet kryesisht u orientuan tek fusha e shëndetësisë dhe reagimit emergjent. Mbështetja nga ABGJ për OJQ-në ishte jetike për të vazhduar punën me gratë dhe për të ofruar mbështetjen sipas nevojave të tyre specifike në kohën e pandemisë. Gjatë intervistave u theksua bashkëpunimi i mirë me ABGJ-në por koha e shkurtër e zbatimit të projektit u përmend të ishte sfiduese për zbatim. U rekomandua se ABGJ do duhej të kishte një fond të madhësisë së ngjashme sikur gjatë pandemisë. Një fond i qëndrueshëm dhe i rregullt do të bënte thirrje të rregullat dhe të parashikuara për organizata e shoqërisë civile, ndërmarrjeve e përfituesve të tjerë potencial.

Në vitin 2024 me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Neni 5 dhe Neni 8, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 04/197 (të datës 29 mars 2024) për zbatimin e Masës 1.7 – Skema e Granteve për Zanate të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nëpërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) në mbështetje me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, shpalli thirrjen për aplikim për ndarjen e subvencioneve për individë fizikë me qëllim të fuqizimit dhe pavarësisht ekonomik të grave dhe vajzave. Shuma e përgjithshme e subvencionit ishte 500,000 Euro dhe shënon herën e parë për mbështetjen e fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave që gëzojnë pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë, apo një anëtare (grua/vajzë) nga familja e ngushtë (sipas Ligjit për familjen) e personave që gëzojnë pension për personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Deri në fund të hartimit të raportit nga kjo thirrje ishin 64 gra përfituese, dhe shuma e shpenzuar ishte në total prej 249,460.00 euro në realizimin e blerjes së pajisjeve për punë sipas specifikave në thirrje-kryesisht pajisje bujqësore.

Ngritja e kapaciteteve të ZBGJ-ve

Gjatë periudhës raportuese u organizuan në vazhdimësi aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të ZBGJ, zyrtarëve publik dhe të institucioneve dhe mekanizmave që ofrojnë shërbime. ABGJ se bashku me UN WOMEN ka mbajtur punëtorinë “ Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor si një mjet për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal”, kjo punëtori është organizuar për nevojat e pushtetit lokal dhe obligimeve në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.

Aktualisht është duke u hartuar Udhëzimi Administrativ për themelimin dhe funksionimin e grupeve komunale koordinuese për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe në bazë gjinore ndërsa në mbështetje të OSBE-së është hartuar Udhëzuesi për punë efektive të Mekanizmave Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje (MKKDDHF)³⁵. Nga praktika është gjetur se mekanizmat lokal koordinues kanë ndikuar në parandalim dhe mbrojtje më efikase të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore.

Qasja në të dhëna dhe evidencë

- ✓ Agjencia e Statistikave të Kosovës vazhdoi publikimin e raportit “*Gratë dhe Burrat në Kosovë*”, i fundit për vitin 2021-22. Raporti prezanton të dhënat nga anketat e realizuara nga ASK dhe të dhënat administrative na institucionet publike.
- ✓ Vlerësimi i rregullt i PKBGJ-së është një dokument i vlefshëm edhe si burim i të dhënave për fushat e përfshira në PKBGJ, kjo u theksua edhe gjatë intervistave të realizuara për këtë vlerësim.
- ✓ ABGJ së bashku me ASK-në kanë filluar përpjekjet për kalkulimin e indeksit të barazi gjinore sipas metodologjisë së Institutit Evropian për Barazi Gjinore. Megjithatë deri më tani në mungesë të të dhënave është kalkuluar vetëm indeksi për domenin e parasë, arsimit dhe vendimmarrjes.
- ✓ Gjatë grumbullimit të të dhënave për vlerësimet e rregullta të PKBGJ-së dhe për këtë vlerësim final vihet re se mungon një sistem i thjeshtë dhe lehtë i qasshëm për të siguruar të dhëna nga të gjitha institucionet. Raportimi i rregullt i të dhënave nga institucionet përmes raporteve publike ose edhe krijimi i një sistemi për prezantim të të dhënave metadata siç ofrohet nga ASK do të ishte shumë përfituese për shfrytëzuesit por edhe për shfrytëzimin efficient të resurseve në institucione-të cilat përballen me kërkesa të shpeshta nga shfrytëzuesit.
- ✓ Në vitin 2024 në mbështetje të ABGJ-së dhe UN Women, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” për herë të parë hartoi Planin e Veprimit për Barazi Gjinore. Ky raport ofroi të dhënat të detajuara për stafin, studentët dhe programet e studimit të ofruara në Universitet. Një praktikë e tillë do të duhet të aplikohet nga të gjitha institucionet, në baza të rregullta vjetore.
- ✓ ABGJ ka përkthyer në gjuhën shqipe “Fjalorin dhe leksikonin e koncepteve të terminologjisë së ndjeshme gjinore “në bashkëpunim me Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Fjalori përmban më shumë se 400 terme dhe definicione gjinore tashmë janë të disponueshme në gjuhën shqipe. Fjalori është instrument i specializuar i terminologjisë gjinore cili ndihmon për integrim të perspektives gjinore në komunikim dhe prezantim³⁶. Fjalor do t'u shërbejë të gjithë përdoruesve shqipfolës në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni Veriore, Mal të Zi dhe Serbi. Gjithashtu, ai do t'i shërbejë diasporës shqipfolëse në vende të ndryshme të botës . Fjalori sjellë qartësi për konceptet gjinore në përdorim në administratën publike, akademi, media dhe jetën e përditshme. ABGJ ndërmori këtë nismë dhe siguroi leadershipin për gjithë trevat shqipfolëse.

³⁶ <https://eige.Eurpa.eu/>

- ✓ Gjatë periudhës 2020-2024, për herë të parë, Kosova raportoi para Komisionit të Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence/GREVIO). Edhe pse Kosova nuk ishte pjesë e Këshillit të Evropës, Komisioni GREVIO-për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit hartoj raportin e parë për nivelin e zbatimit të Konventës në Kosovë. Raporti është hartuar në bashkëpunim me institucionet e RKS-së, dhe organizatat e shoqërisë civile.
- ✓ Në vitin 2021 në mbështetje të GIZ, Kosova ka realizuar studimin e parë për Perspektivën Gjimore në Menaxhimin e Financave Publike si analizë shtesë e PEFA-s (Public Expenditure and Financial Accountability). Ky ishte një zhvillim i rëndësishëm duke pasur parasysh se Kosova është në mesin e vetëm 29 shteteve që ka ndërmarrë këtë angazhim. Studimi ofron një bazë të mirë fillestare, e cila do të shërbej për të matur progresin e Kosovës në zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- ✓ Agjencia e Statistikave të Kosovës realizoi hulumtimin e parë lidhur me praninë e dhunës në familje të titulluar “Dhuna në Bazë Gjimore 2022/23”.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, ABGJ-ja realizoi disa studime kërkimore të listuara ato kryesore:

- ✓ Në vitin 2020 u realizua hulumtimi “Hendeku Gjinor në Paga Parimi i pagës së barabartë për punë me vlerë të barabartë” është thelbësore për avancimin e barazisë gjinore. Kompensimi më i ulët në karakteristikat e njëjta të tregut të punës për gratë sesa për burrat dëshmohet të jetë rezultat i diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë .Hulumtimi është publikuar³⁷. Hulumtimi u realizuar në bashkëfinancim me UN Women;
- ✓ Në vitin 2021, ABGJ realizoi hulumtimin “Mbulueshmëria e reagimit të qeverisë ndaj krizës COVID-19: Kush u la pas dore?”³⁸ Fokusi i kësaj analize ishte të vlerësonte secilin grup të synuar të mbuluar nga çdo masë ekonomike të paketës së rimëkëmbjes ekonomike anti-COVID-19, dhe potencialin e masave për të mbështetur gratë si përfituese të drejtpërdrejta. Kategoritë që mbetën pas, identifikohen si më poshtë: gratë pjesëmarrëse në tregun joformal të punës, gra fermere të punësuar në mënyrë joformale, prindërit - nënat e vetme/vetushqyese. Hulumtimi u mbështet nga Fridrich Ehbort Stiftung;

³⁷[https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20HENDEKU%20GJINOR%20N%C3%8B%20PAGA%20RKS%20%20_compress ed%20\(1\).pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20HENDEKU%20GJINOR%20N%C3%8B%20PAGA%20RKS%20%20_compress ed%20(1).pdf)

³⁸ <https://abgj.rks-gov.net/>

- ✓ ABGJ mbështeti hulumtimin, *“Ndihma Zyrtare për Zhvillim për barazi gjinore –gjendja e përafrimit me prioritetet e Qeverisë së Kosovës 2015-2018”*³⁹;
- ✓ ABGJ realizoi studimin *“Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2016-2019”*⁴⁰;
- ✓ Mbështetur nga ABGj, Qendra Kosovare për Studime Gjinore realizoi studimin *“Gratë dhe vajzat në fushën e sportit: hulumtimi mbi stereotipat gjinore dhe barrierave që pengojnë qasje të barabarte në sport”* dhe
- ✓ Mbështetur nga ABGj Instituti Riinvest realizoi analizën *“Roli i grave në pozitat vendimmarrëse në sektorin publik dhe privat në Kosovë”*.
- ✓ Në vitin 2023 në mbështetje të UN WOMEN, Auditori Kombëtar i Kosovës për herë të parë realizoi auditimin e performancës me perspektivë gjinore, specifikisht realizoi auditimin: *“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës dhe Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”*. Edhe pse realizimi i këtyre auditimeve shënon një progres ngase janë të parat të realizuara, nga një vështrim i auditimeve të fundit të performancës të publikuara në faqen e Auditorit Gjeneral vihet re se perspektiva gjinore nuk është aplikuar në auditimet e tjera të performancës: për shembull në atë lidhur me *Modernizimin e i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit, Efektiviteti dhe efikasiteti i kontraktimit të shërbimeve shëndetësore dhe sociale nga Institucionet e Republikës së Kosovës, Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit*. Barazia gjinore duhet të bëhet pjesë integrale e të gjitha auditimeve e që kërkon edhe ngritje të kapaciteteve për analiza në fusha të ndryshme.
- ✓ Gjithashtu, gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, studime kanë kryer edhe nga RrGK-ja, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, UN WOMEN, Riinvest, D4D, Instituti GAP dhe organizata të tjera aktive. Këto studime mund të gjenden në uebfaqet e këtyre institucioneve, por do të ishte e dobishme që të gjitha këto të publikohen në një faqe të veçantë.

³⁹ https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/SHQIP_ODA_GJINIA_2015_2018_PerafrimiVleresim.pdf

⁴⁰ <https://abgj.rks.gov.net/assets/cms/uploads/files/Prezantimi%20i%20grave%20n%C3%AB%20mediat%20e%20shkrura%202016%20-%202019%20-%20Shqip.pdf>

3.5.2. Qëndrueshmëria financiare

Nga të dhënat e grumbulluara dhe intervistat e realizuara është theksuar se në Kosovë si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal është krijuar një praktikë e mirë e integritit të perspektivës gjinore në dokumentet strategjike si në analizën e situatës ashtu edhe tek objektivat dhe aktivitetet. Megjithatë, siç u raportua në këtë raport ka hapësirë për përmirësimin e cilësisë së integritit të perspektivës për tu siguruar se gjinia është pjesë integrale e të gjitha strategjive.

Një zhvillim me rëndësi për tu përmendur është se Qeveria e Kosovës integroi perspektivën gjinore në masat mbështetëse gjatë pandemisë COVID-19. Kjo e ka vendosur Kosovën ndër vendet të cilat me sukses kanë arritur të përgjigjen situatës së COVID-19 me perspektivë gjinore me masa të ndjeshme në aspektin e gjinisë dhe mjeteve buxhetore të dedikuara për këtë qëllim. Kjo është një ndër praktikatat e suksesshme të BPGJ.

- ✓ Gjatë kohës së pandemisë, është krijuar Strehimorja në karantinë e cila ka ofruar ambient të sigurt për rastet e reja, të nivelit të sigurisë së lartë, dhe ka përmbushur nevojat e përkujdesjes duke përfshirë (strehimin e sigurt, shërbime shëndetësore të sigurta, shërbime psikologjike, ushqim dhe higjienë). Ky përkushtim për integrim të perspektivës gjinore vazhdoi edhe pas tejkalimit të krizës pandemike.
- ✓ Ka një avancim të ndërmarrjes së masave afirmative me fokus tek vajzat dhe gratë dallon e ajo e MASHTI ofron bursa për vajzat në STEM.
- ✓ MFPT mbështet në vazhdimësi strehimoret për rastet e dhunës në familje, MBPZHR zbaton masa afirmative gjatë ndarjes së granteve për bujqësi dhe zhvillim rural.
- ✓ Ministria e Ekonomisë ka zbatuar masa afirmative në masat për efikasitet të energjisë jo vetëm për gratë por mbështetje edhe më të veçantë për nënat vetushqyese.
- ✓ Fondi për Garantimin e Kredive ka hapur dritare të veçantë për bizneset në pronësi të grave.
- ✓ Që nga viti 2015 organizatat buxhetore në Kosovë janë të obliguara të raportojnë për segmente të caktuara të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor duke bërë të qartë ndikimin e shpenzimeve publike në jetën e grave dhe të burrave në Kosovë.
- ✓ Një analizë e mbështetur nga UN Women e realizuar në vitin 2022 për projekt buxhetin e vitit 2023 tregoi se asnjë nga organizatat buxhetore nuk kishin ofruar analizë përmbajtësore lidhur me ndikimin e pritur të buxhetit të kërkuar në jetën e grave dhe burrave në Kosovë.

Analizat e rregullta të mbështetura nga NDI lidhur me projekt buxhetin e Republikës së Kosovës kanë treguar se perspektiva gjinore ende nuk është e integruar gjatë planifikimit buxhetor. Natyrisht duhet theksuar se ka zëra për të cilët buxheti ndahet rregullisht duke përfshi buxhetin për strehimore, pensionet për të mbijetuarit/at nga dhuna seksuale nga dhuna, kompensimin për viktimat e krimit, bursat për vajzat që studiojnë në fushat STEM, mbështetje për bujqësi me pikë shtesë për aplikantët gra, bursa nga komunat, subvencionim për erdhe të fëmijëve të nënave vetushqyese dhe masa të tjera të raportuara në këtë dokument.

Siç u raportua më lartë udhëhequr nga ABGJ grupi punues është duke punuar në hartimin e aktit nënligjor për buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Përmes këtij akti synohet që të saktësohet korniza ligjore në frymën e LBGJ, përmes amendamentimit të kornizës ligjore të specifikuara në koncept dokumentin për BPGJ të aprovuar nga QRK. Kjo do të reflektohet me pastaj në vendosjen e instrumenteve planifikues, zbatues dhe monitorues të BPGJ, dhe procesit të ngritjes së kapaciteteve që BPGJ të vendoset si praktikë e përhershme e qendërimit gjinor në nivel vendi.

Të dhënat e prezantuara në Tabelën 4 tregojnë se gjatë periudhës 2020-prill 2024 janë shpenzuar gjithsej 74 milionë Euro për aktivitete e intervenime në fushën e avancimit të barazisë gjinore, nga të cilat 35 milionë u financuan nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Në vitin 2020 dhe 2021 u raportuan aktivitete në vlerë prej 38 milionë Euro ndërsa në Planin e Veprimit ishin parashikuar 8 milionë Euro për të dy vitet ndërsa në vitin 2022 buxheti i aktiviteteve të realizuara ishte në vlerë prej 14.5 milionë Euro ndërsa ishin planifikuar për vitin 2022 shpenzime prej 5.7 milionë Euro.

Ngase Planin i veprimit ishte vetëm për periudhën 2020-2022 nuk ka pasur planifikim të buxhetit për vitin 2023 dhe 2024 sa është kohëzgjatja e PKBGJ-së: në vitin 2023 dhe janar-prill 2024 nga të dhënat e siguruara aktivitetet e realizuara ishin në shumë prej 20,966,314 Euro nga të cilat 11,857,730 Euro nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Duhet pasur parasysh se në raportimin për vitin 2023 dhe janar-prill 2024 për shumë aktivitete nuk u raportua buxheti, që ka ndikuar në nënvlerësim të buxhetit për këtë periudhë.

Tabela 4: Buxheti për zbatimin e aktiviteteve të përfshira në Planin e veprimit të PKBGJ-së 2020-2022 dhe për vitin 2023-prill 2024 në Euro

	2020 dhe 2021	2022	2023 dhe janar-prill 2024
Buxheti i Republikës së Kosovës (ABGj)	19,697,638 (nga të cilat 2,330,005 ABGJ)	3,504,093 (nga të cilat 66,240 nga ABGJ)	11,857,730 (nga të cilat 308,393 ABGJ)
Shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare	18,525,272	11,003,535	9,108,584
Gjithsej	38,222,910	14,507,628	20,966,314
Planifikimi sipas Planit të Veprimit 2020-2022	8,059,000	5,668,000	n/a

Në buxhetin e Kosovës tani më në baza të rregullta ndahet buxhet për disa zëra ku përfshihet buxheti për pensione për të mbijetuarat/it nga dhuna seksuale gjatë luftës, për strehimoret, bursat për vajzat dhe masa të tjera të prezantuara në këtë raport.

Tabela 5: Buxheti për strehimore dhe pensionet për të mbijetuarat/it nga dhuna seksuale gjatë luftës

	2020 dhe 2021	2022	2023 janar-prill 2024
Strehimoret	324,000 495,000	400,000	Maj 2023-Shkurt 2024 692,000 Euro
Pensionet për të mbijetuarat/it nga dhuna seksuale gjatë luftës	2,247,237.00 Euro, vlerë prej 20,500 Euro për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për Verifikimin e Statusit, 18,000 Euro për pagat e anëtarëve të Sekretarisë dhe 96,000 Euro për 4 OJQ (nga 2,000 Euro për muaj). Në vitin 2021, janë paguar pensione për të mbijetuarit/at nga dhuna seksuale gjatë luftës në vlerë prej 2,733,820 Euro, vlerë prej 20,500 Euro për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për Verifikimin e Statusit, 18,000 Euro për pagat e anëtarëve të Sekretarisë dhe 96,000 Euro për 4 OJQ (nga 2,000 Euro për muaj).	3,689,649	Pensionet; 2023: 4,157,002 Euro Janar-prill 2024: 1,096,662 Pagesat për anëtarët: 2023: 30,346 Euro Janar-prill 2024: 10,115 Euro Për 4 OJQ-të: 2023: 96,000 Euro Janar-prill 2024: 32,000 Euro

3.5.3. Sfidat lidhur me qëndrueshmërinë

Nga analiza e të dhënave dhe intervistat e realizuara janë identifikuar disa sfida kryesore që mund të cenojnë qëndrueshmërinë dhe/ose avancimin e rezultateve të arritura.

- ✓ Disa nga institucionet në nivel qendrorë dhe lokal nuk arritën të caktojnë ZBGJ gjatë kohës në fuqi të planit të veprimit të PKBGJ-së, si p.sh MKRS e cila deri në përfundim të raportimit nuk ka ZBGJ. Komuna e Pejës e cila emëroi ZBGJ në vitin 2024, Komuna e Ferizajtit po ashtu nuk kishte caktuar ZBGJ.
- ✓ Po ashtu fuzionimi i Ministrive krijoi probleme në pozicionimin e ZBGJ-ve si në rastin e MFPT e cila shkoj në kundërshtim të plotë me LBGJ dhe rregulloren përkatëse, ku lëvizti nga pozita fare ZBGJ në dhe për momentin është pa ZBGJ.
- ✓ Një numër i tyre u pensionuan dhe nuk u zëvendësuan me në këto pozita MAPL dhe MAP.
- ✓ ABGJ adresoi këtë mos respektim të LBGJ me shkresa specifike adresuar SP dhe Kryetarëve të Komunave të të gjitha Komunave të RKS, përfshi edhe ato me shumicë serbe. Vlen të theksohet se angazhimi i ZBGJ në këto komuna është sfiduar edhe nga pengesat e stafit politik të shkaktuara në Komunitat me shumicë serbe. ABGJ vazhdon të ftoj në takime dhe të ndaj materiale dhe informata.
- ✓ Për arsye të paqartësisë së shkaktuar me LZZP, dhe situata e propozimit të pozitave me mandat për nivelin e mesëm dhe të ulët menaxherial, dekurajon gratë që të aplikojnë për pozita vendimmarrëse (shih raportin e financuar nga ABGJ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Hulumtimi%20Vendimmarrja%20e%20Grave%20n%C3%AB%20Sektorin%20Publik%20dhe%20Privat%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB.pdf>
- ✓ Nga intervistat u theksua se ka fusha si ajo e drejtësisë në të cilën institucionet kanë dështuar të reflektojnë për situatën dhe qasjen e intervenimeve. Në këtë fushë edhe SHC ka qenë kryesisht reaktive dhe jo proaktive në veprime;
- ✓ *Mungesa e ekspertizës në fushën e barazisë gjinore, posaçërisht në disa sektorë si infrastruktura, mjedisi, ndryshimet klimatike, energjia, digjitalizimi, sigurinë kibernetike, Inteligjencën Artificiale e të ngjashme. Mungesa e ekspertizës e bën të vështirë përballjen me vëllimin e zhvillimeve dhe shpjegimin e fenomeneve. Kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së investimit në ngritjen e kapaciteteve jo vetëm të zyrtarëve publik por edhe të studiuesve. Prandaj edhe cilësia e studimeve mbetet ende sipërfaqësore që është parakusht për dizajnimin e intervenimeve që adresojnë shkaktarët e pabarazive gjinore. Mbështetja e ABGJ-së lidhur me përfshirjen e lëndës Ekonomiksi Gjinor në Fakultetin Ekonomik/Universitetin e Prishtinës është përkushtim për rritjen e kapaciteteve për analiza dhe politikëbërje me perspektivë gjinore. Një synim i tillë është reflektuar edhe përmes aktiviteteve të përfshira në Planin e UP-së për Barazi Gjinore i mbështetur nga ABGJ dhe UN WOMEN;*

- ✓ Koha e gjatë e fillimit të zbatimit të instrumenteve të zhvilluara (p.sh. manualeve) është një tjetër sfidë e që ndikon që efektet e instrumenteve të zhvilluara të mos duken në afat të shkurtër e ndoshta as në afat të mesëm. Për pasojë krijohen kosto për qytetarët dhe vendin në tërësi. Është e domosdoshme ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publik për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor dhe për asistencë teknike për ta vendosur analizën në tjetër nivel;
- ✓ Përkundër progresit qasja në të dhëna mbetet sfidë e rëndësishme që pengon analizën e progresit dhe analizën e adresimit të shkaktarëve të pabarazive gjinore. Qasja në të dhëna administrative nuk është e lehtë dhe merr kohë për tu siguruar. Institucionet e RKS nuk mbledhin dhe nuk i publikojnë të dhënat administrative në baza të rregullta dhe kjo vazhdon të mbetet sfidë e përhershme;
- ✓ Duke pasur parasysh rëndësinë e punës së partnerëve ndërkombëtar gjatë intervistave u theksua se mungesë e ekspertizës gjinore ekziston edhe tek organizatat ndërkombëtare dhe u theksua si e domosdoshme ngritja e kapaciteteve të tyre, për të adresuar nevojat nga terreni, evitimin e duplikimeve, dhe do reflektonte në dizajnimin e programeve dhe projekteve që do të ndikonin në avancimin e barazisë gjinore në nivel më të thelluar;
- ✓ Ka një shmangie nga agjenda e barazisë gjinore si p.sh përmes tendencave të largimit të ZBGJ-ve nga pozitat e përcaktuara me LBGJ dhe rregulloren përkatëse për përshkrimin e detyrave, si dhe mungesës së vullnetit për mos aprovimin e disa prej ligjeve shumë të rëndësishme që do ta avanconin barazinë gjinore dhe të drejtat e grave dhe vajzave të garantuara me Kushtetutën e RKS.

4. REKOMANDIME PËR PROGRAMIN E KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE

Bazuar në të dhënat e raportuara për këtë vlerësim, ky seksion prezanton rekomandimet për PKBGJ-në e re dhe rekomandime për përmirësim të shkallës dhe cilësisë së raportimit për zbatim të PKBGJ-së.

Rekomandime për PKBGJ-në e re

- ✓ Në kapitullin 2 janë identifikuar aktivitetet për të cilat nuk është shënuar progres, e të cilat duhet të jenë fokus për gjatë punës në vitin 2024 dhe hartimit të PKBGJ-së së ardhshme;
- ✓ Duhet të përforcohet analiza dhe të zgjerohet lista e aktiviteteve për avancim në fushën e sportit: mjedisit; transportit; kulturës; dhunës në familje (pas analizës së Strategjisë ekzistuese);
- ✓ Duhet siguruar që për secilën fushë të këtë indikatorë për matjen e progresit dhe indikatorët të plotësojnë kushtet që të jenë të matshëm, të arritshëm dhe specifik. Për shembull edhe pse mjedisi ka qenë një ndër fushat e përfshira në PKBGJ nuk ka pasur indikatorë për mjedisin;
- ✓ Të vazhdojnë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e ndikimit gjinor;
- ✓ Në PKBGJ-në e ardhshme në proces të hartimit të PKBGJ-së dhe në analizën e situatës, indikatorët dhe aktivitete duhet të përfshihen dhe përcaktohen për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Rekomandime për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së raportimit

- ✓ Siç është theksuar në këtë raport jo të gjitha komunat kanë raportuar për monitorimin dhe vlerësimin e PKBGJ-së. Komunitetet duhet ta reflektojnë PKBGJ-në në planet e tyre vjetore të punës. Të ndajnë buxhet adekuat për zbatimin e aktiviteteve të parapara në planin e veprimit të PKBGJ. Të rritet niveli i llogaridhënies nga ana e Komunave për nivelin e zbatimit të PKBGJ-së. Të ngriten kapacitetet e ZBGJ në nivel lokal dhe qendrorë dhe cilësia e raportimit;
- ✓ Ministrinë të caktojnë zyrtaret përkatës për barazi gjinore dhe të fuqizojnë rolin e tyre në Ministri sipas përshkrimit të rregullores përkatëse për përshkrimin e detyrave dhe pozicionimin e ZBGJ-ve ;

- ✓ Mbledhja, raportimi dhe publikimi i të dhënave administrative të të gjitha institucioneve mbetet sfidë e vazhdueshme: të dhënat nuk mblidhen rregullisht, nuk publikohen ne web faqe apo edhe nuk raportohen në kohë të duhur kur ABGJ paraqet kërkesë. Përveç organizmit të institucioneve që paraqet sfidë në vete pasi që ka struktura të rishikuara, lëvizje në pozita të zyrtarëve cilësia dhe raportimi i të dhënave sipas kërkesës vazhdon të mbetet shumë sfidues dhe ngarkon ABGJ-në duke i shtyrë afatet kohore të raportimit;
- ✓ Përkundër organizimit të punëtorive për ngritjen e kapaciteteve për raportim nga ABGJ, cilësia e raportimit lë për të dëshiruar dhe duhet përmirësuar. Si pasojë puna e bërë po mbetet e nënvlerësuar dhe humbet mundësia për ndarjen e praktikave të mira në mes të komunave dhe institucioneve;
- ✓ Një numër i kufizuar i OSHC dhe organizatave ndërkombëtare nuk kanë raportuar duke pamundësuar evidentimin e përpjekjeve në avancim të barazisë gjinore dhe po ashtu duke penguar mundësinë për sinergji e bashkëveprim në mes të të gjithë akterëve;
- ✓ QRK të aprovoj rregulloren për organizimin e brendshëm të ABGJ e cila duhet të mbështet me kapacitete më të mëdha njerëzore dhe financiare, bazuar në performancën e dëshmuar si institucion ombrellë për mekanizmat gjinore në nivel vendi;
- ✓ ABGJ duhet të fuqizohet në aspektin e koordinimit të donatoreve që punojnë në fushën e barazisë gjinore në mënyrë që ndihma dhe asistencë në zhvillim ti përshtatet prioritetëve të vendit. Partnerët, bilateral dhe multilateral duhet të dëshmojnë më shumë përkushtim për tu koordinuar me ABGJ në zbatim të agjendës së QRK për barazi gjinore;
- ✓ Të rritet fondi për ABGJ-në për mbështetjen e organizatave të grave në baza të rregullta vjetore;

Shtojca 1: Evidenca e zbatimit të aktiviteteve gjatë periudhës 2020-prill 2024

Tabela A 1: Progresi në realizimin e aktiviteteve në Objektivën strategjike 1

Nr.	Aktiviteti	2020 dhe 2021	2022	2023 dhe janar-prill 2024
I.1.1	Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë me fokus të veçantë për gratë e nivel të ulët të shkollimit dhe atyre që kanë qenë të papuna për një kohë të gjatë	PO	PO	PO
I.1.2	Zhvillimi i analizës së nevojave të tregut të punës.	PO	PO	PO
I.1.3	Përmirësimi i sistemit të informatave të tregut të punës për të analizuar dhe përmirësuar mekanizmat për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për shkathtësi dhe planifikim në sistemin e AAP-së dhe ARr-së	PO	JO	JO
I.1.4	Rishikimi i profileve që ofrohen në shkollat e AAP-së dhe përshtatja me nevojat e tregut. Kjo do të arrihet me formimin e grupit punues trepalësh i cili do ta bëjë analizën, harmonizimin e profileve me nevojat e tregut, dhe krijimin e listës me profilet prioritare që do të ofrohet.	PO	PO	PO
I.1.5	Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, me fokus të veçantë tek gratë. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rRom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2022	PO	PO	PO
I.1.6	Plotësim/ ndryshimi i Ligjit të Punës për garantimin e pushimit prindëror dhe harmonizimi me Direktivat e BE-së	PO	JO	JO
I.1.7	Aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë dhe prindëror	PO	JO	JO
I.1.7a	Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale	PO	PO UA është ndryshuar dhe është larguar obligimin ligjor për pranimin automatik të fëmijëve dhe mbulimin e kostos	PO UA është ndryshuar dhe është larguar obligimin ligjor për pranimin automatik të fëmijëve dhe mbulimin e kostos
I.1.8	Analiza dhe vlerësimi i kostos financiare për subvencionimin e pagesës për edukimin parashkollor, për fëmijët nga familjet që janë në skema sociale	JO	JO	JO
I.1.9	Trajnimi i përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit	PO	PO	PO
I.1.10	Ndërtimi i qendrave rezidenciale dhe ditore për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare	PO	PO	PO
I.1.11	Ndërtimi i qendrave rezidenciale ditore, për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar	PO	PO	PO
I.1.12	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore të ofruesve publik dhe jo-qeveritar	PO	PO	PO

I.1.13	Nxitja e zhvillimit të bizneseve ekzistuese në pronësi të grave nëpërmjet programeve mikrofinanciare dhe mikrokredive	PO	PO	PO
I.1.14	Krijimi i një strukture stimuluese (fondi të përbashkët) nga qeveria dhe bizneset, për mbështetjen e shkollimit në drejtimet deficitare dhe për vajzat dhe gratë në drejtimet teknike.	PO	PO	PO
I.1.15	Realizimi i emisioneve televizive, dhe shkrimeve me rrëfimeve të suksesshme të femrave në profesionet teknike	PO	PO	PO
I.1.16	Aktivite sensibilizuese për nxitjen e angazhimit të grave dhe burrave në sektorë deficitari (bujqësi, energjetikë, pylltari, ujëra, mjedis)	PO	PO	PO
I.1.17	Hulumtim/analizë e situatës për mundësinë e themelimit të bashkimeve kreditore	JO	JO	JO
I.1.18	Analizë dhe integrimi i perspektivës gjinore në Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK) për mbështetjen e grave	JO	JO	JO
I.1.19	Ofrimi i programeve për edukim financiar	PO	PO 1 KOMUNË	JO
I.2.1	Zhvillimi i manualit për vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike dhe legjislacion	PO	PO	JO
I.2.2	Ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike dhe legjislacion	PO ⁴¹	PO	PO
I.2.3	Ngritja e kapaciteteve për integrimin gjinor në politika publike, në nivelin qendror dhe lokal	PO	PO	PO
I.2.4	Rishikimi i politikave ekzistuese afatgjate (Strategjitë dhe Planet e Veprimit) dhe integrimi i perspektivës gjinore	PO	PO	PO
I.2.5	Rishikimi i legjislacionit dhe akteve normative integrimi i perspektivës gjinore	PO, ABGJ ka ofruar komente por nuk ka evidencë për shkallën e komenteve të adresuara	PO, ABGJ ka ofruar komente por nuk ka evidencë për shkallën e komenteve të adresuara	PO, ABGJ ka ofruar komente por nuk ka evidencë për shkallën e komenteve të adresuara
I.2.6	Monitorimi i politikave ekzistuese publike (i ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve	PO	PO	PO
I.2.7	Identifikimi i treguesve gjinor, për secilin institucion në nivel qendror dhe lokal, dhe raportimi i rregullt i tyre.	JO	JO	JO
I.2.8	Zhvillimi i Indeksit të Barazisë Gjinore	PO	JO	JO
I.2.9	Integrimi i perspektivës gjinore/marrja e masave afirmative për ndarjen e banesave sociale	Janë ndarë banesa për gra por nuk është raportuar nëse janë aplikuar	Janë ndarë bursa dhe aplikuar masa afirmative në grantet e	Janë ndarë bursa dhe aplikuar masa afirmative në grantet e

⁴¹ Në kohën kur është hartuar PKBGJ, ABGJ ka qenë duke realizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve për VNGJ. Për zhvillimin e kapaciteteve për zbatimin e Manualit të VNGJ-ë gjatë viteve 2018 dhe 2019, ABGJ ka realizuar 14 trajnime dyditore dhe 11 sesione orientuese për VNGJ, duke trajnuar 486 zyrtar civilë.

		masa afirmative në komuna (p.sh. Suharekë, Prishtinë, Gjiilan, Vushtrri, Mitrovicë)	bujqëisë	bujqëisë
I.2.10	Hartimi i aktit ligjor për mënyrën e zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj)	JO Është formuar grupi punës. Është hartuar metodologjia e punës	JO Por është realizuar studimi i fisibilitetit	JO Por është realizuar studimi i fisibilitetit
I.2.11	Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e BPGj, në nivel qendror dhe lokal.	PO	PO	PO
I.2.12	Fushata për vetëdijesimin e shoqërisë lidhur me rolin e përfshirjes së grave në vendimmarrje në menaxhimin e burimeve natyrore	JO	JO specifikisht me këtë aktivitet por po ne fushën e bujqësisë	JO
I.2.13	Organizimi tradicional i aktivitetit për promovimin e suksesit të grave, në profesione jo-tipike, në bujqësi, në ndërmarrësi, shembujt e suksesshëm të kooperativave, dhe në fusha të tjera.	PO	PO	PO
I.2.14	Organizimi i panairove të ndërmarrjeve në pronësi të grave edhe në fusha jo tipike; dhe organizimi i B2B, në vend dhe jashtë, për të marrë mësim, rrjetëzim dhe promovim dhe zgjerim të tregut.	PO	PO	PO
I.2.15	Përfshirja e perspektivës gjinore në panairat ekzistuese	PO	PO	PO
I.2.16	Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	PO, shumica kanë raportuar për përfitueset e më pak për aktivitete për sensibilizim	PO	PO
I.2.17	Sensibilizimi për pjesëmarrjen e grave fermerë në Shërbime Këshilluese	PO	PO por jo ndonjë iniciativë ndryshe nga e kaluara, ka ende nevojë për të siguruar qasjen e grave në këshillime	PO por jo ndonjë iniciativë ndryshe nga e kaluara, ka ende nevojë për të siguruar qasjen e grave në këshillime
I.2.18	Zhvillimi i standardeve të profesionit (bazuar në rezultatet e të nxënësve) për profesionet e kërkuara në tregun e punës. Këtu të konsiderohen me prioritet profesionet deficitare (bujqësi, energjetikë, pylltari, ujëra, mjedis, TIK, kujdestare për fëmijë, etj.)	PO	PO	PO
I.2.19	Hartimi i kurrikulave për profesionet e reja në përputhje me standardet e profesionit dhe rifreskimi i kurrikulave ekzistuese, duke përdorur qasjen e bazuar në rezultatet e të nxënësve	PO	PO	PO
I.2.20	Zgjerimi/ zhvillimi MATP të reja (p.sh.	PO	PO	JO

	apprenticeship), specifikisht për vajza dhe gra, me theks tek zonat rurale (grup moshat, etnitetet)			
I.2.21	Fushata vetëdijësuese për informim për efektet negative të informalitetit për personat që punojnë në këtë sektor	PO	JO	JO
I.2.22	Forcimi i kapaciteteve të Inspektoratit të Punës	JO	PO	JO
I.2.23	Forcimi i mekanizmave mbikëqyrës të inspektoratit të punës	JO	PO	JO
I.2.24	Përforcimi i mekanizmave dhe bashkërendimi i veprimeve institucionale për zvogëlimin e punësimit joformal	JO	PO	JO
I.2.25	Angazhimi i palëve të interesit dhe publikut të gjerë në adresimin e punësimit joformal	JO	PO	PO
I.2.26	Forcimi i kapaciteteve të inspektoratit të punës për adresimin e punësimit joformal	JO	PO	JO
I.2.27	Shkëmbimi i të dhënave me institucionet relevante dhe partnerët social për adresimin e punësimit joformal	JO	PO	JO
I.2.28	Zhvillimi i dokumenteve të politikave mbi sigurinë dhe shëndetit në punë të punësuarve	PO	JO MFPT NUK KA RAPORTUAR NE KETE AKTIVITET	JO MFPT NUK KA RAPORTUAR NE KETE AKTIVITET
I.2.29	Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe lansimi i fushatave për të drejtat e të punësuarve lidhur me kornizën e re ligjore	PO	PO	PO
I.2.30	Trajnimi dhe certifikimi i personave që kryen aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë	PO	PO	JO
I.2.31	Funksionalizimi i procesit të licencimit të kompanive / bizneseve që kryejnë aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë	PO	PO	JO
I.2.32	Përgatitja e vlerësimit të ndikimit rregullativ për sigurimet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale	JO	JO	JO
I.2.33	Zhvillimi i metodologjisë dhe analiza për matjen e pabarazisë gjeografike/zonat më pak të favorizuara, me perspektivë gjinore, konsidero minoritetet brenda minoritetit.	JO	JO	JO
I.2.34	Të ndryshohet Ligji 2004/26 për trashëgiminë për ta përfshirë bashkësinë jashtëmartesore si ekuivalente ose e krahasueshme me martesën formale (bashkësinë martesore) për realizimin e të drejtës në trashëgimi, pas 5 viteve bashkëjetesë apo 3 vite nëse ka fëmijë nga ajo bashkësi.	PO	PO e adresuar ne projekt Kodin Civil	PO e adresuar ne projekt Kodin Civil
I.2.35	Vazhdimi i masës afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, pa pagesë	PO	PO	PO
I.2.36	Amandamenti i Udhëzimit Administrativ MMPH 08/2014 për Tarifën e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyret Kadastrale Komunale	JO	JO	JO
I.2.37	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë	PO	JO për trashëgimi	PO
I.2.38	Informimi i grave për mundësitë dhe përparësitë e	JO	JO	JO

	organizimit në kooperativa (takime, broshura)			
I.2.39	Ofrimi i trajnimeve në fushën e ndërmarrësisë dhe shkëmbimi i përvojave të mira me kooperativat e suksesshme	JO	JO	JO
I.2.40	Ofrimi i mbështetjes (konsulenca, ndihmë juridike falas, rrjetëzimi, etj.) për themelimin e kooperativave	JO	JO	JO
I.2.41	Mbështetja financiare për kooperativat e reja	JO	JO	JO
I.2.42	Ofrimi i programeve mbështetëse për ndërmarrësi, për gra, të përcjella me këshillime biznesore	PO	PO	JO
I.2.43	Fushata vetëdijësuese për respektimin e kuotës të punësimit për personat me aftësi të kufizuar dhe evitimin e stigmatizimit në shoqëri	PO Prishtina ka raportuar por pa të dhëna për fushatat	PO	PO
I.2.44	Studimi lidhur me realizimin e të drejtës për alimentacion dhe analiza e praktikave të mira për të siguruar realizimin e alimentacionit	JO	JO	JO
I.2.45	Rishikimi dhe plotësim-ndryshimi i kornizës ligjore për Shërbime Sociale dhe Familjare	PO në proces	PO në proces	PO në proces
I.2.46	Hartimi i manualit dhe kornizës ligjore për monitorimin e LBGJ	PO manuali në fazën e finalizimit	JO	JO
I.2.46	Hartimi i standardeve të profesionit për punëtorët social dhe validimi moduleve të trajnimit	JO	PO	JO
I.2.47	Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe hartimi i programit të trajnimit	JO	PO	PO
I.2.48	Trajnimi i punëtorëve social për zbatimin e standardeve minimale të shërbimeve sociale	PO	PO	PO
I.2.49	Hartimi i kornizës ligjore dhe manualit për monitorimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe trajnimi i zyrtarëve	JO	JO	JO

2020 dhe 2021

RRITJA E PUNËSIMIT DHE PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË PUNËS

- ✓ APRK: në vitin 2020 janë trajnuar 901 gra, ku prej tyre me shkollim të ulët ishin 236, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 932 Gra (nga 1,000 sa janë planifikuar për 3 vite në Planin e Veprimit), ku prej tyre me shkollim të ulët ishin 231 gra;
- ✓ Në total për vitet 2020 dhe 2021 numri i përfituesve në Masat Aktive të Tregut të Punës është 8,923 persona ku prej tyre gra janë 4,977 (që përbëjnë 56% të të trajnuarve). Prej totalit 1,100 përfitues janë nga komunitete pakicë dhe prej tyre gra janë 489;
- ✓ MKRS ka mbështetur 32 gra me grante për start-ups në vlerë prej 206,860 Euro;
- ✓ Trajnine janë ofruar edhe nga komunat, të mbështetura edhe nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare;
- ✓ Është hartuar Draft Strategjia dhe Plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2022-2026;
- ✓ Fushata vetëdijësuese lidhur me të drejtën për pushim të lehonisë;
- ✓ Në vitin 2021 ABGJ ka mbështetur drejtpërdrejtë 273 biznese të vogla në pronësi të grave, në vlerë totale prej 207,284 Euro, këto janë gra të vetëpunësuar apo që punësojnë maksimalisht 2-3 gra
- ✓ MASHTI ka ndarë 1,856 bursa elitare nga 700 Euro për studentë (gjithsej 1.3 milionë Euro), dhe në vitin 2021 në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike MASHT ka ndarë 1,365 bursa për vajza dhe gra që studiojnë në fushën STEM, secilës nga 1,000 Euro, gjithsej 1,365,000 Euro;
- ✓ Bursa janë ndarë edhe nga komunat;
- ✓ ABGJ ka financuar realizimin e një videospoti televiziv dhe janë mbështetur me pajisje pune 11 biznese ekzistuese dhe 4 biznese të reja për promovimin e grave në sektorin e bujqësisë e zbatuar nga OJQ Mundësia;
- ✓ Fondi për Garantimin e Kredive: është hapur dritare për bizneset e grave: në vitin 2021 janë mbështetur me garanci 269 biznese të grave;
- ✓ Trajnimet e zyrtareve lokale për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor;

- ✓ MBPZHR: Subvencionimi përmes pagesave direkte në bazë gjinore: 98,423,460.31 Euro, pagesa direkte për gra: 5,752,626.79 Eur; në vitin 2021 pagesa direkte për burra: 92,670,833.52 Euro; për grante për gra: 2,129,637 dhe 12,627,799 për burra;
- ✓ Organizimi i 21 panairove për gratë në biznes nga MBPZHR dhe në 9 komuna (Podujevë, Shtime, Gjiilan, Mitrovicë, Lipjan, Vushtrri, Hani i Elezit, Viti, Ferizaj);
- ✓ Ofrimi i hapësirës për bizneset e grave në tregjet mobile, për shembull Komuna e Prishtinës dhe Gjakovës;
- ✓ Grante nga MBPZHR për gra në sektorin e bujqësisë;
- ✓ Sesione informuese dhe këshilluese për gratë në bujqësi në Podujevë dhe Kaçanik dhe nga MBPZHR;
- ✓ MFPT: Gjatë vitit 2021, janë miratuar dy Rregullore: Rregullorja Nr. 01/2021, për personat kualifikimin e personave përgjegjës për SSHP, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për SSHP si dhe Rregullorja Nr. 02/2021 për Vlerësimin e Riskut në vendin e punës si dhe është hartuar Draft programi kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë 2022-2027;
- ✓ Janë licencuar 4 qendra të trajnimit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SSHP) dhe 4 Kompani për ofrimin e shërbimeve për SSHP;
- ✓ ABGJ ka mbështetur realizimin dhe ka transmetuar video spotin për të drejtën trashëgimore dhe institucionet përgjegjëse për iniciimin e procedurës së trashëgimisë;
- ✓ Aktivitete vetëdijësuese lidhur me të drejtat pronësore të organizuara nga komunat dhe OJQ-të;
- ✓ Zyra e BE-së mbështeti OJQ-në Syri i Vizionit me 325,420 Euro (2020-2022) për të rritur mundësitë e punësimit dhe perspektivat e qëndrueshme për të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet etnike pakicë në Kosovë.
- ✓ Zyra e BE-së mbështeti Jakova Innovation Center me 232,260 Euro (2020-2022) për të rritur punësueshmërinë e të rinjve, grave dhe grupeve të pafavorizuara përmes zhvillimit të aftësive dhe njohurive të kërkuara në tregun lokal të punës.
- ✓ Zyra e BE-së mbështeti Business Support Center Kosovo (BSCK) me 308,037 Euro (2020-2022) për të rritur punësueshmërinë dhe perspektivat e qëndrueshme të punësimit për të rinjtë dhe gratë në sektorin e energjisë në Kosovë.

- ✓ Në vitin 2020, OSBE mbështeti me 10,907 Euro programi promovon rritjen e mundësive të punësimit për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës përmes praktikave profesionale në bashkëpunim me institucionet publike.
- ✓ Gjatë vitit 2021, OSBE ofroi një trajnim online për Buxhetimin e Ndjeshëm Gjinnor për 14 pjesëmarrës (9 gra, 5 burra). Tema të tjera specifike do të vazhdojnë të ofrohen në vitin 2022;
- ✓ ABGJ ka zhvilluar dhe postuar videos spotin për të drejtën trashëgimorë dhe institucionet përgjegjëse për inicimin e procedurës së trashëgimisë.
- ✓ Ministria e Kthimit të Komuniteteve, gjatë vitit 2021 janë ndërtuar 34 shtëpi për komunitetet pakicë, nga këto kanë përfutur 3 gra kryefamiljare dhe 31 burra, gjithsej 34 familje me 152 anëtar, të financuar nga BE. Këto familje përveç ndërtimit të shtëpive kanë përfutur edhe financime në: Agrikulturë 19, mjete pune 10, autolarje, automekanikë, mjete pasticeri, mjete muzike, mjete për printim 3D. Të gjitha familjet janë ndihmuar me dru për ngrohje gjatë dimrit.
- ✓ Ministria e Kthimit të Komuniteteve ka mbështetur dy projekte në infrastrukturë: 1.ndërtimi i rrethojës së kopshtit të fëmijëve në Prizren.
- ✓ Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë -UA është vazhduar edhe për një vit prill 2020-prill 2021. Si rezultat i kësaj mase afirmative numri i pronave të regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve ka arritur në 5,496 çifte. UA është vazhduar edhe për një vit prill 2021-prill 2022. Për periudhën janar- dhjetor 2021, u regjistruan pronën në emër të të dy bashkëshortëve 3,202 çifte.
- ✓ Në nëntor 2020, OSBE ka mbështetur përditësimin dhe publikimin e udhëzuesit për aksesin e grave në të drejtat e pronës.
- ✓ ABGJ ka zhvilluar dhe postuar videos spotin për të drejtën trashëgimorë dhe institucionet përgjegjëse për inicimin e procedurës së trashëgimisë.

2022

RRITJA E PUNËSIMIT DHE PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË PUNËS

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ Në Qendrat e Aftësimit Profesional/APRK u trajnuan 990 gra, nga të cilat me shkollim të ulët ishin 299 gra;
- ✓ Gjatë vitit 2022 numri i përfituesve në MATP nga APRK ishte 2012 persona, ku prej tyre gra ishin 1,250, 229 ishin nga komunitete pakicë dhe prej tyre gra janë 136;
- ✓ Trajnime profesionale për ngritjen e aftësive të grave janë ofruar edhe nga komunat, të mbështetura edhe nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare;
- ✓ Është aprovuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2022-2026;
- ✓ Gjatë vitit 2022 ndërmjetësim në MATP ishin 32 nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian ndërsa në Aftësim Profesional numri i përfshirë i tyre ishte, 105 persona, po ashtu në ndërmjetësim të rregullt ishin të përfshirë 75 persona Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
- ✓ APRK me mbështetjen e projektit EYE ka zhvilluar kurrikulat dhe paketat mësimore duke u bazuar në Standardet e profesionit në kualifikimet: Nëpunës i kontabilitetit, murator, zdrukthëtari dhe instalime elektrike;
- ✓ MFPT nga projekti EYE është financuar instalimi i programit të kontabilitetit për tri Qendrat e Aftësimit profesional-Pejë, Gjakovë dhe Prizren;
- ✓ Nga APRK 52 persona me aftësi të kufizuara përfituan nga MATP në vitin 2022;
- ✓ MFPT gjatë vitit 2022 Qendrat e Aftësimit Profesional kanë aplikuar në Autoritetin Kombëtarë të Kualifikimeve për Akreditim dhe Validim të programeve, ku profilet që janë akredituar janë: Asistent Administrativ, Saldim, Menaxher i Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla, Automekanik, Nëpunës i Kontabilitetit, Përpunim i Qumështit, Zdrukthuari, Furrтари, pastiqeri dhe Instalime Elektrike;
- ✓ Subvencionim për çerdhe për fëmijët e nënave vetushqyese kanë ofruar këto komuna: Vitia, Gjilan, Obiliq, Fushë Kosovë, Suharekë, Prishtina, Prizren, Vushtrri, Klinë, Mitrovicë, Malishevë, Skenderaj, Klinë;

- ✓ Ne vitin 2022 nga mbështetja financiare ne fushat e Shkencës, Teknologjisë Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM), MASHTI ka ndarë 1,634 bursa nga të cilat 1,383 për student vajza/gra në vlerë prej 1,634,000 Euro;
- ✓ MASHTI ka hartuar aktet juridike dhe janë saktësuar procedurat për studimet gjurmuese të të diplomuarve në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP);
- ✓ MASHTI përmes pakos së Ringjalljes ekonomike, Masa 1.5, ka ndarë 957 kuponë për maturantë që janë trajnuar në fushën e TI (600 Euro për kandidat) dhe janë ndarë 112 bursa për drejtimet deficitare të AAP dhe drejtimet teknike për vajza (500 Euro për nxënës) në vlerë prej 56,000 Euro;
- ✓ Bursa për studente janë ndarë edhe nga komuna e Podujevës, Prishtinës, Deçanit, Skenderajt, Prishtinës; Drenasit;
- ✓ Fondi për Garantimin e Kredive: është hapur dritare për bizneset e grave: ne vitin 2022 janë mbështetur me garanci kredituese 269 biznese te grave;
- ✓ MBPZHR: Në vitin 2022 pagesa direkte përfituat 1,265 gra (23,469 burra) në vlerë prej 2.65 milionë Euro për gra (51.34 milionë Euro për burra); nga grantet kanë përfituar 145 gra (350 burra) në vlerë prej 7,249,148 Euro (burrat 16,914,679 Euro);
- ✓ Organizimi i panaireve për gratë në biznes nga MBPZHR dhe nga komunat;
- ✓ Janë mbajtur sesione informuese dhe këshilluese për gratë në bujqësi;
- ✓ MFPT ka licencuar mbi 17 kompani që kryejnë aktivitete nga siguria e shëndeti në punë dhe janë certifikuar mbi 300 persona për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SSHP) ;
- ✓ Aktivitete vetëdijësuese lidhur me të drejtat pronësore të organizuara nga komunat dhe OJQ;
- ✓ Janë mbështetur gratë për themelim dhe zhvillim të bizneseve përmes granteve dhe trajnimeve;
- ✓ Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) gjatë Vitit 2022 përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar/PZHRB ka përkrahur gjithsej 332 projekte ku nga to: 134 projekte të përfaqësuara nga Gratë (shuma 1,014,883.49 Euro), dhe 198 projekte të përfaqësuara nga Burrat (shuma 2,016,050 Euro). Në Programin për Mbështetje Financiare të OJQ-ve për vitin 2022 në total kanë përfituar 38 projekte, prej tyre 16 përfituese kanë qenë Gra dhe 22 përfitues Burra. Në Programin për Zhvillimi Rajonal Projekte Kapitale (PZHR) – për vitin 2022 në total kanë qenë përfitues 14 Komuna;

- ✓ Komuna e Prishtinës ka mbështetur 10 gra të mbijetuara nga dhuna në familje përmes mbështetjes financiare për banim;
- ✓ MINT ka organizuar Panairin Gratë në Biznes 2022, i cili është mbajtur në Prishtinë dhe ka zgjatur tri ditë. Në këtë panair kanë ekspozuar produktet e veta rreth 40 gra ndërmarrëse dhe panairë nga komunat;
- ✓ Komuna e Malishevës ka raportuar se në ndërtesën e banimit social janë 23-familje (nëna kryefamiljare), ndërsa përgjatë vitit 2022 kanë përfituar 5-familje (gra), është plotësuar kriteri i aplikimit për nënat vete-ushqyese;
- ✓ Gjatë vitit 2022 janë realizuar 6,316 Inspektime prej tyre 3,323 Inspektime të planifikuara; 1 602 të përsëritura-riinspektime; 46 inspektime të jashtëzakonshme; 394 inspektime si pasojë e aksidenteve në vendin e punës nga të cilat 15 raste me fatalitet dhe 860 inspektime sipas ankesës së palëve. Inspektorati i Punës gjatë vitit 2022 ka realizuar 81 Inspektime të përbashkëta me institucionet tjera si me ATK-në, Policinë e Kosovës Inspektoratet e Tregut, Shëndetësisë, Arsimit. Inspektorët e Punës janë trajnuar për adresimin e punës së padëkluar, është hartuar lista kontrolluese dhe Manuali për trajtimin e punës së padëkluar. Sistemi informativ -digjitalizimi i të dhënave të inspektimeve është në proces të realizimit i mbështetur përmes projektit të SIDA Suedeze dhe duke u realizuar përmes ILO-së;
- ✓ Gjatë vitit 2022 është filluar me fushatën vetëdijësuese "Punë e denjë për jetë të dinjitetshme" Kjo fushatë është mundësuar nën udhëheqjen e MFPT-së dhe mbështetet nga ambasada Suedeze në Kosovë, ndërsa partner janë IP, ATK ILO, UN Women, CDF, IKS, QPA dhe Lens;
- ✓ Është vazhduar afati i UA Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Gjatë vitit 2022 4,375 prona janë regjistruar në emër të dy bashkëshortëve në 2022, duke arritur numri në 12,542;
- ✓ MINT ka zhvilluar projektin Iniciativa për Fuqizim Digjital ku gjatë vitit 2021 dhe 2022 kanë përfituar 62 ndërmarrje, prej tyre 35 në pronësi nga grave të cilët kanë zbatuar projektet e tyre në fushën e digjitalizimit;
- ✓ MFPT, gjatë 2022 ka trajnuar mbi 60 trajnerë të shërbimeve sociale familjare, të cilët do të zhvillojnë materialet/modulet dhe do të ofrojnë trajnime për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare;
- ✓ MFPT: Janë trajnuar mbi 200 ofrues të shërbimeve sociale familjare, punëtorë socialë të tre niveleve nga sektori qeveritar dhe joqeveritar;

- ✓ MASHTI nga shtatë fushave kurrikulare që janë, 4 koordinatorë të fushave janë gra. MASHTI gjatë vitit 2022 ka hartuar Informatorin për mësimdhënës për rekomandimet që dalin nga Konventa e Stambollit dhe gjatë vitit 2023 do të organizohen sesione informuese nëpër komuna me mësimdhënës;
- ✓ MASHTI e ka të hartuar informatorin shkollor për procedura e standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje e që çdo vit shkollor u shpërndahen shkollave;
- ✓ MASHTI duke synuar mbështetjen financiare për shkollimin e studenteve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian që janë regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2022/2023 në nivelin bachelor në ndonjërin nga Universitetet publike të Republikës së Kosovës ka shpallur thirrjen për mbështetje financiare për studentët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian. Shuma maksimale e mbështetjes financiare deri 1,000 Euro për studente. Kanë aplikuar 26 studente dhe të gjithë këta kanë përfituar burse. Numri i përfituesve është gjithsej 26 studente 16 vajza dhe 10 djem. Sipas përkatësisë etnike janë: 19 egjiptian; 3 romë dhe 4 ashkali, Shuma totale e shpenzuar: 26,000 Euro;
- ✓ MASHTI ka planifikuar 500 bursa – 150,000 Euro ndërsa për vitin shkollor 2022/23 kanë përfituar 498 nxënës;
- ✓ MASHTI bazuar në UA për masat afirmative për komunitetet për regjistrimin e tyre në institucionet e arsimit të lartë parashihet kuota për lehtësimin dhe regjistrimin e tyre. Në UA parashihet kuota prej 12% në çdo fakultet, gjithashtu kuotë e veçantë është edhe në konvikte, Qendra e studentëve;
- ✓ ABGJ së bashku me UN Women ka mbajtur punëtorinë “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor si një mjet për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal”, kjo punëtori është organizuar për nevojat e pushtetit lokal dhe obligimeve në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024;
- ✓ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), kanë mbajtur trajnimin dy ditor me zyrtarë/e për barazi gjinore në komuna: Në 5 sesione trajnimesh për periudhën janar - tetor janë trajnuar gjithsej 289 zyrtar komuna;
- ✓ Janë organizuar trajnime të zyrtarëve lokal për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor;
- ✓ Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për monitorimin e rregullt të zbatimit të LBGJ-së brenda institucioneve publike u organizuan nga komuna e Obiliqit, Fushë Kosovës, Suharekës, Viti dhe Skenderaj.

- ✓ Zyra e BE-së në vitin 2022 ka përkrahur me 1,500,000.00 Euro Zyren e UN Women për mbështetje për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave që integrojnë perspektivën gjinore, forcimin e kapaciteteve institucionale në Kosovë në të gjitha nivelet dhe përmirësimin e koordinimit mes mekanizmave për barazi gjinore dhe shoqërisë civile;
- ✓ Zyra e BE-së përmes WE Global ka nda 21 grante në vlerë prej 105,000 Euro për OJQ-të e drejtuara nga grat për të përkrahur projektin që synon të nxisë angazhimin qytetar, barazinë gjinore dhe demokracinë gjithëpërfshirëse, duke rritur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje në Kosovë;
- ✓ Zyra e BE-së, me një financim prej 384,756 Euro për vitin 2022-2023, ka mbështetur Qendrën për Trajnim dhe Burime të Avokimit në përmirësimin e kushteve të punës për grupet e cënueshme, forcimin e standardeve të sigurisë dhe promovimin e dialogut social. Projekti synon monitorimin e shkeljeve të të drejtave në punë, fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve dhe OJQ-ve, si dhe rritjen e ndërgjegjësisë mbi ligjin e punës.
- ✓ Zyra e BE-së ka mbështetur UNDP-në me një buxhet prej 4,999,961 Euro për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale nga QPS-të dhe për të siguruar qasje të barabartë dhe cilësore në mbrojtjen sociale për grupet më të cënueshme, përfshirë gratë dhe vajzat.
- ✓ Zyra e BE-së, përmes programit Young Cell Scheme Round, ka mbështetur me 4,500,000 Euro nga viti 2022-2027 zhvillimin profesional të burrave dhe grave në shërbimin civil për t'i shërbyer më mirë qytetarëve të Kosovës. Programi ofron bursa për studime master në universitetet e BE-së, sipas sektorëve prioritarë të përcaktuar nga qeveria. Pas diplomimit, përfituesit angazhohen të punojnë për tre vite radhazi në institucionet e Kosovës.
- ✓ Zyra e BE-së, nga vitit 2022 deri në vitin 2024 në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore, ka organizuar sesione informuese mbi Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Manualin për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor, me fokus të veçantë te grupet e grave dhe deputetët e rinj. Gjithashtu, janë zhvilluar trajnime për stafin e departamenteve dhe komisioneve të përhershme mbi përdorimin e manualit për vlerësimin e ndikimit gjinor.
- ✓ OSBE ka mbështetur me 5,327 Euro organizimin e pesë konsultimeve (maj-gusht 2022), ku morën pjesë 78 gra nga komunitete të ndryshme në Kosovë. Në nëntor u mbajt një konferencë përfundimtare me pjesëmarrës nga OJQ-të, donatorët, organizatat ndërkombëtare dhe Agjencia e Punësimit të Kosovës, ku u prezantua një vlerësim i nevojave për zhvillimin e vitit 2023. Gjithashtu, 33 gra nga konsultimet e mëparshme diskutuan drejtpërdrejt me palët kryesore për fuqizimin socio-ekonomik të grave.

2023 DHE 4 MUAJT E VITIT 2024:

- ✓ Komuna e Prishtinës, ka ofruar subvencionim të pagesës për 24 fëmijë të nënave vetë-ushqyese në kopshte, nëna përfituese të skemave sociale në vitin 2023, në vlerë prej 13,200 Euro. Komuna po ashtu ka subvencionuar 131 fëmijë të kopshteve private me vlerë totale 55,020 Euro për gjashtë (6) muaj Nëntor 2023 deri më Prill 2024;
- ✓ Komuna e Prishtinës është në realizim të punëve finale në kopshtin në lagjen Dardania, IP "Xixillonjat" në Lagjen Pejton, aneksi i IP "Ardhmëria" në lagjen Bregu i Diellit" dhe sapo kanë filluar punimet në ndërtimin e objektit në lagjen Kolovica në afërsi të shkollës Eqrem Qabej.
- ✓ Komuna e Prishtinës deri në vitin 2023 janë angazhuar 20 mësimdhënës mbështetës në SHFMU dhe në IP, ndërsa në 3 muajin e vitit 2024 janë punësuar 4 mësimdhënës mbështetës. Në total komuna ka angazhuar 24 mësues mbështetës;
- ✓ Prishtina mbajti 10 takime këshilluese për grat fermere për aplikim në subvencione dhe grante dhe organizoi punëtorinë me temë "Veglat Digjitale në agrobiznes", e fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve digjitale për grat fermere në sektorin e bujqësisë.
- ✓ Komuna e Malishevës organizoi trajnim për 10 -lidhur me avancimin e njohurive financiare dhe trajnoi 13 gra për biznes dhe mbajti 4 trajnime lidhur me drejtën në pronë, kujdesin për fëmijë dhe trajnim profesional;
- ✓ Prizreni organizoi 3 punëtori me gra nga OJQ ,studente dhe gra pa punë në temën e sfidave në punë dhe vështirësitë gjatë punësimit të grave (rreth 40 gra dhe vajza përfituese) dhe 3 punëtori mbi administrimit të biznesit dhe avokim me 17 gra dhe vajza;
- ✓ Komuna e Shtimes organizoi aktivitet me Grupin e Grave /Instituti LCHT lidhur me ndërmarrësinë;
- ✓ Komuna e Skenderaj organizoi trajnim për 20 gra në fushën e dizajnit grafik;
- ✓ OSBE në vitin 2023 realizoi 14 konsultime dhe organizoi një konferencë ku u prezantuan vlerësimi i nevojave për sfidat e punësimit dhe trajnimit të grave të kthyer dhe grave nga komunitetet jo shumicë;
- ✓ Është themeluar komisioni për AAP dhe ndërlidhjen me tregun e punës në nivel të Kryeministrit me qëllim të avancimit të mëtejshëm të AAP-së përmes koordinimit ndër-institucional. Është iniciuar finalizimi i draft dokumentit të kornizës kurrikulare për AAP dhe finalizimi i një numri të kurrikulave të rishikuara të profileve profesionale;
- ✓ Është themeluar grupi punues, i cili do të merret me standardizimin dhe unifikimin e modelit të qendrave të karrierës për nivelin e shkollave profesionale si dhe janë ndërmarrë hapa drejt definimit të formulës financiare për AAP(përfshirë arsimin e përgjithshëm);

- ✓ MASHTI ka hartuar / rishikuar kurrikulat për 85 profile të AAP, prej tyre 20 janë miratuar nga ministrat e MASHTI-t dhe po pilotohen në një numër të caktuar shkollash;
- ✓ Në vitin 2021 janë verifikuar 9 standarde të profesionit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (në total janë 124 standarde të profesionit të verifikuara);
- ✓ OSBE: 2023 Promovimi i suksesit të grave rromë të Kosovës në tregimin e biznesit: https://www.osce.org/mission-in-kosovo/540107?fbclid=IëAR3y-OaImm7esXIVcqb58vmsrBFeMvq5Fvn0ëdQ_ZYYcMnnYOGZru6QGKËw
- ✓ Aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë dhe prindëror u organizuan nga komuna e Drenasit, Gjakovës, Gjilanit, Istogut, Lipjanit, Prishtinës, Skenderajt, dhe Vushtrrisë.
- ✓ Komuna e Drenasit liroi nga pagesa 5 fëmijë të nenave vetushqyese;
- ✓ Malisheva në vitin 2023 12 fëmijë të prindërve vetushqyes, me nevoja te veçanta dhe veteranëve të luftës ndërsa në vitin 2024 subvencionoi 14 fëmijë dhe me 50% të pagesës janë 31 fëmijë (vendim i asamblesë komunale, përparësi fëmija i dytë në çerdhe);
- ✓ Komuna e Gjilanit kishte 14 fëmijë të subvencionuar në kopshtet e fëmijëve të nënave vetushqyese për vitin 2023 dhe po atë në vitin 2024; Komuna e Klinës kishte subvencionim të një rasti në vitin 2023;
- ✓ Fushë Kosova subvencionoi 5 fëmijë nga këto grupe; dhe 2 në vitin 2024;
- ✓ Komuna e Hanit të Elezit subvencionoi 22 fëmijë për periudhën Janar-Prill 2024;
- ✓ Komuna e Lipjanit QEAP "Çerdhja" Lipjan ,me vendim të Kuvendit ka lirua nga pagesa 11 fëmijë për vitin 2023, QEAP "Çerdhja, fshati Gadime ,me vendim të Kuvendit ka lirua nga pagesa 65 fëmijë për vitin 2023, QEAP "Çerdhja, fshati Sllovi ,me vendim të Kuvendit ka lirua nga pagesa 55 fëmijë për vitin 2023, QEAP" Çerdhja, fshati Shalë ,me vendim të Kuvendit ka lirua nga pagesa 48 fëmijë për vitin 2023-totali i fëmijëve të liruara për vitin 2023 ishte 179;
- ✓ Suhareka subvencionoi 9 fëmijë deri në shtator ndërsa pas shtatorit kanë mbetur 7 fëmijë;
- ✓ Rahoveci subvencionoi 2 nëna vetë ushqyese, njëra është subvencionuar nga shtatori 2023 dhe tjetra dy muaj për vitin 2024;

- ✓ Skenderaji subvencionoi 2 fëmijë; Komuna e Vitisë ka subvencionuar 2 fëmijë të nënave vetushqyese;
- ✓ Komuna e Gjilanit ka nxjerr vendim për subvencionimin e fëmijëve në institucionet parashkollore private, për moshën 09 muaj deri në 6 vjeç fëmijë të familjeve që lartësinë mujore të të hyrave e kanë nën 528€;
- ✓ Komuna e Istogut ka liruar nga pagesa 17 fëmijë dhe 17 të tjerëve iu është ofruar zbritje të shumës - me kosto financiare prej 580 Euro në muaj gjithsej 34 fëmijë të subvencionuar;
- ✓ Lipjani në periudhën, janar-prill 2024 gjithsej janë liruar nga pagesa 20 fëmijë; dhe
- ✓ Komuna e Vushtrrisë ka subvencionuar 15 fëmijë me nga 40 Euro në muaj.
- ✓ MZHR, gjatë vitit 2023, në kuadër të implementimit të projekteve nga “THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTEVE/PROGRAMEVE TË OJQ-ve NË AVANCIMIN E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR, OJQ “Asociacioni i Gruas Feminae” ka realizuar trajnimin me temën, “Përgatitja e grave për tregun e punës “ trajnim i cili u mbajti në kuadër të projektit “Potenciali i grave dhe vajzave për një të ardhme të fuqishme”. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë dhe zyrtari i MZHR-së i cili është në monitorimin të OJQ-ve, si dhe OJQ “Tourism & Marketing Institute” ka realizuar trajnimin me temën, “Roli i shoqatave të grave në stimulimin e ndërmarrësisë “ trajnim i cili u mbajti në kuadër të projektit “Zhvillimi socio-ekonomik i grave dhe rritja e bashkëpunimit në nivele lokale”;
- ✓ Përmes Thirrjes në Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB- Biznese) nga MZHR në vitin 2023 në total kanë përfituar 132 Projekte ku prej tyre kanë përfituar 45 gra dhe 87 burra.
- ✓ Komuna e Klinës filloi ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për personat e moshuar; dhe Komuna e Suharekës është në proces të ndërtimit të 3 qendrave;
- ✓ Në komunën e Suharekës në vitin 2023 është ndërtuar qendra për fëmijët me autizem dhe sindromin Down;
- ✓ Në Skenderaj është ndërtuar një qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara. OJQ-Hendikos-Skenderaj ka përfituar nga ZBGJ 1600€. OJQ-Frymëzimi-Skenderaj ka përfituar nga ZBGJ 1600€. Në projektin “Transformimi i shoqërisë përmes ndërgjegjësimit të të rinjve për të drejtat e njeriut”;

- ✓ Ministria e Drejtësisë: LIGJI NR. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, është miratuar nga Kuvendi me 14 dhjetor 2023 , si dhe ka hyre ne fuqi me 5 janar 2024;
- ✓ Gjatë këtij viti KPSHSF me mbështetjen e OJQ-ve, SOS Fshatrave te Fëmijëve dhe QKRMT, ka Certifikuar 30 trajner qe ndërlidhen me Modulet e validuara nga AKK;
- ✓ Këshilli/Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e te Mbijetuarve te Torturës (QKRMT), në Durrës, Shqipëri me Modul-Trajnimin: “Puna me Imigrant, Refugjatë, Rikthyer, Riatdhesuar” në Kosovë, i cili modul ju është dedikuar zyrtarëve Institucional, te QPS-ve, në nivel te Kosovës, në përbërje prej 10 grupeve, nga 25 kandidat, që deri me tani në këtë vite është përfunduar me (6) gjashtë grupe të trajnimit, ku janë trajnuar 132 zyrtarë, punëtor social te QPS-ve, ndërsa edhe me katër grupe tjera do te vazhdohet në vitin 2024, që gjithsej duhet te trajnohen 200 zyrtarë te QPS – ve, dhe 50 te ZKK-ve.
- ✓ Nga pesë modul-trajnimet e Organizuara nga Këshilli me mbështetjen Organizatës Save dhe Children, janë trajnuar 330 ofrues te shërbimeve sociale familjare nga sektori publik dhe sektori joqeveritar, ndërsa ne total nga gjashtë modulet 462 profesionist, me 79 ditë trajnimi;
- ✓ Trajtime lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale u organizuan nga komuna e Gjilanit; Skenderajt dhe Vitisë;
- ✓ Komuna e Suharekës për vitin 2023 subvencionoi 14 biznese të grave me nga 2,000 Euro;
- ✓ Në Rahovec në vitin 2023 Drejtoria e Ekonomisë ka nënshkruar marrëveshje për subvencionimin e 19 bizneseve në komunën e Rahovecit, ku 11 prej tyre ishin biznese artizanale që menaxhohen nga gratë;
- ✓ Komuna e Skenderajt ka mbajtur një takim informues me gratë e fshatit Kryshec ku kanë marr pjese 20 gra.
- ✓ Në vitin 2023 nga mbështetja financiare në fushat e Shkencës, Teknologjisë Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM), janë përkrahur 1,882 studente vajza/gra nga 1000 Euro. Shuma totale është 1.882.000 Euro. 70 bursa në drejtimet deficitare dhe drejtimet teknike në vlerë 500 Euro për një vit shkollor (30 për nxënëse/vajza të drejtimeve teknike kurse 40 nxënës/ djem në drejtime deficitare). Shuma totale e pagesës 35.000 Euro;
- ✓ Komuna e Suharekës në vitin 2023 ofroi bursa për 206 vajza dhe 64 djem të gjitha drejtimet;

- ✓ Prizreni në vitin 2024 ndau 150 bursa për shkollim universitar prej tyre në fakultete teknike 26 përfitues të bursave dhe
- ✓ Skenderaj ndau 110 bursa për djem dhe vajza;
- ✓ U mbajt konferenca STEMinsts'24 për gratë dhe vajzat në shkencë/promovimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës. Takime në MASHTI me gra të suksesshme në karrierë dhe nxënëse të klasave të nënta, me qëllim të motivimit për përfshirjen e vajzave në profile të ndryshme profitabile dhe zhvillimore;
- ✓ Aktivitete u realizuan nga komuna e Malishevës; Gjilanit, dhe Prishtinës;
- ✓ MBPZHR përmes skemës Kombëtare e mbështetjes/subvencionet në Bujqësi, që synon të përfitojnë mbi 70 mijë fermerë në Kosovë, duke përfshirë 8 masa të ndryshme;
- ✓ Komuna e Malishevës organizoi panairin “Dyert e hapura të shkollës” për të inkurajuar nxënësit e klasave të nënta për regjistrim në shkollat profesionale;
- ✓ Komuna e Gjilanit subvencionoi 128 gra ndërmarrëse, nga të 40 të komuniteteve pakice, në total vlera e subvencioneve 40,800 Euro;
- ✓ Me mbështetjen e UN Women, analiza gjinore specifike sektoriale në sektorin e bujqësisë në komunat e synuara u krye e shoqëruar me sesione ndërgjegjësuëse. Në nivel lokal, 50 gra fermere dhe zyrtare komunale në vitin 2023 mësuan për rëndësinë e sigurimit të mjeteve për gratë për të përmirësuar agrobiznesin e tyre dhe për të kuptuar sesi dixhitalizimi mund të hapë dyert për mundësi të reja ekonomike. U prodhuan një (1) video për sensibilizimin e grave fermere - duke shfaqur tre gra fermere që morën pjesë në seminare mbi AI dhe dixhitalizimin, ku ata fituan aftësi për të përdorur teknologji inovative për rritjen e biznesit të tyre. Kjo video thekson se si mbështetja e UN Women, e marrë përmes analizave gjinore specifike për sektorin, i ka fuqizuar këto përfituese. Videoja u transmetua në mediat kryesore dhe u shpërnda në platformat zyrtare të mediave sociale të UN Women, duke arritur mbi 600 shikues.
- ✓ Në vitin 2023, OSBE promovoi histori suksesi të grave në biznesin në Kosovë në biznes. Detajet mund të gjenden këtu: https://www.osce.org/mission-in-kosovo/540107?fbclid=IwAR3y-OaImm7esXIVcqb58vmsrBFeMvq5Fvn0wdQ_ZYYcMnnYOGZru6QGKWw;

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 dhe janar-prill 2024

- ✓ ABGJ ka mbështetur Komisionin Parlamentar për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione lidhur me mbajtjen e punëtorisë për Amendamentimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore;
- ✓ ABGJ ka mbështetur me punëtori Grupin Punues për Barazi Gjinore, në kuadër të Këshillit të Presidentes për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Qëllimi i punëtorisë ishte prezantimi i metodologjisë për amendamentimin e legjislacionit në fuqi në frymën e LBGJ -se;
- ✓ ABGJ ka mbajtur takim me Zyrtaret për Barazi Gjinore në nivelin lokal dhe qendror si dhe ka ndare mirënjohje për ZBGJ tashme të pensionuara. Gjatë takimit u prezantuan të dalurat nga raporti i monitorimit për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore si edhe u prezantua Plani i punës së ABGJ për vitin 2023.
- ✓ ABGJ ka mbajtur 2 punëtori për Zyrtaret për barazi gjinore në nivelin lokal dhe qendrorë për rishikimin dhe harmonizimin e planeve të punës 2023 me Planin e Veprimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj grave, si dhe koordinimi i aktiviteteve që do të mbahen në kuadër të 16 Ditë të Aktivizimit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas dhe dhunës në baza gjinore 50 pjesëmarrës;
- ✓ Komuna e Gjilanit trajnoi 12 zyrtarë komunal;
- ✓ 50 asambleistë nga 16 komuna të synuara janë trajnuar për të analizuar buxhetet, politikat dhe strategjitë lokale përmes një këndvështrimi gjinor. Përmes një sërë punëtorish të ndihmuara nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe të mbështetura nga UN Women, anëtarët e kuvendit u angazhuan në diskutime rreth rolit të tyre jetik në promovimin e qeverisjes së mirë dhe barazisë gjinore në proceset e vendimmarrjes lokale, e cila është veçanërisht e rëndësishme për miratimin e Komunës. Task Forcat e Buxhetit dhe Planifikimit (MBPTF) dhe Planet e Veprimit Gjinor (GAP) në komunat e synuara;
- ✓ ABGJ organizoi trajnimin në Ministrinë e MPHI pjesa e Infrastrukturës, Agjencia për Barazi Gjinore/ ZKM në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrtaren për Barazi Gjinore në MMPHI (pjesa e Infrastrukturës) temë *“Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës”*;

- ✓ U realizuan trajnime dhe aktivitete të tjera për ngritjen e kapaciteteve për integrimin gjinor në politika publike, në nivelin qendror dhe lokal nga Ministria e Infrastrukturës (mbështetur nga Eco Kos Women); Drenas, Malishevë, Istog, Fushë Kosovë, Prishtinë, Suharekë, Prizren, Skenderaj, Vushtrri;
- ✓ Në mbështetje të UN Women 17 komuna kanë politika dhe praktika për të integruar VNGJ dhe zbatimin e BPGJ-së. Gjatë vitit 2023, 65 zyrtarë lokalë në 17 komunat e synuara, përfshirë nënkryetarët e komunave, drejtorët e buxhetit, zyrtarët financiarë dhe zyrtarët e barazisë gjinore, të mbështetur nga Ministria e Administratës Lokale, janë pajisur me trajnime dhe mentorim specifik. Gjithashtu, në nivel qendror dhe në nivel lokal, pikave lokale gjinore u është ofruar trajnim për mbledhjen, monitorimin dhe vlerësimin e të dhënave gjinore;
- ✓ Në vitin 2022, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës miratoi Strategjinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 2022–2028. Strategjia synon të sigurojë barazi gjinore dhe të mbrojë të drejtat e të gjithë grupimeve në bujqësi dhe zhvillim rural;
- ✓ Komuna e Prizrenit në vitin 2023 , me vendim të Kryetarit të Komunës është formuar grupi punues për hartimin e Planit Komunal për Barazi gjinore dhe janë mbajtur katër takime punuese që në periudhën janar-prill kanë vazhduar edhe me punëtori dy ditore ku është përgatitur Draft Plani i cili në maj do të shkon në Konsultim publik;
- ✓ UN Women ka ofruar ekspertizë teknike për ABGJ dhe 15 iniciativa të mëdha janë ndërmarrë në vitin 2023: në 11 korniza (5 udhëzime administrative, një koncept dokument, 3 projektligje dhe një ligj). Kornizat më të rëndësishme ligjore: projektligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe ligji për tregtinë e jashtme; kornizat e politikave të zhvillimit: 4 (3 draft programe kombëtare dhe një draft strategji). Draft-programi më i rëndësishëm: Programi kombëtar i Kosovës për Shkencë dhe Kërkim;
- ✓ ABGJ: në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), në muajin nëntor ka organizuar takimin e rregullt konsultativ vjetor të nivelit të lartë, të gjashtin me radhë, me akterë institucional, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile. Këtë vit takimi fokusohet në përkushtimin e Kosovës drejt procesit të Integritimit Evropian nga perspektiva gjinore. Qëllimi i këtij takimi konsultativ është zhvillimi i një diskutimi të hapur dhe thelbësor mbi sfidat e avancimit të barazisë gjinore. Është i domosdoshëm analizimi kritik i përpjekjeve të akterëve të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, partive politike, mediave dhe komunitetit ndërkombëtar, në kuadër të procesit të integritetit evropian, në veçanti në procesin e zbatimit të MSA-së;

- ✓ ABGJ realizoi punëtori koordinuese me projektin mbështetës për ABGJ Gender Equality Facility –financuar nga BE dhe implementuar nga UN WOMEN. Transporti 1262.40 Euro;
- ✓ MBPZHR në vitin 2023, kanë qenë 6 (gjashte), Koncept Dokumente, në të gjitha është e integruar perspektiva gjinore ndërsa, ne vitin 2024 janë 5 (pesë) Koncept Dokumente, ku gjithashtu është në integrim e sipër perspektiva gjinore;
- ✓ OSBE Ofroi komente të përgjegjshme gjinore për projektligjin për të rinjtë, projektligjin për të huajt, projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore, dhe draftin e Udhëzimit Administrativ për shoqërimin e të burgosurve;
- ✓ UN Women mbështeti realizimin e studimit të i fizibilitetit të MFP i kryer, ekspertizë teknike e ofruar për ABGJ dhe MLFT;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes hartoi Rregulloren (MM) Nr.09/2023 për Kodin Disiplinor të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kodin e Etikës (MM) Nr.08/2023 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në periudhën Janar-Prill 2024, MM ka qenë pjesë e grupit punues në hartimin e Koncept Dokumentit për Ministrinë e Mbrojtjes dhe të gjitha rekomandimet tona dhe të ABGJ-së janë inkorporuar në Koncept Dokument;
- ✓ ABGJ: Me vendimin e Qeverisë 05/172/2023; 08/11/2023 është themeluar Komiteti Drejtues për mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit “Instrumenti për Barazinë Gjinore” (Gender Equality Facility) në kuadër të programit IPA 2021/4. 20/11/2023 Në kuadër të Projektit Gender Equality Facility, Output 1 është realizuar Aktiviteti 1.1: Vlerësimi / diagnostifikimi funksional i mekanizmit gjinor të Kosovës përballë kërkesave për integrim në BE: qëllimi i aktivitetit është: ‘Kryerja e një vlerësimi/diagnostikimi funksional të mekanizmit gjinor të Kosovës kundrejt kërkesave për integrim në BE. Vlerësimi do të ofrojë njohuri dhe rekomandime të detajuara për funksionalizimin efektiv të mekanizmit të barazisë gjinore dhe rolin dhe angazhimin e tij në proceset e anëtarësimit në BE. ABGJ në vitin 2023 ka lansuar Projektin: Gender Equality Facility (GEF). Janë mbajtur dy trajnime: 1. Integrimi gjinor ne Integrimin ne BE. 2. 17/10/2023 Është realizuar punëtorja ‘Integrimi gjinor në integrimin në BE – sesion fillestar’, objektivat kryesore është zhvillimi i njohurive, aftësive dhe kapaciteteve të pjesëmarrësve për t’u angazhuar në integrimin gjinor të harmonizuar me BE-në; si dhe identifikimin e nevojave specifike të kapaciteteve të nëpunësve civilë për integrimin gjinor në proceset e integritit në BE.

- ✓ Dragashi në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore kemi realizuar një trajnim një ditor për 25 shërbyesit civil me temë :”Ngacmimi seksuale në vendin e punës si dhe mënyrat e raportimit të saj; komuna e Gjilanit ofroi trajnime për ngritjen e kapaciteteve për 12 shërbyes civil të trajnuar; Prishtina mbajti një trajnim;
- ✓ ABGJ 2024: në bashkëpunim me zyrtaren për barazi gjinore ne komunën e Fushë Kosovë ka organizuar punëtorinë për Buxhetimin Gjinor. Në këtë punëtori ishin prezent zyrtar nga Komuna e Fushë Kosovës të cilët u njoftuan për rëndësinë e BPGJ, për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e proceseve buxhetore;
- ✓ UN Women: mbështeti MF përmes ofrimit të ekspertizës lokale; Prezantimi i Pasqyrës së Buxhetit; Propozimi i dispozitave gjinore të Ligjit të Prokurimit;
- ✓ ABGJ- ka mbështetur themelimin e Rrjetit të Grave në administratë publike në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, duke financuar 2 punëtori. Me qëllim të fuqizimit të rolit të grave në administratë publike dhe inkurajimit për të aplikuar për pozita vendimmarrëse, shkëmbimit të përvojave dhe ndarjes së sfidave. Morën pjesë 51 pjesëmarrëse;
- ✓ UN Women: përmes ekspertizës teknike duke përfshirë (logjistikë, CN, Axxhenda) mbështeti organizimin e seminarit me gra deputete; Workshopi do të zhvillohet në shtator/tetor 2024;
- ✓ Drenas: Tryezë e rrumbullakët "Avancimi i njohurive financiare" organizuar nga DZHE-Drenas dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ku janë certifikuar 23 pjesëmarrëse gra;
- ✓ Komuna e Suharekës me rastin e 8 marsit janë promovuar 2 gra në sport të cilave ju është ndarë edhe mirënjohje;
- ✓ Komuna e Vitisë ka vendosur 13 kioskë në një hapësirë publike të qytetit, ku u ka ofruar mundësinë bizneseve të grave që të shesin produktet që kanë në fushë veprimtarinë e bizneseve të tyre;
- ✓ Gjatë vitit 2023 dhe 2024 u organizuan panairë vendore dhe ndërkombëtare të ndërmarrjeve në pronësi të grave nga komuna e Malishevës, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Lipjanit, Prishtinës, Rahovecit, Shtimes, Vitisë, Skenderajt;
- ✓ MBPZHR: Vizite studimore ne Republikën e Hungarise, organizuar nga organizata ndërkombetare CNVP. Qellim i vizites studimore ishte pjesëmarrja në ngjarjen e

organizuar nga Unioni i Grave ne Hungari, per ditën Nderkombetare te Grave Rurale ne patronazh te Ministrise se Bujqesise ne Hungari, si dhe bashkepunimi institucional publik te Kosoves;

- ✓ Në kuadër të thirrjes në Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB-Biznese) - për vitin 2023 në total kanë përfituar 132 Projekte ku prej tyre kanë përfituar 45 gra dhe 87 burra;
- ✓ MZHR, gjatë vitit 2023, në kuadër të implementimit të projekteve nga “Thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve/ programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, OJQ “Asociacioni i Gruas Feminae” ka realizuar trajnimin me temën, “Përgatitja e grave për tregun e punës “ trajnim i cili u mbajt në kuadër të projektit “Potenciali i grave dhe vajzave për një të ardhme të fuqishme”. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë dhe zyrtari i MZHR-së i cili është në monitorimin të OJQ-ve, si dhe:
- ✓ OJQ “Tourism & Marketing Institute” ka realizuar trajnimin me temën, “Roli i shoqatave te grave në stimulimin e ndërmarrësisë “ trajnim i cili u mbajte në kuadër të projektit “Zhvillimi socio-ekonomik i grave dhe rritja e bashkëpunimit në nivele lokale”;
- ✓ Panairë janë organizuar nga komuna e Malishevës, Hanin e Elezit, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Skenderaj, Vushtrri;
- ✓ Informimi lidhur me mundësitë e përfitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural u ofrua në komunën e Gjilanit; Kaçanikut, Fushë Kosovës, Prishtinës, Suharekës, dhe Vushtrrisë;
- ✓ Mbështetjet për gratë në bujqësi ofruan komuna e Dragashit (mbështetje për sera, fidanë - sistemin pikë-pikë);
- ✓ Aktivitete informuese / senzibilizuese për pjesëmarrjen e grave fermere në Shërbime Këshilluese u organizuan nga komuna e Dragashit, Malishevës, Gjilanit, Lipjanit, Prishtinës, Suharekës, Rahovecit, dhe Shtimes;
- ✓ Trajnime në fushën e bujqësisë u organizuan nga komuna e Shtimes me temat: sigurime bujqësore me bletarët dhe me kryetar të këshillave lokale; angazhimi i gruas në sektorin e bujqësisë; trajnim me fermerë për shfrytëzimin racional të ujit; trajnim për shfrytëzimin e resurseve natyrore për mjedis dhe zhvillim ekonomik;

- ✓ UN Women mbështeti Panairin e bujqësisë në Gjakovë dhe ai në Prishtinë i organizuar nga ECOKOS i mbështetur nga UN Women në Ditën Ndërkombëtare të Grave në zonat rurale mbledhën 50 gra fermere dhe më shumë se 2,000 vizitorë;
- ✓ UN Women mbështeti raportin tematik të auditimit me temën “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës u prezantua dhe rekomandimet u ndanë me vendimmarrësit kryesorë;
- ✓ UN Women në vitin 2023: Njëzet e katër (24) inspektorë të punës, gjashtë (6) gra dhe tetëmbëdhjetë (18) burra, nga rajone të ndryshme të Kosovës forcuan të kuptuarit e tyre për dallimet gjinore në SSHP dhe ngacmimet seksuale në mjediset e punës, të mbështetur nga UN Women dhe të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe i miratuar nga Inspektorati i Punës. Modulet e trajnimit ishin në përputhje dhe në mbështetje të strategjisë shumëvjeçare të trajnimit për Inspektoratin e Punës;
- ✓ Komuna e Prizrenit në vitin 2024 mbajti një punëtori nën udhëheqjen e Avokatit të Popullit mbi Shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve në sektorin publik dhe privat.
- ✓ Ministria e Drejtësisë në Projekt Kodin Civil, sipas librit të katërt përcakton se bashkëshorti nga bashkëjetesa trashëgon nëse bashkëjetesa ka zgjatur 5 vite, ndërsa në rast se kanë fëmijë nga bashkëjetesa 3 vite. Këta persona thirren në trashëgim sipas radhës së caktuar në këtë Kod;
- ✓ OJQ -Drugëza në Skenderaj ka përfituar 1,600 €.ne projektin Avancimi I grave në prone dhe fuqizimi i grave në tregun e punës;
- ✓ ABGJ propozoi për miratim Qeverisë vazhdimin e masës afirmative “Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë.” UA është vazhduar edhe për një vit prill 2023-prill 2024. Nga kjo masë afirmative për periudhën janar- dhjetor 2023 janë regjistruar 5,050 prona në emër të dy bashkëshortëve, ndërsa në total janë 17,592 çifte që kanë pronën në emër të përbashkët;
- ✓ Sesion informues lidhur me këtë masë afirmative në komunën e Gjilanit;
- ✓ U organizuan fushata vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë në komunën e Drenasit, Dragashit, Malishevës, Gjakovës; Istogut, Kaçanikut, Fushë Kosovës, Lipjanit, Suharekës, Prishtinës, Rahovecit, Shtimes, dhe Skenderaj-it’
- ✓ Aktivitet specifik për organizim në kooperativa u organizuan nga në Gjakovë në bashkëpunim me Care International;
- ✓ MBPZHR është duke përgatitur Koncept dokumentin për Kooperativat bujqësore, me grupin punues, i formuar nga MBPZHR. Komuna e Skenderaj ka organizua 3 trajnime dhe në vitin 2024 UNDP ka mbështetur 6 OJQ të do të ofrojnë trajnime për 50 të rinjë.

PËRMIRËSIMI I MIRËQENIES EKONOMIKE DHE SOCIALE

2020 dhe 2021:

- ✓ UN Women ka organizuar trajnimin për 10 përfaqësues nga Divizioni i Ndihmës Sociale dhe 40 përfaqësues nga Qendrat për Punë Sociale për ofrimin e shërbimeve sociale.
- ✓ Në vitin 2021, ABGJ përmes fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike në Maj të 2021 ka mbështetur 24 OJQ - organizata të grave, në vlerë prej 647.000.00 Eur. Përmes financimit të këtyre 24 OJQ janë mbështetur 1296 gra dhe vajza , nga të cilat përfituan 185 gra dhe vajza -persona fizik përfituan grante për zgjerim biznesi; 48 OJQ -organizata të grave - përfituan grante; 803 gra dhe vajza, janë trajnuar për hapje e bizneseve të reja, shitjen e produkteve online, marketingun e produkteve, themelimit të brendit, funksionalizimit të faqeve për shitje të produkteve të bizneseve individuale;
- ✓ Subvencionim i çerdheve nga komunat për 67 fëmijë të prindërve vetushqyes, me nevoja të veçanta dhe nga skemat sociale; Prishtinë 93 fëmijë; Mitrovicë e Jugut (11); Gjilan (5); Fushe Kosovë (21); Kaçanik (1); Skenderaj (8);
- ✓ ABGJ Gjatë vitit 2020, ka komentuar 30 ligje, ligje nënligjore dhe politika publike. Gjatë vitit 2021, ABGJ & VNGJ ka komentuar në 27 koncept dokumente, 12 projektligje, 9 udhëzime administrative, 4 draft rregullore dhe 3 strategji dhe plane veprimi. Në periudhën prill-qershor 2022, ABGJ ka dhënë komente në 10 udhëzime administrative, 1 koncept dokument dhe një dokument strategjik.
- ✓ ABGJ nga pako emergjente ka subvencionuar 18 kopshte në të cilat ishin përfitues 41 fëmijë nga skema sociale;
- ✓ Qendër rezidenciale ditore, për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara është ndërtuar në Vushtrri, komuna e Podujevës ka ofruar një ambient në objektin e komunës; Komuna e Mitrovicës ka ofruar në shërbim një objekt për shërbime ditore për personat me aftësi të kufizuara; në kompleksin social në Gjilan është ndërtuar edhe qendra rezidenciale për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara; Komuna e Skenderajt është në fazën përfundimtare të përfundimit të qendrës rezidenciale dhe rehabilituese për personat me nevoja të veçanta; në Kaçanik është ofruar një ambient në objektin e shtëpisë së kulturës nga komuna si hapësirë me e përshtatshme për aktivitete;
- ✓ ABGJ 2020.Financimi i 115 kopshteve private dhe partneritet publiko privat përmes fondit të rimëkëmbjes ekonomike shtator 2020-vendimi I Qeverisë.108 nga 115 çerdhet udhëhiqeshin nga gratë ndërsa numri i grave të punësuar në këto kopshte ishte 1,145 gra dhe 65 burra;
- ✓ Mbështetje përmes banimit social dhe bonus banimit (për raste sociale dhe të dhunës në familje) në komunën e Vushtrrisë, Suharekë, Prishtinë, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Istog, Gjakovë;

- ✓ Zyra e BE-së, përmes IOM-it nga viti 2020 dhe që do të vazhdojë për 30 muaj, mbështet krijimin e një shoqërie multietnike përmes stabilitetit socio-ekonomik dhe zhvillimit komunitar, duke siguruar qasje të barabartë dhe (ri)integrim të qëndrueshëm. Me kosto shtesë prej 2,460,000 Euro, projekti fokusohet në mbështetjen e bizneseve familjare të drejtuar nga gra dhe nismave komunitare;

2022:

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ Është miratuar Koncepti i dokumentit për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor në vitin 2022;
- ✓ Komuna e Gjilanit me donatorë nga Kuvajti ka realizuar ndërtimin e kompleksit social ku është ndërtuar edhe qendra rezidenciale për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe pa përkujdesje sociale. Mirëpo, qendra ende nuk është funksionalizuar;
- ✓ Komuna e Vitisë ka ndarë lokacionin për ndërtimin e një qendre rezidenciale për personat e moshës së tretë pa përkujdesje familjare (projekti në vazhdim); Podujevë; Komuna ka ndarë parcelën dhe një pjesë të buxhetit për ndërtimin e kësaj qendre në bashkëpunim me OJQ, Jetimat e Ballkanit-Halil Kastrati;
- ✓ Për shërbime për personat me aftësi të kufizuara: Gjakovë: Komuna e Gjakovës e ka subvencionuar Handakosin në Gjakovë me vlerë prej 20.000 Euro, ku të njëjtin objekt iu ofron shërbime edhe për 3 shoqata me persona me aftësi të kufizuara.
- ✓ Në Suharekë është ndërtuar objekti i ri i, "HANDIKOS" nga firma ndërtimore "EURO ING".
- ✓ Në Prishtinë në përfundim është edhe qendra për personat me dowe syndrom dhe autizëm;
- ✓ Në Prizren është funksionalizuar Qendra për strehimin dhe ofrimin e shërbimeve për persona me të meta mendore;
- ✓ Në Viti, Kuvendi i Komunës ka ndarë lokacionin për ndërtimin e një objekti rezidencial për personat me aftësi të kufizuara mendore, qëndrim 24 orë ndërsa komuna e Podujevës: Komuna ka ndarë një zyrë ku kjo kategori i kryen aktivitetet ditore për persona me nevojë të veçanta;
- ✓ Gjatë periudhës korrik 2022 deri në dhjetor 2023 ka realizuar 18 aktivitete - ligjërata edukative, me nxënës të ciklit të ulët fillor, të mesëm 8 dhe 2 aktivitete edukative e ligjërata me studentë. Është mbajtur edhe Java Ndërkombëtare e Parasë, 1 qershor dhe

Dita Ndërkombëtare e fëmijëve dhe 31 tetori Dita Botërore e Kursimeve ku kanë marrë pjesë rreth 470 nxënës e studentë. BQK ka përgatitur dhe shpërndarë materiale edukative gjatë tërë kohës rreth 50 materiale dhe rreth 24 materiale te reja edukative, informuese, broshura apo studime. Gjithashtu ka shpërndarë materialet (librat edukativë) tek nxënësit në gjuhën shqipe, në gjuhën rome dhe në gjuhën boshnjake. Janë organizuar 3 gara (konkurse), për Ese, për nxënës të shkollave të mesme dhe janë përzgjedhur në qershor 2023 – 7 nxënës fitues, prej tyre 2 vajza e 5 djem, ndërsa në konkursin e fundit (çmimet janë ndarë me 11 janar 2024) – janë përzgjedhur 10 çmime fituese prej tyre 7 vajza e 3 djem. Me qëllim të nxitjes së hulumtimeve mes ekonomistëve të rinj të Kosovës, BQK ka krijuar mundësinë e dhënies së një çmimi për studimin më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj. Në vitin 2022 dhe 2023 janë shpallur gjashtë fitues të çmimeve për vitin 2022 tri studente gra dhe gjithashtu në vitin 2023 tri gra, gjithsej 6 punime fituese;

- ✓ Finalizimi i Projekt ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- ✓ Është akredituar Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), me tri (3) kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve: Bashkëpunëtor Profesional të Punës Sociale; Profesionist i Punës Sociale dhe Këshillimit, dhe Menaxher i Mirëqenies Sociale dhe janë validuar 24 module. Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, në bashkëpunim me Institutin e Psikologjisë ka ofruar trajnime për katër (4) module, ku janë trajnuar mbi dyqind (200) ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori publik dhe ai privat. Trajnime për punëtorët social të Qendrave për Punë Sociale janë ofruar edhe nga komunat;

2023 dhe 4 muajt e vitit 2024:

- ✓ Fushata vetëdijësuese për respektimin e kuotës të punësimit për personat me aftësi të kufizuar dhe evitimin e stigmatizimit në shoqëri u mbështetën nga Komuna e Prishtinës dhe Skenderaj-it. Komuna e Skenderaj-it ka hartuar Planin lokal të veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- ✓ Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare është miratuar nga Kuvendi me 14 dhjetor 2023 , si dhe ka hyrë në fuqi me 5 janar 2024;
- ✓ Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale Familjare, është themeluar me vendimin Nr.25 të datës 25.01.2023 nga Ministria e Drejtësisë në përbërje të 21 anëtarëve, që ka për mandat zhvillimin e profesionistëve ofruesve të shërbimeve sociale familjare dhe i cili është përgjegjës për të gjitha çështjet nga fusha e shërbimeve sociale familjare në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi;

- ✓ Gjatë vitit 2024 në bazë të vendimit Nr. 01/131 të dt.31.03.2023, Këshilli është Akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit për periudhën tri vjeçare me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, janë validuar 24 Module Trajnimi;
- ✓ Janë mbajtur trajnime të punëtorëve social për zbatimin e standardeve minimale të shërbimeve sociale në komunën e Drenasit, Dragashit, Malishevës, Gjakovës, Suharekë, Skenderaj, Viti;
- ✓ OSBE organizoi punëtori informuese për trajner mbi vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje;
- ✓ Ministria e drejtësisë organizoi trajnim “Puna me viktimë të dhunës në familje, trajtimi dhe referimi”;
- ✓ Medica Kosova organizoi trajnim me temën “Të kuptuarit të traumës dhe efekteve të ndërlidhur me dhunën në baza gjinore”;

2020 dhe 2021:

Organizatet e tjera, disa nga aktivitetet në kuadër të Shtyllës së Parë të PKBGJ-së

- ✓ Gjatë vitit 2020 dhe 2021 RrGK ka publikuar raportet hulumtuese: Nga Ligjet në Vepra; Më shumë zgjedhje përmes politikave miqësore për familjen; Një ulës në tryezë; Pandemia nuk njeh Gjini; dhe “Monitorimi i zbatimit të indikatorit 5.c.1 (Buxhetimit Gjinnor) të Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë;
- ✓ Në bashkëpunim me GIZ-in është realizuar hulumtimi lidhur me efikasitetin edhe efektivitetin e masave aktive të tregut të punës.
- ✓ RROGRAEK 2021 ka realizuar një studim lidhur me gjendjen e punësimit të grave dhe vajzave nga Komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptian në komunat e Pejës, Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Gjakovës;
- ✓ Në vitin 2021, UNFPA në partneritet me Rrjetin e Grave të Kosovës lansoi raportin “Zgjerimi i zgjedhjeve përmes politikave miqësore ndaj familjes” pasqyron shkallën në të cilën Kosova e ka harmonizuar kornizën me Direktivën e Bashkimit Evropian (BE) për balancën e punës dhe jetës. Raporti përmban tabelën e transpozimit për Direktivën e BE-së 2019/1158 në Aneksin 1;
- ✓ MFPT me mbështetje me UNDP në vitin 2021, përmes Programit Aktiv të Tregut të Punës ka zhvilluar manualin operativ për avancimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës sociale në komuna në përputhje me kornizën ligjore për MFPT/ Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjeve (DSPF); Udhëzimin Administrativ për llogaritjen e shumës mujore të Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për Procedurat Administrative për kthimin e pagesave nga përfituesit e Skemës së Ndihmës

Sociale; Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për pagesën e ndihmës së njehershme të ndihmës sociale; Udhëzimin Administrativ për llogaritjen e shumës mujore të Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për Procedurat Administrative për kthimin e pagesave nga përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për pagesën e ndihmës së njehershme sociale;

- ✓ RROGRAEK 2021: Janë ndare 5 grante te vogla për gra dhe vajza te komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian, për të filluar biznese vetanake, nga shtëpia si përgatitje e ëmbëlsirave -2 grante, fotografe-2 grante dhe një rrobaqepëse;
- ✓ Agjencionit Kosovar për Eficiencë të Energjisë/projekti për Eficiencë të Energjisë, Millenium Foundation Kosova kanë përfituar grante për Eficiencë të Energjisë; 410 gra, ndërsa 100 gra kanë përfituar praktikë profesionale në vitin 2021;
- ✓ Shoqata e Grave ne Sektorin e Energjisë-AËESK-u ka treguar sukses ne projektin për mbështetjen e vajzave për orientim në STEM përmes qendrave për orientim në karrierë. Anëtarët e shoqatës kanë mbajtur pesë ligjërata, në disa qytete te Kosovës në kuadër të projektit në muajt janar dhe shkurt të vitit 2020;
- ✓ MCC: Programi WEE- Women in Energy Entrepreneurs mbështeti 174 gra sipërmarrëse me asistencë teknike dhe grante për të ndihmuar në rritjen e bizneseve të tyre nëpërmjet përdorimit efikas të energjisë. Programi EES- Women in Energy Scholarship mbështeti 28 gra me bursa nga të cilat në vitin 2021, 26 përfituese të bursave u diplomuan dhe iu dhanë Diploma Associate në kolegjin DMAC, Iowa (SHBA) në lëndë të ndryshme të lidhura me energjinë. Ky grup grash fitoi diploma në fusha si teknologjia e erës, teknologjia diellore, teknologjia e rinovueseve, teknologjia e termocentraleve, prodhimi etj;
- ✓ WEI- Programi i praktikave të grave në energji gjatë kësaj periudhe mbështeti rreth 100 gra dhe vajza studente të larta dhe/ose të sapo diplomuara duke ofruar praktika me pagesë për 6 muaj në kompani dhe organizata të sektorit të energjisë.
- ✓ UN WOMEN, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, lansoi Task Forcën Joformale të Avokimit mbi Standardet e ndjeshme gjinore për sigurinë në punë, shëndetin dhe punën e denjë më 25 tetor 2021;
- ✓ UNDP në vitin 2021, përmes Programit Aktiv të Tregut të Punës ka zhvilluar manualin operativ për avancimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës sociale në komuna në përputhje me kornizën ligjore për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjeve (DSPF); Udhëzimin Administrativ për llogaritjen e shumës mujore të Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për Procedurat Administrative për kthimin e pagesave nga përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për pagesën e ndihmës së njehershme të ndihmës sociale; Udhëzimin Administrativ për llogaritjen e shumës mujore të Ndihmës Sociale; Udhëzimin Administrativ për Procedurat Administrative për kthimin e pagesave nga përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale;

Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për pagesën e ndihmës së njehershme sociale;

- ✓ Në vitin 2021, UNDP ka trajnuar 10 përfaqësues nga Divizioni i Ndihmës Sociale dhe 40 përfaqësues nga Qendrat për Punë Sociale;
- ✓ UNDP gjatë vitit 2021 ka ofruar mbështetje në rindërtimin, rehabilitimin dhe rinovimin për 11 qendra të kujdesit rezidencial të OJQ-ve (strehëza urgjente, shtëpi për të moshuarit dhe fëmijët e braktisur, strehimoret e grave, qendrat e rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara) përmes skemave të granteve të ofruara për OJQ-të;
- ✓ UNDP në vitin 2021, përmes praktikës në vendin e punës ka angazhuar 40 të sapo diplomuar në punë sociale, psikologji, sociologji dhe/ose fusha të ngjashme të angazhuar si vullnetarë të komunitetit të OKB-së në Qendrat për Punë Sociale në mbarë Kosovën;
- ✓ UN WOMEN ka ofruar Trajnime të Trajnerëve (ToT) mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor për 15 përfaqësues nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror, OJQ, konsulentë ku 15 pjesëmarrës, në dy sesione, morën trajnime të avancuara për BPGJ dhe do të ofrojnë trajnime.

2022:

Organizatat e tjera, disa nga aktivitetet në kuadër të Shtyllës së Parë të PKBGJ-së

- ✓ RrGK ka trajnuar 42 punëtorë të Strehimoreve për menaxhim të rasteve dhe “djegien/mbingarkesën profesionale”;
- ✓ RrGK dhe Institucioni i Avokatit të Popullit realizuan fushatë vetëdijësuese mbi ngacmimin seksual në tregun e punës;
- ✓ RrGK ka hartuar dy module ToT të cilat janë miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare. ToT: Puna me viktimat të dhunës në familje – trajtimi dhe referim; dhe Puna me viktimat e krimeve seksuale dhe trafikimit. RrGK ka trajnuar 15 punonjës social për dy modulet e akredituara: Puna me viktimat e dhunës në familje – trajtimi dhe referimi dhe Puna me viktimat e krimeve seksuale dhe trafikimit. RrGK ka trajnuar 186 anëtarë të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje që përfshijnë institucione të ndryshme lokale për Protokollin Shtetëror për Trajtimin e rasteve të dhunës seksuale;

- ✓ UN Women ka realizuar analizën e zbatimit të obligimit për buxhetim të përgjegjshëm gjinor që buron nga Qarkorja buxhetore e MFPT, rezultatet për 15 ministritë e përfshira u prezantuan në punëtori me përfaqësues të nivelit qendror dhe komunal;
- ✓ UN Women ka realizuar punëtori me 64 përfaqësues në nivel komunal duke përfshirë - zëvendës kryetarë, drejtorët e buxhetit, zyrtarët e barazisë financiare dhe gjinore dhe përfaqësues të Kuvendit Komunal - nga 16 komuna përmes tre seancave të punëtorisë që u zhvilluan në mars, qershor dhe nëntor të vitit 2022, forcuan kapacitetet e tyre mbi BPGJ dhe analizën gjinore. Në nëntor 2022, UN Women nënshkroi Memorandume mirëkuptimi me 16 komuna të Kosovës duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm drejt avancimit të paritetit gjinor duke vendosur hapa strategjikë përpara me qeverinë lokale në zbatimin e aktiviteteve të rëndësishme të fokusuara në Buxhetimin Përgjegjës Gjinore; Institucioni udhëheqës dhe mbështetës;
- ✓ Në vitin 2022, UN Women organizoi trajnim për ngritjen e kapaciteteve të 82 përfaqësuesve lidhur me parandalimin e ngacmimit seksual në vendin e punës; 10 gra ndërmarrëse, 36 zyrtarë publik të nivelit qendror dhe lokal dhe 31 përfaqësues të Qendrave të Arsimit Profesional dhe Qendrat e Kompetencës dhe 3 nga universitetet u trajnuar lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe ngacmimin dhe ngacmimin seksual;
- ✓ Gjatë vitit 2022, MCC nga Programi Gratë në Energji Praktika në Punë kanë përfituar 237 gra dhe vajza, ka ofruar 6 muaj praktikë në punë me pagë mujore prej 250 Euro në ndërmarrje të sektorit të energjisë. Po ashtu, nga Programi Gratë Ndërmarrëse në Energji, kanë përfituar 387 gra dhe vajza me grante në blerjen e pajisjeve të ndryshme për shfrytëzim eficient të energjisë për veprimtarinë e bizneseve të tyre;
- ✓ Organizata Gratë për Gratë ka ofruar trajnime për 629 gra pjesëmarrëse; ka përkrahur me grante 25 biznese/start-up të grave; dhe 500 gra janë organizuar në rrjetëzim, takime dhe diskutime për mundësitë e bashkëpunimit dhe zgjerimit të tregut;
- ✓ Organizata Gratë për Gratë ka organizuar trajnim për të drejtat pronësore për 5 shoqata të grave;
- ✓ UNDP ka ofruar trajnim për 221 gra (prej të cilave 84 janë gra të riatdhesuara) në përdorimin e arteve dhe zanateve tradicionale si mjete për të përmirësuar punësueshmërinë e tyre. Aktivitetet përfshinin trajnimin mbi dizajnin artizanale, promovimin, brendimin dhe identifikimin e mundësive të shitjes siç janë përshkruar në katalogun "Prodhimi i Artizanatit Efektiv - Gratë mund ta bëjnë atë" që shfaq punën e 24 grave, si dhe dokumentarin mbi "Dollama - veshja e nusërisë";

- ✓ UNDP ka mbështetur investime në infrastrukturën e 30 Qendrave për Punë Sociale dhe 11 qendrave rezidenciale u rehabilitua duke çuar në përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve të përqendruara në përfituesit, me këto të fundit shërbejnë mbi 2,000 persona;
- ✓ UNDP ka trajnuar 55 zyrtarë të punësimit dhe trajnimit profesional (30 gra dhe 25 burra) rritën njohuritë dhe aftësitë e tyre për të zbuluar stereotipat gjinore në profesione, paragjykimet gjinore dhe mënyrën e adresimit të tyre. Për Agjencinë e Punësimit të Kosovës është zhvilluar manuali për integrimin gjinor dhe anti-stereotipizim për të përfshirë perspektivën gjinore në trajnime dhe shërbime;
- ✓ UNDP ka mbështetur hartimin e 4 politikave kombëtare lokale me perspektivë gjinore: Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit në komunën e Fushë Kosovë; Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit në komunën e Obiliq; Ndryshimet klimatike Plani Ndërsektorial i Ndërhyrjes në Suharekë; dhe Zhvillimi për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike të Komunës së Prizrenit;
- ✓ Nga UN Women, u sigurua mbështetje e synuar për të rritur barazinë gjinore përmes fuqizimit ekonomik të grave. Gratë sipërmarrëse u mbështetën. 81 gra nga grupet e cenueshme dhe të mbijetuarit e dhuna në familje nga 3 komuna përfitojnë nga trajnime për të zgjeruar bizneset e tyre. 51 biznese të drejtura nga gra morën pajisje për të krijuar mundësi punësimi për të mbijetuarit nga dhuna në familje, gratë nga komunitetet jo-shumicë, gratë rurale, ata me aftësi të kufizuara, në agrobiznes, prodhim në shkallë të vogël dhe shërbime;
- ✓ Në mbështetje të UNDP-së Akselatori Boost x Kosovo mbështeti rritjen e aftësive të 32 prej të cilave 16 bizneseve të udhëhequra nga gra dhe ka ofruar grante të konsiderueshme prej 20,000 USD për 13 biznese që zotërojnë gra dhe të menaxhuara nga gra, të cilat përfituan nga programi i përshpejtimit të biznesit të gjelbër;
- ✓ Në mbështetje të UNDP-së u lansua skema e parë e mentorimit për ndryshimet klimatike për 28 studentë universitare (18 femra/10 burra), duke rritur njohuritë dhe interesin për mjedisin, ndryshimet klimatike dhe zhvillimin rural, dhe për të rritur përpjekjet për të përshpejtuar veprimet për klimën;
- ✓ Duke bashkëpunuar me UNFPA, u rritën njohuritë dhe aftësitë e 43 të rinjve (25 gra/18 burra) për të identifikuar dhe ndarë informacione të besueshme në rrjetet sociale, duke rritur rezistencën ndaj dezinformimit ndërsa 21 mësimdhënësve shkollave fillore (gra) përparuan njohuritë dhe aftësitë e tyre për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe dezinformacionit në internet punëtori hibrid.
- ✓ Në nëntor-dhjetor 2022, OSBE mbështeti dy trajnime të drejtpërdrejta për çështje lidhur me dhunën ndaj grave dhe qasjen në të drejtat e pronës, me pjesëmarrës 73 persona, përfshirë 72 gra dhe 1 burrë.

Tabela A 2: Progresi në realizimin e aktiviteteve në Objektivën strategjike 2

Nr.	Aktiviteti	2020 dhe 2021	2022	2023 dhe janar-prill 2024
II.2.1	Integrimi i studimeve gjinore në sylabuset e lëndëve dhe zhvillimi i lëndëve nga studimet gjinore në IAL	PO, UP/Fakulteti Ekonomik dhe Juridik	Gjithsej janë 17 lëndë me fokus gjininë në UP	Gjithsej janë 17 lëndë me fokus gjininë në UP
II.2.2	Hulumtim për integrim të perspektivës gjinore në të gjitha nivelet e arsimit formal.	PO	PO	PO
II.2.3	Integrimi i perspektives gjinore dhe eliminimi i stereotipeve gjinor në tekste shkollore dhe kurrikula në nivelin fillor dhe të mesëm	PO	PO	PO
II.2.4	Rritje e përfaqësimit të autoreve gra, dhe eksperteve gjinor, në përpilimin e teksteve, kurrikulave, dhe recensione.	PO	PO	PO
II.2.5	Zhvillim i programit i cili trajton dhunën në baza gjinore në shkolla	PO	PO	PO
II.2.6	Ofrimi i bursave për studime gjinore jashtë vendit për djem dhe vajza (Young Cell Scheme)	JO	JO	JO
II.2.7	Themelimi i fondit dhe programit për mbështetjen e komuniteteve (100 bursa për studime, përfshirë shpenzimet e strehimit, udhëtimi dhe materiale mësimore)	PO	PO	PO
II.2.8	Panaire mbi edukimin në karrierë për nxënësit, prindërit, dhe mësime dhënësit.	PO	PO	PO
II.2.9	Program vullnetar me student për mentorim për vajza dhe djem në nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë (thyerja e stereotipeve në profesione).	JO	PO	PO
II.2.10	Zgjerimi i shërbimeve orientuese dhe këshillim në karrierë në shkolla për vajza (Strategjia e komunikimit shkollë-prindër për orientimin në karrierë për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët 2018-2021)	PO	PO	PO
II.2.11	Monitorim i zbatimi i kuotave për regjistrimin e studentëve Rom, Ashkali, dhe Egjiptas	PO	PO	PO
II.2.12	Stimulimi i hapjes dhe akreditimit të institucioneve parashkollore private dhe qendrave me bazë në komunitet nga ana e komunave	Në proces	JO	JO
II.2.13	Hartim i standardeve dhe trajnim i stafit në Qendrat e Komuniteteve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve sociale dhe familjare për vajzat dhe gratë përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore të ofruesve publik dhe jo-qeveritar (në harmonizim me Strategjinë Sektoriale të MPMS 2018-2022)	JO	JO	JO
II.2.14	Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve për parandalimin e martesave të hershme.	PO	PO	PO
II.2.15	Fushata vetëdijësuese për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore me fokus te komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.	PO	PO	PO
II.2.16	Trajnime në Qendrat Mësimore në Komunitet për ofrim të shërbimeve arsimore dhe vetëdijësuese.	PO	PO	PO
II.2.17	Aktivitete vetëdijësuese dhe politika publike për t'i kontribuar parandalimit të braktisjes së shkollimit për vajza dhe djem në arsimin e mesëm të lartë, me fokus të komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptas	PO	PO	PO
II.2.18	Studim i fizibilitetit dhe identifikimi i formave alternative (të bazuara në shtëpi) për edukim parashkollor.	PO	PO	PO

II.2.19	Hartimi dhe përplotësimi i legjislacionit për zhvillimin e formave alternative për edukimin parashkollor	JO	PO	PO
II.2.20	Ndërtimi i objekteve për parashkollor/parafillor (Rezultati 2.8.2. Plani i Veprimit i PSAK)	PO	PO	PO
II.2.21	Fushatë vetëdijësuese për rritjen e shkallës së regjistrimit të fëmijëve në edukim parashkollor alternativë.	PO	PO	PO
II.2.22	Trajnim dhe inspektim për ngritjen e kapaciteteve për monitorim dhe vlerësim të edukimit parashkollor.	PO	PO	PO
II.2.23	Fushatë për të inkurajuar djemtë dhe burrat për të studiuar drejtimin parashkollor në institucionet e arsimit të lartë.	JO	PO	PO
II.2.24	Zhvillimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të performancës në arsimin e ulët dhe të mesëm (PSAK 7.9.2. për arsimin e lartë)	JO	JO	JO
II.2.25	Grante për të avancuar qasjen e vajzave dhe grave në grante hulumtuese dhe zhvillim profesional akademik	JO	JO	JO
II.2.26	Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin në shkollat profesionale dhe aftësimin profesional, me theks tek vajzat dhe gratë me nevoja të veçanta	JO	JO	JO
II.2.27	Fushatë vetëdijësuese për mundësitë e pjesëmarrjes në Arsim Profesional Joformal, në Shkolla Profesionale, dhe Programe të përsheptuara.	JO	JO	PO
II.2.28	Krijimi i kushteve për të ndjekur program të përsheptuar të shkollës fillore dhe të mesme, me veçanti për gratë Rome, Ashkali, dhe Egjiptase.	Ekziston baza ligjore	Ekziston baza ligjore	Ekziston baza ligjore
II.2.29	Trajnime të personelit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës	PO	PO	PO
II.2.30	Shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma burimore	Tashmë nuk ekziston koncepti i klasave të bashkangjitura. Fëmijët sistemohen në klasat e rregullta, apo sipas vlerësimeve profesionale, rekomandohen për Qendra burimore.	N/A	N/A
II.2.31	Fuqizimi i mekanizmave për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta-rritja e numrit të mësimdhënësve mbështetës	PO	PO	PO
II.2.1	Ndërgjegjësim i qytetarëve për të drejtat e tyre dhe qasjen në shërbime	PO	PO	PO
II.2.2	Krijimi i mundësive për gratë për avancim profesional dhe në karrierë në institucionet publike	PO	PO	PO
II.2.3	Përkrahje financiare për avancim profesional, infrastrukturë dhe ndërgjegjësim publik për ngritjen e pjesëmarrjes së vajzave grave në sport.	PO	PO	PO
II.2.4	Hartimi i politikave të reja, përplotësuese, për përfaqësim të barabartë gjinor në organizata mediatike dhe politika editoriale.	JO	JO	PO
II.2.5	Analiza të buxhetit me perspektivë gjinore në fushën e arsimit, shkencës, sportit, energjetikës,	PO	PO	PO

	kulturës, rinisë, diasporës, shëndetësisë, kthimit dhe komuniteteve.			
II.2.6	Hartim i modulit të trajnimit për media në trajtimin e: koncepteve bazike gjinore, LGBTI, dhunën dhe sigurinë në bazë të gjinisë, rrezikun e bartjes së armëve, nevojat e veçanta	PO	JO	PO
II.2.7	Krijim i sistem i monitorimit dhe raportimit për imazhin e grave (reprezentimet gjinore) në media.	JO	JO	PO
II.2.8	Krijimi i programeve edukativo-arsimore për edukim medial Program i trajnimit profesional për gazetarë në fushën e barazisë gjinore në nivelin e mesëm të lartë dhe IAL	JO	PO	PO
II.2.9	Program i trajnimit profesional për gazetarë në fushën e barazisë gjinore	JO	JO	PO
II.2.10	Program i trajnimit profesional për gazetarë në fushën e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm	JO	JO	PO
II.2.11	Aktivitete vetëdijësuese për organizatat mediale mbi LBGJ dhe Ligjin Kundër Diskriminimit	JO	JO	PO
II.2.12	Promovimi dhe mbështetja e grave krijuese	PO	PO	PO
II.2.13	Shërbime për gratë e moshës së tretë për përmirësimin e mirëqenies sociale të tyre	JO	JO	PO
II.2.14	Aktivitete kulturore dhe ekonomike në Qendra për të Moshuar	JO	PO KOMUNE 1	PO
II.2.15	Hulumtime mbi hapësirat publike, trashëgiminë kulturore, dhe gjininë	JO	JO	JO
II.3.1	Zgjerimi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë	PO	PO	PO
II.3.2	Integrimi i të dhënave në SISH për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijut	Në proces	Në proces	Në proces
II.3.3	Përmirësimi i cilësisë së metodologjisë për mbledhjen e të dhënave dhe raportimit për shtatëzënat dhe lehonat	JO	Në proces	Në proces
II.3.4	Trajnim për ngritje të kapaciteteve profesionale për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojave specifike shëndetësore të femrave dhe meshkujve	PO	PO	PO
II.3.5	Vaksina HPV të futet në listën esenciale të barnave	PO	PO	PO
II.3.6	Vaksinim universal i fëmijëve	Jo të gjithë 73% (38% e fëmijëve që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian)	MSH NUK KA RAPORTUAR	MSH NUK KA RAPORTUAR
II.3.7	Ndërgjegjësimi i popullatës për shëndetin riprodhues dhe seksual	PO	PO	PO
II.3.8	Trajnimi i harmonizuar i mësimdhënësve në shkollat promovuese të shëndetit për shëndetin riprodhues dhe seksual	PO	PO	JO
II.3.9	Trajnim dhe ndërgjegjësim i mediave për informimin e qytetarëve për çështjet shëndetësore (shëndet riprodhues, të ushqyerit me qumësht gjiri, të ushqyerit e shëndetshëm, edukatë seksuale) dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë për raportim etik dhe profesional të çështjeve shëndetësore	JO	JO	JO
II.3.10	Fushata të vazhdueshme të sensibilizimit të popullsisë për shëndetin riprodhues dhe seksual.	PO	PO	JO
II.3.11	Hartimi dhe zbatimi i pakos informuese për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues për shkollat fillore dhe të mesme	PO	PO	PO
II.3.12	Akreditim i programit të trajnimit për	PO	PO	PO

	mësimdhënësit mbi shëndetin riprodhues (tri nivelet)			
II.3.13	Amandamenti i Ligjit për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri dhe promovim i ushqyerjes me gji dhe të ushqyerit e shëndetshëm, me theks te veçantë për grupet e ndjeshme	JO	JO	JO
II.3.14	Zhvillimi i një hulumtim mbi praktikat e planifikimit familjar dhe abortit selektiv	JO	Në proces	Në proces
II.3.15	Fushata vetëdijësuese për të rinjtë/të rejtat për: rrezikun e bartjes së armëve, veprimeve të rrezikshme në komunikacion, abuzimin e substancave psikotrope, alkoholit, duhanit	PO	PO	PO
II.3.16	Fushatë edukativo-shëndetësore për parandalimin dhe trajtimin e TBC-në	PO	PO	PO
II.3.17	Aktivitetet vetëdijësuese për shëndetin mendor (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, seksualitetin, substancat narkotike, etj.)	PO	PO	PO
II.3.18	Trajnim i stafit mjekësor për ofrim të shërbimeve me ndjeshmëri gjinore dhe trajtimin të barabartë të personave LGBTI.	PO	PO	JO
II.3.19	Akt nënligjore për rritjen e numrit të psikologëve në shkolla	JO	JO	Në proces
II.3.20	Akt nënligjor për rritjen e numrit të mjekëve në shkolla.	JO	JO	JO
II.3.21	Krijimi i linjës ndihmëse telefonike falas dhe avancim i platformave elektronike me staf profesional për të rinjtë (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, identiteti seksual, substanca narkotike, etj.)	PO	PO	JO
II.3.22	Realizimi i aktiviteteve vetëdijësuese mbi faktorët e ndotjes së mjedisit natyror dhe të ndërtuar dhe efektet shëndetësore	PO	PO	PO
II.3.23	Hulumtim i politikave mbi zhvillimin e sektorit të energjisë, mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore, me perspektive gjinore	JO	JO	JO

Në kuadër të shtyllës së Zhvillimit Njerëzor Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore, janë arritur këto rezultate:

ARSIMI, 2020 dhe 2021 Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ Gjatë vitit 2020 gjatë procesit të botimit të teksteve të reja MASHTI ka organizuar sesion informues me të gjithë recensentët (të cilët kanë pranuar edhe manualin) rreth respektimit të barazisë gjinore në tekstet shkollore si dhe parandalimit të stereotipave në tekstet shkollore.
- ✓ ABGJ: Manuali për parandalimin e stereotipave gjinore në tekstet shkollore i hartuar dhe është realizuar videospoti televiziv⁴².
- ✓ MASHTI e ka të hartuar informatorin shkollos për procedura e standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje e që çdo vit shkollos u ka shpërndarë shkollore dhe në secilin vit kemi mbajtur sesione informuese në shkollë në lidhje me rolin e sektorit arsimor në parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje;
- ✓ Komunitetët kanë organizuar aktivitete lidhur me dhunë në familje, duke i informuar për raportimin, institucionet përgjegjëse dhe shërbimet e disponueshme për rastet e dhunës në familje.
- ✓ Gjatë vitit 2020, ABGJ ka mbështetur me 10,185 Euro dy OJQ të cilat kanë punuar me të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, dhe të mbijetuarat e dhunës ndaj grave, duke financuar iniciativat për fuqizim ekonomik, inicim dhe zhvillim të bizneseve të vogla për të dy kategori të mbijetuarave të dhunës. OJQ Medica Kosova është mbështetur me 5,485 Euro për fuqizim ekonomik të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës dhe OJQ Mundësia për fuqizim ekonomik të mbijetuarave / gra të mbijetuara të dhunës) në vlerë prej 4,700 Euro.
- ✓ Gjatë vitit 2021 ABGJ nga buxheti vetanake ka financuar /subvencionuar projektet /programet e 4 OJQ-ve në vlerë totale prej 40,000 Euro të kontribuojnë në: Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore përmes realizimit të programeve trajtuese psiko sociale të dhunuesve/abuzuesve, ofrimin e këshillimeve psikologjike përmes telefonit për të gjitha kategoritë në nevojë që kanë shqetësime emocionale dhe psikologjike sidomos nën efektin e situatës së pandemisë COVID 19. Strehimorja Gjilan OJQ- Liria është mbështetur me 12.000 Euro për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetje në inicimin e bizneseve /sigurimi i pajisjeve për biznes, për të mbijetuarat e dhunës të cilat ishin përkohësisht të strehuara në strehimore. Strehimorja e Gjakovës - OJQ "Shtëpia e Sigurt" Gjakovë është mbështetur me 8.500 Euro (janë financuar seanca këshillimi / trajtimi psiko-social të dhunuesve, dhe është financuar themelimi i linjës telefonike falas për ofrimin e këshillimit falas për gra dhe vajza për Komunitetin e Gjakovës). Këshillim për parandalim - OJQ SIT Qendra për Këshillime Sociale dhe

⁴² <https://www.youtube.com/ëatch?v=8Psop7rehgo>

Hulumtime në vlerë prej 14.500 Euro. Janë ofruar 25 seanca këshilluese për djem/burra -kryerësit e dhunës dhe me probleme të dhunës; po ashtu është projektuar dhe dizajnuar platforma për këshillim online “ KËSHILLIM PËR PARANDALIM” e para e llojit të tillë në Kosove dhe rajon, e funksionalizuar në dhjetor 2021 <https://sitandtalk.org/>. Është financuar fletushka me informacione të detajuara se ku mund të kërkojnë ndihmë burrat dhe djemtë të cilët dhe manifestojnë sjellje të dhunshme apo kanë probleme zemërimi, ndryshimit të sjelljes dhe qëndrimeve të kryerësve të dhunës. Qendra për informim dhe përmirësim social -Linja e jetës u mbështet me 14 500 Euro- këshillim shërbime psikologjike falas online nga ora 14:00-02:00.

- ✓ MASHTI gjatë vitit 2021 ka përkrahur 24 kandidatë për bursë të doktoratës në vlerë prej 5,000 Euro (gjithsej 100,000 Euro) për studentët që studiojnë në 500 universitet me të mira të botës, prej tyre 10 vajza);
- ✓ MASHTI ka nda 500 bursa çdo vit për komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptian në vlerë 150,000;
- ✓ ABGJ ka realizuar videospotin televiziv “Parandalimi i ngacmimit seksual në vendin e punës⁴³
- ✓ Komunitat që kanë raportuar për zbatimin e PKBGJ-së kanë realizuar aktivitete informuese me vajza dhe gra lidhur me të drejtat e tyre dhe barazinë gjinore.
- ✓ Në vitin 2020 dhe 2021 ka filluar ndërtimi i rreth 20 institucioneve parashkollore por vetëm një numër i kufizuar i tyre janë finalizuar dhe funksionalizuar;
- ✓ Është rritur numri i mësuesve mbështetës (p.sh. në Gjakovë 7 mësues mbështetës, 5 në Suharekë).
- ✓ MASHTI: Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me partnerët kemi realizuar 3 analiza për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme si: me Bankën Botërore kemi realizuar analizën “Nxjerrja e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private dhe të partneriteteve publiko-private për edukim parashkollor në Republikën e Kosovës”. Me UNICEF-in Zgjerimi i edukimit parashkollor në Kosovë - Një instrument model për llogaritjen e projeksioneve si bazë për zgjerimin e infrastrukturës parashkollore në Kosovë. Me UNICEFIN - është realizuar studimi i Fisibilitetit të Kopshteve Modulare për rritjen e qasjes në Edukimin e Hershëm në Kosovë;
- ✓ Është ndërtuar një çerdhe (në Vrellë-Istog) dhe janë adaptuar 2 shkolla në kopshte për fëmijë (në Çifllak-Viti dhe në Zhegër-Gjilan). Po ashtu në 4 shkolla të reja të kryera janë kryer edhe 5 klasa për parafillor (në Gramaçel-Deçan; Uçë dhe Llukavc-Istog , Batllavë-Podujevë);

⁴³ <https://www.youtube.com/ëatch?v=3sE29it9dyU>

- ✓ MASHTI ka bashkë organizuar konferencën ndërkombëtare për shëndetin, mirëqenien edukimin dhe të drejtat e fëmijës, ku seanca dhe hulumtime të veçanta prezantohen për edukimin parashkollor;
- ✓ Janë trajnuar 48 mësimdhënës të qendrave burimore përdorimin e instrumentit për vlerësimin pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta në komuna. Trajnimi është bërë nga projekti i INCLUDE i Këshillit të Evropës dhe janë trajnuar 10 trajnerë për zbatimin e programit të trajnimit për arsim gjithëpërfshirës. Programi ka 10 module. Janë trajnuar 73 mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ultë në 10 modulet e programit për arsim gjithëpërfshirës. Trajnimet janë duke u bërë në 25 shkollat, cilat do të mbështeten nga projekti i Këshillit të Evropës "INCLUDE";
- ✓ Në mbështetje të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar, në 2022 janë punësuar 103 asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuar;
- ✓ ABGJ me mbështetje të Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung ka identifikuar libri "The Economics of Gender" nga autorja Joyce .P. Jacobsen, si tekst universitar. 230 kopje te librit donacion per UP/FE; 20 kopje per Fakultetin Filozofik, dhe 5 Bibliotekës Kombëtare Universitare si edhe 10 Bibliotekës Hivzi Sylejmani ne Prishtine. Po i njëjti është prezantuar nga ABGJ ne Tirane dhe per nevojat e Fakultetit Ekonomik Tirane u dhuruan 30 kopje dhe në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut;
- ✓ OSBE, me buxhet prej 1,910 Eurosh (tetor – dhjetor 2021), mbështeti një fushatë ndërgjegjësimi për dhunën në familje për nxënësit e shkollave. U shpërndanë 10,000 broshura në gjuhën shqipe dhe serbe, dhe oficerët e PK-së nga njësi për DV vizituan 29 shkolla në 14 komuna të Kosovës, duke mbajtur ligjërata për nxënës nga komunitetet shqiptare, rome, egjiptiane dhe ashkali.
- ✓ Komuna e Skenderaj ka organizuar aktivitete informuese lidhur me drejtat dhe qasjen në shërbime dhe ndihmë juridike falas;
- ✓ Në periudhën maj-qershor 2021, OSBE ka mbështetur pesë sesione informuese për standardet e Konventës së Stambollit dhe rolin e institucioneve arsimore, duke përfshirë mbi 90 përfaqësues nga shkollat dhe drejtori të arsimit nga Prizreni, Peja, Ferizaj, Skenderaj dhe Obiliqi, me një buxhet prej 4,430 Euro. Gjithashtu, u organizuan punëtori pesë-ditore mbi "Barazinë Gjinore në Arsim dhe Sfidat e Stereotipave Gjinore në Tekstet Shkollore," ku morën pjesë mbi 80 mësues të shkollave fillore të larta nga pesë komuna, duke u trajnuar për barazinë gjinore dhe parandalimin e stereotipave në arsim.

2022

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ MASHTI: Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me partnerët kemi realizuar 3 analiza për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme si: me Bankën Botërore kemi realizuar analizën “Nxjerrja e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private dhe të partneriteteve publiko-private për edukim parashkollor në Republikën e Kosovës”. Me UNICEF-in Zgjerimi i edukimit parashkollor në Kosovë - Një instrument model për llogaritjen e projeksioneve si bazë për zgjerimin e infrastrukturës parashkollore në Kosovë. Me UNICEFIN - është realizuar studimi i Fisibilitetit të Kopshteve Modulare për rritjen e qasjes në Edukimin e Hershëm në Kosovë;
- ✓ Është ndërtuar një çerdhe (në Vrellë-Istog) dhe janë adaptuar 2 shkolla në kopshte për fëmijë (në Çifllak-Viti dhe në Zhegër-Gjilan). Poshtu në 4 shkolla të reja të kryera janë kryer edhe 5 klasa për parafillor (në Gramaçel-Deçan; Uçë dhe Llukavc-Istog , Batllavë-Podujevë);
- ✓ MASHTI ka bashkë organizuar konferencën ndërkombëtare për shëndetin, mirëqenien edukimin dhe të drejtat e fëmijës, ku seanca dhe hulumtime të veçanta prezantohen për edukimin parashkollor;
- ✓ Janë trajnuar 48 mësimdhënës të qendrave burimore përdorimin e instrumentit për vlerësimin pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta në komuna. Trajnimi është bërë nga projekti i INCLUDE i Këshillit të Evropës dhe janë trajnuar 10 trajnerë për zbatimin e programit të trajnimit për arsim gjithëpërfshirës. Programi ka 10 module. Janë trajnuar 73 mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulta në 10 modulet e programit për arsim gjithëpërfshirës. Trajnimet janë duke u bërë në 25 shkollat, cilat do të mbështeten nga projekti i Këshillit të Evropës “INCLUDE”;
- ✓ Në mbështetje të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar, në 2022 janë punësuar 103 asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuar;
- ✓ ABGJ me mbështetje të Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung ka identifikuar libri “The Economics of Gender” nga autorja Joyce .P. Jacobsen, si tekst universitar. 230 kopje te librit donacion për UP/FE; 20 kopje per Fakultetin Filozofik, dhe 5 Bibliotekës Kombëtare Universitare si edhe 10 Bibliotekës Hivzi Sylejmani ne Prishtine. Po i njëjti është prezantuar nga ABGJ ne Tirane dhe për nevojat e Fakultetit Ekonomik Tirane u dhuruan 30 kopje dhe në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut;
- ✓ ABGJ ka zhvilluar dhe postuar videos spotin për të drejtën trashëgimorë dhe institucionet përgjegjëse për inicimin e procedurës se trashëgimisë.

2023 dhe 2024

- ✓ MASHTI e ka përkrahur hulumtimin mbi gjuhën e përdorur në tekste shkollore. Institucioni i Avokatit të Popollit (IAP) ka realizuar dhe publikuar raportin Ex-officio për gjuhën e përdorur në tekstet mësimore të arsimit fillor. Fatbardhësisht raporti është pozitiv, ka konstatuar që tekstet nuk janë diskriminuese
- ✓ Barazia gjinore është pjesë integrale e Kurrikulës së Kosovës, pjesë e programeve dhe e teksteve shkollore. dhe të mesëm të ulët (1-9), në gusht të vitit 2023 (janë trajtuar telkstet e lëndëve: Gjuhë shqipe, Histori, Shoqëria e mjedisi, Edukatë qytetare. Fatbardhësisht raporti është pozitiv, ra është konstatuar që tekstet nuk janë diskriminuese. Tutje, IAP ka adresuar emalin njoftues që të njëjtin hulumtim do ta vazhdojnë edhe për tekstet e klasave 10, 11 dhe 12, të lëndëve: Gjuhë Shqipe, Letërsi, Histori, Sociologji, filozofi, Psikologji, Edukatë Qytetare;
- ✓ MASHTI ka angazhuar projektin KosEd për shqyrtimin e teksteve dhe fillimisht janë shqyrtuar tekstet e gjuhës shqipe dhe të matematikës nga klasat 1-9. Tekstet në mënyrë të veçantë janë shikuar edhe nga aspekti gjinor. Tashmë raportet janë përfunduar me rekomandime dhe pritet të adresohen. Tutje pritet të vazhdohet trajtimi edhe teksteve në lëndët tjera;
- ✓ Gjatë vitit 2023 e kemi hartuar pakon e moduleve për mësimdhënës Mbrojtjen e fëmijës. Një prej moduleve është Promovimi i barazisë gjinore, parandalimi i dhunës në familje. Janë mbajtur sesione Informuese me mësimdhënës dhe koordinatorë të cilësisë të shtatë regjioneve;
- ✓ Komunitat kanë organizuar aktivitete vetëdijësuesë nëpër shkolla lidhur me dhunën në familje dhe dhunën në bazë gjinore;
- ✓ Komuna e Prizrenit ofroi 10 bursa për studime jashtë vendit në SHBA, bashkëfinancim;
- ✓ 55 studentë të komuniteteve romë, ashkali, dhe egjiptianë përfitues të bursave për vitin akademik 2023/2024 kanë përfituar nga 1 mijë Euro. Shuma totale e pagesës 55.000 Euro. MASHTI ka planifikuar 100 bursa për studentet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ndërsa ka pasur pak aplikime);
- ✓ MASHTI në vitin 2023 ka angazhuar 20 mësimdhënës mbështetës në SHFMU dhe në IP, ndërsa në 3 muajt e vitit 2024 janë punësuar 4 mësimdhënës mbështetës. Në total kemi 24 mësues mbështetës të angazhuar;
- ✓ Komunitat kanë organizuar panairë për edukimin në karrierë;

- ✓ Komuna e Suharekë në vitin 2023 ndau bursa për 1,903 nxënës, 961 djem dhe 942 vajza;
- ✓ Modulet e shërbimeve në karrierë janë të përfshira në Kurrikulën e Kosovës duke filluar prej fëmijërisë së hershme deri gjimnazet dhe shkollat profesionale;
- ✓ Në bazë të UA për masat afirmative për komunitetet për regjistrimin e tyre në institucionet e arsimit të lartë parashihet kuota për lehtësimin dhe regjistrimin e tyre. Në UA parashihet kuota prej 12 % në çdo fakultet, gjithashtu kuotë e veçantë është edhe në konvikte, Qendra e studentëve;
- ✓ Në vitin 2023 Komuna e Fushë Kosovës realizoi një fushatë për ndërgjegjësimin e martesave të hershme dhe dy fushata u organizua në Komunën e Prishtinës;
- ✓ OSBE: Në bashkëpunim me MESTI-n, Misioni organizoi një sesion informues për parandalimin e martesave të hershme. Në seancë u mbledhën 21 përfaqësues (19 gra) të Këshillit të Prindërve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në komunën e Gjakovës;
- ✓ Në bashkëpunim me MASHT OSBE organizoi një sesion informues për parandalimin e martesave të hershme. Në seancë u mbledhën 21 përfaqësues (19 gra) të Këshillit të Prindërve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në komunën e Gjakovës që njëkohësisht janë bashkëpunëtor të rregullt të MASHTI kanë organizuar fushata fetëdijësuese për komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian;
- ✓ Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me partnerët kemi realizuar 3 analiza për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme si: Me Bankën Botërore kemi realizuar analizën “Nxjerrja e kostove të ofrimit të modaliteteve publike, private dhe të partneriteteve publiko-private për edukim parashkollor në Republikën e Kosovës”. Me UNICEF-in Zgjerimi i edukimit parashkollor në Kosovë - Një instrument model për llogaritjen e projeksioneve si bazë për zgjerimin e infrastrukturës parashkollore në Kosovë. Me UNICEFIN - është realizuar studimi i Fizibilitetit të Kopshteve Modulare për rritjen e qasjes në Edukimin e Hershëm në Kosovë. Të tri këto analiza, janë financuar nga partnerët;
- ✓ Është hartuar Projektligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Ky Ligj ka kaluar në diskutim paraprak dhe në diskutim publik. Ligji është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ky Projektligj, ka parapare zhvillimin e formave alternative për zgjerimin e formave të organizmit që ofrojnë edukimin në fëmijërinë e hershme;
- ✓ MASHTI ka raportuar se gjatë vitit 2023 janë ndërtuar 2 çerdhe dhe vazhdon ndërtimi i 19 çerdheve. Janë adaptuar 3 objekte të shkollave në çerdhe dhe vazhdon adaptimi i 7 shkollave në çerdhe;

- ✓ Pas miratimit të Ligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme, MASHTI, në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF-in, ka organizuar konferencë për prezantimin e ligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme. dhe pas miratimit të Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, MASHTI ka formuar grupin punues për hartimin e udhëzimeve administrative që dalin nga ky Ligj dhe sa i përket rritjes së shkallës së përfshirjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme, në kemi draftuar udhëzimin administrativ për përfshirjen e fëmijëve në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe po ashtu kemi hartuar udhëzimin administrativ për format e organizimit të edukimit në fëmijërinë e hershme të cilat sipas ligjit të ri janë të shumta e të cilat kanë për synim rritjen e përfshirjes në këtë nivel edukimi siç janë: Institucionet parashkollore publike, Institucionet parashkollore private, dhe ato me partneritet publiko-privat. Në mbështetje të rritjes së përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel edukimi, Ligji ka parapare edhe forma tjera të organizimit siç janë: Institucionet me baze në komunitet, Organizimi i institucioneve parashkollore brenda institucioneve qendrore, lokale apo korporatave të ndryshme dhe format tjera alternative që organizohen në bashkëpunim me komunën. Shkalla e regjistrimit të fëmijëve në edukimin parashkollor pritet të rritet edhe me bërjen obligative të klasës para fillorë moshës 5-6 vjeç të fëmijëve e vendosur kjo në dispozitat kalimtare të ligjit për EFH, dispozite kjo që hyjnë në fuqi në vitin shkollor 2024\2025. Në vitin 2024, në kuadër të fushatës vetëdijësuese për rëndësinë e investimit në moshën e hershme, MASHTI në bashkëpunim me Caritasin Zvicëran dhe fakultetin e Edukimit në Prishtinë, kanë filluar përgatitjet për organizimin e një konferencë kombëtare e cila do të trajtojë “Politikat dhe Cilësinë në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme”;
- ✓ MASHTI, ka hartuar kurrikulën për edukimin në fëmijërinë e hershme, e cila në muajin shkurt të vitit 2024, ka filluar pilotimin në 10 komuna në 12 institucione parashkollore dhe në 17 klase para fillorë. Kurrikula e re është hartuar për nivelin 0 të edukimit dhe përfshinë moshën 0-6 vjeç. Në kuadër të pilotimit të këtij dokumenti të kurrikulës për EFH, i cili konsiderohet si dokumenti bazë për rritjen e cilësisë në edukimin e hershëm, është hartuar dokumenti bazë dhe dy udhëzues praktik për punën në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme. Për këtë proces, është hartuar plani i procesit të pilotimit, janë aftësuar 11 trajner për trajnimin e edukatorëve për pilotimin e kurrikulës për EFH. Janë trajnuar 186 pjesëmarrës për pilotimin e kurrikulës për EFH. Pjesë e këtij trajnimit kanë qenë edukatorët e institucioneve parashkollore në 10 komuna dhe nga 12 institucione parashkollore dhe nga 17 klase para fillorë nga këto komuna. Pjesë e trajnimit përveç edukatoreve kanë qenë edhe drejtorët, stafi profesional i kopshtit, koordinatorët e cilësisë dhe zyrtarët komunal të arsimit. Trajnimi i kurrikulës ka zgjatur 4 ditë dhe është organizuar për 8 grupe. Janë përgatitur edhe dokumentacionin pedagogjik për procesin e pilotimit për kopshtet në pilotim. Janë aftësuar për kurrikulën e re 13 Inspektor të Arsimit – të cilët veprojnë në 10 komunat ku po pilotohet kurrikula. Mentorimin e punës në pilotim të Kurrikulës për EFH- po e realizojnë trajnerët. Tash më janë realizuar mentorimet e para dhe kemi përgatitur raport për të gjitha këto mentorime. Janë trajnuar gjithashtu 10 monitoruese për procesin e kurrikulës për EFH\ Studente të fakultetit të edukimit.

- ✓ ABGJ ka vazhduar bashkëpunimin m Fakultetin Ekonomik për zhvillimin e lëndës së Ekonomiksit Gjinor duke e përkthyer librin e dytë "Hyrje e avancuar e Ekonomiksit Feminist" nga autorja Joyce P. Jacobsen, si tekst universitar e cila do te ndihmoj studentet qe ta ndjekin lëndën me literature aktuale profesionale në gjuhën shqipe. ABGJ ka te drejtën autoriale, te autores prof. Jacobsen, libri është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe, për nevojat e Universitetit te Prishtinës në 200 kopje. Kjo iniciativë u mbështet nga Institutit Kombëtar Demokratik (NDI);
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me NDI ka organizuar: *"Shkollën Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikën"* me program 5 ditor ku janë certifikuar 30 studente 18 deri 29 vjeç;
- ✓ ABGJ ka mbështetur Universitetin e Prishtinës " Hasan Prishtina" në hartimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2023/4- 2025/6 te Universitetit te Prishtinës. Po i njëjti është miratuar nga Senati i UP, është publikuar dhe promovuar;
- ✓ Në mbështetje të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në 2023 MASHTI ka punësuar 126 asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Totali i të punësuarve për dy vite është 286;
- ✓ Ministria e Punëve të Brendshme ka lansuar fushatën ndërgjegjëse kundër të shtënave festive "Festo me zemër, jo me armë";
- ✓ MPB në mbështetje të Bashkësisë Islame të Kosovës, në të gjitha xhamitë e Kosovës është mbajtur ligjërata me temë "Që gëzimet tona të mos shndërrohen në tragjedi", kushtuar mospërdorimit të armëve gjatë ahengeve familjare.
- ✓ Komuna e Malishevës gjatë vitit 2023 në bashkëpunim me PK - realizoi 17 ligjërata, duke përfshirë te gjitha shkollat, më temat: "siguria rrugore si një e drejte dhe përgjegjësi per te gjithë"; "delikuenca e te miturve, dhuna ne baza gjinore"; Droga, duhani, alkooli"; Mbrojtja nga trafikimi me qenie njerëzore. Aktivitete u realizuan edhe nga komuna e Prishtinës, Klinës, Rahovecit, Vitisë;
- ✓ Komuna e Prishtinës organizoi aktivitet ,50 nxënës lidhur me bullizmin, ngacmimet seksuale ,substancat narkotike;
- ✓ Në vitin 2023 OSBE organizoi punëtori për mësimdhënës nga 59 shkolla të mesme për trajtimin e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual;
- ✓ Është në proces të shqyrtimit dhe rishikimit të Udhëzimit Administrativ MASHT nr 34/2014 Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkolla;
- ✓ Zyra e BE-së nga viti 2023-2026 ka ndarë 214,700 Euro, ku përmes Qendrës për Edukim në Kosovë, synon të promovojë dinjitetin, respektin dhe politikën kundër diskriminimit në shkolla dhe shoqëri. Përfitues deri me tani janë rreth 5,000 nxënës të moshës 15-18 vjeç nga 15 shkolla, autoritetet lokale nga 10 komuna dhe publiku i gjerë, me të rinjtë e Kosovës si përfitues përfundimtarë.

SPORTI 2020 dhe 2021

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë vitit 2020, nga fondi emergjent kanë ofruar mbështetjen si në vijim:

- ✓ Klube të femrave gjithsej 91 me vlerë buxhetore 442,750.00 Euro;
- ✓ Klube të përziera ne bazë të raporteve te Federatave , klubet e femrave kanë përfituar 134,640 Euro (30% i totalit të ndare në vlerë 448,800);
- ✓ Në vitin 2020 MKRS ka ndarë buxhet të veçantë për avancimin e femrave në sport, rreth 15% e totalit të kodit të subvencioneve;
- ✓ Departamenti i Sportit në kuadër të politikave programore të vitit 2020 për kundër që ka ndarë buxhet të veçantë për femra sipas politikës nr.1 më rreth 380,000 Euro ka dizajnuar programe dhe mundësi të përfitimeve edhe në të gjitha politikat programore të Departamentit të Sportit;
- ✓ Gjatë vitit 2020, nga fondi emergjent ka ofruar mbështetjen për 91 klube me vlerë buxhetore 442,750 Euro dhe 134,640 Euro për klube të përziera;
- ✓ Në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike të vitit 2021, MKRS ka ndarë 118,500 Euro për 38 sportiste gra dhe janë mbështetur edhe 42 klube të vajzave në vlerë prej 150,979 Euro;
- ✓ Komuna e Suharekës ka krijuar 5 fusha rekreative-sportive për gratë dhe fëmijët e tyre;
- ✓ Komuna e Gjilanit ka realizuar projektin në fushën e sportit “Barazia gjinore ne Sport” Debat i organizua me te rinjtë dhe profesionistet e fushës, me teme “Pasioni s’ka gjini”. Financuar nga DKRS dhe realizuar nga ZBGJ dhe OJQ Gruaja Hyjnore.

2022

- ✓ Në vitin 2022, nga 40% e fondeve të MKRS për klube kanë qenë klube të grave ndërsa nga thirrjet e veçanta individuale kategorizimi, shpërblimet, bursat, lëndimet dhe mobiliteti ishin gjithsej 61 përfituese gra me vlerë prej 310,266 Euro (nuk e kemi gjetur të dhënë për gjithsej mbështetjen për ta gjetur përfitimin në %);
- ✓ Përmes subvencionimit të ABGJ-së, QKSGJ ka realizuar hulumtimin “Gratë dhe vajzat ne fushën e sportit: hulumtimi mbi stereotipat gjinore dhe barrierave qe pengojnë qasje te barabarte ne sport”;

- ✓ ABGJ ka realizuar dhe shfaqur videospotin: Parandalimi dhe trajtimit i ngacmimit seksual ne sport;
- ✓ Komuna e Deçanit, Prishtinës, Malishevës, dhe Skenderajt kanë mbështetur klubet sportive të grave;
- ✓ Komuna e Dragashit, Suharekës, Prizrenit, Shtimes dhe Lipjanit në mbështetje të UN Women ka realizuar analizën gjinore në Drejtorinë e Artit te Kulturës Rinisë dhe Sportit.

2023 dhe 2024

- ✓ MKRS ofroi mbështetje financiare për ngritje të kapaciteteve profesionale në sport për 6 vajza dhe gra përmes thirrjes publike. MKRS mbështeti publikimin e 1 libri dhe 2 dokumentarëve për promovimin e vajzave dhe grave në sport. Krijimi i platformës dhe udhëzuesit për sport të sigurt dhe mbështeti mbajtjen e 36 kampionateve shtetërore për vajza dhe gra. Buxheti për këto aktivitete ishte 242,924.00 Euro;
- ✓ Komuna e Malishevës në vitin 2023 ka përkrahur 5-Klube te Vajzave ne sport;
- ✓ Komuna e Gjilanit ka përkrahur Klubin e Volejbollit - “Drita” vajzat Kampion i Kosovës;
- ✓ Në Komunën e Prizrenit janë mbajtur 5 tryeza të rrumbullakëta, 55 gara sportive;
- ✓ Komuna e Hanit të Elezit mbështeti s 7 klube, ne mesin e tyre edhe klubi i volejbollit te vajzave.

GRATË NË MEDIA,

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ ABGJ: realizimi i studimit ‘Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2016-2019’;
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, me Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe UN EOMEN ka nënshkruar deklaratë të përbashkët me transmetuesin publik RTK për luftimin dhe parandalimin e seksizmit.

2023 dhe 2024

- ✓ Lënda e edukimit medial zhvillohet në të gjitha shkollat e mesme të larta në lëndët ekstrakurrikulare;
- ✓ Trajnim me gazetarë mbi Raportimin e Ndjeshëm Gjinator. Pjesëmarrës në trajnim ishin gazetarë të mediave kombëtare dhe lokale;
- ✓ Prizren ka mbajtur një cikël të trajnimit/certifikimit të realizuara në fushën e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm;
- ✓ ABGJ realizoi dhe shfaqti një videospot për: Gratë Krijuese që ndryshuan historinë;
- ✓ ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me dedikimin në kujtimin e grave krijuese, artiste profesoresha universitare dhe gazetare që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje dhe të cilat nuk jetojnë me''. Ku me këtë rast u organizuan 3 panele diskutimi me gratë krijues, profesoresha universitare dhe gazetare. Konferencën e ndoqën pjesëmarrës;

KULTURA,

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ ABGJ ka mbështetur me 10,000 Artpolis për financimin e shfaqjes teatrale.
- ✓ Gjatë vitit 2021 përmes thirrjes publike, MKRS ka mbështetur 2 OJQ të udhëhequra nga gratë në vlerë prej 13,000 Euro (nga gjithsej 56,000 të mbështetjes);
- ✓ MKRS, ka mbështetur 2 gra me total 4,300 (nga mbështetja totale prej 18,700);
- ✓ Në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike, MKRS për kulturë ka mbështetur 8 OJQ të grave në vlerë prej 29,400 Euro (nga vlera totale prej 82,600 Euro) dhe 4 projekte në vlerë prej 31,000 Euro (nga gjithsej 169,000 Euro);
- ✓ Nga MKRS 10 gra krijuese janë mbështetur me 25,800 Euro (nga shuma totale prej 71,100 Euro);
- ✓ MKRS ka mbështetur 5 gra në vlerë prej 12,900 Euro nga vlera totale prej 63,240 Euro;
- ✓ MKRS ka mbështetur 10 OJQ të udhëhequra nga gratë për aktivitete projekte në vlerë prej 82,000 Euro (nga totali prej 153,000 Euro);

- ✓ Në kuadër të thirrjes së rregullt, MKRS ka mbështetur 29 OJQ në udhëheqje të grave në vlerë prej 88,180 Euro nga total prej 281,530 Euro;
- ✓ Në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike në vitin 2021, MKRS ka mbështetur 37 gra në vlerë prej 83,697 Euro nga totali prej 284,007 Euro;
- ✓ Në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike 2020, MKRS me 19,500 Euro ka mbështetur për 7 gra në fushën e arteve pamore;
- ✓ Në vitin 2021 MKRS ka mbështetur 7 projekte individuale të grave në vlerë prej 42,145 nga gjithsej 108,648 Euro; 7 OJQ të udhëhequra nga gratë janë mbështetur në vlerë prej 62,000 Euro (nga gjithsej 202,000 Euro); dhe janë ofruar 3 bursa për studente në vlerë prej 31,806 Euro (nga totali prej 113,645 Euro);
- ✓ Në vitin 2020, MKRS ka mbështetur 13 OJQ të udhëhequra nga gratë në vlerë prej 62,000 nga vlera totale prej 206,000 Euro; 6 gra me shumën prej 27,500 Eur nga gjithsej 70,730 Euro.

2022

- ✓ Në vitin 2022, nga 40% e fondeve të MKRS për klube kanë qenë klube të grave ndërsa nga thirrjet e veçanta individuale kategorizimi, shpërblimet, bursat, lëndimet dhe mobiliteti ishin gjithsej 61 përfituese gra me vlerë prej 310,266 Euro (nuk e kemi gjetur të dhënë për gjithsej mbështetjen për ta gjetur përfitimin në %);
- ✓ Përmes subvencionimit të ABGJ-së, QKSGJ ka realizuar hulumtimin “Gratë dhe vajzat në fushën e sportit: hulumtimi mbi stereotipat gjinore dhe barrierave që pengojnë qasje të barabartë në sport”;
- ✓ ABGJ ka realizuar dhe shfaqur videospotin: Parandalimi dhe trajtimin e ngacimit seksual në sport;
- ✓ Komuna e Deçanit, Prishtinës, Malishevës, dhe Skenderajt kanë mbështetur klubet sportive të grave.

2023 dhe 2024

SHËNDETËSIA, 2020 dhe 2021

Qeveria e Kosovës: niveli qendror dhe lokal

- ✓ Gjatë vitit 2021, Ministria e Shëndetësisë në kuadër të programit të “vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë ” nga 22 komuna numri total i vizitave është 22,888; 19,182 vizitave shtëpiake për fëmijë; 3,695 vizita të grave shtatzëna dhe 813 vizita fëmijëve të komunitetit Romë Ashkali dhe Egjiptas;
- ✓ Në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, janë 20 komuna që kanë organizuar fushata vetëdijësuese;
- ✓ Vizita për nënat dhe foshnjat janë raportuar edhe nga komuna e Vushtrrisë, Gjakovës, Lipjanit, Mitrovicës, Gjakovës; Prishtinës; etj’;
- ✓ Disa komuna sikur ajo e Vushtrrisë kanë subvencionuar lehonat me nga një shumë prej 120 Euro dhe Suhareka nga 250 Euro për lehonë;
- ✓ ABGJ në kuadër të muajit tetor-muaji kundër kancerit të gjirit ka ndriçuar ndërtesën e Qeverisë me ngjyrë rozë dhe kordelen e bardhë, simbol i luftës kundër kancerit të gjirit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për kontrole parandaluese;
- ✓ Është mbajtur trajnimi për MISP (pako Minimale Iniciale për Shëndetin riprodhues në situatë emergjente- 17 trajnime me 290 profesionistë shëndetësor të trajnuar;
- ✓ Aktivitete informuese komunat(Gjakova, Prishtina) lidhur me vaksinimin, planifikimin familjar, kancerin e gjirit, kancerin e qafës së mitrës;
- ✓ Në vitin 2022 do të ofrohen 300 vaksina HPV, për herë të parë në Kosovë;
- ✓ UNFPA ka organizuar 45 trajnime të mësimdhënësve mbi Shëndetin Riprodhues dhe Edukimin Seksual Gjithëpërfshirës;
- ✓ Shënimi i ditës botërore të kontraceptive 2020-2021 me 1,750 përfitues;
- ✓ Shënimi i javës evropiane të testimit për HIV 2020-2021, përfitues 1,550;
- ✓ Shënimi i ditës botërore të AIDS-it 2020-2021, përfitues 2,050;
- ✓ ABGJ ka realizuar video spotin për kancerin e gjirit;

- ✓ Shënimi i ditës Botërore të Tuberkulozit;
- ✓ Në vitin 2020-2021 Ministria e Shëndetësisë organizoi Tryezat me 50 profesionistë shëndetësor të nivelit: udhëheqës i drejtorisë, shefa të njësive në kuadër QKMF-së, kryeinfermierë, koordinator i cilësisë me temën: Prezantimi i Ligjit për Mbrojtje nga diskriminimi;
- ✓ ABGJ ka realizuar dhe transmetuar video spotin ABGJ: Identifikimi i dhunës psikologjike;⁴⁴

2022

- ✓ Gjatë vitit 2022, Janar-Qershor në kuadër të programit të “vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë” nga 22 komuna numri total i vizitave është 22,888, numri i vizitave shtëpiake për fëmijë është 19,182 ndërsa numri i grave shtatzëna 3,695 ;
- ✓ MSH është duke e finalizuar raportin perinatal për vitin 2022;
- ✓ ABGJ ka ndriçuar Ndërtesën e Qeverisë në shënim të muajit të Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit;
- ✓ ABGJ ka realizuar dhe shfaqur videospotin Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës <https://www.youtube.com/watch?v=ISvixnVGawM;>
- ✓ Për vitin 2022 janë siguruar 300 HPV vaksina ndërsa nga vitit 2023 vaksina është bërë pjesë e kalendarit të vaksinave;
- ✓ Komunitetet kanë organizuar aktivitet për ndërgjegjësimin e popullatës për shëndetin riprodhues dhe seksual;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka trajnuar 45 punëtorë shëndetësor (PSH): për identifikimin dhe menaxhimin dhe referimin e të mbijetuarave nga dhuna në bazë gjinore, 19 punëtorë shëndetësor në menaxhimin sindromik I IST-ve dhe 21 për planifikimin familjar; 25 P.sh.-trajnimi për shëndetin e adoleshentëve; 44 profesionistë nga KPSH janë trajnuar për kodin etik dhe deontologji; trajnime të Trajnerëve) Edukimi Bashkëmoshatar; 16 TiT 2020, të certifikuar 560 Edukator Bashkëmoshatar; 15 TiT 2022, të certifikuar dhe 239 Edukator Bashkëmoshatar;

⁴⁴ <https://www.youtube.com/ëatch?v=ë2p50yBKv1M>

- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka organizuar Java e kancerit të qafës së mitrës 26 - 31 Janar 2022(në bashkëpunim me Tryeza 'Smear to smear', 42 pjesëmarrës, janë shpërndarë 1,562 fletëpalosje;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ofroi trajnim për 1,436 adoleshentë lidhur me Shëndetin Riprodhues;
- ✓ Gjatë vitit 2022, QKUK ka raportuar për130 ekzaminime me mamograf;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka organizuar 30 Trajtime të mësimdhënësve mbi Shëndetin Riprodhues dhe Edukimin Seksual Gjithëpërfshirës dhe bashkë me UNFPA ka hartuar tre doracak për mësimdhënës për edukimin për shëndetin riprodhues dhe edukimin seksual. Janë trajnuar gjatë vitit 2022: 839 mësimdhënës gjithsejtë 645 mësimdhënësë gra dhe 194 burra;
- ✓ Ligjërata dhe aktivitete vetëdijësuese për shëndetin riprodhues dhe seksual kanë organizuar komuna e Mitrovicës dhe Gjilanit;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka organizuar Ditën botërore të kontraktivëve 2022 me 1,750 përfitues; ka shënuar Javë Evropiane të testimit për HIV me 1,550 pjesëmarrës dhe Ditën botërore të AIDS-it me 2,050 pjesëmarrës;
- ✓ MPB ka lansuar fushatën për parandalimin e gjuajtjeve festive me armë dhe keqpërdorimit të tyre gjatë ahengjeve familjare, motoja e kësaj fushate ishte “Çdo plumb ka një shënjestër, Festo me zemër, jo me armë”, janë mbajtur takime me përfaqësuesit e komunitetit, anëtarët e KKS-vë, nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe prindër;
- ✓ Aktivitete vetëdijësuese për rrezikun e bartjes së armëve, veprimeve të rrezikshme në komunikacion, abuzimin e substancave psikotrope, alkoolit, duhanit janë organizuar edhe në komunën e Suharekës, Vushtrisë, Malishevës dhe Klinës;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka shënuar Ditën Botërore të Tuberkulozit si fushata kryesore ndergjegjësuere sa i përket kësaj sëmundjeje, T2 dhe ka organizuar trajnime në komunitet , sa i përket parandalimit të TB,T4;
- ✓ Pjesëmarrës në Shënimin e DBT 300, me gjithsej 700 të trajnuar;
- ✓ Aktivitete informuese për parandalimin dhe trajtimin e TBC-në u organizuan nga komuna e Vitisë, Mitrovicës dhe Klinës;

- ✓ MASHTI edhe gjatë vitit 2022 ka organizuar sesione informuese me nxënës të 4 komunave me qëllim të parandalimit të ngacmimeve seksuale. Aktivitete kanë organizuar edhe komuna e Prishtinës, Suharekës dhe Gjakovës;
- ✓ Me qëllim të ngritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësorë janë mbajtur pesë (5) tryeza prezantimi dhe diskutimi me profesionistët shëndetësor të nivelit parësor me përkrahjen financiare të projektit të AQH-së, ku është bërë prezantimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi në pesë (5) komunat: QKMF- Lipjan; QKMF -Klinë; QKMF - Kamenicë; QKMF - Rahovec; QKMF - Malishevë. Tryezat kanë përfshirë 61 profesionistë shëndetësor të nivelit: udhëheqës i drejtorisë, shefa të njësive në kuadër QKMF-së;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka ofruar trajnim për 185 profesionistë shëndetësor lidhur me shëndetin riprodhues në situata emergjente;
- ✓ Trajtime dhe aktivitete lidhur me edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojave specifike shëndetësore të femrave dhe meshkujve organizuar nga komuna e Gjakovës; Vitisë, Obiliqit, Fushë Kosovës, Suharekës, Prishtinës, Suharekës, Mitrovicës, Klinës dhe Dragashit.
- ✓ Në nëntor-dhjetor 2022, OSBE me buxhet 1,220 Euro, i ofroj 11 seanca edukative shëndetësore për gratë në gjithë Kosovën, duke përfshirë mamografinë falas për pjesëmarrëset.

2023 dhe 2024

- ✓ Në komuna janë ofruar trajtime për ofrimin e vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë;
- ✓ Në Komunën e Gjilanit janë mbajtur 7 sesione informuese për nënat dhe baballarët për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e ushqyeshmërisë së drejtë;
- ✓ ABGJ ka shënuar Tetori- Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit. Është realizuar ndriçimin i Ndërtesës së Qeverisë me ngjyrë vjollce dhe kordele roze si dhe janë shpërndarë materialeve promovuese;
- ✓ Aktivitete vetëdijësuese janë organizuar nga shumica e komunave që kanë raportuar për këtë vlerësim final;
- ✓ OSBE ofroi mbështetj Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë në Lipjan për të mbajtur një seancë për vlerësimin e nevojave dhe ngritjen e vetëdijes në mesin e 28 grave nga komunitetet joshumicë që jetojnë në fshatra me rastin e muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit;

- ✓ Janë hartuar doracakët për mësimdhënës dhe për prindër për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues. Ato janë lansuar. Keto doracak janë materiale ndihmese dhe nuk i zëvendësojnë tekstet por janë materiale alternative që u ndihmojnë mësimdhënësve në arritjen e rezultateve. Janë realizuar 12 video për 12 klasë, Eshtë realizuar broshura për prindër dhe Doracaku për fëmijët me aftësi të kufizuara. Janë mbajtur trajnime me mësimdhënës (2,040) bazuar në lëndët që trajtojnë shëndetin seksual riprodhues.

MJEDISI

2020 dhe 2021

- ✓ MMPHI ka mbajtur ligjërata për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor nga 4- 20 qershor në institucionet arsimore fillore duke përfshirë nga 2 SHFMU në secilën nga komunat si në vijim: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Gjakovë;
- ✓ MMPHI ditën Botërore e Ujërave 22 Mars 2021- e ka shënuar përmes aktiviteteve, përmes publikimit të 2 videove promovuese nën moton botërore bashkohuni në bisedën e #WorldWaterDay. Çfarë do të thotë Uji për ju?;
- ✓ Dita Botërore e Tokës 22 Prill 2021, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe SHFMU “Hasan Prishtina” në Prishtinë është shënuar Dita Botërore e Tokës. Është publikuar video adresimi i Ministrit të MMPHI-së;
- ✓ MMPHI ka shënuar Ditën Botërore të Biodiversitetit 22 Maj 2021, Ditën Botërore të Mjedisit 05 Qershor 2021; Ditën Botërore ‘Pa makina’ me datë 22 shtator 2021; Ditën Ndërkombëtare të Ejes së Lirë në Natyrë 15 tetor 2021;
- ✓ Aktivitete për vetëdijësim për mbrojtjen e ambientit janë raportuar edhe nga komuna e Fushë Kosovës, Junikut dhe Gjakovës.

2022

- ✓ Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës ka organizuar një sërë aktiviteteve lidhur me vetëdijësimin për mbrojtjen e mjedisit: anë mbajtur ligjërata profesionale lidhur me mbrojtjen e mjedisit si: Toka, Uji, Ajri, Biodiversiteti dhe ndryshimet klimatike. Pjesëmarrja e nxënësve ka qenë mbi 700 nxënës dhe nxënës të SHFMU -ve, dhe personeli shkollor, edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor -Shënimi i festave mjedisore sipas Kalendarit Mjedisor; Organizimi dhe shënimi i 22 Marsit “Dita Ndërkombëtare e Ujit”; Organizimi dhe shënimi i 23 Marsit “Dita Ndërkombëtare e Meteorologjisë”; Organizimi dhe shënimi i 22 Prillit “ Dita Ndërkombëtare e Tokës”; Organizimi dhe shënimi i 22 Majit, “Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit; Organizimi dhe shënimi i 5 Qershorit, “Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit; Organizimi dhe shënimi nga 16-22 shtator

i Javës Evropiane të lëvizshmërisë dhe 22 shtatorit 2022 “Ditën Ndërkombëtare pa Makina”; Organizimi dhe shënimi i 4 Tetorit, “Ditës Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve”;

- ✓ Aktivitete për vetëdijësimin për mbrojtjen e mjedisit janë organizuar edhe nga komuna e Fushë Kosovës, Prishtinës, Podujevës, Klinës dhe Skenderajt;
- ✓ Ministria e Ekonomisë në kuadër të programit për efikasitet të energjisë ka mbështetur 45 prindër vetushqyes me pajisje për efikasitet të energjisë;
- ✓ Komuna e Deçanit, Obiliqit dhe Fushë Kosovës kanë hartuar plane komunale që kanë në fokus mbrojtjen e ambientit dhe efikasitetin e energjisë;
- ✓ Ministria e Shëndetësisë ka organizuar 8 trajnime për MISP (pako Minimale Iniciale për Shëndetin riprodhues në situatë emergjente, organizoi 8 trajnime me 185 profesionistë shëndetësor.

2023 dhe 2024

- ✓ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkë organizim me SKAT programi IËRM-K, kanë organizuar takim publik për hartimin e koncept dokumentit të fushës së ujërave më 22 mars 2023 “Ditën Ndërkombëtare të Ujërave” me pjesëmarrës nga komunat dhe OJQ të;
- ✓ MMPHI në bashkëpunim me MASHT, IKSHP-MSH dhe DKA-të kanë organizuar ligjërata për “Ditën Ndërkombëtare të Ujërave” dhe 23 mars “Dita Ndërkombëtare e Meteorologjisë” në SHFMU-të në nivel vendi, sipas planit dhe duke respektuar kalendarin mjedisor sipas festës dhe motos botërore përkatëse me aprovim dhe kërkesë drejtuar nga Ministria e MASHTI-të për të gjitha DKA-të;
- ✓ Me rastin e shënimit të 23 marsit 2023 Dita Ndërkombëtare e Meteorologjisë MMPHI ka organizuar Vizitë të shkurtër laboratorit me rreth 50 nxënës të SHFMU-së “Iliria” në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës;
- ✓ Më 22 Prill 2023 “Dita Botërore e Tokës” MMPHI në bashkëpunim Zyrën e Presidencës, Komunën e Prishtinës, UNDP-në, Ambasadën e Luksemburgut, Ambasadën Japoneze, USAID dhe shumë partnerë zhvillimorë ka shënuar aktivitete sipas agjendës dhe aktivitete me fëmijë ku fëmijët kanë ndërtuar një kënd lojërash nga plastika njëpërdorimshme në sheshin “Skënderbe”;
- ✓ Me rastin e 22 Majit, “Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit”, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkë organizim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”, INDEP-KSDË, OJQ “Era”, kanë shënuar këtë ditë në Prizren;

- ✓ Studentët e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Shkencave Matematike- Natyrore, Drejtimi Biologji kanë prezantuar: Biodiversiteti i Kosovës; Konservimi i Biodiversitetit në Kosovë; Kush po e rrezikon Biodiversitetin e Kosovës? Konventa e Biodiversitetit;
- ✓ Studentët e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, kanë prezantuar: Temën sipas motos botërore për 22 maj 2023 “Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit” -Nga Marrëveshja në Veprim: Rindërtoni Biodiversitetin”;
- ✓ Në Komunën e Rahovecit në bashkëpunim me PAMKOS u realizua aktivitet pastrimi “Drini rrjedh i lirë pa plastikë” me pjesëmarrës rreth 100 fëmijë të këtij lokaliteti dhe të komuniteteve që jetojnë në Komunën e Rahovecit;
- ✓ MMPHI në bashkëpunim me CNVP Aktivitete pikturimi me nxënës dhe mbjellje të fidanëve në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” Komuna Lipjan;
- ✓ MMPHI në bashkëpunim me INDEP, Komunën e Prishtinës aktivitete pikturimi me fëmijë “ Piktoret e Planetit” Pjesmarrës rreth 30 fëmijë;
- ✓ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkë organizim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Policinë e Kosovës, Komunën e Prishtinës, OJQ-në “Marakli t’biciklave”, kanë shënuar “Ditën Ndërkombëtare Pa Makina” më 22 shtator 2023 me aktivitete sipas agjendës;
- ✓ Marshi me biçikleta në rrugën “Dëshmorët e Kombit” Prishtinë sipas skemës të bashkangjitur, ndalim-qarkullimi për makina, krijohen hapësira publike për aktivitete, ecje dhe çiklizëm me rreth 100 pjesëmarrës;
- ✓ Shpërndarja e fletëpalosjeve për vozitësit e makinave;
- ✓ Kinemaja me Biçikleta- Bike On Cinema – Parku Taukbashqe, Prishtinë, pjesëmarrësit janë inkurajuar të vinë në kinema me biçikleta;
- ✓ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkë organizim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Fondacionin për të drejtat e kafshëve, OJQ ERA, do të shënojnë “Ditën Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve” më 04 tetor 2023;
- ✓ Vizitë me studentët e UP-së, (FSHMN-së), në vendin me rëndësi të veçantë në Blinajë me rreth 100 pjesëmarrës;

- ✓ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkë organizim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Institutin për Politika Zhvillimore – INDEP, kanë shënuar “Ditën Ndërkombëtare të Maleve” më 11 dhjetor 2023 me aktivitete;
- ✓ MMPHI në bashkëpunim me MASHTI-në dhe DKA-të në SHFMU-të në nivel vendi, duke respektuar kalendarin mjedisor sipas festës dhe motos përkatëse, kanë realizuar ligjërata për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Maleve”;
- ✓ Aktivitete u realizuan nga shumë komuna në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- ✓ MMPHI gjatë vitit 2023 ka mbajtur aktivitete vetëdijesuese lidhur me cilësinë e ajrit dhe mbrojtjen e natyrës janë mbajtur edhe në kuadër të projektit të bashkëpunimit në mes të AMMK dhe Agjencisë së Mjedisit të Suedisë dhe punëtorinë dy ditore “Kontributi i Grave në mbrojtjen e resurseve ujore dhe përfshirja e barabartë gjinore” përkrahur nga Programi i Menagjimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë. Të kuptuarit e roleve, përgjegjësi, përparësi dhe nevojave të ndryshme thelbësore për çdo projekt në lidhje me menagjimin e ujërave;
- ✓ Është mirëmbajtur dhe përmirësuar portali për cilësinë e ajrit (<https://airqualitykosova.rks-gov.net/?lang=sq>) si dhe janë publikuar të dhëna dhe informata në ueb faqen e AMMK (ammk-rks.net) dhe të IHMK (ihmk-rks.net).

Organizatat e tjera, disa nga aktivitetet në Shtyllën e Dytë të PKBGJ-së

- ✓ Përmes mbështetjes së UN Women më shumë se 370 të reja dhe vajza nga grupet e cënueshme vazhduan shkollimin e tyre të pandërprerë nga COVID-19 UN Women. Gjithsej 220 vajza nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe 150 gra dhe vajza me aftësi të kufizuara morën pajisje TI (laptop, tabletë dhe teknologji ndihmëse);
- ✓ Projekti INCLUDE i Këshillit të Evropës ka organizuar trajnimin e 126 anëtarë të ekipeve vlerësuese pedagogjike në komuna, 48 mësimdhënës të qendrave burimore lidhur me përdorimin e instrumentit për vlerësimin pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta në komuna. Janë trajnuar 10 trajnerë për zbatimin e programit të trajnimit për arsim gjithëpërfshirës dhe janë trajnuar 73 mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ultë në 10 modulet e programit për arsim gjithëpërfshirës;
- ✓ UNDP fushata ndërkufitare ndërkufitare me Maqedoninë e Smal Arms dhe Armë të Lehta “festoni me zemrën tënde, jo me armën tënde”;

- ✓ UNDP realizoi një fushatë e valës së nxehtësisë u krijua për të edukuar publikun e gjerë për rritjen e rrezikut të temperaturave të rrezikshme të larta për shkak të ndryshimeve klimatike;
- ✓ Këshilli i Evropës në kuadër të Projektit INCLUDE ka mbajtur trajnim për 70 profesionistët e arsimit mbi Arsimin Gjithëpërfshirës, vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe plane individuale arsimore dhe 250 profesionistë të arsimit përfunduan dy punëtori mbi Krijimin e një komuniteti të mësimi demokratik ku u theksua aspekti gjinor i diskriminimit në shkollë;
- ✓ RrGK ka trajnuar 102 anëtarë të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje për menaxhim të rasteve të dhunës në baza gjinore;
- ✓ Projekti i Këshillit të Evropës me Akademinë e Drejtësisë, “Përputhja e ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit” dha Trajnim të Trajnerëve për Profesionalistë Ligjorë mbi “Parandalimi dhe Luftimi i Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje” bazuar në manualin e Këshillit të Evropës për gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithsej 33 profesionistë (21 gra dhe 12 burra) përfituan dhe u certifikuan si trajnerë, duke përfshirë: prokurorët, gjyqtarët, bashkëpunëtorët ligjorë nga gjykatat dhe prokuroritë; policinë; avokatët e viktimave dhe zyrtarë të barazisë gjinore nga Agjencia për Barazi Gjinore;
- ✓ UN Women ka mbështetur 64 të mbijetuar nga dhuna në familje u certifikuan për aftësi bazë të rrobaqepësisë dhe 50 kanë përfunduar trajnime për sipërmarrje dhe aftësi sociale, pas përfundimit të kursit intensiv të trajnimit profesional të mbajtur nga partneri i Gratë për Gratë me qëllim përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe rritjen e shanseve të tyre për t'u pavarësuar ekonomikisht. Të gjitha 114 gra të trajnuara janë të regjistruara në Zyrën Punësimit të gatshme për të hyrë në tregun e punës, 50 prej të cilave të pajisura me plane individuale të biznesit. Për më tepër 30 gra pranuan ndihmë për 7 biznese të reja;
- ✓ UN Women ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e Protokollit për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, i miratuar më 5 dhjetor 2022. Ministria e Drejtësisë ka dorëzuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal të Kosovës më 14 tetor, për dënime të ashpra për personat e shpallur fajtorë për përdhunim, sulm seksual dhe dhunë në familje, duke i bërë publike aktgjykimet ndaj këtyre të dënuarve dhe duke shtuar dy nene të rinj;

1) penalizimi i testimit të virgjërisë dhe

2) mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna në jetën publike.

- ✓ RROGRAEK gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka organizuar 6 fushata vetëdijesuese “derë më derë” me përfshirje të rreth 180 familjeve Rome Ashkalike dhe Egjiptiane. Ka organizuar ligjërata mbi martesat e hershme në 12 shkolla fillore dhe të mesme, në klasat me nxënës nga komunitetet romë, ashkalike dhe egjiptiane;
- ✓ Në vitin 2021, RrGK, ka informuar 535 vajza dhe djem mbi ngacmimet seksuale dhe raportimin;
- ✓ UN Women ka organizuar aktivitete me 300 individë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian janë më të informuar për rëndësinë e arsimit për GRATË dhe vajzat përmes fushatës “derë më derë” dhe me 57 drejtorë dhe mësues të shkollave janë informuar se si të reduktojnë shkallën e braktisjes së shkollës për vajzat dhe vajzat e reja nga komunitetet pakicë;
- ✓ UN Women mbështeti zhvillimin e platformës dhe raportit të hartës dixhitale për të identifikuar komunat me rrezik të lartë të braktisjes së shkollës për gratë dhe vajzat e reja nga komunitetet pakicë;
- ✓ Në vitin 2021, MASHTI në bashkëpunim me Bankën Botërore ka hartuar dhe finalizuar Raporti – Saber, në Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme (ECD) në Kosovë, dhe finalizimin e Analizës së Situatës së Shërbimeve në Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme (ECD) në Kosovë;
- ✓ UNFPA ka organizuar trajnime për edukimin shëndetësor, shëndetin riprodhues dhe barazinë gjinore, gjithsej janë realizuar 20 trajnime për gjithsej 400 punonjës shëndetësorë;
- ✓ RrGK Fondi i Grave i Kosovës (FGK) (2021): 20 gra me aftësi të kufizuara të informuara mbi shëndetin riprodhues dhe seksual përmes trajnimeve;
- ✓ UNFPA në vitin 2020 ka organizuar 11 fushata ndërgjegjësimi për SRHR të zhvilluara nga partnerët zbatues të UNFPA-së rezultuan në angazhimin, nëpërmjet platformave online, të 422,536 personave;
- ✓ Në vitin 2021, partnerët zbatues të UNFPA kryen 6 aktivitete sensibilizuese, duke arritur në 1,450,950 njerëz përmes platformave online;
- ✓ Është finalizuar zhvillimi dhe printimi i manualeve të edukimit seksual gjithëpërfshirës (CSE) me mbështetjen e UNFPA-së për mësuesit për nivelin para universitar 1-12, të shtypura në shpërndarje. Gjithashtu, 12 video, një për çdo klasë, janë zhvilluar dhe janë të disponueshme në faqen e internetit të MASHT-it;
- ✓ Në vitin 2021, UNFPA mbështeti zhvillimin e manualit të mësuesve për CSE për nxënësit me aftësi të kufizuara; broshurë për CSE për prindërit, dhe përfshirja e CSE në plan programin e fakultetit të arsimit dhe miratimi i standardeve të CSE për Kosovën;

- ✓ UNFPA, përmes partnerit zbatues KOPF, ka mbështetur trajnimin e mësuesve para universitar për edukim gjithëpërfshirës seksual (comprehensive sexuality education – CSE): në vitin 2020 380 mësime të trajnuar për CSE ndërsa 798 mësime në vitin 2021;
- ✓ Në vitin 2020, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në bashkëpunim me UN WOMEN kanë vazhduar ciklin e trajnimeve për gazetarë, duke organizuar trajnime online me temë “Rreziku i dezinformimit në kohë pandemie”;
- ✓ Në vitin 2021, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës – AJK, i mbështetur nga UN WOMEN Kosova, ka përfunduar ciklin e trajnimeve për rolin e mediave në ndërtimin e paqes. UN WOMEN Kosova në bashkëpunim me UNOPS-in dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, shënuan fushatën “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”;
- ✓ Në vitin 2021, UN Women ka mbështetur trajnimin për më shumë se 15 gazetarë nga mediat lokale dhe qendrore ndoqën trajnimin online mbi Buxhetin e Përgjegjshëm Gjinor;
- ✓ Në vitin 2022, OSBE ndau buxhet prej 5,137 Eurosh dhe organizoi dy tryeza diskutimi për “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore – Qasja në Drejtësi për Viktimat e Dhunës në Familje, me Fokus në Siguri.” Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues nga ministritë, organe ligjore, qendrat e punës sociale, OJQ-të, forume të sigurisë, strehimore për viktimat e dhunës dhe media. Në dhjetor 2022, misioni mbështeti një strehimore për dhunën në Pejë për prodhimin e 10,000 çantave letre me mesazhe kundër dhunës, që u shpërndanë në bukëpjekësit e rajonit për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën ndaj grave;
- ✓ Në dhjetor 2022, OSBE ndau fond prej 3,188 Eurosh dhe në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Gjilanit organizoi një shfaqje me role dhe ngjarje pjesëmarrëse në galerinë e artit për të shënuar 16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Në ngjarje morën pjesë 40 pjesëmarrës, përfshirë 22 gra dhe 18 burra (36 shqiptarë të Kosovës dhe 4 serbë të Kosovës);
- ✓ Në 6 dhjetor, për të shënuar 16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, OSBE mbështeti Mekanizmin Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje (MCMDV) në Shtime për të organizuar një tryezë diskutimi me titull “Të Bashkuar Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore.” Ngjarja u ndoq nga 19 pjesëmarrës, përfshirë 4 gra, 15 burra dhe kryetarin e Shtimes Buxheti i ndarë ishte 800 Euro.
- ✓ Në dhjetor 2021, me buxhet prej 22,556 Euro, OSBE mbështeti fushatën “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës Ndaj Gjinore” duke prodhuar video, billborde dhe debate televizive në tri gjuhë, që trajtonin ngacmimet seksuale, dhunën ndaj grave në politikë, të drejtat pronësore dhe trashëgiminë, si dhe rëndësinë e strehimoreve për viktimat.

Tabela A 3: Progresi në realizimin e aktiviteteve në Objektivën strategjike 3

Nr.	Aktiviteti	2020 dhe 2021	2022	2023 dhe janar-prill 2024
III.1.2	Caktimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të profilizuar të mirren me dhunën në baza gjinore	PO, në Mitrovicë dhe Pejë dhe gjyqtar kujdestar në Prishtinë	PO	PO
III.1.3	Përfshirja e rasteve të dhunës në baza gjinore në mekanizmin ekzistues raportues dhe përcjellës për rastet specifike në polici, prokurori dhe gjykata për të mundësuar monitorimin e rasteve	PO	PO	PO
III.1.4	Trajnim i vazhdueshëm i policisë, prokurorëve, gjykatësve, mbrojtësve të viktimave, punëtorëve social, ofruesit e shërbimeve të licencuar nga ShoC-te lidhur me dhunën në baza gjinore, me theks të veçantë lidhur me definicionet e reja të Kodit Penal	PO	PO	PO
III.1.5	Hartimi i manualit në temën e dhunës në baza gjinore	PO për Policinë	JO	JO
III.1.6	Vazhdimi i afatit për aplikim për pension për të mbijetuarat nga dhuna seksuale gjatë luftës	PO	PO	JO
III.1.7	Sensibilizimi i shoqërisë përmes avokimit dhe vetëdijesimit për qasje në drejtësi duke u fokusuar në të drejtat pronësore, dhunën në baza gjinore, të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës dhe të drejtat tjera që rrjedhin nga legjislacioni përkatës	PO	PO	PO
III.1.8	Analizë e situatës së grave të burgosura në shërbimin korrektues përfshi qasjen në të drejta, rehabilitim dhe reintegrim	PO	JO	JO
III.1.9	Ofrimi i trajnimeve lidhur me të drejtat për gratë e burgosura përfshi qasjen në të drejta, rehabilitim dhe reintegrim	PO	JO	JO
III.1.10	Analizë e situatës nga aspekti gjinor i pozitës së grave të dënuara për dhunën në familje përfshi politikat ndëshkimore	PO, në proces	JO	JO
III.1.11	Analizë e situatës fenomenin e dhunës në baza gjinore	JO	PO ASK ka realizuar anketën për dhunën në familje, që planifikohet të publikohet në vitin 2024	PO
III.1.12	Fuqizimi i kapaciteteve të Komisionit Qeveritar për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe organizatave të përfshira në procesin e aplikimit për njohjen e statusit	PO	PO	JO
III.1.13	Krijimi i programeve specifike për qasjen në drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës	JO	JO	JO
III.1.14	Krijimi i programeve rehabilituese për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës	PO	JO	JO
III.1.15	Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare për Procesin e Verifikimit të Statusit të të mbijetuarave nga dhuna seksuale gjatë luftës	JO	JO	JO
III.1.16	Realizimi i studimeve për të matur pranimin e dhunës fizike dhe psikologjike tek vajzat dhe gratë	JO	JO	JO

III.2.1	Ngritja e kapaciteteve për monitorimin e rregullt të zbatimit të LBGJ-së brenda institucioneve publike	JO	JO	JO
III.2.2	Harmonizimi dhe plotësimi i ligjit për zgjedhje, ligjit për financimin e partive politike dhe rregullores së Punës së Kuvendit me LBGJ-në	JO	JO	JO
III.2.3	Ndërmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore në pozitat vendimmarrëse	JO	JO	JO
III.2.4	Realizimi i hulumtimeve periodike për përfaqësimin e grave në pozitat vendimmarrëse në sektorin publik dhe atë privat	JO	PO	JO
III.2.5	Organizimi i trajnimeve sipas kurrikulës për barazinë gjinore lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në kuadër të shërbimit civil	JO	JO	JO
III.2.6	Ofrimi i bursave për avancim profesional për gra në institucione publike në nivelin lokal dhe qendror	JO	JO BURSA	JO BURSA
III.2.7	Trajnimi për leadership të grave për mundësinë e kandidimit për pozita vendimmarrëse në nivel lokal dhe qendror	JO	PO NE 2 KOMUNA	PO
III.2.8	Mbajtja e aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe vetëdijësuëse mbi barazinë gjinore për grupin e grave deputete të asambleve komunale dhe nivelit qendror	PO	PO	PO
III.2.9	Ndërmarrja e kampanjave vetëdijësuëse për rritjen e numrit të grave në procesin e menaxhimit dhe monitorimit të procesit zgjedhor në përputhje me LBGJ-në	PO	JO	PO
III.2.10	Hulumtim për pjesëmarrje dhe përfaqësim të grave brenda partive politike përmes strukturave dhe mekanizmave të partive politike dhe sondazheve të opinionit publik	PO	JO	JO
III.2.11	Fushatat e ndërgjegjësimi dhe aktivitete mbi transparencën dhe alokimin e barabartë të fondeve për gratë dhe burrat në partitë politike	JO	JO	JO
III.3.1	Hulumtim rreth formave të diskriminimit dhe mjedisit të sigurtë për burrat dhe gratë në sektorin e sigurisë	PO	JO	PO
III.3.2	Krijimi i Bordit Këshillues Gratë, Paqja dhe Siguria brenda institucioneve të sigurisë	JO	JO	JO
III.3.3	Analizë e situatës mbi nevojën e themelimit të shoqatës së grave në forcat e sigurisë së Kosovës	JO Sipas keshillës Ligjore te Departamentit Ligjor ne MM, nuk ka baze ligjore për themelimin e shoqatës se grave ne Forcën e Sigurisë se Kosovës.	JO NE FSK Sipas keshillës Ligjore te Departamentit Ligjor ne MM, nuk ka baze ligjore për themelimin e shoqatës se grave ne Forcën e Sigurisë se Kosovës.	JO NE FSK Sipas keshillës Ligjore te Departamentit Ligjor ne MM, nuk ka baze ligjore për themelimin e shoqatës se grave ne Forcën e Sigurisë se Kosovës.
III.3.4	Inkurajimi i krijimit dhe mbështetjes së shoqatave të grave në sektorin e sigurisë	PO, vetëm përmes trajnimeve	PK KA NDERSA FSK JO	PK PO
III.3.5	Trajnimi i anëtarëve të institucioneve të sigurisë	PO	PO	PO

	lidhur me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore përfshi buxhetimin gjinor dhe integrimin e perspektivës gjinore			
III.3.6	Rishikimi dhe avancimi i kurrikulës së policisë, Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe institucioneve tjera të sigurisë nga perspektiva gjinore në përputhje me LBGJ-në dhe praktikën ndërkombëtare	PO NË PK DHE MM	PO NE MM	PO NE MM
III.3.7	Ndërmarrja e masave afirmative me qëllim të rritjes së numrit të grave në sektorin e sigurisë	JO	JO	JO
III.3.8	Hulumtim i vazhdueshëm mbi pozitën e grave në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, shërbimi korrektues	PO NË MM JO në PK e shërbim korrektues	JO	JO
III.3.9	Ndërmarrja e fushatave për rritjen e vetëdijes lidhur me rekomandimet e dala nga hulumtimi i vazhdueshëm për pozitën e grave në sektorin e sigurisë	PO	JO	JO
III.3.10	Hulumtim lidhur me ndikimin e armëve të vogla në sigurinë e burrave dhe grave nga perspektiva gjinore	JO	JO	JO
III.3.11	Hartimi i Agjendës për Barazi Gjinore dhe Planin e Veprimit 2021-2023 për Policinë e Kosovës për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në Agjendën e Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillimin të Qëndrueshëm dhe 17 Synimet për Zhvillime të Qëndrueshëm	PO	PO	PO
III.4.1	Organizimi i debateve publike për përfaqësimin e grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit	PO	PO	JO
III.4.2	Lobimi dhe avokimi lidhur me përfshirjen e grave në procesin e negociimit, paqes dhe pajtimit	PO	JO	JO
III.4.3	Krijimi i bazës së të dhënave për gratë pjesëmarrëse në aktivitetet emergjente apo humanitare brenda dhe jashtë vendit	PO	PO	PO

QASJA NË DREJTËSI DHE SHËRBIME

- ✓ Kushtetuta e Kosovës është ndryshuar për të përfshirë Konventën e Stambollit në listën e dokumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt;
- ✓ Zhvillimi i Strategjisë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna kundër Grave për 2022-2026 është finalizuar në nëntor 2021 dhe Strategjia e re është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 26 janar 2022;
- ✓ ABGJ ka realizuar ciklin e trajnimeve për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për nevojat e Policisë së Kosovës, ku përmes këtij trajnimi policia informohet, orientohet për përgjegjësitë institucionale konform Procedurave Standarde të Veprimit dhe obligimeve të reja që derivojnë nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Gjatë muajit qershor- dhjetor 2021 janë realizuar 6 sesione trajnimi dhe janë certifikuar 196 polic hetues dhe polic të rinj në Komunën e Prishtinës, Ferizajt, Gjilanit, Mitrovicës, Gjakovës;
- ✓ Në vitin 2020 Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX ka organizuar fushatën kundër dhunës në familje me moton “Dhuna në Familje nuk është çështje private”, fushata ndërtuar në tri elementet e dhunës në familje si pas Kodit Penal neni 248: billbordat, “Dhuna në familje nuk është çështje private”, janë vendosur në të gjitha komunat, në dy gjuhët zyrtare; video spot për Radio, janë transmetuar në dy gjuhët zyrtare Radio Dukagjini dhe Radio KFOR; dhe video spot për TV, është emituar në televizionin publik/RTK, në dy gjuhët zyrtare dhe në gjuhën e shenjave;
- ✓ RrGK ka organizuar 1 fushatë e organizuar në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit dhe 5 fushata që kanë targetuar grupet e marginalizuara, me fokus njoftimin për kornizën ligjore dhe mënyrat e raportimit të dhunës
- ✓ Në nivel vendi në vitin 2020 dhe 2021 është shënuar Fushata e 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës në familje, dhe shënimit të 25 Nëntorit Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas;
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore ka mbajtur Konferencën e nivelit të lartë me akterë institucionalë, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile “Përgjigjja institucionale ndaj dhunës kundër grave në periudhën (post) COVID-19”;

- ✓ ABGJ ka përgatitur dhe shfaqur Videospotin *Informues për identifikimin dhe pasojat e dhunës psikologjike dhe atë për shënimin e 10 vjetorit të Konventës së Stambollit* (me fonde te donatoreve);
- ✓ Me financim nga ABGJ, Qendra për Informim dhe Përmirësim Social ka krijuar platforma on line “Këshillim për Parandalim” për ofrimin e seancave këshilluese online për dhunuesit;
- ✓ ABGJ ka financuar 3 OJQ në vlerë totale prej 37,500 Eur të specializuara në ofrimin e shërbimeve/seancave të trajtimit psikoterapeutik për këshillim dhe trajtim të dhunuesve;
- ✓ ABGJ ka vazhduar mbështetjen e me dy punëtori për Komisionin për Verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në ndërsa në vitin 2021 ka mbështetur edhe një punëtori të Komisionit;
- ✓ Më 10 dhjetor 2021, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili përfshin kompensimin e drejtpërdrejtë të krimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje, në të gjitha format e saj;
- ✓ Është aprovuar Ligji Nr. 08/L-035 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas. Përmes amendamentit të ligjit është avancuar ndihma juridike falas, si një mekanizëm i rëndësishëm i cili i kontribuon sundimit të ligjit në vend Pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale, ndihma juridike falas i ofrohet kategorive si: viktimave të dhunës në familje; viktimave dëshmitare të dhunës, të cilët janë në varësinë e viktimave të dhunës në familje; viktimave të dhunës në baza gjinore; viktimave të cilitdo lloj të dhunës seksuale, përfshirë dhe ngacmimin seksual; personat e dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999;
- ✓ Në vitin 2020 ABGJ ka subvencionuar dy OJQ të cilat kanë punuar me të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, dhe të mbijetuarat e dhunës ndaj grave, duke financuar iniciativat për fuqizim ekonomik, inicim dhe zhvillim të bizneseve të vogla për të dy kategori të mbijetuarave të dhunës;
- ✓ ABGJ ka mbështetur realizimin e publikimit “Buxheti Operacional i strehimoreve në Kosovë dhe udhëzuesi i projektimit”⁴⁵

- ✓ Në shkurt 2020, OSBE financoi 3,000 Euro për organizimin e katër punëtorive rajonale me 133 zyrtarë policorë (26 gra, 107 burra) mbi rolin e policimit komunitar në parandalimin e dhunës në familje dhe me bazë gjinore.
- ✓ Zyra e BE-së në vitin 2021 ka mbështetur me 400,000.00 Euro fuqizimin e OJQ-ve të të grave përmes Kosova Women's Network (KWN) për promovimin e barazisë gjinore gjatë pandemisë COVID-19. Qëllimi është përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse dhe sigurimi që nevojat e tyre të pasqyrohen në përgjigjen shtetërore ndaj pandemisë.
- ✓ Nga prilli deri në tetor, OSBE financoi 10,700 Euro për trajnimin e 30 anëtarëve të rinj të katër Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP), përfshirë 9 gra dhe përfaqësues nga komunitetet shumicë dhe pakicë (23 shqiptarë, 6 serbë, 1 romë);
- ✓ Në gusht 2021, OSBE financoi 7,090 Euro për organizimin e tetë punëtorive njëditore në rajonet e Policisë së Kosovës (PK), me 124 pjesëmarrës (41 gra). Pjesëmarrësit përfshinin 102 zyrtarë policorë, 16 nga Qendrat për Punë Sociale dhe 6 nga Zyra për Ndihmë dhe Avokim të Viktimave;
- ✓ Në qershor 2020, OSBE mbështeti me 4,800 Euro organizimin e një Trajnimi për Trajnerë (ToT) online për 30 gra nga komuniteti islamik i Kosovës;
- ✓ OSBE ne Shtator 2022 - 24 gra, të moshës 20-27 vjeç, morën pjesë në program; 12 nga Prishtina dhe 12 nga Beogradi (OMiK AoR: 11 kosovarë shqiptarë, 1 kosovar rom, OMiS AoR: 11 serbë, 1 shqiptar);
- ✓ Shkurt – Nëntor 2022, OSBE mbështeti 34 gra politikane lokale dhe anëtare të LWCs në mbarë Kosovën (31 shqiptare dhe 3 serbe) që morën pjesë në të paktën një nga katër sesionet e PA;
- ✓ OSBE, ndahu 2,350 Euro në vitin 2021, mbi 40 gra morën pjesë aktive në pesë takime dhe dy trajnime, ku dy nga tre trajnerët ishin gra;
- ✓ OSBE ndau 10,000 Euro nga 28 qershori deri më 2 korrik 2021 për fuqizimin dhe avancimin e grave të reja. Aktiviteti përfshiu 16 pjesëmarrëse dhe të katër trajneret ishin gra.

SIGURIA

- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka realizuar një hulumtim duke anketuar 175 gra dhe vajza ushtarake lidhur me diskriminimin dhe mjedisin e sigurt për burrat dhe gratë në sektorin e sigurisë;
- ✓ Divizioni i Trajnimeve i Policisë së Kosovës ka formuar grupin punues që janë duke rishikuar planin programin për trajtimin e dhunës në familje, si rrjedhojë e ndryshimit të Kodit Penal, dhe miratimit të Konventës së Stambollit;
- ✓ Në kurrikulën për trajnim profesional për zyrtarët Korrektues është edhe moduli për legjislacionin vendor ku përfshihet edhe LBGJ;
- ✓ Kurrikula e Qendrës për Stërvitje Bazike (QSB), është avancuar në përfshirjen e barazisë gjinore në eliminimin e diskriminimit gjinor, stereotipave negative, pabarazisë dhe paragjykimet. Programi i QSB ofron ligjërata për Trajnimin Bazik për Komponentin aktiv dhe rezervë, ndërsa Shkolla e Nën Oficerëve në tri programet zhvillimore për nënoficerët e FSK, realizon 10 orë mësimore për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe ngacmimet seksuale;
- ✓ Në vitin 2021 është aprovuar Agjenda për Barazi Gjinore në Policinë e Kosovës dhe Plani i veprimit 2021-2023;
- ✓ Në maj dhe qershor 2021, OSBE ka financuar 3,680 Euro për dy trajnime njëditore për kryetarët e Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) në rajonet e Mitrovicës dhe Gjilanit. Në trajnime morën pjesë 50 persona (13 gra, 37 burra), përfshirë përfaqësues të Policisë së Kosovës. Trajnimet trajtuan rolin e mediave në promovimin e sigurisë komunitare dhe rëndësinë e avokimit për rolin e grave në forumet e sigurisë përmes mediave lokale;
- ✓ Në dhjetor 2021, OSBE ka financuar 7,905 Euro për trajnimin e 20 zyrtarëve të Policisë së Kosovës mbi dhunën në familje, përfshirë 9 gra;
- ✓ Në maj dhe qershor 2021, OSBE financoi 3,000 Euro për dy trajnime njëditore për kryetarët e Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) në rajonet e Mitrovicës dhe Gjilanit. Në trajnime morën pjesë 50 pjesëmarrës (13 gra dhe 37 burra).

2022

- ✓ Ministria e Drejtësisë e ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe dhuna ndaj grave dhe Planin e Veprimit, 2022-2026 (është miratuar në janar 2022);
- ✓ Ministria e Drejtësisë: Me miratimin e Strategjisë ("SKMDHF"), nga kryetarët e gjykatave është kërkuar të caktohen koordinatorët. Sipas Raportit një vjeçar të kësaj Strategjie deri tani të gjitha gjykatat kanë caktuar koordinator. Në një pjesë të gjykatave tanimë janë profilizuar gjyqtarët, kurse për pjesën tjetër, mbetet të bëhet një gjë e tillë;
- ✓ Komuna e Gjilanit ka mbështetur financiarisht Strehimoren e grave raste të dhunës në familje dhe ka paguar qiranë për 28 të mbijetuara të dhunës në familje;
- ✓ Ministria e Drejtësisë përmes Ligjit Nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ka paraparë ofrimin e ndihmës juridike falas pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale, edhe personat e dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë gjatë vitit 1998-1999;
- ✓ Protokolli shtetëror për Trajtimin e rasteve të dhunës seksuale- Qëllimi i Protokolli është standardizimi i veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe ri-integrimin e viktimave, të mbijetuarave të dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse. Pjesa e tretë, përmban informacion të përgjithshëm mbi trajtimin e rasteve të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës;
- ✓ ABGJ ka ofruar mbështetje financiare publike për financimin e projekteve të 3 OJQ-ve, që kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të përgjithshëm për luftën kundër dhunës ndaj grave, në zbatimin e prioriteteve të parapara në Objektivat Strategjike të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 dhe planit të veprimit. Organizatat përfituese janë: Organizata Rinore-AKTI, Bussines Ëomen Mitrovica, Qendra për Education and Community Development Friends;
- ✓ ABGJ ka ndriçuar ndërtesën e Qeverisë në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në baza gjinore. Ka shtypur materiale promovuese (ombrellat, totbeg/çanta, kordelet e bardha, fletore me numra kontaktues të institucioneve që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës ndaj grave dhe materiale tjera) në kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizimit;

- ✓ Aktivitete vetëdijësuese gjatë 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje janë organizuar në komuna; ABGJ ka realizuar dhe shfaqur videospotin për raportimin e dhunimeve seksuale- Rëndësia e marrjes së Provave Biologjike: <https://www.youtube.com/watch?v=MpFOmw8f8LY>
- ✓ ABGJ ka mbajtur 11 sesione trajnimi lidhur me zbatimin e prioriteteve të vendosura në PKBGJ dhe në zbatim të drejtpërdrejtë të Konventës së Stambollit, janë trajnuar, gjithsej 130 pjesëmarrës nga Kline, Malisheva, Mamusha, Drenasi, Obiliqi, Vitia dhe Juniku;
- ✓ Ministria e Drejtësisë ka plotësuar dhe ndryshuar Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit i cili ka hyrë në fuqi më 17 nëntor 2022, më të cilin janë adresuar një mori ndryshimesh si:
 - Zgjatja e afatit për aplikim nga 6 muaj sa ka qenë në ligjin e vjetër, në 3 vjet pas pranimit të aktgjykimit të formës së prerë;
 - Është krijuar mundësia e qasjes së menjëhershme në kompensim të viktimave të dhunës në familje, viktimave fëmijë, etj.;
 - Janë ndryshuar mënyrat dhe lartësia e kompensimit sidomos veprat penale të dhunës në familje të cilat me lehtësi, sipas ligjit për kompensim e që në të kaluarën janë refuzuar;
 - Është rritur buxheti në fondin e kompensimit nga 78.000 Euro në 148.000 mijë Euro;
 - Janë thjeshtësuar formularët për aplikim si dhe mënyrat e aplikimi. Parashtruesit e kërkesave mund të dërgojnë në adresë elektronike në emailin e komisionit, në mënyrë fizike, apo edhe me postë;
 - Gjatë vitit 2022 janë bërë ndryshime ligjore në palët përfituese të ndihmës juridike falas. Me datë 13 Mars 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ku bazuar në këtë ligj janë shtuar Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas të cilët pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik, i ofrohet ndihma juridike falas;
- ✓ OSBE ka ndarë buxhet prej 3,884 Euro në vitin 2022 për organizimin e pesë punëtorive dyditore mbi sulmet dhe ngacmimet seksuale, ku u trajnuan 60 nxënës të shkollave të mesme (30 vajza, 30 djem, përfshirë nxënës nga komunitetet Ashkali dhe Boshnjakë) në pesë komuna. LJS gjithashtu organizoi 16 sesione informacioni, përfshirë gjashtë për 190

nxënës (130 vajza, 60 djem) në Skenderaj/Srbicë, dhe mbështeti tre OJQ për të organizuar gjashtë sesione për 142 pjesëmarrës (136 vajza, 6 djem). Gjatë 16 Diteve të Aktivizmit, nxënësit e trajnuar udhëhoqën tre seanca peer për 60 nxënës (40 vajza, 20 djem), mbështetur nga psikologët e shkollës. Të gjitha aktivitetet u realizuan pa shpenzime buxhetore;

- ✓ Në periudhën shkurt-mars 2022, OSBE ka financuar 12,300 Euro për trajnimin e 39 zyrtarëve të Policisë së Kosovës nga tetë rajone mbi vlerësimin e rreziqeve dhe hartimin e planeve të sigurisë për rastet e dhunës në familje, me qasje të ndjeshme gjinore. Trajnimi përfshiu 24 gra, 15 burra dhe katër pjesëmarrës nga komunitetet joshumicë;
- ✓ Në tetor 2022, OSBE ka mbështetur Policinë e Kosovës me 2,600 Euro për organizimin e pesë punëtorive për zyrtarët e rinj. Trajnimet adresuan legjislacionin mbi dhunën ndaj grave/dhunën në familje, mekanizmat ndër-institucionalë dhe procedurat standarde të policisë, me fokus te urdhrat mbrojtës, vlerësimet e rrezikut dhe shmangia e ri-viktimizimit. Morën pjesë 144 zyrtarë, përfshirë 40 gra, 104 burra dhe 21 përfaqësues nga komunitetet joshumicë;
- ✓ OSBE ndau 6,600 Euro në vitin 2022 për një analizë gjinore me 5 kryetare komisionesh të Kuvendit të Kosovës, duke identifikuar sfida dhe perspektiva për lidhshimin e grave.

2023 dhe 2024

- ✓ E drejta në kompensim, Republika e Kosovës si vendi i parë në rajon zbaton programin për kompensimin e viktimave të krimit, se kompensimi i viktimave të krimit është kategori ligjore dhe kështu është shoqëria me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Pretendimet e trajtuara nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit kanë qenë për veprat penale të vrasjes, përdhunimit dhe abuzimit seksual të të miturve, dhunës në familje, trafikimit të qenieve njerëzore etj. Gjatë vitit 2023 Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsejtë 129 kërkesa për kompensim. Prej tyre janë aprovuar 98 kërkesa, kurse janë refuzuar 24 dhe 7 kërkesa janë bartur për vitin 2024. Prej tyre janë 86 femra dhe 43 meshkuj;
- ✓ Kuvendi i Republikës së Kosovës, datë 26.10 2023, ka miratuar Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Përveç dënimeve të parapara në Kodin Penal janë shtuar vepra të reja penale dhe dënimet plotësuese, për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje: ndalimi i blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, aseteve publike apo licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet; ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo forme tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislacioni në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet; ndalon të drejtën e kandidimit në çdo pozite publike nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, personit i

cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje; ndalon punësimin në sektorin publik në të gjitha nivelet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit; ndalon të drejtën në përfitimin e patente shoferit dhe të drejtën në drejtimin e automjetit në çdo lloj të kategorisë, nga një (1) deri në pestë (5) vjet, personit që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit; Gjykata urdhëron publikimin e aktgjykimit për personin që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit, sulmit seksual si dhe dhunës në familje. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mbanë dhe publikon regjistrin e personave të dënuar për veprën penale të dhunimit, dhunimit seksual dhe dhunës në familje. Vepra të reja penale janë: testimi i virgjërisë; dhuna kundër grave në jetën publike; krimet kibernetike;

- ✓ Ministria e Drejtësisë/ Zyra e Koordinatorës Nacionale Kundër Dhunës në Familje, në Planin e Punës për vitin 2024, ka planifikuar-aktivitet Plotësim/Ndryshimin e Kodit Penal për të përfshirjen e femicidit si vepër të veçante penale;
- ✓ Më 23 nëntor 2022 Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 500,000 Euro për Organizatat joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, përfshirë edhe strehimore për mbrojtjen e viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, zbatimi i të cilit ka filluar në periudhën Janar-Prill 2023.;
- ✓ Në maj 2023, MD ka hapur thirrjen publike për mbështetje financiare për subjektet juridike dhe organizatat jo-qeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për periudhën Maj-Dhjetor 23- Shkurt 24. Krahas thirrjes publike të MD-së, (15/03/23) është themeluar komisioni për vlerësimin e projekteve për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale, ku pas aplikimit të 49 subjekteve juridike (strehimore, OJQ) kanë përfituar 41 nga të cilat 10 strehimore. Nga buxheti i MD-së periudha maj - dhjetor 2023/ shkurt 2024 vlera e financimit të strehimoreve është 692,000 Euro. Në kuadër të vendimit të Qeverisë, vlera e buxhetit për subjektet juridike/OJQ është rritur nga 1,000,000 Euro në 1,500,000 Euro;
- ✓ Ministria e Drejtësisë me miratimin e Strategjisë ("SKMDHF"), nga kryetarët e gjykatave është kërkuar të caktohen koordinatorët. Sipas Raportit një vjeçar të kësaj Strategjie deri tani të gjitha gjykatat kanë caktuar koordinator. Në një pjesë të gjykatave tanimë janë profilizuar gjyqtarët, kurse për pjesën tjetër, mbetet të bëhet një gjë e tillë;
- ✓ Ministria e Drejtësisë data bazën nacionale për evidentimin e rasteve të dhunës në familje nga e cila gjenerohen të dhënat për dhunën në familje të ndara në baze të gjinisë. Është rrit numrin i institucioneve që ofrojnë të dhëna duke zhvilluar module për tri institucione të reja: Shërbimin Korrektues, Shërbimin Sprovues dhe Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas;

- ✓ ABGJ ka realizuar 6 trajnime dy ditore për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe, ku përmes këtij trajnimi policia informohet, orientohet për përgjegjësitë institucionale konform Procedurave Standarde të Veprimit dhe obligimeve të reja që derivojnë nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Gjatë muajve janar- dhjetor 2023 janë certifikuar 119 policë, prej tyre 85 burra dhe 34 gra në Komunitet: Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjirokastrë;
- ✓ ABGJ ka realizuar 4 trajnime për Mekanizmat Koordinues Lokal kundër dhunës në Familje, në bashkëpunim me ZBGJ e këtyre Komunave ku janë prezantuar përgjegjësit dhe obligimet për mekanizmin lokal në baze të prioritetëve të vendosura në SKDHF 2022-2026. Komunitet: Fushe Kosovë, Deçan, Vushtrri, Lipjan morën pjesë 72 persona, 46 gra dhe 26 burra;
- ✓ Në Gjirokastrë janë mbajtur 2 trajnime për anëtarët e MKKDHF;
- ✓ ABGJ ka shënuar Fushatën Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në baza gjinore- 16 ditët e aktivizmit. ABGJ ka ndriçuar 1 Ndërtesat e Qeverisë me simbolin e fushatës dhe Ndërtesën e MD për organizmin e Konferencës. Janë shtypur materialeve promovuese –sensibilizuese për fushatën kombëtare (ombrellat, totbëg, kordelet e bardha, fletore) në kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizmit;
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Institutin e Kosovës së Administratës Publike dhe në mbështetje të asistencës teknik UN Women, ka realizuar 16 trajnime për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës. Janë certifikuar 36 Zyrtarë për Barazi Gjinore (ZBGJ) në Ministri dhe Komuna. Në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor janë certifikuar 112 zyrtarë të nivelit udhëheqës dhe menaxherial. Trajnimet janë mbajtur në 11 Komuna : Drenas, Viti, Lipjan, Kline, Deçan, Obiliq, Dragash, Kamenice, Skenderaj, Istog, Prizren janë certifikuar 227 zyrtarë të nivelit udhëheqës dhe menaxherial;
- ✓ ABGJ në vitin 2024 ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare të Gruas nën sloganin “Bashkë për barazi” në këtë ditë në bëjmë thirrje për unitet në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave çdokund. Në linjë me temën globale “Investimi në gra përshpejton progresin”, në këtë konferencë u diskutua për qasjet që nevojiten në mënyrë që të rritet ndikimi dhe të forcohet roli i grave në proceset dhe agjendat e zhvillimit socio ekonomik të vendit, për një transformim shoqëror të qëndrueshëm dhe të barabartë. Konferencën e ndoqën rreth 75 pjesëmarrës;

- ✓ ABGJ në vitin 2024 ka themeluar grupin punës dhe ka mbajtur një takim njoftues me grupin punës për plotësimin dhe ndryshimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore;
- ✓ Komuna e Gjilanit ka organizuar aktivitete gjatë fushatës 16 ditë aktinizmit kundër dhunës ndaj gruas: shpenzimet e mbuluara nga 1000 persona të informuar: është ndriçuar objekti i Komunës me ngjyrë portokalli dhe janë mbajtur ligjërata në shkollat e mesme të Komunës së Gjilanit, me temë: “Parandalimi i Dhunës ndaj Gruas”, mbështetur nga SUISSE SOLIDAR;
- ✓ ABGJ ka vizituar Qendër Korrektuese në Lipjan, ku u takuan me gra të burgosura në këtë qendër dhe u diskutua për të drejtat e garantuara me legjislacionin e Kosovës në avancimin dhe përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri;
- ✓ Ministria e Drejtësisë ka ofruar trajnime për gratë të burgosura ofrohen programe dhe trajnime në temat: Menaxhimi i zemërimit të kanës ndjekur 8 të burgosura; bisedën për ndryshime 1 të burgosur; Dhuna në familje me 6 të burgosura;
- ✓ Në kuadër të fushatës “16 ditë kundër dhunës me bazë gjinore”, është zhvilluar një seancë informuese me temë “Dhuna në familje” për 60 zyrtarë të institucioneve korrektuese, me synim për të vazhdimin gjatë vitit 2024. Janë shpërndanë broshura për stafit të mbështetur nga OSBE;
- ✓ Në koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrit, me mbështetjen e OSBE-së, u mbajt sesioni informues me temën “Manuali për zbatimin e politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike”. Përfundues të këtij sesioni ishin afër 30 zyrtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ✓ Në bashkëpunim me OSBE u mbajtën dy ligjërata në Qendrën Korrektuese në Lipjanit, për dhunën në familje për 34 zyrtarë civilë dhe korrektues nga disa institucione korrektuese. U mbajt sesion informues për sensibilizim të qytetarëve për reagim ndaj dhunës të të gjitha formave, shfaqja e dokumentarit “Backlash-Misogyny in the Digital Age, mbështetur nga EULEX përmes OJQ CCNO;
- ✓ Ministria e Drejtësisë përmes Ligjit Nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ka paraparë ofrimin e ndihmës juridike falas pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale, edhe personat e dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë gjatë vitit 1998-1999. Protokollin shtetëror për Trajtimin e rasteve të dhunës seksuale- Qëllimi i Protokollit është standardizimi i veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe ri-integrimin e viktimave, të

mbijetuarave të dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse. Pjesa e tretë, përmban informacion të përgjithshëm mbi trajtimin e rasteve të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës.

- ✓ Ministria e Infrastrukturës organizoi aktivitet me rastin e 8 Marsit "Ditës Ndërkombëtare të Gruas" si Zyrtare për Barazi Gjinore në MMPHI-ës, e organizuar në Njësinë e Patentë Shoferit në Ferizaj për tetë (8) Gratë e para të cilat do të paraqesin provimin për Patent Shofer janë liruar nga pagesa, në shenjë të kësaj dite "8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas". Ky aktivitet është ndërmarrë me qëllim të inkurajimit të Grave për të aplikuar dhe për tu pajisur me patentë shofer'
- ✓ Zyra e BE-së mbështeti Solidar Suisse (2023-2025) me 193,982 Euro për të rritur ndërgjegjësimin se dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe për të inkurajuar qytetarët ta sfidojnë atë. Projekti promovon masa efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave në nivel qendror dhe lokal;
- ✓ OSBE, ne vitin 2023 në bashkëpunim me Zyrën e Qeverisjes të Mirë, ka buxhetuar €3,265.75 për workshop-e që synonin rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndihmën në ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e Politikës kundër Ngacmimit Seksual në Administratën Publike. 1,600 zyrtarë u trajnuan, dhe gjithashtu mbështeti botimin e udhëzuesit për këtë politikë dhe trajnimin e rreth 110 zyrtarëve publikë;
- ✓ Nga 7 tetori deri më 24 nëntor 2022, OSBE organizoi pesë workshop-e për zbatimin e Politikës kundër Ngacmimit Seksual në Prishtinë, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren dhe Pejë. Në total, morën pjesë 66 persona (43 gra dhe 23 burra).

PËRFAQËSIMI I GRAVE NË JETËN PUBLIKE DHE NË SEKTORIN E SIGURISË

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në institucione publike

- ✓ ABGJ ka organizuar një trajnim dy ditor për Grupin e Grave deputete dhe komisionin Parlamentar për buxhet dhe financa lidhur me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor si instrument i politikave drejt arritjes së barazisë gjinore;
- ✓ Policia e Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes kanë organizuar fushata informuese dhe inkurajuese për përfshirjen e grave në Policinë e Kosovës dhe në FSK;
- ✓ Në vitin 2020 u organizuar takimi vjetor i Bordit të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police (IAWP) dhe Konferencën Ndërkombëtare, 'Roli i zyrtareve policore në reagim ndaj kërcënimeve transnacionale'. Këto dy ngjarje të mbajtura në Kosovë u vlerësuan lart edhe nga Qeveria e Kosovës dhe u klasifikuan si ngjarja më e madh e fuqisë së grave që mbledhi rreth 500 burra dhe gra nga sektori i sigurisë që ndanë ekspertizën dhe të kontributin për paqen dhe sigurinë në mbarë globin;
- ✓ IKAP: 2020-deri në tetor 2022 janë trajnuar 20 zyrtarë për BPGJ dhe 91 për çështjet gjinore, politikat dhe praktikat bashkëkohore;
- ✓ Divizioni i Trajnimeve në kuadër të Policisë së Kosovës në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare gjatë vitit 2020 ka mbajtur disa trajnime dhe punëtori sa i përket dhunës në familje, perspektives gjinore, për barazi gjinore, për të drejtat e grave etj. Për vitin 2020 janë mbajte 21 punëtori, trajnime dhe kanë marrë pjesë 254 zyrtar policor kryesisht të gjinisë femërore. Ndërsa në vitin 2021 janë mbajti 213 trajnime, punëtori etj. ku kanë marrë pjesë: 4,816 zyrtar policor të të dy gjinive.

2022

- ✓ ABGJ ka realizuar një konferencë e nivelit të lart për të shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me temën "Zhbëjmë paragjykimet, synojmë gjithë përfshirjen me qëllim të pjesëmarrjes së grave në procese vendimmarrëse në nivelin legjislativ ekzekutiv, misione diplomatike dhe shërbimin civil;
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me QKSGJ kanë mbajti takimin tashme tradicional, konsultativ i nivelit të lartë, me temë "Pjesëmarrja e Grave në Tregun e Punës";
- ✓ ABGJ ka realizuar dhe shfaqur videospotin *Parandalim ndaj diskriminimit*: <https://www.youtube.com/watch?v=X81HgDOXFDc>;

- ✓ Trajnimi për lidërsnip të grave për mundësinë e kandidimit për pozita vendimmarëse në nivel lokal dhe qendror janë organizuar nga komuna e Gjilanit dhe Vushtrrisë;
- ✓ Aktiviteteve ndërgegjësuëse dhe vetëdijësuëse mbi barazinë gjinore për grupin e grave deputete janë organizuar nga komuna e Gjilanit, Vushtrrisë, Malishevës dhe Skënderajit;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes: Gjatë vitit 2022, janë mbajtur 25 takime me qytetarë, OJQ, zyrtarë komunal në të gjitha komunat, me qëllim të inkurajimit dhe informimit të grave dhe vajzave të reja si dhe komuniteteve, për tu bërë pjesë e FSK;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes: Janë realizuar shtatë (7) takime me komandantët e Regjimenteve dhe Njërive të FSK, lidhur me funksionimin e rrjetit për Të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në FSK;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes organizoi një trajnim për kadetët lidhur me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore përfshi buxhetimin gjinor dhe integrimin e perspektivës gjinore e Qendrës për Studime universitare;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes në kuadër të Programit të Qendrës për Studime Bazike (QSB) në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) ofron ligjëрата për Trajnimin Bazik për Komponentin aktiv dhe rezervë, ndërsa Shkolla e Nën Oficerëve në tri programet zhvillimore për nënoficerët e FSK, realizon orë mësimore për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe ngacmimin seksual;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka realizuar shtatë takime me komandantët e Regjimenteve dhe Njërive të FSK, lidhur me funksionimin e rrjetit për Të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në FSK;
- ✓ Komuna e Mitrovicës ka organizuar një debat publik për përfaqësimin e grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit në vitin 2022;
- ✓ OSBE, me buxhet prej 4,000 Eurosh, organizoi një aktivitet më 23-25 mars 2022 për të forcuar lidërsnipin dhe pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë, në kuadër të zbatimit të Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria në Kosovë. Aktiviteti përfshiu 14 pjesëmarrës, ndër ta 10 gra dhe 4 burra;

2023 dhe 2024

- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka realizuar dhe dorëzuar tek SP Analiza lidhur me përfaqësimin e Grave dhe Vajzave në Pozita Vendimmarrëse në Ministrinë e Mbrojtjes;
- ✓ Janë realizuar pesë takime në kazermat e FSK –së me qëllim të identifikimit të sfidave dhe vështirësive të grave/vajzave në uniformë dhe adresimi i tyre;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes: Janë mbajtur trajnime për pjesëtarët e FSK-së në të gjitha kazermat, ku i është prezantuar pakjoja Ligjore për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;
- ✓ Ministria e Drejtësisë në kurrikulën për trajnim profesional për zyrtaret Korrektues është edhe moduli për legjislacionin vendor ku përfshihet edhe LBGJ;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes: Programi i Qendrës për Stërvitje Bazike, ofron Ligjërata në trajnimin Bazik për komponentin aktiv dhe rezervë me temën – Parandalimi i ngacmimit Seksual në Ushtri. Me përditësimin e Modulit (që bëhet në çdo 2 vite);
- ✓ NJDNJ, ka rekomanduar që të futet edhe perspektiva gjinore në përputhje me LBGJ-në dhe praktikën ndërkombëtare;
- ✓ Ministria e Drejtësisë pranoi 50 Zyrtare Korrektuese në fillimin e vitit 2023;
- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka filluar mbajtjen e takimeve për hulumtim lidhur me pozitën e grave në Forcën e Sigurisë së Kosovës;

ORGANIZATAT E TJERA

Organizatave tjera 2020 dhe 2021

- ✓ UN WOMEN në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka lansuar Doracakun mbi shërbimet policore me ndjeshmëri gjinore për rastet kur vajzat dhe gratë i nënshtrohen dhunës;
- ✓ Janë publikuar disa raporte për situatën e grave të burgosura në shërbimin korrektues: raportet vjetore nga QKRMT 2020 dhe 2021; raporti i Këshillit të Sigurisë 2020/21; raporti i CPT për vitin 2020; raporti për të drejtat e njeriut për Kosovë për vitin 2020 dhe 2021 nga SHBA; dhe raporti nga Bashkimi Evropian/Programi për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST) Janar-Mars 2022 qasja në drejtësi nga gratë e burgosura;

- ✓ Rreth 40 gra të burgosura kanë ndjekur trajnime në menaxhimin e zemërimit, shkathtësi për vendin e punës, trajnim për mënyrën e të menduarit dhe reagimin në situatë të vështira, etj;
- ✓ UN Women në vitin 2021 ka organizuar trajnim për 40 oficerë të Policisë së Kosovës për Reagimet Efektive të Policisë ndaj dhunës me bazë gjinore;
- ✓ UN WOMEN së bashku me Policinë e Kosovës prezantuan “Doracakun mbi Shërbimet Policore të Përgjegjshme ndaj Gjinisë për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës”;
- ✓ UN Women ka mbështetur studimin 2021 “Perceptimet publike për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj Grave në Kosovë”;
- ✓ Studimi i mbështetur nga UN WOMEN mbi Dhunën ndaj Grave në Politikë;
- ✓ RrGK ka organizuar tri takime me Lobin për Barazi Gjinore i cili përbëhet nga asambleiste komunale, zyrtare për barazi gjinore, përfaqësuese të partive politike;
- ✓ RrGK ka realizuar 2 fushata për zgjedhjet lokal dhe qendrore;
- ✓ RrGK kanë organizuar 11 diskutime publike me 130 vajza nga nëntë komuna të ndryshme, si përfshirje lidhur me lansimin e raportit “Një ulëse në tryezë”;
- ✓ UNDP ka mbështetur realizimin e raportit Understanding the Misuse of Firearms in Domestic Violence in South East Europe/ Analiza e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje në Evropën Juglindore, në të cilin studim është përfshirë edhe Kosova.

2022

- ✓ NDI ka trajnuar 120 burra dhe gra nga partitë politike, shoqëria civile, media dhe akademia për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike; 12 udhëheqëse gra në politikë janë trajnuar;
- ✓ Organizata “Gratë për Gratë” ka realizuar sesione informuese për 112 gra për të trajtuar temën e dhunës ndaj grave dhe vajzave, prej të cilave janë përzgjedhur 24 Agjentë të Ndryshimit kanë përfunduar trajnimin e avancuar të udhëhequr nga një ekspert në fushën e VAËG. Ato gjithashtu janë aktivizuar brenda komuniteteve të tyre si aktiviste kundër dhunës duke bërë aktivitete të ndryshme përfshirë shpërndarjen e fletushkave informuese në rrugë, organizimin e bisedave me anëtarët e familjes dhe në shkolla, dhe lehtësimin e diskutimeve me gratë nga komunitetet e tyre;

- ✓ Organizata "Gratë për Gratë" 30 gra nga Mitrovica (nga 10 Shqiptare, Serbe dhe komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptas) kanë marrë pjesë në debate publike lidhur me përfaqësimin e grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit;
- ✓ UN Women ofroi certifikim për 64 të mbijetuar të DhF/DHBGJ për aftësitë bazë të rrobaqepësisë dhe 50 të përfunduara trajnime mbi ndërmarrësinë dhe aftësitë sociale, pas përfundimit të kursit intensiv të trajnimit profesional të mbajtur nga partneri RrGK me qëllim përgatitjen e tyre për punë, dhe rritjen e mundësive për t'u bërë ekonomikisht të pavarur. Të 114 gratë e trajnuara janë të regjistruara në Zyrën e Punësimit, të gatshme për të hyrë në tregun e punës, 50 prej të cilave u pajisën me plane biznesi individuale. Po ashtu, 30 grave iu ofrua asistencë fillestare për fillimin e biznesit dhe 7 gra u punësuan;
- ✓ UN Women mbështeti realizimin e analizave gjinore në 16 komuna;
- ✓ UNDP realizoi fushata e ndërgjegjësimit për 16 ditët e aktivizmit: Ngjarja: 'Shënimi i përfundimit të Projektit të Asistencës Humanitare në Kosovë'; 'ORANGE HACKATHON: ECSHlire 2.0. Zgjidhjet dixhitale kundër dhunës me bazë gjinore; Seanca e ndërgjegjësimit mbi GBV në shkollën e mesme Suhareka; Panel diskutim mbi "Qëndro për pronën time" në Suharekë; Mini-parada e heshtur #UNITE! në Suharekë Ndriçimi në portokalli të Urës së Suharekës së bashku me autoritetet lokale; Tryezë e Rrumbullakët me temën 'Mbrotja online dhe offline kundër GBV-së përmes Digitalit' 16 ditë ligjëratë në shkolla në Prishtinë 'Dhuna online me bazë gjinore dhe ngacmimin kibernetik' 16 ditë përfundim me 'Orange Walk: me ombrella portokalli';
- ✓ OSBE, me buxhet prej 1,889 Eurosh, organizoi më 23 dhe 25 nëntor 2021 dy trajnime për Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës (AWKP) për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë praktike në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Trajnimet synuan të forcojnë rolin e grave në PK për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të trafikimit. Në aktivitet morën pjesë 50 persona (45 gra dhe 5 burra), të cilët fituan aftësi praktike për identifikimin e viktimave, një hap i rëndësishëm në luftimin e këtij krimi;
- ✓ OSBE, gjatë vitit 2022, mbështeti zhvillimin e aftësive lidërsipi dhe inteligjencës emocionale të oficerët e policisë, për të përmirësuar ndikimin e tyre në kulturën organizative me praktika bashkëkohore. Trajnimi përfshiu 11 pjesëmarrës, prej tyre 8 gra, 3 burra dhe 2 nga komunitetet joshumicë;
- ✓ OSBE, me buxhet prej 7,862 Eurosh në nëntor 2022, organizoi një aktivitet me mbi 100 zyrtarë të sigurisë publike, studiues dhe akademikë për të diskutuar ndikimin e pandemisë COVID-19 mbi integritetin e policisë, masat ligjzbatuese dhe rritjen e dhunës në familje ndaj grave dhe vajzave. U theksua roli i grave në polici dhe sfidat në mbrotjen e viktimave. Pjesëmarrësit përfshinin 35 gra, 65 burra dhe 15 nga komunitetet joshumicë;
- ✓ OSBE, me buxhet prej 1,800 Eurosh (prill-qershor 2022), prodhoi 5,000 karta xhepi për Seksionin e Dhunës në Familje të Policisë së Kosovës (PK), me udhëzime hap pas hapi bazuar në Procedurat Standarde të Operimit (SOP) të miratuara rishtazi për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;

- ✓ OSBE, me buxhet prej 10,900 Eurosh (dhjetor 2022), mbështeti Policinë e Kosovës (PK) për përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe operative në raportimin e rasteve të dhunës në familje (DV) për të dënuarit me probacion. Kjo përfshinte dhënien e 15 laptopëve (dy për secilin prej shtatë rajoneve të PK-së dhe një për nivelin qendror) dhe organizimin e një tavoline diskutimi për oficerët e PK-së mbi sfidat dhe praktikën më të mira në raportimin e shkelësve të DV gjatë periudhës së probacionit. Në aktivitet morën pjesë 21 persona, përfshirë 13 gra dhe 8 burra;
- ✓ OSBE mbështeti Policinë e Kosovës (PK) në lansimin e Agjendës për Barazi Gjinore (GEA) për Policinë dhe Planit të Veprimit 2021-2023. GEA synon përmirësimin e zhvillimit të karrierës dhe pozicionit të grave në të gjitha nivelet e PK-së, duke u përputhur me Ligjin për Barazi Gjinore, Rezolutën e OKB-së 1325 dhe Agjendën 2030 të OKB-së. Aktiviteti i lansimit pati 30 pjesëmarrës (14 burra, 16 gra), përfshirë menaxherët e lartë të PK-së dhe mysafirët vendorë dhe ndërkombëtarë. Misioni do të vazhdojë të mbështesë zbatimin e GEA-së, duke u fokusuar në barazi, diversitet dhe të drejtat e njeriut brenda PK-së;
- ✓ OSBE mbështeti Policinë e Kosovës dhe Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës (AWKP) në organizimin e Takimit Vjetor të Bordit të Parë të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave në Polici (IAWP) nga 7 deri më 10 mars 2020 në Prishtinë. Aktiviteti mbledhi rreth 30 anëtarë të IAWP nga e gjithë bota dhe mbi 150 zyrtarë të lartë të rendit në Kosovë për të ndarë ekspertizën dhe për të përmirësuar rolin e grave në polici.

2023 / 2024

- ✓ OSBE në vitin 2023 ka organizuar trajnim për 20 oficerë të Police se Kosoves nga të tetë regionet dhe Shtabi i PK-së dhe dy staf të IPK-së do të certifikohen si trajnerë të vlerësimit të rrezikut të Dhunes ne Familje. Është mbajtur punëtori informuese për 50 oficerë policie mbi vlerësimin e rrezikut të DhF dhe punëtori për të drejtat e grave, qasje në drejtësi dhe siguri: 104 zyrtarë të rinj të PK-së, përfaqësues nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale dhe Policia e Kosovës. Në shënjestër ishin 47 përfaqësues të PK-së, prokurorët për dhunë në familje, Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale, organizatat joqeveritare të grave dhe strehimoret e dhunës në familje; OSBE: ka zhvilluar Udhëzuesin për performancën efektive të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje;
- ✓ NDI: Program trajnimi me tre module për asistentët personalë të deputetëve të parlamentit. Moduli i parë u fokusua në "Hartimi dhe analiza e buxhetimit gjithëpërfshirës dhe me sens gjinor". Moduli dy fokusohet në "Buxhetimi i ndjeshëm gjinor" dhe moduli i tretë në "komunikim efektiv dhe gjithëpërfshirës";

- ✓ NDI realizoi Programin e Mentorimit të Lidershipit , programi përfshin përmbajtje trajnimi që synon të mbyllë boshllëkun e njohurive rreth pjesëmarrjes politike të grave përmes seancave të ndërtimit të aftësive personalisht, serive motivuese të folësve dhe mentorimit që çifton gratë në ose të gatshme për të hyrë në politikë me gra mentore;
- ✓ NDI organizoi 10 dialogje lokale për ti bë qytete më gjithëpërfshirëse;
- ✓ OSBE ka organizuar 5 punëtori rajonale trajnuese për komunikimin me publikun për gratë zyrtare komunale. U organizua punëtori dyditore me 20 drejtorë komunalë të cilët mësuhan për konceptet teorike të qeverisjes së përgjegjshme gjinore dhe shembuj praktik/krahasues të praktikave të mira. Peë kryetarë të komunave morën pjesë në një udhëtim studimor në qytetin e Grazit, Austri, duke sjellë praktika të mira në promovimin komunal të barazisë gjinore nga shembulli i qytetit;
- ✓ OSBE mbajti takim për ngritjen e një platforme për ndërtimin e konsensusit më të gjerë politik dhe eksplorimin e modaliteteve për vendosjen e bashkëpunimit të strukturuar për avancimin e pozitës së gruas në Kuvendin e Kosovës nëpër nivele të ndryshme të qeverisjes dhe në jetën publike në përgjithësi. Po ashtu OSBE organizoi tryezë e rrumbullakët me përfaqësuesit e qeverisë dhe të nivelit vendor për të diskutuar proceset gjithëpërfshirëse legjislative dhe përfaqësuese dhe mbështeti pjesëmarrjen e tri grave deputete të Kuvendit të Kosovës në një konferencë rajonale të organizuar nga Misioni i OSBE-së në Shkup nën kujdesin e Kryesisë së OSBE-së të Maqedonisë së Veriut;
- ✓ Përmes Programit EmPower, komisionet kryesuese të grave u angazhuan si mentore për gratë aktive në politikën lokale në mbarë Kosovën;
- ✓ U mbajt një panel i nivelit të lartë i titulluar “Përkrahja e Rolit të Kuvendit të Kosovës në Monitorimin e Konventës së Stambollit përmes fuqizimit të mekanizmave të saj të koordinimit të brendshëm dhe të jashtëm” u organizua në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”;
- ✓ NDI organizoi Platformën e dialogut Java e Grave, më shumë se 120 pjesëmarrës ishin pjesë e grupit të Javës së Grave 2023 dhe përr të rritur vetëdijësimin lidhur me dhunën ndaj grave në politikë NDI organizoi pesë episodet e programit “ Prijme”;
- ✓ OSBE organizoi punëtori për rishikimin vjetor të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shoqatës së Grave në Policinë e Kosovës (ASHKP) 2022-2024 dhe mbajti trajnim për teknikat e intervistimit të të miturve – qasja ndaj të miturve;
- ✓ NDI mbështeteti për Konferencën Rajonale të Grupit të Grave për Parlamentarizëm dhe Rezolutën 1325 nga Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo ngjarje e rëndësishme synonte të eksploronte rolin e parlamenteve në avancimin e agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë (WPS) në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë në zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

